

ENVER HOXHA

VEPRA

27

PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT
QENDROR TË PARTISE SE PUNES TË
SHQIPERISE



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

VELLIMI

27

QERSHOR 1964 - TETOR 1964

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1978

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 27-TË

Veprave të shokut Enver Hoxha po u shtohet edhe një vëllim tjetër, vëllimi i 27-të, që përfshin dokumente të periudhës qershor - tetor 1964, shumica e të cilave botohen për herë të parë.

Problematika e këtij vëllimi është e shumëllojshme. Temat që shtjellohen, militojnë jo vetëm kur janë shkruar, por edhe sot. Duke mbajtur vulën e kohës, njëkohësisht ato kanë edhe një tingull të theksuar aktual. Mbi të gjitha vëllimi ka një përmbajtje të thellë politiko-ideologjike. Ai përshkohet fund e krye nga partishmëria proletare, nga një frymë e lartë revolucionare.

Një nga çështjet kapitale që mishërohet në faqet e këtij vëllimi është forcimi dhe kalitja revolucionare e Partisë, rritja e rolit të saj udhëheqës në të gjithë jetën e vendit. Kjo çështje konsiderohet kushti kryesor për të zhvilluar pandërprerë revolucionin socialist në vendin tonë. Ideja e forcimit të mëtejshëm të Partisë dhe e rolit të saj udhëheqës pasqyrohet në shumë materiale, por veçanërisht në disa prej tyre, si «Komunisti është i pari në sulm dhe i fundit në tërheqje», «Udhëheqja e Partisë në rreth t'i përgjigjet nivelit të kuadrove — ndihma e saj të jetë sa më efektive», «Je-

tën e Partisë ta shohim në dinamizmin e saj» etj. Në këtë fjalime e diskutime shtrohen detyra të rëndësishme për zbatimin e parimeve dhe të normave të Partisë, për forcimin e unitetit të radhëve të saj, për përmirësimin e metodës së punës të organeve udhëheqëse, për gjallërimin e organizatave-bazë të Partisë, sidomos në fshat, për rritjen e shembullit pararojë të komunistëve, për forcimin e organizatave të masave etj.

Forcimin e Partisë dhe rritjen e rolit udhëheqës të saj, KQ i PPSH nuk i ka ndarë asnjëherë nga kalitja ideologjike e komunistëve, ashtu si këtë të fundit e ka parë kurdoherë të lidhur ngushtë me edukimin e gjithë punonjësve. Duke e vlerësuar edukimin si një problem kyç, shoku Enver Hoxha, në fjalën e vet mbajtur para Plenumit të 13-të të KQ të PPSH, theksonte: «Po e mbajtëm mirë në dorë këtë kyç, po e mbajtëm të ndritur dhe të pastër, s'ka derë që të mos çelim; po e lamë të ndryshket, dyert mbeten mbyllur». Pikërisht për këtë në dokumentet e këtij vëllimi spikatin detyra të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmbajtjen, larminë e formave, metodat e stilit e punës edukuese, organizuese e drejtuese të Partisë. Këto duken qartë në fjalimet dhe në diskutimet që botohen në vëllim, si «Edukimi i punonjësve me moralin komunist është problem kyç», «Edukimi duhet bërë në mënyrë të gjithanshme e të vazhdueshme dhe jo me fushata», «T'i bëjmë studentët të ndërgjegjshëm përse mësojnë dhe si të mësojnë», «Mësimet e Partisë mbështeten në teorinë dhe në praktikën revolucionare», «Në kushtet e sotme ka mundësi të zhvillohet një punë më e mirë shkencore» etj.

Duke vazhduar luftën për zbatimin e detyrave të mëdha në frontin ekonomik të ndërtimit socialist të vendit, PPSH kishte fituar një përvojë të pasur. Në të njëjtën kohë, ajo kritikonte me guxim dobësitë e të metat në punë, kundër të cilave zhvillonte një luftë këmbëngulëse. Në këtë vëllim bëhet një përgjithësim shkencor i luftës së madhe që zhvillonte populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, për realizimin e planit të shtetit, sidomos në bujqësi, në industri e në sektorë të tjerë, evidentohen arritjet, vështirësitë dhe çelen perspektiva të gjera pune. Detyra konkrete përcaktohen veçanërisht në dokumentet: «Socializmi bazohet në punën e përbashkët», «Zgjerimi i njohurive bujqësore ndihmon shumë për rritjen e prodhimit», «Skuadrat e rendimentit të lartë t'i shërbejnë ngritjes së mëtejshme të bujqësisë në përgjithësi», «Administrimi i mirë i drithit ka rëndësi të madhe», «Kuadrot e mesëm janë mbështetja e kuadrit të lartë» etj.

Në këtë vëllim i bëhet një analizë e thellë marksiste-leniniste gjendjes ndërkombëtare. Në dokumentet e tij pasqyrohen qartë vija e drejtë e PPSH, lufta e saj e vendosur e parimore në dy fronte: kundër imperializmit, me atë amerikan në krye, dhe kundër revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye. Në mënyrë të veçantë demaskohen revizionistët e ngjyrave të ndryshme, të cilët kishin rënë në gjunjë para imperializmit amerikan dhe shtrohet detyra që në këtë luftë të mos ketë disfatistë, liberalë, të lëkundshëm, frikacakë, revizionistë të maskuar e të tjerë të këtij kallëpi, por kundër armikut të zhvillohet një luftë frontale dhe parti-

zane, legale dhe ilegale, politiko-ideologjike, ekonomike dhe, po të jetë nevoja, edhe me armë.

Një tablo e qartë e luftës së papërkulur revolucionare që bënte PPSH për të mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe atdheun tonë socialist jepet në dokumentet: «Të mbrojmë të sotmen që të sigurojmë të nesërmen», «Të jemi të përgatitur për të përballuar çdo agresion të mundshëm armik», «Kur populli zbaton një vijë të drejtë, s'ka forcë që e lëkund dhe e mposht», «Partia jonë ecën sypatrembur nëpër valët e stuhitë e kohës dhe fiton», «Marksizëm-leninizmi i bën njerëzit të kenë kokë të kthjellët dhe zemër të fortë», «Të sqarojmë të lëkundurit, të luftojmë kundër atyre që janë të vendosur në rrugën e tradhtisë», «Të gjithë marksistë-leninistët duhet të zhveshin shpatën kundër revizionizmit modern», «Revizionizmi merr forma të ndryshme, të luftojmë me vendosmëri kundër tyre», «Të jemi vazhdimisht në sulm kundër revizionizmit» etj.

Vëllimi i 27-të i Veprave të shokut Enver Hoxha është një armë e shëndoshë në duart e komunistëve dhe të të gjithë punonjësve tanë. Ky vëllim na frymëzon dhe na ndriçon rrugën për të punuar e për të luftuar kurdoherë si revolucionarë, për lumturinë e popullit tonë, për begatinë e atdheut, Shqipërisë socialiste.

TE MBROJMË TË SOTMEN QË TË SIGUROJMË TË NESËRMEN

*Shënime rreth veprimtarisë antimarksiste të grupit
të Hrushovit*

[Qershor] 1964

Grupi revizionist sovjetik, me në krye Hrushovin, është bërë i rrezikshëm për Bashkimin Sovjetik, për socializmin, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për çështjen e paqes botërore. Ai është edhe më i rrezikshëm nga çdo grup tjetër revizionist, sepse ndodhet në krye të BS dhe të PK të BS, fshihet pas prestigjit dhe autoritetit të tyre të madh dhe ka në dorë mjete të fuqishme materiale dhe propagandistike.

Ky grup filloi veprimtarinë e hapët pas vdekjes së Stalinit dhe shkoi duke e intensifikuar edhe veprimtarinë e tij të fshehtë, në mënyrë intrigante, të mbuluar me demagogji deri në Kongresin e 20-të të PK të BS. Që nga ky kongres ai doli më hapur, veproi më lirisht dhe më me guxim, derisa arriti në kohën e sotme, kur veprimtaria e tij antimarksiste është zbuluar pothuajse krejtësisht. Grupi i Hrushovit vazhdon të veprojë

hapur, pa përfillur kërkënd, pa përfillur teorinë marksiste-leniniste, normat leniniste dhe një nga një po flak edhe maskat. Qëllimi i fundit i grupit revizionist të Hrushovit është shkatërrimi i kampit të socializmit, degjenerimi i tij, degjenerimi i doktrinës marksiste-leniniste dhe restaurimi i kapitalizmit në vendet socialiste. Siç duket qartë, ky është një plan i madh që po vë në zbatim grupi i Moskës. Mirëpo për realizimin e këtij plani kundërrevolucionar, grupi i Hrushovit ka gjetur dhe do të gjejë pengesa shumë serioze. Ai e di këtë, dhe po e sheh se si ndeshet me botën komuniste, me klasën punëtore ndërkombëtare, me të gjitha masat përparimtare dhe popujt e botës.

Në synimet e tij armiqësore grupi i Hrushovit ka aleatë imperialistët dhe, në radhë të parë, imperializmin amerikan, ka kapitalistët e botës, forcat kundërrevolucionare dhe gjithë revizionistët modernë e, në radhë të parë, revizionistët jugosllavë.

Para së gjithash, grupi tradhtar i Hrushovit lufton të sigurojë prapavijat e tij në Bashkimin Sovjetik, domethënë të krijojë mbështetjen kryesore kombëtare për të përforcuar veprimet ndërkombëtare. Kësaj veprimtarie ai i është futur me ethe. Në fillim Hrushovi eliminoi me intriga, me shpifje e me kurthe të përgatitura elementin marksist-leninist të shëndoshë të udhëheqjes sovjetike dhe filloi një fushatë të madhe diskriminuese kundër tyre. Ai propagandoi me marifet se «ndërtimi i socializmit në Bashkimin Sovjetik kishte mbetur prapa» dhe vuri në dukje sidomos të ashtuquajturat vështirësi të mëdha në bujqësinë sovjetike. Gjatë kësaj fushate propaganda e grupit revizionist ngriti në

qiell të ashtuquajturat talente gjeniale të Hrushovit në bujqësi, e paraqiti këtë si mjeshtrin e madh që «do të shëronte» bujqësinë sovjetike, do të krijonte bollëkun, do t'ia kalonte SHBA-së, tregu do të mbushej me mish dhe qumshti do të rridhte si lumë. Këto ai i ka thënë vetë në fjalimet e tij prej sharlatani. Pra, faji për këtë prapambetje, sipas këtij grupi tradhtar, binte mbi Stalinit, mbi udhëheqësit e tjerë, të cilët, sipas grupit të Hrushovit, «s'kishin haber as nga drejtimi i bujqësisë as i industrisë dhe as i ekonomisë në përgjithësi».

Çështja tjetër që propagandonte grupi trockist i Hrushovit, ishte «çlirimi i partisë» nga «sektarizmi stalinian», «lidhja e gjerë» me masat nga ana e Hrushovit, i cili, «për ta vërtetuar» këtë, organizon shëtitje nëpër kolkoze e ferma në vendet e ish-demokracisë popullore e në vendet kapitaliste, takime në ambasada të ndryshme në Moskë për të dhënë përshtypjen se ky farë burri nuk ndien lodhje, është një fenomen i gjuhës, i udhëtimeve, i politikës, i ideologjisë e i çfarëdo gjëje. Nga ana tjetër, propaganda hrushoviane s'mungonte të vinte në dukje që Stalini s'dinte ç'bëhej në Bashkimin Sovjetik, pa le në botë, se ai «rrinte» në Kremlin, «shikonte filma e pinte vodka» e të tjera shpifje të tilla.

Qëllimi i grupit tradhtar, që filloi luftën gjoja parimore kundër kultit të Stalinit, ishte gjetiu, të ngrinte kultin e Hrushovit, ku do të bazoheshin të gjitha veprimtaritë antiparti dhe antimarksiste të këtij grupi revizionist, të errësonte veprën gjeniale të Leninit, të Stalinit dhe të bolshevikëve, të diskreditonte Bashkimin Sovjetik nëpërmjet shpifjeve kundër Stalinit dhe

të paraqiste ardhjen e këtij grupi tradhtarësh në fuqi si «një eveniment historik me karakter ndërkombëtar», si një epokë të re, «epokën e ndërtimit të komunizmit». Prandaj, ky grup, duke menduar se ia kishte arritur qëllimit, në Kongresin e 20-të të PK të BS, u dha ideve të tij revizioniste dorën e fundit, u vuri vulën në dy drejtime kryesore: shkurorëzimin e leninizmit dhe frenimin e revolucionit në botë.

Ne akuzohemi nga Hrushovi si luftënxitës, sikur gjoja dëshirojmë dhe luftojmë të hedhim në zjarrin e luftës atomike Bashkimin Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe ne, shqiptarët, të bëjmë sehir e të hamë gështenjat që na i nxjerrin të tjerët nga zjarrri. Gati sa nuk na akuzojnë se luftojmë për të sunduar botën, dhe të vendosim hegjemoninë botërore shqiptare!

Po pse grupi i Hrushovit ka arritur deri në absurditete të tilla? Kjo është e qartë për të gjithë. Ata kanë humbur çdo masë, çdo gjykim, sepse PPSH u zbuloi tradhtinë dhe lufton pa u përkulur kundër kësaj tradhtie që iu bë socializmit dhe paqes botërore në favor të imperializmit dhe të luftës atomike.

Lufta parimore marksiste-leniniste e PPSH nuk nxit luftën atomike, por synon për ta penguar këtë luftë. Mund të thuash shumë fjalë për paqen sa për të gënjyer naivët, dhe t'i bësh lëshime vdekjeprurëse imperializmit. Kjo e shpejton luftën dhe nuk e pengon. Popujt dhe marksistë-leninistët nuk u janë nënshtruar as në të kaluarën dhe nuk do t'u nënshtrohen as në të ardhmen imperializmit dhe kapitalizmit.

Grupi i Hrushovit, me politikën e tij tradhtarë,

përpiqet të gënjejë popujt dhe komunistët, me njëfarë arritje të «uljes së tensionit», që, në fund të fundit, është provizore dhe përgatitore për ndërmarrje më të egra nga ana e imperializmit kundër komunizmit, vendeve socialiste dhe popujve të botës. Politika e grupit tradhtar të Hrushovit synon që njerëzit dhe popujt të preokupohen për njëfarë kompromisi, bile dhe të turpshëm, momentan, dhe të mos gjykojnë për rrjedhimet katastrofike të së nesërme.

Partia jonë lufton për të mbrojtur të sotmen që të sigurojë të nesërmen. Duhet të jemi vigjilentë sot që të mos vuajmë nesër. E sotmja e fituar, duhet të ruhet fort që të fitohet e nesërmja.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

NE GJITHIMONË E KEMI PARË ARTIN SI ARMË TË EFEKTSHME PËR EDUKIMIN E MASAVE

Nga biseda me delegacionin e dramaturgëve kinezë

5 qershor 1964

Në fillim u shkëmbyen përshëndetjet e rastit, pastaj shoku Enver Hoxha i pyeti miqtë se si ishin me shëndet, zhvilloi me ta një bisedë të ngrohtë dhe midis të tjerash tha:

Ju arritët në një kohë kur te ne po zhvillohet olimpiada teatrale, kështu, ju keni pasur mundësinë të bisedoni me shumë amatorë dhe artistë profesionistë, të njiheni me rrugën e teatrit tonë.

Ne themi se sukseset duhet t'i matim edhe me të kaluarën dhe, pa u vetëkënaqur, të ecim përpara me perspektivë të qartë. Kështu edhe përparimet e teatrit tonë duhet t'i shikojmë në krahasim me të kaluarën, kur në Shqipëri, mund të themi, se ai nuk ekzistonte fare. Teatri ynë është i ri, ai është vepër e Partisë dhe e Revolucionit tonë Popullor, prandaj, kur e matim me të kaluarën, themi se kemi bërë diçka, s'kemi ecur

keq. Por, njëkohësisht, duke parë rëndësinë e madhe të tij për perspektivën, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit, për edukimin politik dhe ideologjik të masave, themi që ne kemi akoma shumë e shumë për të bërë.

Zhvillimin e kulturës dhe të artit në përgjithësi e të teatrit në veçanti Partia jonë e ka konsideruar si një çështje mjaft të rëndësishme. Ne duhej ta krijojmë atë në një vend që nuk kishte tradita të shumta në këtë fushë. Kjo kishte anën e keqe, por edhe anën e saj të mirë. Mosekzistenca e një teatri të organizuar borgjez ose feudal në vend ishte një gjë e mirë, sepse qenia e tij mund të na kishte dëmtuar, por, nga ana tjetër, kjo kishte edhe anën e saj të keqe, se ne nuk kishim tradita dhe përvojë në këtë drejtim. Në këto kushte Partia jonë vuri detyrën që jo vetëm të krijohej teatri, por që ky të kishte edhe një frymë të re, të përshkohej nga partishmëria e thellë proletare, nga përmbajtja e shëndoshë socialiste, ku të shfaqeshin virtytet e mira të popullit tonë. Teatri ynë i ri kishte si detyrë të forconte ndjenjën revolucionare të popullit dhe njëkohësisht t'i hapte atij perspektivën, të bëhej një përçues i vijës së Partisë në masat, një tribunë nga do të luftoheshin si mbeturinat mikroborgjeze të trashëguara nga e kaluara, ashtu dhe influencat e huaja të artit dekadent, që nëpërmjet radios e revistave mund të reflektoheshin në zhvillimin e kulturës së popullit, dhe veçanërisht tek artistët tanë.

E kaluara e lavdishme e popullit tonë ka qenë dhe mbetet një thesar i madh për Partinë. Ne do të bënim gabim po të shkëputeshim nga ky thesar, ku përmbli-

dhen ato ideale, ndodhi e zakone, ato tradita e virtyte të mrekullueshme, të cilat, në kompleksin e tyre, e kanë bërë popullin tonë t'u qëndronte në shekuj rrebesheve të huaja. Prandaj jemi përpjekur që edhe në pjesët tona teatrale të mbështetemi në ngjarjet heroike si dhe në zakonet, në aktet morale e shoqërore që kanë luajtur rol përparimtar në të kaluarën. Ka nga ato zakone që për kohën e solme mund të jenë prapanike, por që në të kaluarën i kanë shërbyer popullit për të ruajtur ekzistencën e tij, për të forcuar unitetin ndaj armiqve të huaj, për t'u bërë ballë vështirësive e rreziqeve që i vinin nga të gjitha anët. Për një zakon të tillë flet edhe drama «Besa» e patriotit Sami Frashëri. Ajo është një dramë, ngjarjet e së cilës zhvillohen në fshat. Tema kryesore e saj është hakmarrja: populli hakmerret kundër beut, sepse beu me njerëzit e tij kishin bërë krime ndaj njerëzve të pafajshëm. Ngjarja, me pak fjalë, zhvillohet kështu: Një burrë, që po kthehej pas 20 vjetësh në shtëpinë e tij, takohet me një grua dhe mëson se asaj qehajai i beut i kishte vrarë të shoqin dhe i kishte rrëmbyer çupën. Burri, i prekur nga ato që dëgjoi, si dhe nga trimëria e asaj gruaje që kishte dalë vetë të hakmerrej ndaj vrasësit, i jep fjalën se do ta gjente e do ta vriste fajtorin. Mirëpo më vonë mori vesh se qehajai i beut, pra, ai që e kishte bërë këtë krim, ishte biri i tij, të cilin kishte 20 vjet pa e parë. Pavarësisht nga kjo, ai, meqë kishte dhënë besën, e mbajti fjalën dhe e vrau djalin.

Ky zakon në kohët e regjimeve antipopullore kishite rëndësinë e vet, sepse populli atëherë s'gjente askund drejtësi ligjore, askush s'e mbronte nderin, dinji-

tetin dhe jetën e tij, ndaj detyrohej të hakmerrej sipas parimit: «Po më vrave, të vras». Kurse sot, populli është në fuqi, ai ka vendosur ligjet e tij, gjykatësit janë njerëzit e popullit dhe të zgjedhur nga populli. Partia dhe shteti i mbrojnë me zjarr të drejtat e qytetarëve dhe i japin dënimin e merituar kujtdo që përpiket të shkelë ligjet. Kuptohet se zakoni i vjetër i hakmarrjes s'ka e s'mund të ketë kuptim në shtetin tonë të demokracisë popullore. Ndaj Partia, që në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke e bashkuar popullin rreth idealeve të saj të larta, duke luftuar për mbrojtjen e interesave të tij, e goditi këtë zakon dhe i vëllazëroi njerëzit. Tani te ne ky zakon është zhdukur. Megjithatë, këtë dramë ne ia japim popullit ta lexojë që të njohë të kaluarën e tij, por në skenë një vepër të tillë nuk e vëmë.

Natyrisht, përveç pjesëve që tregojnë mbi të kaluarën e ndritur, trimërinë dhe patriotizmin e popullit tonë në shekuj, një rëndësi e veçantë i është kushtuar e i kushtohet pasqyrimin në artin skenik të patriotizmit dhe të frymës revolucionare të popullit tonë në Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në periudhën e ndërtimit të socializmit.

Në skenat tona vihen edhe pjesë të huaja, me përmbajtje progresive e revolucionare. Nuk kemi harruar gjithashtu edhe veprat klasike, pasi nuk është e mundur të shkëputet kultura jonë socialiste nga veprat e bukura klasike, që ruajnë akoma aktualitetin e tyre.

Tani shkrimtarët dhe artistët tanë po përpiqen të krijojnë pjesë pak a shumë më të studiuara, me një përmbajtje ideoemocionale më të thellë, pse, dashje

pa dashje, në shkrimet e në rolet e tyre ka dhe gjëra të dobëta.

Preokupacioni i vazhdueshëm i Partisë sonë është përmbajtja e pjesës, që ajo të jetë revolucionare, me partishmëri të lartë, me tendenciozitet të theksuar klasor, me frymë edukative, patriotike dhe internacionaliste, në mënyrë që masat të shohin në të vijën e Partisë dhe jo vetëm ta kuptojnë, por edhe ta ndiejnë thellë dhe ta zbatojnë këtë vijë. Gjithashtu, ne duam që këto vepra të jenë të shkruara bukur, me nivel të lartë artistik, të interpretohen sa më mirë, që aktorët të edukohen dhe të edukojnë masat, që brendia dhe forma e veprës të bëjnë efekt sa më të mirë te spektatorët, të prekin ndjenjat e mendimet e tyre. Kështu teatri bëhet i popullit, shpreh ndjenjat e tij dhe pjesët interpretohen e përvetësohen mirë. Në këto drejtime ne nuk jemi pa të meta, por, me siguri, do t'i kapërcejmë, sepse populli ynë e do mjaft teatrin dhe Partia i ka krijuar të gjitha kushtet për zhvillimin e tij.

Një fitore tjetër që solli revolucioni ynë është pjesëmarrja e gruas si aktore në teatër. Gruaja, me ndjenjat e saj të holla, me shpirtin e gjerë, me aftësitë e saj të mëdha, e bën teatrin që të luajë më mirë rolin e tij edukues.

Partia jonë ka gati 23 vjet që është krijuar dhe po mbush 20 vjet që është në pushtet. Por, siç na mëson marksizëm-leninizmi dhe siç tregon jeta, ka parti që mund të jenë të reja në moshë, por që me pjekurinë e shpirtin e tyre revolucionar mund të transformojnë botën, kurse ka parti që mund të jenë të vjetra në moshë, por që prestigji e pushteti i tyre bien çdo ditë

e më poshtë. Kështu ndodhi me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, për shkak të tradhtisë së N.Hrushovit, klika e të cilit po i heq asaj shpirtin revolucionar e militant, po e zhvesh nga tiparet bolshevike. Revizionistët hrushovianë kanë arritur gjer atje sa t'u zgjasin dorën imperialistëve amerikanë.

Ne do të ecim përpara në të gjitha fushat. Askush nuk mund të na pengojë në rrugën tonë të drejtë marksiste-leniniste për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Revizionistët na vënë neve shumë epitete, si «nacionalistë», «shovinistë» etj., etj., kurse në të vërtetë ata janë nacionalistë dhe shovinistë të shtetit të madh. Ata thonë se kultura e tyre është më e mirë dhe se shpikjet vetëm ata i kanë bërë, prandaj të tjerët duhet të zvarriten pas tyre!

Revizionistët u ngjajnë imperialistëve. Çfarë nuk kanë bërë imperialistët? Ata jo vetëm që e kanë rrjepur popullin kinez, po janë përpjekur të errësojnë edhe kulturën e tij të madhe e përparimtare.

Ne e çmojmë teatrin tuaj. Teatri juaj është i dëgjuar jo vetëm se ndjek traditat e vjetra shekullore, po pse në të janë pasqyruar jeta dhe lufta heroike e popullit të madh kinez, zgjuarsia, zemërbardhësia e tij, shija e hollë, që shprehen në ritmet e valleve, në intonacionet e muzikës, në nuancat origjinale të teatrit, të operës etj.

Unë nuk di shumë për teatrin tuaj, por kam lexuar dhe kam dëgjuar për të. Imperialistët janë munduar ta përbuzin artin kinez. Kuptohet, ata kanë dashur ta bënë këtë sepse arti kinez paraqet jetën dhe luftën e një populli të madh, paraqet zotësinë dhe trimërinë e

popullit tuaj. E njëjta gjë duhet thënë edhe për Shqipërinë.

Populli shqiptar ka pasur merita edhe për të kaluarën, por për historinë e tij nga ana e fuqive imperialiste dhe e reaksionit ka pasur heshtje. Kur ishte puna për ta copëtuar Shqipërinë, të gjithë armiqtë tanë ishin gati. Kur vinte puna që të zbuloheshin çështja shqiptare, çdo gjë bllokohej prej qeverive reaksionare e gjithë armiqtë të popullit tonë. Për monumentet e vjetra që nxirreshin nga nëntoka jonë e që dëshmojnë për lashtësinë e këtij populli, për traditat e shquara të tij, armiqtë thoshin se janë vepra të popujve të vjetër grekë ose italianë. Për megalomaninë dhe synimet e tyre kolonialiste as që kishte ekzistuar ndonjëherë populli shqiptar. Mirëpo e vërteta mbetet e vërtetë. Tani studiuesit tanë dhe studiues të huaj të shquar, në veprat, studimet e në zbulimet e tyre sjellin fakte e argumente nga më interesantet, që vërtetojnë se ç'kulturë të lashtë, ç'art e ç'tradita të shkëlqyera ka krijuar populli ynë në thellësi të shekujve.

Me këtë doja të thosha se nuk errësohen dot lehtë puna dhe vepra e popujve, ca më pak mund të ndodhë kjo kur popujt udhëhiqen nga partitë marksiste-leniniste. Të gjitha të këqijat do të kapërcehen me luftë dhe me revolucion dhe jo me bashkekzistencën paqësore që propagandojnë revizionistët modernë. Ata, me siguri, do të dështojnë, sepse e kanë nxjerrë kokën në një kohë kur marksizëm-leninizmi është bërë flamur për të gjithë popujt, sepse hrushovizmi e titizmi nuk mund të vazhdojnë me gënjeshtër për një kohë të gjatë, sepse miliona e miliona njerëz luftojnë për revolu-

cionin kundër imperializmit e reaksionit. Dalja e revizionistëve modernë ndodh në kushte të atilla kur imperializmi dhe ideologjia e tij janë në kalbëzim, kurse revolucioni është në rritje. Popujt e botës dhe të gjitha forcat përparimtare e revolucionare kanë respekt të madh për partitë e vërteta marksiste-leniniste, sepse shikojnë që në këto momente, kur imperializmi dhe revizionizmi kërkojnë të shpërthejnë luftën e të sundojnë botën, ato qëndrojnë si fanar që ndrit rrugën drejt së ardhmes, drejt revolucionit.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

REVIZIONISTËT IRUSHOVIANË JANË PËR IZOLIMIN E POPUJVE TË AZISË E TË AFRIKËS

Nga artikulli i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

11 qershor 1964

Në fillim të prillit në Xhakartë u mbajt një mbledhje përgatitore për konferencën e dytë të Azisë dhe të Afrikës. Siç është bërë tanimë e njohur, mbledhja u kurorëzua me sukses dhe hapi perspektiva mjaft prem-tuese për suksese të tjera edhe më të mëdha në konfe-rencën e dytë, që do të mbahet në mars të vitit të ardh-shëm në një nga vendet afrikane.

Pjesëmarrësit e mbledhjes përgatitore në Xhakartë, të cilët përfaqësonin 22 shtete, u bënë një vlerësim shu-më pozitiv rezultateve të arritura që nga Konferenca e Bandungut, duke i konsideruar ato si një fitore të re për unitetin e popujve afro-aziatikë në luftën e tyre kundër imperializmit dhe kolonializmit të vjetër e të ri. Nën-kryetari i delegacionit indonezian në mbledhjen përga-titore për konferencën e dytë afrikano-aziatike, Ali Sas-troamixhoxho, në njërin nga fjalimet që mbajti në se-

sionet plenare të mbledhjes, theksoi se është e nevojshme të luftohet kundër kolonializmit e neokolonializmit dhe të kundërshtohet ndërhyrja e jashtme në vendet e Azisë dhe të Afrikës. «Konferenca e ardhshme afro-aziatike, tha ai, duhet t'u japë vendeve të Azisë dhe të Afrikës parimet drejtuese, në mënyrë që ato të mund të frymëzohen për të vazhduar luftën kundër kolonializmit dhe dallimit racial në të gjitha format dhe të konsolidojnë pavarësinë e tyre».

Rezultatet e punimeve të mbledhjes përgatitore për konferencën e dytë afro-aziatike u vlerësuan shumë jo vetëm nga mjaft personalitete të shquara shtetërore e shoqërore të vendeve të Azisë e të Afrikës, por ato u përshëndetën nga i gjithë shtypi përparimtar botëror, si një sukses që u arrit në saje të mirëkuptimit reciprok të vendeve të Azisë e të Afrikës dhe të unitetit të interesave të tyre rrënjësore, të cilat kërkojnë forcimin e pavarësisë së tyre kombëtare dhe të luftës kundër armikut të përbashkët, imperializmit dhe kolonializmit. Këto rezultate i përshëndet me gjithë zemër edhe populli shqiptar, i cili ushqen ndjenja të larta të simpatisë për popujt afro-aziatikë dhe për luftën e tyre të drejtë kundër imperializmit, për forcimin e pavarësisë nacionale.

Ishte e natyrshme që imperialistët dhe të gjitha forcat reaksionare, armike të njohura dhe të betuara kundrejt solidaritetit afrikano-aziatik, të bëjnë çmos dhe të luftojnë me të gjitha mjetet për ta bërë të pamundur mbledhjen e konferencës së dytë afro-aziatike dhe të mobilizojnë të gjitha forcat për ta bërë që ajo të mos ketë sukses. Janë të njohura përpjekjet e imperialistëve në këtë drejtim, që filluan me intrigat për sabotimin e

mbledhjes përgatitore dhe po vazhdojnë me shpifjet për të shtrembëruar qëllimet e saj, si dhe me kompletet për të penguar mbajtjen e konferencës. Për këtë nuk është nevoja të zgjatemi.

Por nuk mund të mos të të habitë fakti që tani kundër mbledhjes së Xhakartës dhe konferencës së dytë afro-aziatike kanë shpërthyer në sulm të tërbuar edhe revizionistët modernë, të kryesuar nga grupi i Hrushovit. Në artikullin e gazetës «Pravda» të 25 prillit me titull «Kujt i intereson izolimi i popujve të Azisë e të Afrikës?», në deklaratën e qeverisë sovjetike të 5 majit 1964, drejtuar qeverive të vendeve të Azisë e të Afrikës, si dhe në një numër të pafund artikujsh e deklaratah të ndryshme, botuar në shtypin sovjetik, udhëheqësit sovjetikë, në mënyrë arrogante, brutale e krejt të pahijshme, mundohen të sjellin «argumente» për të vërtetuar se gjoja mbledhja përgatitore ka shpënë në «izolim të popujve të Azisë e të Afrikës» dhe se një konferencë e dytë e vendeve afro-aziatike, si ajo e Bandungut, «do të dëmtojë unitetin e forcave që luftojnë kundër imperializmit». Në formë ultimatum ata kërkojnë, gjithashtu, që Bashkimi Sovjetik të marrë pjesë medoemos në këtë konferencë. Ata përpiqen, bile, ta heqin veten «të fyer» që mbledhja e Xhakartës nuk i ftoi për të marrë pjesë në të, si dhe në konferencën e ardhshme.

Duke u njohur me deklaratën e qeverisë sovjetike, si dhe me artikujt e shtypit sovjetik, nuk mund të mos vëresh se «argumentet» që sjellin ata për të imponuar pjesëmarrjen sovjetike në konferencën e ardhshme, janë fare absurde dhe pa asnjë bazë juridike:

Së pari, dihet se në Konferencën e parë të vendeve të Azisë e të Afrikës, që u mbajt dhjetë vjet më parë në Bandung të Indonezisë, Bashkimi Sovjetik nuk mori pjesë. Në atë kohë qeveria sovjetike këtë fakt e quajti një gjë të natyrshme, ajo nuk bëri asnjë vërejtje, nuk paraqiti asnjë kërkesë që të merrte pjesë, bile e përshëndeti konferencën dhe rezultatet e saj. Konferenca e dytë e vendeve afro-aziatike që do të mbahet në fillim të vitit të ardhshëm, është vazhdimi i Konferencës së parë të Bandungut. Duke ngritur çështjen e pjesëmarrjes së saj në konferencën e dytë të vendeve afro-aziatike, është e qartë se qeveria sovjetike kërkon të krijojë artificialisht një çështje të paqenë, një çështje që është zgjidhur përfundimisht nga vetë praktika.

Së dyti, qeveria sovjetike tani «u kujtua» se pjesëmarrja e saj në konferencën afro-aziatike rrjedhka nga fakti se Bashkimi Sovjetik shtrihet edhe në Azi. Por konferenca e shteteve afrikane e aziatike është konferencë e kryetarëve të qeverive dhe të shteteve të Afrikës dhe të Azisë. Nga e gjithë praktika ndërkombëtare qeveria sovjetike njihet dhe vepron si një qeveri evropiane. Dihet mirë se kriteret që përcaktojnë se kujt grupimi politik i përket një shtet territori i të cilit shtrihet në dy kontinente, nuk mbështeten në nocione formale gjeografike. Dihet se edhe Ballkani është një nocion gjeografik i caktuar. Bile shpesh organizohen edhe mbledhje të ndryshme të vendeve ballkanike. Po të ndiqet logjika e udhëheqësve sovjetikë, në këto mbledhje duhet të bëjë pjesë edhe Bashkimi Sovjetik, meqenëse një pjesë e territorit të tij, Moldavia, shtrihet në Ballkan. Po kështu ekziston edhe një nocion i qartë mbi vendet

nordike, por do të ishte larg mendsh, që, duke u nisur nga fakti se një pjesë e tokave të Bashkimit Sovjetik, si territori Karelofin, shtrihen në këtë zonë, Bashkimi Sovjetik të kërkojë të marrë pjesë në mbledhjet e shteteve nordike. Do të ishte njësoj sikur ne, meqë shumica e popullsisë së Shqipërisë është myslimane, të kërkonim që Shqipëria të marrë pjesë në mbledhjet e shteteve afro-aziatike, për arsye se një pjesë e madhe e këtyre vendeve kanë, gjithashtu, shumicën e popullsisë myslimane etj. Deri këtu mund të çojë logjika e udhëheqësve sovjetikë. Absurditeti i tyre nuk ka kufi, veçanërisht kur verbohen nga dëshira për të arritur qëllime jo të ndershme.

Përkatësia e një shteti në këtë ose në atë grupim është krijuar historikisht, si një e tërë e pandashme, e forcuar nga tradita dhe nga precedenca të ngritura në parime. Bashkimi Sovjetik është anëtar i OKB-së që nga themelimi i saj, por asnjëherë ai nuk është ftuar të marrë pjesë në grupin e vendeve afro-aziatike, dhe as vetë nuk e ka kërkuar ndonjëherë një gjë të tillë. Sigurisht, kjo nuk ka ndodhur pse vendet afro-aziatike anëtare të OKB-së nuk e dinin që një pjesë e territorit të Bashkimit Sovjetik ndodhet në Azi, as sepse udhëheqësit sovjetikë e patën harruar gjeografinë e vendit të tyre. Por ka ndodhur kështu sepse të gjithë e njihnin dhe e njohin qeverinë sovjetike si një qeveri evropiane, prandaj asnjëherë nuk lindi, as nuk kishte pse të lindte, ndonjë problem për anëtarësinë e saj në grupin e shteteve afro-aziatike.

Së treti, udhëheqësit sovjetikë, në pretendimet e tyre absurde, arrijnë deri atje sa praktikisht të thonë

se vetëm po të marrin pjesë ata në konferencën e dytë të vendeve afro-aziatike, ajo do të marrë një karakter antiimperialist, se mungesa e tyre do të dobësojë forcat antiimperialiste etj. Logjikë e çuditshme! Kësaj i thonë: «Pa mua nuk lind dielli». Konferenca e parë e vendeve afro-aziatike që u mbajt në Bandung, që antiimperialiste, megjithëse Bashkimi Sovjetik nuk mori pjesë në të. E tillë do të jetë edhe konferenca e dytë. Deri sot antiimperializmi i konferencave ose i mbledhjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe i vendeve e i qeverive që kanë marrë pjesë në to, është përcaktuar nga qëllimet që pjesëmarrësit i kanë vënë vetes, nga fryma që ka ekzistuar në to, nga vendimet që janë marrë dhe nga lufta konkrete që kanë bërë popujt e atyre vendeve kundër imperializmit e kolonializmit. Ky është një kriter i drejtë. Antiimperializmi nuk është një monopol i udhëheqësve sovjetikë. Përkundrazi, duke shkarë në revizionizëm, ata janë larguar tani nga pozitat antiimperialiste, prandaj ata janë antiimperialistë me fjalë dhe proimperialistë me vepra. Nuk është më një sekret se udhëheqësit sovjetikë nuk e përkrahin, por po përpiqen ta minojnë konferencën e dytë të vendeve afro-aziatike.

Përkrahja e solidaritetit të popujve të Azisë e të Afrikës në luftën e tyre kundër imperializmit është një detyrë e lartë për të gjitha vendet socialiste, për të gjitha vendet paqedashëse, pavarësisht nëse ato marrin pjesë ose jo në konferencën e këtyre shteteve. Dhe kjo përkrahje nuk mund të bëhet me kushte, siç bëjnë udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik. Aq më tepër ajo nuk mund të bëhet duke u diktuar popujve të Azisë e të Afrikës direktivat e udhëheqjes sovjetike, se

ku, kur dhe si duhet t'i diskutojnë ata problemet që i interesojnë luftës së tyre të përbashkët kundër imperializmit, kolonializmit dhe neokolonializmit.

Është fakt i pamohueshëm se grupi tradhtar i Hrushovit po ndjek prej kohësh politikën e afrimit dhe të bashkëpunimit të ngushtë me imperializmin amerikan. Të gjitha ngjarjet e këtyre viteve të fundit kanë treguar, gjithashtu, me prova të shumta se revizionistët hrushovianë, për t'u bërë qejfin imperialistëve amerikanë, «për të provuar» efikasitetin e bashkekzistencës së tyre paqësore, jo vetëm kanë hequr dorë nga përkrahja e luftës nacionalçlirimtare antiimperialiste të popujve, por janë përpjekur dhe përpiqen me çdo mjet ta pengojnë atë, duke arritur deri atje sa të bashkëpunojnë me imperialistët për shtypjen e saj. A nuk e tregon qartë këtë qëndrimi i udhëheqësve sovjetikë ndaj çështjes së Kongos?

Udhëheqësit sovjetikë duhet ta dinë mirë se popujt e Azisë dhe të Afrikës e dallojnë tani mirë të keqen nga e mira, shokun dhe mikun nga intriganti dhe keqdashësi, luftëtarin e vërtetë antiimperialist nga mbrojtësi i imperializmit, atë që është për solidaritetin luftarak të popujve të Azisë e të Afrikës nga përçarësi i këtij solidariteti.

Zhurma që udhëheqësit sovjetikë kanë ngritur tani rreth konferencës së dytë të vendeve afro-aziatike, si dhe sharjet e kërcënimeve kundër vendeve pjesëmarrëse në mbledhjen përgatitore të Xhakartës, nuk mund të mos ngjallin zemërim te të gjithë ata që luftojnë imperializmin dhe që përkrahin pa rezerva

përpyekjet e lavdishme që bëjnë popujt e Azisë e të Afrikës për të kundërshtuar imperializmin, për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e tyre, për të shkatërruar orvatjet e kolonialistëve e të neokolonialistëve për të mbrojtur e për të forcuar paqen e përgjithshme. Udhëheqësit sovjetikë duhet, tanimë, ta dinë se koha e intrigave dhe e kërcënimeve ka kaluar. Popujve të Azisë e të Afrikës nuk mund t'u diktohet më vullneti i të tjerëve, ata nuk pranojnë më ndërhyrje në çështjet e tyre të brendshme, siç bëjnë udhëheqësit sovjetikë, duke kërkuar nga ata që të hedhin poshtë vendimet që u morën në Xhakartë. Me këto qëndrime udhëheqësit revizionistë sovjetikë e demaskojnë edhe një herë vetveten dhe dalin përpara botës si përçarësit më të mëdhenj të luftës së popujve kundër imperializmit, kolonializmit dhe neokolonializmit.

Populli ynë përshëndet sinqerisht përpjekjet e vendeve afro-aziatike për organizimin në vitin e ardhshëm të konferencës së tyre të dytë dhe uron që ajo të përfundojë me sukses, t'u sjellë fitore të reja popujve të Azisë dhe të Afrikës në radhë të parë, luftës së tyre kundër imperializmit e kolonializmit, të sjellë një kontribut të rëndësishëm edhe për çështjen e paqes në botë. Prandaj ai gëzohet bashkë me miqtë e tij për çdo përparim në forcimin e solidaritetit afro-aziatik dhe hidhërohet për çdo pengesë e vështirësi që u nxirret popujve të Azisë e të Afrikës, qoftë nga imperialistët, qoftë edhe nga revizionistët modernë. Ky qëndrim i popullit shqiptar dhe i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë në këtë çështje të madhe për fatet e njerëzimit buron nga qëllimet dhe nga preokupacionet

tona të ligjshme për çështjen e ruajtjes së paqes, për shkatërrimin e planeve luftëdashëse të armiqve të solidaritetit afro-aziatik e të paqes në botë.

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Zëri i popullit»,
Nr. 139 (4921), 11 qershor 1964*

*Botohet sipas tekstit të gazetës
«Zëri i popullit», Nr. 139 (4921),
11 qershor 1964*

MËSIMET E PARTISË MBËSHTETEN NË TEORINË DHE NË PRAKTIKËN REVOLUCIONARE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 qershor 1964

Shokët thanë shumë gjëra. S'kam se çfarë të flas më tepër, do të them vetëm pak fjalë.

Në Mirditë ne kemi një popull dhe një organizatë-partie të shëndoshë, prandaj edhe sukseset janë të mëdha. Kjo është meritë e Partisë dhe e shokëve që drejtojnë në rreth e në bazë. Natyrisht, si kudo, edhe në Mirditë ka të meta, kundër të cilave duhet të organizohet më mirë puna për edukimin moralo-politik dhe teknik të njerëzve. Këtu nuk është çështja për t'i dërguar të gjithë njerëzit në universitet, por Partia duhet t'i vërë rëndësi përgatitjes së kuadrove të mesëm. Ku-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e Komitetit të Partisë dhe të organizatave-bazë të ndërmarrjeve të minierave dhe të gjeologjisë të rrethit të Mirditës për edukimin dhe për trajtimin e punonjësve.

adrot e mesëm kanë një rëndësi të madhe, ata duhet të nxirren nga baza dhe të edukohen në vend. Për sa i përket çështjes së gjeologëve që vijnë nga Tirana ose nga Vlora, kjo nuk duhet të na preokupojë. Në qoftë se këta do të jenë nga Mirdita, do të jetë mirë, por edhe sikur të mos jenë nga ky rreth, nuk prish shumë punë. Gjeologët që mbarojnë shkollat, duhet të venë atje ku është minerali. Prandaj sigurimit të kuadrove të mesëm duhet t'i vini rëndësi të madhe, që të plotësoni nevojat e rrethit.

Kemi marrë vendim që punonjësit të mbarojnë shkollat, me qëllim që të kryejnë mirë detyrat e ngarkuara. Në rast se ndonjë nuk e kryen shkollën dhe shteti ka njerëz të tjerë që kanë arsim, atëherë këtyre mund t'u lirohet vendi. Kjo nuk do të thotë që në qoftë se ndonjëri nuk vazhdon shkollën, të mos zëvendësohet me një tjetër që, gjithashtu, nuk e ka shkollën, por që është më i zoti.

Dëshiroj të theksoj që Partia të shikojë më mirë bazën e punës së saj edukative, të braktisë punën e sipërfaqshme me formula, të përmirësojë metodën dhe stilin e drejtimit. Në disa çështje ne kemi adaptuar formula e metoda, të cilat janë vjetruar. Mundet që një formë të qëndrojë disa muaj, por kur ajo nuk përputhet më me kushtet e kohës, nuk duhet të mbahemi pas saj. Në qoftë se në mensat, për shembull, venë vetëm dy punëtorë, atëherë duhet propozuar që këto të mbyllen dhe jo t'i mbajmë të hapura, duke thënë se kështu është vendosur. Prandaj na vihet detyra që ta rishikojmë punën dhe të praktikojmë forma e metoda të reja.

Instruktorët ose sekretarët e komiteteve të Partisë që përgatitin leksionet, të kenë parasysh që këto t'u përshtaten dëgjuesve. Sot kemi ku bazohemi për të bërë leksione të këndshme dhe për t'i dëgjuar ato, veçse duhet që njerëzit, të cilët i përgatitin këto leksione, të reflektojnë e të ngrenë vazhdimisht nivelin e tyre dhe jo të dalin përpara masës po me ato gjëra që kanë dalë disa vjet më parë. Më parë s'kishte inxhinierë në Mirditë, kurse sot ka me dhjetëra. Gjithashtu atje s'kishte njerëz të përgatitur, ndërsa tani gjendja ka ndryshuar krejtësisht. Prandaj, detyra jonë është që të ndërtojmë një punë më të thellë dhe të arrijmë që njerëzit të shkunden, në qoftë se i ka zënë ndryshku.

Një shok pohoi këtu se nuk aktivizohen inxhinierët. Unë them se ata janë të gatshëm, por ne duhet të dimë si t'i aktivizojmë. Në qoftë se punëtorët, për shembull, i preokupon çështja e shkrirjes së mirë të metalit dhe ne në vend që ta ngarkojmë inxhinierin të përgatitë një leksion për këtë çështje, që lidhet me punën e tij, e aktivizojmë për një punë tjetër shoqërore, atëherë ai s'ka si të aktivizohet. Edhe punë shoqërore duhet bërë, por kjo të jetë sa më e lidhur me zanatin e njerëzve. Kështu, po ta ngarkojmë inxhinierin që në bazë të udhëzimeve teknike të nxjerrë konceptet morale, ideologjike dhe teknike lidhur me punën e tij, edhe këtë e kemi mobilizuar si duhet dhe të tjerët do ta dëgjojnë me interes. Një inxhinier që aktivizohet me një punë shoqërore të tillë, ai do t'i edukojë punëtorët si duhet. Një herë tjetër inxhinieri ngarkohet t'u flasë punëtorëve për vjedhjet, duke u treguar se ç'do të thotë kjo politikisht. Kështu do të bëhet më

mirë edhe edukimi i punëtorëve me ndjenjën e klasës. Prandaj Partia duhet t'i shikojë problemet dhe detyrat sipas njerëzve, sipas punës, të zhvillojë leksione dhe t'i edukojë punonjësit me frymë revolucionare. Në këtë drejtim mendoj të veprojnë gjallërisht edhe organizatat e masave, sidomos bashkimet profesionale.

Urdhëresat e Qeverisë përmbajnë udhëzime praktike, por në përmbajtje ato kanë një kuptim filozofik dhe ideologjik. Prandaj edhe bashkimet profesionale duhet t'i mbajnë parasysh këto udhëzime. Nuk duhet të shkohet me parimin se punëtorët i dinë këto udhëzime. Atëherë përse janë Partia dhe bashkimet profesionale? Që t'ua shpjegojnë dhe t'ua bëjnë të ditur punëtorëve edhe udhëzimet e urdhëresat e Qeverisë. Në radhë të parë këtë punë është e nevojshme ta bëjnë bashkimet profesionale. Në qoftë se nuk zbatohen këto, s'mund të ketë as emulacion dhe as gara socialiste.

Vendimet e plenumeve të Komitetit Qendror janë direktiva të përgjithshme, të cilat zbërthehen e konkretizohen edhe nga organizatat e Partisë dhe nga levat e tyre, bashkimet profesionale, që janë rripa të transmisionit dhe lidhin Partinë me klasën punëtore e punonjës të tjerë. Partia duhet ta ndihmojë këtë organizatë, por në qoftë se shpjegimin e direktivave të saj te punëtorët do ta marrë përsipër Partia, atëherë çfarë do të bëjnë bashkimet profesionale? Në këtë drejtim, organizata e bashkimeve profesionale jo vetëm nuk mund të komandojë, por ajo duhet t'i dënojë ata që komandojnë jashtë ligjeve. Ne e kemi përsëritur kaq herë që bashkimet profesionale kanë për detyrë të ko-

rrigjojnë dhe të goditin shfaqjet burokratike në institucionet dhe në ndërmarrjet shtetërore.

Në Mirditë mund të keni ngritur 10 brigada të punës socialiste, mund të shikoni, nëpërmjet statistikave, nëse vajti ky ose ai në shkollë dhe të veproni për të shtuar frekuentimin, por jo të pakësoni kujdesin për të zhvilluar leksione politike. Por në ekonomi ka shumë gjëra, të cilat duhet të zërthehen, prandaj është e domosdoshme të caktohen mirë përgjegjësitë dhe detyrat, që secili të bëjë punën e tij. Kështu edhe bashkimet profesionale e rinia.

Udhëheqja e Partisë në bashkimet profesionale nuk duhet të jetë formale. Çështja kryesore këtu është ajo e edukimit, për të cilin ka detyra jo vetëm Partia, po edhe bashkimet profesionale dhe rinia. Në këtë drejtim duhet t'u japim një ndihmë më të mirë rretheve. Partinë e kemi të fortë, ajo ka sot një nivel më të lartë, popullin e kemi patriot etj., por kjo nuk do të thotë që jemi të mësuar. Mësimet tona mbështeten në teorinë dhe në praktikën revolucionare.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
taritit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUR SEMINARET PËRGATITEN MIRË, NDIHMUJNË NË ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 qershor 1964

Seminaret me sekretarët e organizatave-bazë zhvillohen me qëllim që ata të edukohen, të bëhen të aftë në disa probleme të caktuara e të nevojshme, për të udhëhequr më mirë organizatat e Partisë.

Ajo që ka rëndësi për këto seminare është zgjedhja dhe përgatitja e temave. Në qoftë se e bëjmë mirë këtë, atëherë e kemi ndihmuar Partinë të ecë përpara dhe të zgjidhë problemet që i dalin. Prandaj komiteti i Partisë i rrethit duhet të dijë nivelin politik dhe kulturor të sekretarëve të organizatave të Partisë dhe mbi këtë bazë të caktojë temat qysh në fillim të vitit. Gjithashtu

1 Ndër çështjet që u diskutuan në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi zhvillimin e seminareve me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë.

rëndësi ka që në këto seminare sekretarët e organizatave-bazë, sidomos ata që janë të rinj, të mësohen dhe të edukohen, sepse ndryshe nuk ndihmohen si duhet në zgjidhjen e problemeve, por do të lodhen e do të mërzhiten.

Seminaret një ose disaditore gjatë vitit nuk duhet të zëvendësojnë kurset dymujore.

Seminaret mujore janë shumë të nevojshme, megjithëse duhet të theksojmë se komitetet e Partisë nuk bëjnë për to një përgatitje serioze. Në këto seminare më shumë jepen porosi e udhëzime për çështje ekonomike, për të cilat interesohen organet shtetërore. Organizatat-bazë nuk duhet të harrojnë detyrën që kanë për të mobilizuar masat në realizimin e detyrave ekonomike, por në qoftë se seminare të bëhen për të dhënë një varg direktivash, kjo nuk është e drejtë, sepse ato duhet të zhvillohen sipas udhëzimeve të Komitetit Qendror. Sekretari i parë i komitetit të Partisë duhet të mendojë për problemet e stinës, duke u bazuar në eksperiencën e kaluar; për çështjet politike, për shfaqjet e huaja etj., duke u orientuar nga artikujt e gazetës «Zëri i popullit». Kështu në rast se komiteti i Partisë mendon se duhet forcuar puna politike, atëherë mbledh sekretarët e organizatave-bazë dhe u jep sqarime. Këtë muaj mendon t'i mbledhë për çështjet e politikës së jashtme, atëherë duhet t'u flasë dhe t'i sqarojë ata mirë. Muajin tjetër mendon t'u flasë për një problem ekonomik, ta zëmë, për fushatën e korrje-shirjeve, duke e lidhur këtë me rëndësinë që kanë drithërat për vendin tonë. Mbasi mbaron së foluri, shoku i komitetit të Partisë u drejtohet pjesëmarrësve të seminarit

nëse kanë ndonjë vërejtje ose propozim në mënyrë që të merren masa. Këto vërejtje e propozime sekretari i komitetit të Partisë duhet t'i marrë shënim dhe, kur është nevoja, të ndërhyjë ku duhet për t'i zgjidhur. Në qoftë se ushqehet organizata e Partisë kështu dhe jo vetëm me porosi, atëherë ajo ndihmohet efektivisht.

Eksperiencia tregon se seminarët duhet t'i bëjmë të diferencuara. Në qoftë se bëhet kjo punë mirë, e ke armatosur Partinë, kurse po nuk u instruktuan si duhet sekretarët e organizatave-bazë, atëherë do të ndihet një boshllëk në punën e Partisë. Prandaj, që të sakrifikohet gjysmë dite në muaj për një gjë të tillë, më duket se nuk është kohë e humbur. Megjithatë, në qoftë se është shumë një herë në muaj, atëherë seminarët mund të zhvillohen edhe një herë në dy muaj e gjysmë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NË KUSHTET E SOTME KA MUNDËSI TË ZHVILLOHET NJË PUNË MË E MIRË SHKENCORE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

16 qershor 1964

Mendimi im është se ne po kalojmë në një etapë të re e më të organizuar të punës shkencore. Tani na janë krijuar kushte më të mira organizative dhe teorike e praktike për ta ngritur një punë të tillë në një nivel më të lartë.

Ne vepruam me guxim të madh kur hapëm universitetin, atëherë nuk i kishim mundësitë e sotme, megjithatë e krijuam dhe ai na dha fryte në zhvillimin e arsimit tonë të lartë. Krijimi i universitetit qe një hap i madh përpara. Ai ka shërbyer jashtëzakonisht në ndërtimin socialist të vendit tonë. Sot janë krijuar mun-

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi gjendjen dhe mbi perspektivat e zhvillimit në fushën e shkencave natyrore, bujqësore dhe teknike.

dësi më të mëdha për punën shkencore në të gjitha fushat.

Ashtu siç vepruam për hapjen e universitetit, duhet të veprojmë edhe për zhvillimin e shkencave. Vetëm se këtu të kemi parasysh që këto të ecin paralelisht, domethënë universiteti, edhe në të ardhmen, të ketë si detyrë përgatitjen teorike e shkencore të kuadrove, edhe puna shkencore të zhvillohet më tej, duke krijuar institute kërkimore dhe të forcohet drejtimi nga ana e ministrive për të zbatuar në jetë vijën e Partisë në ekonomi dhe në sektorët e tjerë, pra për të zbatuar në praktikë programet shkencore.

Është e natyrshme që ne të mos lejojmë shkëputje në mes universitetit, instituteve kërkimore-shkencore dhe ministrive. Këto duhet të kenë bashkëpunim të plotë me njëri-tjetrin, pse edhe qëllimi i tyre është i njëjtë: të ndihmojnë në ndërtimin e bazave të socializmit që të kalojmë në ndërtimin e shoqërisë komuniste. Vetëm se këtu duhet pasur parasysh që të mos ketë dublime, studime pas studimesh, ose marrje me gjëra të vogla. Të kuptohet mirë se cila është detyra e universitetit, detyra e instituteve kërkimore-shkencore dhe detyra e ministrive. Prandaj ka rëndësi përcaktimi drejt i detyrave të tyre.

Laboratorë duhet të kenë jo vetëm fabrikat dhe dikasteret, por edhe institutet kërkimore, sepse këta laboratorë do të shërbejnë për studimin e temave të caktuara. Laboratorët e dikastereve dhe të fabrikave do të kenë për detyrë zgjidhjen e problemeve konkrete lidhur me prodhimin, kurse studimet për problemet e mëdha teorike, që do t'u shërbejnë ekonomisë ose di-

kasterit, do t'i bëjnë laboratorët e instituteve kërkimore-shkencore. Ato çështje, për shembull, që i interesojnë menjëherë gjeologjisë, duhet të bëhen në laboratorin e ministrisë përkatëse, kurse temat e tjera që kërkojnë një kohë të gjatë, duhet të kalojnë në Institutin e Kërkimeve Gjeologjike.

Ana organizative ka një rëndësi të madhe, prandaj mund të studiohet e të përcaktohet më mirë se çfarë institutesh kërkimore-shkencore do të ngrihen, drejtimi i tyre brendapërbrenda dhe drejtimi nga ana shtetërore. Mendoj se tani për tani ne nuk mund ta krijojmë Akademinë e Shkencave, por në fillim të ndajmë më mirë punët që duhet të bëjë universiteti dhe ato që duhet të bëjnë institutet shkencore.

Ne duhet të nisemi nga parimi që të shikojmë shumë seriozisht jo vetëm çështjen e laboratorëve, të bibliotekës dhe të kuadrit shkencor, por duhet të shikojmë edhe më tutje, të shikojmë edhe çështjen e kuadrove të mesëm. Prandaj Qeveria të studiojë çështjen e përgatitjes së kuadrove të mesëm, pse këtyre instituteve do t'u duhen shumë laborantë. Kur flasim për laboratorët, të kemi parasysh që duhen një numër kuadrosh mekanikë, për t'i riparuar këta laboratorë, pse ata nuk mund t'i dërgosh për t'i riparuar në uzinën «Enver».

Rëndësi të madhe t'u japim laboratorëve dhe bibliotekës së universitetit. Nga studentët e universitetit duhet të dalin kuadro të shëndoshë dhe të përgatitur mirë, sepse, duke i dhënë kuadro të tillë bazës, do të na shkojnë mirë jo vetëm puna e instituteve kërkimore-shkencore, por edhe prodhimi. Për këtë qëllim ne duhet të caktojmë fonde dhe të shikojmë drejt

asaj që universiteti, institutet dhe fabrikat të kenë secili laboratorët e vet. Kështu të evitohet sa të jetë e mundur që në laboratorin ku bën praktikë studenti, të bëjë studime edhe shkencëtari. Prandaj këta laboratorë duhet të jenë të ndarë dhe të shkojmë drejt plothësimit të tyre. Natyrisht, punë të tilla nuk bëhen menjëherë. Në këtë drejtim ne, kryesisht, duhet të punojmë vetë, po duhet të marrim eksperiencë edhe nga vendet e tjera.

Për çështjen e kuadrove të lartë unë them që, në rast se shikojmë pak më mirë planet mësimore të shkollave të mesme dhe të universitetit, mund të ekonomizojmë edhe kuadro, pse për mbrojtjen e temave, mund të ndihmojnë edhe kuadro që kanë një stazh pune të gjatë. Në qoftë se shikojmë me këtë sy se çfarë kuadrosh na duhen për kulturën e përgjithshme dhe për kulturën speciale, në qoftë se e realizojmë këtë në rrugë të drejtë, do të bëjmë një zgjedhje më të mirë të kuadrove për të kaluar në universitet, ndërsa ata që mbarojnë, të venë në prodhim. Kështu, pas disa vjetëve, do të kemi kuadro shkencorë.

Të gjitha këto që u thanë këtu në përputhje me mundësitë që kemi, duhet t'i fusim në planin e ardhshëm pesëvjeçar.

Në fund kisha për të bërë një vërejtje: Pedagogët dhe studentët që do të punojnë në institutet shkencore, duhet të dinë të paktën dy gjuhë të huaja. Në qoftë se ata nuk dinë gjuhë të huaja, do ta kenë vështirë të kryejnë si duhet detyrat.

Në vendet e tjera ka institute kërkimore-shkencore edhe për sëmundje të rënda, si për shembull, për së-

mundjet e zemrës etj. Tani për tani ne nuk kemi mundësi që të krijojmë institute të tilla, po mundet që për këto sëmundje, që janë jashtëzakonisht të rrezikshme, këtu në Tiranë të ecet më përpara, për shembull, me operacionet e zemrës, për të cilat të sigurojmë edhe disa aparate.

Prandaj, kur të aprovojmë planin pesëvjeçar, të vendosim definitivisht.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**EDUKIMI DUHET BËRË NË MËNYRË TË
GJITHANSHME E TË VAZHDUESHME
DHE JO ME FUSHATA**

*Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit
të Partisë të Rrethit të Shkodrës*

18 qershor 1964

Në këtë mbledhje u zhvillua një bisedë e përzemërt midis shokut Enver Hoxha dhe anëtarëve të byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit. Në fillim e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Unë erdha në rrethin tuaj për t'u njohur më nga afër me punën dhe me përpjekjet e organizatës së Partisë. Ç'mund të na thoni? Tani fjalën e keni ju. Nuk është nevoja që të më informoni në detaje, po si paraqitet në përgjithësi gjendja politike dhe ekonomike e rrethit dhe cilat janë problemet kryesore që ju preokupojnë.

Pastaj folën sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit dhe shokë të tjerë të byrosë. Ata informuan se organizata e Partisë në rrethin e Shkodrës ka ar-

dhur duke u rritur. Gjatë vitit 1963 u bënë më shumë pranime në Parti se viti i kaluar, nga të cilat një numër shoqesh. Deri tani janë plotësuar dokumentet e reja të Partisë për gjysmën e efektivit dhe janë shpërndarë mjaft tesera. Në të gjitha qendrat e punës dhe në kooperativat bujqësore ka organizata të Partisë. Gjendja politike e rrethit është e shëndoshë. Këtë e tregojnë rezultatet e arritura në realizimin e planit...

Shoku Enver Hoxha dëgjoi me vëmendje diskutimet e shokëve të byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit, pastaj bëri disa pyetje, siç ishin:

Sekretarët e organizatave-bazë të Partisë ndjekin kurse apo shkolla? Organizoni seminare me ta dhe kur, e përse e keni bërë seminarin e fundit? Si i zhvilloni këto seminare, si diskutohet në to dhe çfarë gjërash interesante ngrenë sekretarët e organizatave-bazë? Çfarë konkluzionesh të thella teorike e politike nxirren kur zhvillohen tema? Ç'bëhet për organizimin socialist të punës? A e lexojnë shtypin komunistët? Si punohet me artikujt që botohen në gazetën «Zëri i popullit»? A i shikojnë shokët komunistë çështjet nga ana ideologjike? Sa agjitorë kanë shkuar për të punuar tema në kooperativat bujqësore? A punojnë mirë intelektualët, si të vjetrit ashtu dhe të rinjtë? Desha të di se cili është mendimi juaj, si e shikoni ju situatën, zhvillimin e luftës kundër revizionizmit? A i siguron ju drithërat e bukës për nevojat e rrethit?

Pasi dëgjoi përgjigjet e pyetjeve të sipërme, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Dëshiroj të them edhe unë pak fjalë për disa çë-

shtje që diskutuat edhe ju. Po e filloj nga seminarët që organizohen me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë. Këto kanë rëndësi shumë të madhe, prandaj duhet menduar mirë për temat që do të zhvillohen me ta në mënyrë që ato të përgatiten në nivelin e duhur e në kohë dhe të mos lihen për ditët e fundit. Shpesh ndodh që për temën e caktuar në seminar, flitet vetëm gjysmë ore, kurse për çështjet e tjera të ditës vazhdohet dy orë, kështu sekretarët e organizatave-bazë, kur vjen fundi, harrojnë se cili ishte problemi kryesor për të cilin u thirrën.

Forcimi i punës në fshat është një detyrë me rëndësi për Partinë. Prandaj ju duhet të dërgoni në fshat punëtorë të cilët t'u tregojnë fshatarëve se si e kuptojnë ata disiplinën në punë në ndërmarrjet e tyre, sa humbje ka nga mosshfrytëzimi i kohës së punës dhe nga mosmarrja pjesë në punë etj., etj., si dhe të ndihmojnë fshatarësinë kooperativiste në punët e stinës. Kjo mendoj se do t'u bëjë përshtypje të madhe fshatarëve dhe ata do të përfitojnë nga disiplina e klasës punëtore. Punëtorët nuk është nevoja t'u flasin fshatarëve me fjalë të bukura, por me thjeshtësinë që i karakterizon, të tregojnë esencën se ç'do të thotë disiplinë në punë, ç'është norma dhe pse duhet ta realizojnë atë etj.

Në këtë drejtim të gjithë komunistët duhet të jenë agjitorë të punës së Partisë, të kritikojnë cilindo në rast se punët nuk ecin mirë. Kritika mund të bëhet zyrtarisht dhe jo zyrtarisht. Natyrisht, në mbledhjen e byrosë kritika zyrtare është më e efektshme. Por sekretari i Partisë ka çdo ditë kontakte me shokët e tjerë

dhe në punë e sipër secili shfaq mendimet e tij, bëhen edhe kritika, kjo nuk është kritikë zyrtare.

Në goftë se sekretari i Partisë i thotë, për shembull, instruktorit që bëj kështu siç them unë dhe ai përgjigjet «si urdhëron», megjithëse gjykon se ajo që thotë sekretari nuk është e drejtë, në këtë rast nuk ka kritikë. Kur instruktori bën vërejtje, duke thënë se ajo që thoni ju nuk është ashtu, shoku sekretar, se po të veprohet siç thoni ju, do të kemi këto ose ato konsekuenca, atëherë kjo është një kritikë, vërejtje ose këshillim për sekretarin e Partisë. Këtë mund ta marrësh si të duash, po në fakt ajo është një formë kritike që atë e ndreq. Në rast se sekretari i Partisë do t'i thotë këtij instruktorit se nuk është ashtu, se unë e di më mirë këtë punë, atëherë kjo nuk është autokritikë nga ana e tij. Kur ai i thotë instruktorit se «është kështu si them unë», duke u nisur nga ajo që është sekretar partie, kjo do të thotë se ai nuk është i predispozuar për të bërë autokritikë.

Instruktori mund ta bëjë vërejtjen apo kritikën aty për aty, ose më vonë, pasi të jetë menduar. Në këtë rast sekretari i Partisë duhet të reflektojë menjëherë dhe t'i thotë instruktorit që ke plotësisht të drejtë. Kjo është një autokritikë nga ana e përgjegjësit. Një veprim i tillë e rrit kuadrin, sepse inferiori do të mendojë që ka të bëjë me një shok që gjykon drejt, se ai nuk do të ketë rreth vetes njerëz servilë që t'i thonë «si urdhëron». Kjo gjë duhet të bëhet edukatë në Partinë tonë, se zhduk shumë të këqija, pse kur instruktori ka një mendim, nuk e bren nga brenda, po vjen e ta thotë

në sy. Në këtë mënyrë ne përgatitim në Parti njerëz me pikëpamje të shëndosha dhe jo servilë.

Kritika dhe autokritika janë zinxhir dhe duhet të përpiqemi që këto të zhvillohen në mënyrë të pandërprerë e vazhdimisht, në punë e sipër. Kur një kuadër gabon, ai duhet të flasë e të bëjë autokritikë edhe në aktivet e Partisë. Kështu do të mësohen të veprojnë edhe komunistët e tjerë, kur gabojnë.

Një nga detyrat kryesore të Partisë është të organizojë më mirë punën për edukimin e komunistëve dhe të masave. Kështu artikujt e botuar në gazetën «Zëri i popullit» lidhin teorinë me praktikën, me gjendjen aktuale. Ata janë pjesë e teorisë marksiste-leniniste dhe zbërthim konkret i saj që shërbejnë jo vetëm për komunistët shqiptarë, po edhe për komunistë në vende të tjera. Në ta jepet qartë thelbi i oportunizmit dhe i trockizmit dhe është më lehtë të studiohen e të kuptohen sesa në librat teorikë. Në ta pasqyrohet lufta kundër revizionistëve modernë, ashtu sikurse kanë luftuar kundër oportunistëve dhe trockistëve Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Pra, në këta artikuj lidhet ngushtë lufta aktuale kundër revizionizmit dhe edukimi i komunistëve me teorinë marksiste-leniniste. Për disa anëtarë të Partisë sonë mund të jetë e vështirë të kuptojnë teorinë e Kautskit, Bernshtajnit dhe oportunizmin e tyre, ndërsa kur u flet për Titon dhe Hrushovin, ata e kuptojnë fare mirë se ku është puna. Prandaj punimi dhe studimi i artikujve të gazetës «Zëri i popullit» ka rëndësi të madhe. Ne duhet t'i njohim me ta të gjithë komunistët dhe t'i nxitim për t'i studiuar. Kur del në gazetë një artikull prej dy faqesh, komu-

nistët duhet ta lexojnë atë me kënaqësi, por me këtë nuk duhet të mjaftohemi, përkundrazi ta punojmë e ta komentojmë duke e lidhur më gjerë me teorinë.

Në qoftë se u kushtojmë kujdes të veçantë këtyre materialeve dhe i punojmë mirë në masat, kemi ndihmuar që të ngrihet dhjetë herë më shumë niveli i tyre politik dhe ideologjik. Këto duhet të punohen edhe në format e arsimit të Partisë, kurse ata që studiojnë në Shkollën e Lartë të Partisë t'u futen më thellë teorisht. Dëshira e Partisë është që të gjithë anëtarët e saj të venë në shkolla, po kështu edhe masat e popullit, por një gjë e tillë nuk ka mundësi të bëhet për të gjithë, prandaj ne duhet t'i vëmë rëndësi punës që, duke i studiuar këta artikuj, komunistët dhe masat të bëhen më të qartë politikisht dhe të përgatiten teorikisht.

Tani jemi duke përgatitur artikuj të tjerë. Kështu, sa del një artikull, vjen tjetri. Mirëpo këta duhen bluar mirë. Për këtë qëllim do të përgatiten edhe broshura me artikuj të botuar sipas problemeve të veçanta për çështje të Partisë, për luftën dhe paqen. Nëpërmjet këtyre artikujve ne duhet të bëjmë, në radhë të parë, edukimin në masë të komunistëve me ideologjinë marksiste-leniniste, lidhur kjo me situatën. Në këtë mënyrë ne do t'i edukojmë komunistët me këto materiale dhe do t'u mësojmë atyre teorinë marksiste-leniniste.

Po gjersa të përgatiten këto broshura, nuk duhet në asnjë mënyrë të ndërprisni punën edukative. Komunistëve mund t'u thuhet të rilexojnë dhe të ristudiojnë artikujt e botuar më parë. Format e arsimit të Partisë kanë programet e tyre, po ato nuk do të bëhen tërhe-

qëse në qoftë se në to nuk do të përdoren edhe këta artikuj të gazetës «Zëri i popullit».

Format edukative nuk duhet të zhvillohen në mënyrë burokratike. Një komunist mund të jetë nisur për një punë tjetër, por rrugës ai mund të shohë, për shembull, se në kafene janë grumbulluar disa arsimtarë, atëherë, kur ka mundësi, ulet në një tryezë me ta dhe kështu përfiton nga rasti për të biseduar. Këtë gjë duhet ta bëni edhe ju, shokë.

Organizata e bashkimeve profesionale, nën udhëheqjen e Partisë, në radhë të parë duhet të merret me edukimin ideopolitik të klasës punëtore, se çështja e edukimit është një kompleks i tërë, prandaj puna e Partisë dhe e bashkimeve profesionale në këtë drejtim nuk është një gjë e lehtë. Në këshillat e bashkimeve profesionale janë pothuajse të gjithë komunistë dhe, si të tillë, ata marrin në organizatat-bazë të Partisë direktivat e Komitetit Qendror dhe të komitetit të Partisë të rrethit. Përveç kësaj, komiteti i Partisë i rrethit i jep edhe organizatës së bashkimeve profesionale disa orientime se çfarë konferencash dhe aktivesh duhet të organizojë për t'i zbërthyer këto më gjerë. Mundet që format e punës të bashkimeve profesionale të shikohen më seriozisht. Prandaj duhet menduar për të gjetur forma të përshtatshme pune, që bashkimet profesionale t'i vënë mirë në jetë direktivat e Partisë, në mënyrë që, kur të thërriten e të ngarkohen me detyra të tjera, të kenë plotësuar detyrat e mëparshme. Në këtë punë komunistët duhet të aktivizohen e të jenë shembull, ata duhet ta kenë të qartë se bashkimet profesionale janë një organizatë e rëndësishme e klasës punëtore, se ato

janë leva të Partisë dhe janë krijuar për të lehtësuar punën e saj, duke aktivizuar një sërë njerëzish me parti ose pa parti.

Ju theksuat se ato janë ngarkuar me detyra të caktuara. Unë nuk them se atyre nuk u janë caktuar detyra, por puna është se merren më shumë me shifra, ndërsa duhet të nxjerrin konkluzione e detyra. Kjo gjë nuk bëhet si duhet.

Në ndërmarrjet ekonomike duhet ngritur në një nivel më të lartë përgjegjësia e drejtorit. Këtë shteti e ka caktuar në krye të ndërmarrjes për të drejtuar prodhimin, prandaj në qoftë se ai lejon që prodhimi të dalë skarco, që makineria të dalë jashtë përdorimit dhe të ndodhë që të përvetësohet pasuria socialiste pesë vjet me radhë, atëherë ai ka përgjegjësi dhe ndaj tij duhet të mbahet qëndrim. Në rast se një drejtues i sjell dëme ndërmarrjes, duhet të mbajë përgjegjësi për dëmet dhe këto t'i paguajë. Kështu do të forcohet edhe më tepër disiplina në punë. Kjo duhet të rregullohet edhe me rrugë ligjore.

Lidhur me zbatimin e Statutit të kooperativave bujqësore dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave mbi organizimin socialist të punës në kooperativat bujqësore çfarë plani ka hartuar Komiteti i Partisë, sektori i agjitacionit e i propagandës dhe kabineti i Partisë? Ç'punë bëhet, për shembull, për t'u shpjeguar kooperativistëve se, po punuan dhe realizuan normën, do të kenë më shumë të ardhura? Një rol të madh këtu luan, në radhë të parë, çështja e edukimit të komunistëve, në mënyrë që ata të zhvillojnë pastaj një punë të dendur politike, ideologjike dhe morale në fshat, duke i shpje-

guar kooperativistit se po nuk doli në punë, atëherë nuk ka me se të mbajë familjen, se po dëmtoi në një mënyrë apo në një tjetër ekonominë e kooperativës, ajo është në dëmin e tij etj., etj.

A bëhen seminare për këto çështje? Kjo që thashë është vetëm një anë, se vendime dhe urdhëresa, të cilat kanë të bëjnë me punën në ndërmarrje, në shkollë etj., dalin vazhdimisht nga Qeveria. Në këto vendime dhe urdhëresa të Qeverisë gjejnë shprehjen e tyre praktike vija dhe direktivat e Partisë. Komiteti Qendror i Partisë jep direktiva, kurse Qeveria i përpunon dhe i konkretizon këto në rrugën shtetërore. Prandaj, për shpërgimin dhe për zbatimin e tyre, Partia ka një punë të madhe për të bërë, e kam çështjen te puna edukative që duhet të bëjë Partia, për t'i shpjeguar masës se nga moszbatimi i një vendimi do të ketë këto ose ato konsekuenca, që këto të lidhen teorikisht dhe të kuptohen mirë nga kooperativistët.

Çështja e edukimit nuk është një fushatë. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të gjithanshme dhe të vazhdueshme. Shfaqjet jo të mira që duken në këtë drejtim, tregojnë se diçka nuk e kemi bërë si duhet dhe se kemi lënë pas dore një anë të problemit. Në qoftë se komunisti ose anëtari i kooperativës e kupton çështjen si duhet, do të kemi më pak të meta. Ne duhet të kuptojmë realisht se të metat kanë një arsye, megjithëse këtu mund të ketë gjëra të komplikuar, po që nëpërmjet tyre Partia gjen dhe rrugët e zgjidhjes, duke aplikuar metoda pune të tilla që t'i mësojë njerëzit.

Për të gjitha problemet Partia duhet të vërë mirë në lëvizje organet e pushtetit, bashkimet profesionale

dhe organizatat e tjera të masave, pa aktivizimin e të cilave nuk mund të bëhet mirë puna e saj. Partia të ketë kujdes që të mos marrë kompetencat e pushtetit. Ajo duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë çështjes së edukimit të njerëzve, e cila është një punë e vështirë dhe e komplikuar. Pse po degjeneron Bashkimi Sovjetik? Sepse revizionistët po shkatërrojnë ideologjinë komuniste dhe po nxitin ndjenja nga më të shëmtuarat. Për të mbështetur revizionizmin, Hrushovi ka krijuar edhe shtresën e borgjezisë së re. Ndërsa te ne puna qëndron krejt ndryshe.

Në rast se nuk keni ndonjë gjë, mund ta mbyllim bisedën e sotme dhe mund të mblidhemi përsëri edhe ndonjëherë tjetër para se të largohem.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

ZGJERIMI I NJOHURIVE BUJQËSORE NDIHMON SHUMË PËR RRITJEN E PRODHIMIT

*Nga fjala para punonjësve të ndërmarrjes bujqësore
«Perlat Rexhepi» në Shkodër*

19 qershor 1964

Pasi dëgjoji një informacion të shkurtër mbi gjendjen dhe punën në këtë ndërmarrje bujqësore, shoku Enver Hoxha tha:

Ju treguat se të rinjtë dhe të rejat e ndërmarrjes suaj, përgjithësisht, kanë mbaruar shkollën 7-vjeçare. Ky fakt më gëzon shumë. Partia jonë qysh në fillim i ka kushtuar një kujdes të veçantë zgjerimit të arsimit në vendin tonë.

Çdo shtet për çështjen e arsimit ka pikëpamjen e tij dhe ndjek qëllimet e veta. Shtetet borgjeze, kulturën dhe arsimin që japin, i kanë vënë në shërbim të politikës së tyre imperialiste. Kështu në programet e shkollave ata fusin jo vetëm mësimin e historisë së vendit të tyre, po edhe historinë e shumë vendeve të tjera. Këtë e bëjnë me qëllim që të përgatitin kuadro, që të

njohin për qëllime shfrytëzimi vendet që sundojnë. Kështu veprojnë edhe për shumë lëndë të tjera.

Programet e shkollave ne duhet t'ua përshtatim kërkesave e nevojave tona. Për të ndërtuar socializmin, fëmijët tanë duhet të kenë dijeni të gjera, në mënyrë që të jenë në gjendje të përvetësojnë shkencën moderne, por nuk është e nevojshme që ata të dinë me hollësi historinë e vendeve të tjera, kryesorja është që nxënësve tanë t'u mësojmë historinë e popullit tonë që nga ilirët e Skënderbeu, t'u mësojmë gjuhën tonë etj. Prandaj për shkollat tona ne duhet të ndërtojmë një program të tillë, që t'i shërbejë ndërtimit të socializmit.

Më parë, kur nxënësi mbaronte gjimnazin, mendohej se duhej të dinte gjithçka, të ishte enciklopedist, kurse tani s'ka nevojë për një gjë të tillë. Ne duhet të kemi në shkollë një program për ta pajisur nxënësin me njohuri të tilla, që t'i vlejnë për punën e tij, ta bëjnë njeri të aftë për të ndërtuar shoqërinë socialiste dhe t'i hapirr horizont, sepse, mbasi të mbarojë shkollën, ai i ka mundësitë të lexojë vetë edhe shumë gjëra të tjera. Kështu, në qoftë se ai që mbaron gjimnazin do të ndjekë Fakultetin e Historisë në Universitet, atje do të mësojë me hollësi historinë e popujve të botës e të tjera, ndërsa po të marrë degën e kimisë, do të mësojë më me hollësi kiminë, e kështu me radhë.

Në të kaluarën mësuesit tanë nuk kishin këto mundësi që kanë pedagogët dhe mësuesit sot. Pastaj në atë kohë edhe libra e materiale, ku mund të zgjeronin njohuritë, nuk kishte. Sot nxënësi mund t'i vejë për t'i kërkuar ndihmë mësuesit edhe në shtëpi, por nxënësit ndihmojnë edhe vetë njëri-tjetrin. Nga ana tje-

tër, edhe interesimi i prindërve për mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë është rritur. Prandaj të rinjtë i kanë sot të gjitha kushtet për të mësuar.

Shkolla të mesme nuk mund të ngremë në çdo fshat, por vetëm në qytete dhe në qendra të lokaliteteve, pasi shteti nuk ka mundësi të japë bursa për të gjithë. Kështu, disa me bursë e disa me shpenzimet e tyre, do të kenë mundësi të vazhdojnë shkollën.

Kuadro të mesëm duhen edhe për qytetin. Në qytet ka mjaft nevojë për elektrikistë, hidraulikë, bojaxhinj etj. Nga këta nuk duhen një e dy, por shumë. Në Durrës, për shembull, ka vetëm dy njerëz për të fshirë oxhaqet e shtëpive, ju mund të mos e çmoni ndofta shumë këtë punë, po oxhaqet duhen fshirë, pse ndryshe ka rrezik të digjet shtëpia. Qytetarëve në apartamente u prishen rubinetat e ujit dhe ndërmarrrja e pasurisë së shtetit u thotë: «Pritni se s'kam njerëz për t'ua rregulluar». Shumë shtëpi banimi ndërtohen në fshat, po këto duan karpentierë dhe muratorë. Ne deri tani kemi nxjerrë shumë nga këta specialistë nëpër kurse e shkolla po, kur pyesim, Ministria e Ndërtimit përgjigjet: «Nuk dimë se ku janë». Ku kanë vajtur këta? Janë shpërndarë kudo, në të katër anët e vendit, pse kudo janë ndërtuar dhe vazhdojnë të ndërtohen shtëpi të reja. Kështu, pra, ka shumë zanate që duhet të mësojë rinia, si në fshat, ashtu edhe në qytet. Në fshat këta kuadro duhet të përgatiten sipas kulturrave kryesore të bujqësisë. Ndërtimi i socializmit në vendin tonë kërkon një mori kuadrosh të mesëm.

Sekretarja e organizatës së rinisë tha se në ndërmarrrjen tuaj ka disa të rinj të paorganizuar, për arsye

se janë bij kulakësh, por që këta të rinj sillen mirë. Atëherë, kur këta mbajnë qëndrim të mirë dhe sjellje të mira, pse t'ia lëmë kulakut? Këta nuk duhen trajtuar si prindërit e tyre, por të shikohen një për një dhe të gjykohet se cilët mund të pranohen në organizatën e rinisë. Të rinjtë ndreqen kollaj, sa më shumë t'i afro-ni dhe t'i tërhiqni në punët tona, aq më tepër ata largohen nga fryma e vjetër e prindërve të tyre. Çështja është që organizata e rinisë të punojë dhe t'i bëjë të rinjtë shqiptarë patriotë të ndershëm, të duan punën, të duan atdheun.

Është e vërtetë se me të rinjtë që janë bij kulakësh ka ca vështirësi për të punuar, por duhet punuar vazhdimisht, sepse vetëm kështu mund të dobësohet influenca e prindërve ndaj tyre. Pastaj, kur prindi të shikojë se djali ose vajza e tij është me pushtetin popullor, do të thotë: çfarë bëj unë kështu? Fjalën e komunistit kulaku mund që edhe të mos e dëgjojë, po atë të të birit ose të vajzës së tij e dëgjon, prandaj organizata e rinisë duhet të tregojë kujdes dhe të punojë edhe me këta të rinj që sot janë të paorganizuar.

Në fund shoku Enver Hoxha, pasi foli për disa çështje të situatës ndërkombëtare, u uroi punonjësve shëndet e punë të mbarë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KUADROT E MESËM JANË MBËSHTETJA E KUADRIT TË LARTË

*Fjala para nxënësve e mësuesve të teknikumit veterinar
dhe me kuadrot e Stacionit Qendror të Zooteknisë
në Shkodër*

19 qershor 1964

Ju falënderoj, shokë, për informacionin që më dhatë! Me këtë rast dëshiroj edhe unë t'ju them pak fjalë.

Ju e kuptoni rëndësinë e madhe që kanë shkollat bujqësore për vendin tonë, sepse nëpërmjet tyre ne do të përgatitim një mori kuadrosh të mesëm bujqësorë, mbasi nevojat tona për ta janë mjaft të mëdha, bile aq të mëdha, saqë, me këto teknike që kemi, mund të themi se jemi në fillimin e kësaj pune. Me këtë nuk duhet të nënvleftësojmë shkollat e larta dhe kuadrot që dalin nga ato, por e theksojmë se kemi shumë nevojë për kuadro të mesëm. Në qoftë se kuadri i lartë nuk do të ketë në ndihmë një numër të caktuar kuadrosh të mesëm, ai nuk mund ta kryejë si duhet detyrën, sepse kuadrot e mesëm janë mbështetja e tij. Di-

turia dhe puna e kuadrit të lartë duhet të bien në një «tokë» të punuar mirë, ku të ketë një bazë kuadrosh të mesëm, ndryshe asgjë nuk mund të ecë përpara.

Me kushtet që kanë krijuar Partia dhe pushteti ynë popullor shumë njerëz mund të vazhdojnë universitetin, por të rinjtë duhet të kuptojnë mirë se, kur dalin nga teknikumet dhe shkojnë në prodhim, i sjellin një shërbim shumë të madh shoqërisë. Në mosvlerësimin si duhet të kësaj çështjeje mund të ketë infiltruar, me dashje ose pa dashje, edhe pikëpamja e vjetër që ekzistonte në një numër arsimtarësh, sipas së cilës, ata që kryejnë shkollën e mesme, duhet të jenë njerëz që të dinë gjithçka, në mënyrë që të barazohen me kuadrot e vendeve të tjera. Kjo është një pikëpamje që nuk duhet ta lejojmë të përhapet në vendin tonë. Para Çlirimit nuk kuptohej si duhej zhvillimi i ekonomisë. Atëherë ky zhvillim kuptohej në mënyrë kapitaliste ose fare feudale, kurse sot kulturën e arsimin, që ne i japim rinisë në shkollë, duhet t'ia përshtatim situatës sonë, nevojës për ndërtimin e socializmit.

Më parë, kur i riu mbaronte shkollën e mesme, për të vazhduar studimet e larta, duhej të kishte një kulturë të tillë që t'u përshtatej shkollave të huaja të vendit ku do të shkonte, ndryshe nuk mund të studionte në ato vende. Pastaj, dijet që merrte i riu në këto shkolla të larta, ishin të ndërtuara sipas nevojave dhe pikëpamjeve të regjimit shtypës në fuqi, që kështu t'u shërbenin interesave të borgjezisë kapitaliste, për të shfrytëzuar vendet koloniale e të varura. Kurse shkolla jonë duhet ta edukojë brezin e ri me arsim e kulturë so-

cialiste, që t'u përgjigjet nevojave të vendit gjithnjë në rritje, sidomos në ato drejtime ku është vënë më tepër theksi për të krijuar të mirat materiale e kulturore për popullin. Prandaj, të gjitha pikëpamjet e vjetra në këtë drejtim, të trashëguara nga e kaluara, ne duhet t'i shkulum nga rrënjët dhe t'u japim djemve e vajzave tona në shkolla atë kulturë të përgjithshme dhe ato dijeni teknike, të cilat t'u hapin atyre horizont, që të kenë mundësi të zhvillojnë shkencën. Kështu, pra, në teknike duhet vënë theksi në lëndët profesionale dhe të mbahet një proporcion më i drejtë me kulturën e përgjithshme, duke dhënë ato lëndë të kulturës së përgjithshme që me të vërtetë të riut ose së resë duhet t'i mbeten në kokë.

Nga sa jemi informuar, djemtë dhe vajzat që dalin nga teknikumet, punojnë mirë, janë të zellshëm dhe bëjnë përparime kudo që venë, prandaj puna juaj është për t'u lavdëruar.

Teknikumi juaj duhet të tregojë një kujdes më të madh për tekstet dhe për pajisjen më mirë të laboratorëve.

Po kështu edhe puna shkencore ka rëndësi të madhe. Para pak ditësh Byroja Politike mori vendim për krijimin e disa instituteve kërkimore-shkencore. Në bazë të këtij vendimi do të ngrihen institute kërkimore-shkencore të reja për fizikën, matematikën, kiminë, naftën etj. Me një fjalë, brenda pesëvjeçarit të ardhshëm do të ketë 7-8 institute të tilla, të cilat do të bëhen bërthama e Akademisë së Shkencave në vendin tonë.

Këto institute shkencore do të jenë të shkëputura

nga universiteti. Ndërsa universiteti merret me punën mësimore dhe përgatitjen e kuadrove të lartë, këto institute do të merren me punën kërkimore-shkencore. Institutet kërkimore-shkencore do të kenë laboratorët e tyre, përveç atyre që ka universiteti; ata do të jenë të destinuar vetëm për studime shkencore, për t'i shërbyer zhvillimit të ekonomisë sonë. Këto institute do të merren me problemet e perspektivës, me studime të veçanta, me ato që nuk i bëjnë vetë dikasteret.

Po a kemi në kuadro për t'i përballuar këto nevojat? Po, se Partia ngriti disa vite më parë Universitetin Shtetëror të Tiranës, i cili ka përgatitur mjaft kuadro të lartë. Si kudo, edhe këtu ka njerëz që kanë një përvojë të madhe shkencore, prandaj këta do të jenë studiuesit që do të ngarkohen të bëjnë studimet në këto institute dhe do të jenë në të ardhmen shkencëtarët dhe akademikët e vendit tonë. Studentët që do të dallohen në lëndët e matematikës dhe të fizikës, do të caktohen që të punojnë në këto institute.

Krijimi i këtyre instituteve, pra, do të na japë mundësi të mëdha për ta çuar shkencën tonë përpara. Shkencëtarët tanë duhet t'i lidhin punën dhe përvojën e tyre shkencore me shkencën botërore. Në kohën e sotme shkenca është zhvilluar shumë, por kjo nuk do të thotë që edhe në gjirin e shkencëtarëve tanë të mos dalin të tillë, që të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të shkencës.

Ne kemi matematicienë dhe fizikanë që bëjnë studime shkencore dhe që kanë arritur suksese në fushën e algjebërës. Këto studime janë paraqitur edhe në këshillat e akademive të shkencave të vendeve të tjera,

të cilat i kanë vlerësuar. Drejtimet e punës së shkencëtarëve tanë duhet të përcaktohen më mirë, që t'i shërbëjnë ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Djemtë dhe vajzat tona që dalin nga universiteti janë mjaft të përgatitur. Miqtë e luaj, që vijnë në vendin tonë, habiten kur shohin se një vajzë ose një djalë, që porsa ka mbaruar universitetin, drejton një pjesë të punimeve në një vepër të madhe. Pse e lehtë është të drejtosh punimet në një vepër të tillë? Në vendet kapitaliste, për t'u bërë mjek, studenti që ka mbaruar për mjekësi qëndron me vite të tëra pranë një mjeku që ka shumë vjet në profesion, me qëllim që t'i mbetet klinika kur ai të mos ketë më mundësi të punojë. Ndërsa te ne, ata që mbarojnë shkollën, hyjnë menjëherë në marrëdhënie pune dhe kudo shikojmë që kanë rezultate shumë të mira.

Kështu, pra, perspektivat tona, me masat që ka marrë Partia janë të mira. Rruga jonë është e drejtë. Ne duhet t'i vëmë rëndësi, veçanërisht çështjes së bujqësisë. Në qoftë se ju nxirrni nga bankat e shkollës suaj teknike të mirë, çdo gjë do të shkojë në rregull. Trupi mësimor në shkollën tuaj është i mirë. Sikurse e thate edhe ju, është vepruar mjaft mirë që kjo shkollë është ngritur në rrethin e Shkodrës. Ju, shokë të Stationit Qendror të Zooteknisë, që keni arritur suksese në punën tuaj për përmirësimin e racës së lopëve, po t'i kushtoni kujdes punës për përgatitjen e mirë të nxënësve të kësaj shkolle, do të bëni që të kemi kudo lopë të mira.

Në të gjitha degët e saj bujqësia jonë përparon, kurse në BS nuk shkon mirë. E dini se çfarë tha Hru-

shovi në Danimarkë? Në qoftë se bujqësia në Bashkimin Sovjetik nuk do të shkojë mirë brenda këtyre pesë vjetëve, ai do të dorëzojë taserën e partisë! Kurse taserën e partisë ai e ka dorëzuar me kohë. N. Hrushovi e ka çorientuar krejtësisht bujqësinë sovjetike, e ka përmbysur dhe po e çon në rrugën e bujqësisë kapitaliste. Duhet të kemi parasysh se Bashkimi Sovjetik është një vend i madh dhe bujqësia kërkon që investimet e bëra të shfrytëzohen në maksimum për të dhënë përfitime sa më të mëdha. Patjetër, që Hrushovi do të bëjë diçka për të shtuar ca prodhimet, duke marrë hua nga imperialistët amerikanë, por kjo do ta shpjerë bujqësinë sovjetike drejt degjenerimit në rrugën e kapitalizmit. Me stimujt materialë që kanë vënë, revizionistët modernë kërkojnë të krijojnë shtresa të pasura në bujqësi, kështu filloi procesi i degjenerimit të bujqësisë sovjetike. Por marksistë-leninistët kanë besim se, në mos sot, nesër, revizionistët do të përmbysen dhe kjo do të bëhet me revolucion, me gjak.

Revizionistët modernë ndodhen sot në një situatë shumë të vështirë. Ata s'kanë unitet në mes tyre, ata kanë një unitet në vijën e përgjithshme kundër marksizëm-leninizmit dhe kundër partive tona marksiste-leniniste, kurse në mes tyre kanë mosmarrëveshje, pse revizionistët e vendeve të ndryshme mundohen t'i shpëtojnë shovinizmit të shtetit të madh hrushovian, nuk pranojnë të qëndrojnë nën udhëheqjen dhe diktatin e Hrushovit. Shumica e klikave revizioniste në fuqi kanë prirje drejt aleancave me vendet kapitaliste, sidomos me kapitalistët amerikanë. Por kundër tradhtisë

së tyre ngrihen forcat revolucionare të marksistë-leninistëve.

Imperializmi amerikan ndiqte një politikë të ngurtë ndaj vendeve që sot janë në fuqi revizionistët, kurse tani ai mendon të zhvillojë një politikë më elastike. Me këtë imperializmi amerikan kërkon që Hrushovi dhe revizionistët e tjerë t'i bien në gjunjë.

Dalja e revizionizmit modern, megjithëse është një e keqe e madhe, ka edhe të mirën, sepse sëmundja doli hapur, prandaj kjo duhet luftuar deri në fund. Kur Partia e Punës e Shqipërisë filloi sulmin në Bukuresht, Hrushovi pësoi tronditjen e parë dhe pas kësaj patjetër do të pësojë disfatë të plotë, kurse marksizëm-leninizmi do të fitojë me siguri.

Ju uroj të gjithëve suksese në punën tuaj! Juve, të rinjve, ju uroj suksese në provime!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TË JEMI TË PËRGATITUR PËR TË PËRBALLUAR ÇDO AGRESION TË MUNDSHËM ARMIK

*Nga fjala me drejtuesit e një nënreparti ushtarak
në një fshat të Shkodrës*

20 qershor 1964

Pasi pyeti për shëndetin e ushtarëve e të oficerëve, për punën që bëhet lidhur me ngritjen e nivelit politik, ideologjik, arsimor e kulturor të tyre, për stërvitjen ushtarake, për punimet xheniere etj., shoku Enver Hoxha tha:

Kudo që shkon në të tilla vende, siç janë repartet ushtarake, pranë ushtarëve tanë ndien një entuziazëm të madh për përparimet që ka bërë ushtria. Kjo tregon për punën e madhe të Partisë dhe të oficerëve tanë. Me kujdesin e saj të vazhdueshëm Partia ka përgatitur për vendin tonë kuadro ushtarakë të ndërgjegjshëm dhe me një nivel të kënaqshëm politik dhe teknik. Detyra e oficerit është që të ndjekë vazhdimisht zhvillimin e Artit Ushtarak në përgjithësi, duke iu përmbytur parimeve tona. Oficerët e Ushtrisë sonë Popu-

llore janë të detyruar të dinë se ç'bën armiku, si përgatitet, çfarë armësh disponon etj. Oficeri ynë është i detyruar të dijë se ç'bën imperializmi në fushën ushtarake, për t'i bërë ballë, po të jetë nevoja, çdo sulmi nga ana e tij.

Ju keni dijeni për shumë armë të reja që janë shpikur. Rreth këtyre armëve moderne shtabet e vendeve imperialiste kanë krijuar teori, por që kanë të njëjtin qëllim: zhdukjen e socializmit dhe sigurimin e fitimeve. Me zhvillimin dhe me perfeksionimin e armëve nxirren teori të tjera të reja, sepse, për të siguruar fitime, duhet të krijosh edhe diçka të re, prandaj është mirë që ne t'i dimë të gjitha këto. Për shembull, imperialistët amerikanë hodhën bombën e parë atomike në Hiroshima, mirëpo tani ajo nuk është më monopol i tyre, prandaj, për të pushtuar vendet dhe popujt e tjerë, për t'i detyruar që të punojnë për ta, për t'i kthyer në skllevër, pra për të nxjerrë fitime, imperialistëve u duhet të shpikin armë të reja. Por imperialistët kanë edhe frikë, sepse, po të fillojnë një luftë frontale dhe të përdorin armët moderne, një gjë të tillë do ta bëjnë edhe kundërshtarët e tyre. Prandaj ata përgatiten për luftë dhe, nga ana tjetër, bëjnë edhe shantazhe e presione, me qëllim që të frikësojnë popujt.

Disa «teoricienë» borgjezë kërkojnë të trembin popujt duke thënë se shpërthimi i një lufte totale atomike rrafshon gjithçka mbi tokë, pavarësisht se edhe vetë iniciatori i kësaj lufte mund të zhduket. Të tjerë «teoricienë» thonë se lufta atomike zhvillohet jo për të shkatërruar krejtësisht vendin, po për ta djegur e për ta demoralizuar kundërshtarin, ashtu siç vepruan gjer-

manët në Luftën e Dytë Botërore kundër Anglisë, me anë të bombardimeve, me qëllim që të shkatërrohej industria dhe të demoralizohet kundërshtari. Edhe kundër Bashkimit Sovjetik kështu e filloi Hitleri, por, megjithëse industria sovjetike u shkatërrua, qëllimi për të demoralizuar popullin nuk u arrit. Tri herë më shumë nga sa parashikonte në planet e veta e dëmtoi Hitleri me bombardime qytetin e Leningradit dhe nuk ia arriti qëllimit të tij, populli sovjetik luftoi me heroizëm gjer në fitoren e tij të plotë. Ka dhe disa të tjerë që thonë të fillohet lufta gradualisht dhe, në qoftë se kjo nuk ka efekt, pastaj të zhvillohet totalisht.

Kështu, pra, lidhur me çështjen e luftës ka mjaft «teorira». Prandaj në këto kushte ne duhet të jemi të përgatitur për të përballuar çdo agresion të mundshëm armik. Oficerët tanë kanë dijeni për të gjitha këto që thashë, po duhet t'i dinë akoma më mirë.

Punimet xheniere që bëni ju, janë shumë të mira dhe të domosdoshme. Duhet kuptuar se shkoj koha kur luftohej në këmbë. Tani, kur të luftosh, duhet ta godasësh armikun dhe vetë të mos dëmtohesh. Natyrisht, ju e kuptoni se në luftë nuk qëndrohet gjithnjë në strehim. Që të rrish në tunel, të detyron lufta moderne, pse të grin mitralozi, mortaja, avioni, bomba atomike, por në të njëjtën kohë duhet manovruar edhe për të dalë sa më shpejt, për të sulmuar dhe për të shkatërruar armikun.

Një ndër detyrat kryesore që ju duhet të merrni më mirë në dorë është çështja e edukimit ideopolitik të ushtarëve dhe të oficerëve. Përveç të tjerave, të organizoni mirë punimin e artikujve të rëndësishëm të

gazetës «Zëri i popullit». Këta artikuj që boton herë pas here kjo gazetë janë mbi baza të marksizëm-leninizmit, prandaj punimi i tyre i kalit ideologjikisht ushtarët dhe oficerët. Në rast se u zhvillohet një temë mbi luftën që kanë bërë në kohën e tyre Lenini dhe Stalini kundër Buharinit dhe Trockit, do të ketë vështirësi në kuptimin e saj, por në qoftë se punohet një artikull nga «Zëri i popullit» që është i ilustruar edhe me probleme e shembuj aktualë, kjo do të ndihmojë që të kuptohet më mirë edhe lufta që është zhvilluar kundër oportunistëve të vjetër.

Për këto materiale nuk duhet mjaftuar vetëm me një të lexuar, ato në dukje janë të thjeshta e të kuptueshme, por çështja është që të depërtohet në thellësinë e tyre. Kështu, po të diskutohen e po të shpjegohen mirë problemet, njerëzit nuk do të qëndrojnë në sipërfaqen e tyre. Nikita Hrushovi është tradhtar, por metodat që përdor për të luftuar marksizëm-leninizmin, Leninin dhe Stalinin, me një të lexuar nuk të mbeten të gjitha në mendje, kurse ne duam që këto të rrënjosen mirë te njerëzit, në mënyrë që këta të jenë në gjendje të kuptojnë me lehtësi çdo situatë e çdo dredhi të armikut. Kështu duhen lexuar dhe duhen studiuar këta artikuj, të cilët kanë rëndësi të madhe parimore dhe një përmbajtje të thellë politike e ideologjike.

Programi i punës suaj ideopolitike nuk është i veçuar, por i lidhur ngushtë me përgatitjen dhe me rritjen e aftësisë luftarake si dhe me përvetësimin e teknikës. Gjithë puna politike dhe ideologjike e Partisë në forcat e armatosura duhet të shërbejë për t'i edukuar

ushtarakët që të zbatojnë detyrat shtetërore me një ndërgjegje të lartë. Ushtari ynë duhet të dijë mirë si ta vrasë armikun dhe përse e vret atë.

Ju uroj, shokë, që në punën tuaj të keni suksese edhe më të mëdha!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

SOCIALIZMI BAZOHET NË PUNËN E PËRBASHKËT

*Fjala para kooperativistëve të Bërdicës
të rrethit të Shkodrës*

20 qershor 1964

Para se t'u fliste kooperativistëve, shoku Enver Hoxha u drejtoi atyre këto pyetje:

A është më mirë të jesh i bashkuar në kooperativë? A jeni të kënaqur nga puna e përbashkët? Si e keni organizuar punën? Si punojnë drejtuesit tuaj? A e dëgjojnë këta fjalën e kooperativistëve?

Dhe pasi mori përgjigje nga kooperativistët, shoku Enver Hoxha tha:

Siç e dini, më parë, si kudo në vendin tonë, edhe në anët tuaja secili punonte për veten e tij, por, sado që punonte, fshatari i veçuar nuk mund t'i merrte tokës ato të mira që jep ajo kur punohet bashkërisht. Puna e përbashkët të jep më shumë sesa ajo e individëve të veçuar, pse, sikurse thotë populli, «bashkimi bën fuqinë». Nga puna e përbashkët në kooperativë, dalngadalë do të largohet ndjenja e pronës private dhe kur të zhvillohet akoma më tepër ndjenja e bukur e

pronës së përbashkët, edhe puna do të shkojë më mirë. Prandaj duhet ta forconi gjithnjë e më shumë ndjenjën e pronës së përbashkët dhe të gjithë të punoni që pasurinë e kooperativës ta ruani dhe ta shtoni vazhdimisht, që t'i jepni sa më shumë kolektivit.

Por Partia, duke futur frymën e kolektivizmit te njerëzit, punon që t'i edukojë ata me këtë frymë. Prona private, shtypja dhe shfrytëzimi i borgjezisë, i bejlerëve dhe i agallarëve, regjimet në fuqi nuk i lejojnë popujt kudo në botë që të jetojnë tamam si njerëz, kurse në socializëm populli punon për vete. Është e vërtetë se më parë njeriu duhej të mendonte për të ardhmen e tij dhe të familjes, sepse regjimet e kaluara nuk mendonin për njerëzit, për punëtorin dhe për fshatarin, por vetëm për veten e për pasurinë e tyre, duke shtypur e duke shfrytëzuar të tjerët. Sot për ta mendojnë gjithë kolektivi, shoqëria e shteti. Partia dhe Qeveria mendojnë për shëndetin e popullit, prandaj për këtë qëllim kanë ngritur spitale dhe ambulanca, ku punëtorët e fshatarët mjekohen falas.

Kur hytë në kooperativë, ju nuk i mendonit gjithë këto të mira që ka krijuar e krijon ajo. Tani në kooperativë është rritur shkalla e mekanizimit, sistemi i ujitjes e i plehërimit të tokës, për pasojë, rendimentet janë të larta dhe të ardhurat për ditë-punë janë më të mira, pra dhe niveli i jetesës është përmirësuar. Ja, pra, ç'bën puna e përbashkët, kooperativa, bashkimi i dëshirave të njerëzve, kujdesi i shtetit për fshatarësinë punonjëse.

Në shoqëri gjithsecili mendon të rregullojë punën ose jetën e tij, kjo është e natyrshme dhe e mirë, por

ka edhe disa gjëra që janë të përgjithshme. Ndonjëri mund të mendojë, për shembull, të mos vejë vetë në shkollë ose të mos e dërgojë fëmijën për të mësuar, kurse Partia na mëson se në shkollë duhet të shkojnë të gjithë, pse ajo zbukuron dhe ndriçon mendjen. Në fillim ishte e detyruar shkolla fillore, më pas detyrimi u bë për 7-vjeçaren, kurse tani u bë për shkollën 8-vjeçare. Më parë ndonjë mund të thoshte: «Ç'është kjo punë, përse duhet medoemos të vesh në shkollë?!», ndërsa tani kjo po kuptohet si një nevojë për të gjithë.

Edhe pjesëmarrja në punë është bërë një ndjenjë e përgjithshme. Tani të gjithë punojnë, po ka edhe disa nga ata që kanë mbetur prapa. Kryetari i kooperativës suaj më tha se në punë dallohen veçanërisht gratë. Gjithë ndërtimi dhe zhvillimi i socializmit janë të bazuar mbi punën. Prandaj, në jetën kolektive që keni krijuar, duhet ta zhvillonin edhe më tej disiplinën në punë dhe ndjenjën e përbashkët për të, sepse disiplina e fortë në punë të sjell shumë të mira. Kush punon më mirë e më shumë në kooperativë, ai siguron edhe më shumë të ardhura. Në kooperativë nuk duhet që çdo njeri ta fillojë punën sipas qejfit, por të gjithë të shkojnë të organizuar në brigada e në skuadra dhe punën ta bëjnë çdo ditë e më të mirë, më të kënaqshme dhe më të këndshme, që duke punuar edhe të këndojnë, në mënyrë që bashkë me grurin që rritet nga puna, të rritet e të zhvillohet edhe njeriu i ri socialist. Partia, në radhë të parë, përpiket t'i edukojë e t'i zhvillojë njerëzit, dhe tok me ta, ajo shton e zgjeron të gjitha këto mjete që t'i ndihmojnë në punën e tyre. Fshatarësisë sonë kooperativiste i vihet detyra të më-

sojë më mirë bujqësinë. Të mos mendoni kurrë se këto që dini janë të mjaftueshme. Rritja e njohurive shkencore për zbatimin e agroteknikës ka rëndësi mjaft të madhe, sepse kjo luan një rol të rëndësishëm për rritjen e rendimenteve.

Do të vijë një kohë që do të kemi në mënyrë të kënaqshme çdo gjë, si mjetet e mekanizuara ashtu edhe plehun, por përveç këtyre duhet të zotërosh mirë edhe zanatin. Tani vihet detyra për të mësuar teknikën bujqësore. Pra, ju duhet t'u vini veshin mirë teknikëve dhe agronomëve dhe të veproni si ju thonë dhe ju rekomandojnë ata, të hapni sytë e të dëgjoni me vëmendje ato që këshillojnë ata dhe të luftoni për t'i zbatuar, për t'i vënë në jetë, sepse atëherë do të dini të përdorni më mirë traktorët, kultivatorët, plehtrat kimike, do të mësoni si të vilni e të thani më mirë duhanin etj. Këto njohuri teknike duhet që kooperativistët t'i mësojnë. Sot kooperativa juaj mund të ketë vetëm një agronom, kurse vitet e ardhshme do të ketë më shumë kadro të lartë e të kualifikuar. Partia do të mendojë, gjithashtu, që djemtë dhe vajzat tuaja, që mbarojnë shkollën 7-8-vjeçare të mësojnë edhe më tej nëpërmjet kurseve e shkollave bujqësore për problemet e bujqësisë. Ju mbillni këtu duhan, misër dhe oriz, prandaj të rinjtë dhe të rejat duhet të mësojnë agroteknikën e misrit, të orizit dhe të duhanit, në mënyrë që të dinë, shkencërisht, si punohet toka dhe sa pleh duhet t'i hidhet asaj për secilën kulturë, si të sigurohet farë e mirë etj. Kështu, në të gjitha kooperativat bujqësore të Shqipërisë, do të përgatiten një numër i madh kuadrosh dhe bujqësia do të përparojë më shpejt.

Kooperativa bujqësore është një organizatë ekonomike nga më demokratiket, prandaj atë duhet ta forconi çdo ditë e më shumë. E gjithë udhëheqja e kooperativës zgjidhet, prandaj ajo duhet të përbëhet nga njerëzit më të mirë, më punëtorët dhe më të mësuarit që çdo gjë që dinë ta vënë në shërbim të kooperativës, në shërbimin tuaj. Për këtë arsye detyrat që ju ngarkon kryesia, duhet t'i zbatoni me rigorozitet.

Kooperativat duhet të përpiqemi t'i forcojmë në çdo drejtim, pse kundër sistemit kooperativist janë hedhur në sulm mjaft armiq. Përveç imperialistëve kanë dalë edhe revizionistët, të cilët kanë për qëllim të shkatërrojnë socializmin, të prishin kooperativat bujqësore. Në Jugosllavinë titiste s'ka fare kooperativa bujqësore. atje janë në fuqi pasanikë të vjetër, por përveç këtyre, janë krijuar edhe të rinj. Në këto kushte të vështira, fshatarët jugosllavë, sidomos shqiptarët e Kosovës, janë të detyruar të ikin nga Jugosllavia për në Turqi dhe në Evropën Perëndimore, ku kërkojnë punë për të siguruar bukën e gojës. Titoja dhe Hrushovi synojnë të shkatërrojnë socializmin në Shqipëri, por ata nuk do të mundin kurrë ta bëjnë këtë, përkundrazi në këto përpjekje të tyre do të humbasin, pse socializmi te ne ka fituar dhe do të fitojë. Jeta ka vërtetuar se armiqtë tanë, megjithëse kanë qenë të shumtë, kurdoherë janë mundur.

Në vendet revizioniste ekonomia shkon gjithnjë e më pas, kurse ne ecim përpara. Më parë shumë fshatarë nuk e kuptonin se me punën në kooperativë mund të siguronin të ardhura e të jetonin më mirë, prandaj disa mendonin të shkonin në qytet, se gjoja kjo rrugë

do të ishte më e mirë për familjet e tyre. Kurse vitin e kaluar, duke u mobilizuar më tepër në punët e kooperativës, ju e prodhuat bukën vetë, i shlyet shtetit borxhet dhe morët më shumë të ardhura. Kjo është një gjë shumë e mirë. Por ju nuk duhet të mendoni të bëni bukën vetëm për vete, sepse drithërat që merr shteti, i përdor për furnizimin e popullit, dhe sa më shumë të ketë shteti, aq më shumë ka edhe për ju. Këto janë të lidhura. Çdo vit që vjen, do të sjellë begati, sepse kooperativa drejtohet më mirë dhe forcat i keni të bashkuara, pra keni kaluar në një ekonomi më të madhe e më të përparuar. Ndërsa vitin e ardhshëm do të jeni gjithashtu edhe më përpara, sepse Qeveria ka në plan dhe do të sjellë traktorë të tjerë, do të përmirësohen farnat, do të shtohet sipërfaqja e ujitshme etj., kurse pesëvjeçarin tjetër, kooperativa, ashtu si gjithë ekonomia e vendit, do të ecë me hapa akoma më të mëdhenj.

Plani i ardhshëm pesëvjeçar do të ketë rëndësi të madhe, veçanërisht për bujqësinë. Ju e dini se do të ndërtohen uzinat e plehrave kimike, të cilat do të bëjnë që të rritet shumë rendimenti i prodhimeve bujqësore. Do të sjellim nga jashtë shumë traktorë, pa folur për makinat e tjera bujqësore. Një kujdes të posaçëm do t'i kushtojmë zgjerimit të sipërfaqes së ujitshme jo vetëm në zonat fushore, por edhe në ato malore. Për këtë qëllim shteti do të investojë shuma të mëdha.

Përveç bujqësisë do të përparojë edhe industria. Fabrika të reja do të ngrihen, do të shtohet prodhimi i bezes dhe i mallrave të tjera të konsumit të gjerë, për të cilat ka nevojë populli. Ju mund të thoni se këto fa-

brika na i japin miqtë, kjo është e vërtetë, por ato kush-tojnë dhe duhen paguar. Ndihma, natyrisht, ka rëndësi, por më e rëndësishme është puna e vetë popullit tonë, sepse kreditë me të cilat duhen blerë fabrikat, dalin nga djersa e popullit. Ndërtimi i fabrikave, i uzinave e i minierave etj., të cilat do të bëhen me mundin e djersën e popullit tonë, do të na sigurojë të ardhura për rritjen e nivelit të jetesës, sepse mallrat e konsumit do të shtohen, çmimet do të vijnë duke u ulur, shtëpi të reja do të ndërtohen, pra jeta e popullit do të vijë gjithnjë duke u përmirësuar. Kështu ekonomia jonë në përgjithësi dhe ajo e kooperativës suaj do të rriten vazhdimisht. Kur të vij ndonjëherë tjetër në Bërdicë, ju do të më thoni: «Ku kemi qenë dhe ku kemi arritur!». Djemtë dhe vajzat tuaja do të kenë edhe biçikleta dhe, kur të jepet ndonjë shfaqje e bukur në Shkodër, do të kenë mundësi të venë e ta shikojnë. Më vonë do të ketë edhe autobus për të vajtur në Shkodër. Shtëpitë do t'i keni më të mira dhe të pajisura me orendi shtëpiake. Në vendin tonë do të kemi edhe uzina që do të përpunojnë naftën e gazin dhe do të nxjerrin prodhime sintetike të lira, të bukura dhe të forta, duke filluar qysh nga çorapet e grave e gjer te gotat e ujit dhe te kovat.

Edhe në vendet kapitaliste ngrihen fabrika moderne, po këto janë pronë e kapitalistëve, prodhimet atje mund të jenë të mira, po masat punonjëse nuk mund t'i blejnë ato se s'kanë para, qiratë e shtëpive janë të shtrenjta dhe jeta e popullit është e vështirë.

Partia përpiket që çdo problem t'ua bëjë njerëzve të kuptueshëm, pse kur populli është i qartë, nuk ndien vështirësi në luftë dhe në punë.

Tani ju jeni përpara punëve të mëdha të stinës. Mbjelljet e pranverës dhe korrjet e grurit i keni përfunduar, por duhet të luftoni që grurin ta fusni brenda sa më parë dhe të mos mbetet asnjë kokërr në arë. Nga duhani këtë vit do të keni të ardhura më shumë. Në qoftë se i bëni shërbimin më mirë, në oriz do të merrni prodhime më tepër, prandaj i vini rëndësi zbatimit të agroteknikës. Po kështu edhe për misrin.

Ju, siç më tha kryetari i kooperativës, keni të gjithë shtëpi, por Partia ju siguron se edhe drita elektrike do t'ju vijë dhe kjo ditë nuk është e largët. Ju keni dëgjuar që këtu afër, në Vaun e Dejës, do të ngrihet një hidrocentral i madh. Në Shkodër po ndërtohet edhe fabrika e telave të bakrit. Dritë elektrike nuk kërkoni vetëm ju, po të gjitha fshatrat, bile ka edhe qytete. Në Jug të Shqipërisë, sikurse keni dëgjuar, ndërtohet hidrocentrali i Bisticës, mirëpo në Delvinë që ndodhet pranë tij, dhe që nuk ka akoma energji elektrike, qytetarët thonë: si të mos marrim edhe ne dritë elektrike nga ky hidrocentral kur të ndërtohet? Por me radhë të gjithë do të marrin. Përse e themi ne këtë? Sepse energjinë elektrike e llogarisim, në radhë të parë, për nevojat e industrisë. Edhe ju nuk do të pranoni, për shembull, që kombinatin e tekstileve «Stalin» në Tiranë ta lëmë pa energji e të prodhojë më pak beze. Po t'ju pyesim, ju vetë do të thoni: jo, kjo të mos bëhet!

Në Shqipëri kudo punët shkojnë mirë dhe bazë për këtë është vija e drejtë e Partisë, besimi i madh dhe dashuria e pakufishme që populli ynë ka për Partinë, për komunistët.

Populli ynë e do Partinë me të gjitha forcat e shpir-

tit të tij, ashtu si edhe komunistët. Po përse, do të thoni ju, nuk bën pjesë kushdo në Parti? Komunistët kanë disa detyra më të rënda që duhet t'i kryejnë më parë se të tjerët. Ata duhet të jenë njerëz të sakrificës, revolucionarë, shembull në punë e në jetë, të ndershëm, të mësojnë të parët. Këto janë disa nga detyrat e rëndësishme që atyre komunistëve të cilët nuk i kryejnë mirë, Partia u thotë se nuk e meritojnë të qëndrojnë në radhët e saj dhe në vend të këtyre vijnë të tjerë që i thonë Partisë: «Unë jam nga ata që bëj ç'thotë Partia». Prandaj Partia i jep rëndësi shumë të madhe edukimit të rinisë dhe ata më të mirët i pranon në radhët e saj.

Komiteti Qendror i Partisë ka udhëzuar të forcohet Partia në fshat, domethënë nga fshati të pranohen më shumë anëtarë partie se deri tani, të pranohen më tepër sidomos vajza dhe gra, sepse në këtë drejtim jemi më pas. Në ara, dhe kudo që vemi, shikojmë se vajzat dhe gratë punojnë së bashku me burrat, atëherë përse të mos jenë tok edhe në Parti? Prandaj ta forcojmë Partinë, duke i shtuar radhët e saj me gra dhe vajza.

Shikoni, shokë kooperativistë, këtu pranë keni edhe një repart ushtarak, me të cilin duhet të forconi lidhjet, të bashkëpunoni e të ndihmoni njëri-tjetrin.

Mirupafshim! Ju uroj shëndet dhe suksese edhe më të mëdha në punën tuaj!

Rroftë Partia!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

KOMUNISTI ËSHTË I PARI NË SULM DHE I FUNDIT NË TËRHEQJE

Fjala në takimin me komunistët e organizatave-bazë të Partisë të Fabrikës së Cigareve, të SMT-së dhe të Fabrikës së Tisazhit në Shkodër me rastin e shpërndarjes së tesarave të reja të Partisë

20 qershor 1964

Të dashur shokë,

Ju sot jeni të gëzuar që merrni tesarat e reja të Partisë. Po edhe unë jam shumë i gëzuar që ndodhem këtu në Shkodër, në mes jush, në këtë moment solemn të ndarjes së tesarave të reja të Partisë disa komunistëve të organizatës së Partisë të rrethit tuaj.

Natyrisht ju jeni të gëzuar që merrni tesarat e reja, por ju vjen edhe keq që ndaheni nga tesarat e vjetra, pse me to keni një varg kujtimesh. Tok me to, duke i mbajtur në gji, ju keni luftuar me vetëmohim gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, keni kryer detyrat e mëdha të pasçlirimit, keni bërë sa e sa sakrifica, të cilat ju janë dukur si detyra nga më të thjesh-

tat, keni vënë të gjitha forcat tuaja për të kryer me nder detyrat e mëdha që ju ka ngarkuar populli. Pra, tesarat e vjetra ju kanë shoqëruar në luftën tuaj të përditshme. Por duke marrë të rejat, jeni po ashtu të gëzuar, sepse, megjithëse tesarat ndërrohen, puna e Partisë sonë s'ka ndërprerje, ajo është një vijë e vetme e shkëlqyer.

Rëndësi të madhe ka për ne komunistët shqiptarë çështja që tesarat e Partisë nuk ndahen çdo vit, ashtu sikurse ndodh në disa parti të vendeve të ndryshme, si dhe fakti që ato nuk ndahen duke bërë rishqyrtimin e aktivitetit politik, ideologjik e revolucionar të komunistëve, siç ngjet në shumë parti të tjera. Rishqyrtimi i gjendjes së anëtarëve të Partisë te ne është bërë një herë dhe atëherë ajo ishte e domosdoshme për ta kalitur Partinë, për ta spastruar atë nga elementët që kishin mundur të hynin kontrabandë në Parti, duke fshehur të kaluarën e tyre.

Partia e Punës e Shqipërisë ndjek një vijë të drejtë marksiste-leniniste revolucionare, një vijë politike, ideologjike dhe organizative të tillë që për çdo shqiptar pranimi në radhët e saj është bërë një nga qëllimet dhe dëshirat më të zjarrita. Secili komunist duhet ta dijë se pranimi në Parti nuk i sjell asnjë favor personal, nuk i lejon të përfitojë qoftë edhe një majë gjilpëre më tepër nga të tjerët, por përkundrazi e ngarkon me detyra të rënda, kërkon sakrifica, të jetë kurdoherë në ballë të luftës dhe, kur ta lypë nevoja të jetë i pari në sulm dhe i fundit në tërheqje, të jetë i ndershëm dhe të mësojë vazhdimisht.

Çdo komunist, kur futet në Parti, e ndien veten

si në një familje të madhe, të fortë, të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin nga qëllimi i lartë për fitoren e lirisë së vërtetë, jo vetëm për bashkatdhetarët e tij, por për të gjithë popujt liridashës të botës. Futja në Parti komunistit i zhvillon mendjen, e bën atë të fortë si çelik, me ndjenja të pastra, që të jetë zemërmirë, por jo pacifist, të ketë zemër të bardhë për popullin e tij dhe për të gjithë njerëzit që vuajnë nga shtypja e nga skllavërimi, e bën të ashpër kundër atyre që kërkojnë të gënjejnë popullin dhe ta çojnë në rrugë të gabuar.

Ai që futet në Parti e shikon se ajo nuk është një Parti sektare dhe e mbyllur, një parti socialdemokrate e shthurur dhe pa principe, që lufton vetëm për të grumbulluar vota, për të gënjyer klasën punëtore, me qëllim që t'i zgjatë jetën kapitalizmit për të mbajtur popullin nën zgjedhë. Jo, Partia jonë është një Parti krejt e ndryshme nga ato. Partia jonë ndryshon gjithashtu edhe nga partitë revizioniste, të cilat s'kanë një disiplinë të ndërgjegjshme në radhët e tyre, sepse ato kanë si qëllim të përçajnë proletariatin në luftën e tij kundër kapitalit dhe imperializmit, kurse Partia jonë është një Parti proletare marksiste-leniniste, e kalitur në beteja me armiqtë e klasës. Proletariati e di që ka përpara një armik të egër dhe se kundër tij mund të fitojë vetëm duke organizuar e duke bashkuar forcat dhe duke pasur një disiplinë të ndërgjegjshme. Këtë disiplinë proletariati e ka mësuar në luftë, me gjak, me djersë. Kjo disiplinë e ndërgjegjshme është bërë vija e Partisë sonë.

Pra komunistët hyjnë në Parti duke ditur se këtu ka disa rregulla që duhet t'i zbatojnë me ndërgjegje të lartë politike, sepse vetëm kështu sigurohet fitorja e

revolucionit, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit. Duke qenë e tillë dhe duke i edukuar anëtarët e saj me një frymë të lartë revolucionare, në Partinë tonë nuk është e nevojshme të bëhet ndërrimi i shpeshtë i dokumenteve ose të rishikohet gjithë jeta e veprimtaria e komunistëve. Kjo është një fitore e madhe.

Natyrisht, kjo nuk do të thotë se komunistët shqiptarë janë të prerë të gjithë si me gërshërë, nuk kanë të meta, ose nuk bëjnë kurrë gabime. Jo. Në Partinë tonë ka edhe shokë që nuk i kuptojnë plotësisht detyrat e mëdha që kanë përpara, nuk i zbatojnë si duhet detyrat që u ngarkohen, nuk janë kurdoherë në krye të punës dhe shembull në çdo gjë, nuk bëjnë sa duhet përpjekje për edukimin komunist, megjithëse shumica dërrmuese luftojnë me vetëmohim në vijën e drejtë të Partisë. Por normat e Partisë sonë janë të atilla që komunistët ndihmojnë shoqi-shoqin për të kryer me sukses detyrat që ka mbi supe Partia; Partia përpiqet me forma të ndryshme që, edhe ata që kanë nivel të ulët kulturor ose të meta të tjera, t'i ndreqë, t'i hedhë në pararojë, t'i bëjë komunistë të vërtetë.

Partia jonë është një Parti e çeliktë, që ka kaluar përmes furtunash të mëdha dhe u ka bërë ballë me sukses, duke fituar mbi armiqtë e egër e dinakë. Partia i ka edukuar politikisht dhe ideologjikisht anëtarët e saj të ecin në rrugën revolucionare dhe të dinë të dallojnë armikun dhe metodat e punës së tij, të dallojnë ata që bëjnë gabime nga padituria, nga ata që në mënyrë të ndërjegjshme përpiqen ta dëmtojnë çështjen e Partisë e të popullit. Partia i ka edukuar komunistët që të kritikojnë pa druajtje cilindo që nuk

ecën në rrugë të drejtë. Në drejtim të rritjes së ndër-gjegjes së komunistëve, kemi akoma një punë të madhe për të bërë, në mënyrë që çdonjëri prej tyre të shikojë me syrin kritik punën e përditshme të secilit, nëse ajo u shërben apo jo interesave të përgjithshme të popullit dhe të Partisë. Në qoftë se një punë bëhet në interes të popullit e të Partisë, ajo duhet kryer, në rast të kundërt komunisti duhet të jetë vigjilent.

Kritika dhe autokritika e mirë nuk bëhen vetëm në mbledhje, por edhe vazhdimisht në punë e sipër. Kur një komunist bisedon me përgjegjësin e tij dhe shikon se ai nuk ka të drejtë, pasi e dëgjon me vëmendje, duhet t'i thotë përgjegjësit mendimin e vet. Me fjalë të tjera, kjo është një kritikë. Në këtë rast drejtori ose sekretari i Partisë nuk duhet të thotë se fjala ime është e paprekshme, se unë jam superior, prandaj «të bëhet ashtu siç them unë» edhe kur ai s'ka të drejtë; ky nuk do të ishte një qëndrim korrekt. Në qoftë se nuk ka të drejtë, drejtori ose sekretari i Partisë, aty për aty, duhet të pranojë gabimin. Ata komunistë që veprojnë në këtë mënyrë, do ta çojnë punën e tyre kurdoherë përpara. Kështu do të bëhet më pak kritikë dhe autokritikë zyrtare.

Kritika dhe autokritika zyrtare kanë rëndësi më të madhe, sesa vërejtja që i bëhet drejtorit ose sekretarit të Partisë në punë e sipër, pasi këtë ai mund ta pranojë, por pastaj vazhdon si më parë. Kurse kur shtrohet çështja në organizatën-bazë është ndryshe, këtu nuk janë dy ose katër sy, po shumë që shikojnë nëse e bën autokritikën sa për të kaluar radhën, apo e ka kuptuar dhe e ka ndierë si duhet gabimin. Shokët e tu

të organizatës-bazë të Partisë, duke të shikuar në sy të kuptojnë nëse fjalët që thua janë ose jo të sinqerta. Po të jesh i sinqertë, Partia të kupton. Ka njerëz që nuk dinë të thonë shumë fjalë, po me ato pak fjalë thonë: «Shokë, unë kam bërë gabim dhe ju jap fjalën se nuk do të bëj më gabime të tilla», të tjerët e kuptojnë se këto fjalë ky komunist i thotë me sinqeritet dhe në këtë rast nuk është nevoja t'i thuhet: «Thellohu më shumë, shok!». Kurse mund të jetë një komunist tjetër, që e ka gojën brisk, të flet një orë e gjysmë duke u justifikuar dhe mund të ketë nga ata syleshë që thonë: «Ama ç'autokritikë!». Prandaj, shokë, atje ku ka të meta dhe gabime, ta forcojmë punën që jo vetëm të kryejmë si duhet detyrat që na shtron Partia, por të kryejmë më së miri dhe detyrat ndaj lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Partia jonë e Punës, e cila qëndron në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, jo vetëm që i ka bërë ballë me sukses luftës kundër imperializmit e revizionizmit, por është bërë shembull për të gjitha partitë e tjera dhe revolucionarët në botë, duke treguar se, për të fituar revolucionin dhe për të ndërtuar socializmin, duhet që partia të ndërtohet mbi parimet e marksizëm-leninizmit. Partitë që udhëhiqen nga këto parime, duhet të shkatërrojnë demagogjinë e revizionistëve modernë, të cilët, për të fshehur tradhtinë e tyre, ngrihen edhe çështjen e kultit të individit të Stalinit. Nën maskën e kultit të individit N. Hrushovi kishte për qëllim të diskreditonte jo vetëm figurën e Stalinit, por edhe veprën e Leninit, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit në Bashkimin Sovjetik. Prandaj Partia jonë

ka një detyrë të madhe për demaskimin e kësaj bande.

Revizionistët modernë e kanë të qartë se në Shqipëri është një situatë e shëndoshë revolucionare në Partinë dhe në popull, se të gjithë të bashkuar i janë përvetur punës për ndërtimin e socializmit dhe, njëkohësisht, pushkën e mbajnë afër. Revizionistët modernë e dinë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Shqipëria e vogël është bërë një shkëndijë e marksizëm-leninizmit. Kjo shkëndijë që duket si një pikë e vogël në oqeanin e Evropës kapitaliste dhe revizioniste, u shkakton revizionistëve një dëm jashtëzakonisht të madh, prandaj ata zhvillojnë një fushatë të madhe shpifjesh e intrigash kundër Partisë dhe vendit tonë, po armët e tyre janë thyer e do të thyhen kurdoherë.

Në vendet dhe në partitë ku janë në fuqi revizionistët ka filluar të vlojë kusia gjersa të hedhë tej kapakun. Qoftë në Bashkimin Sovjetik, qoftë në vendet e ish-demokracisë popullore, diktatura e proletariatit është kthyer në një diktaturë borgjeze, ajo nuk drejtohet më kundër kulakëve dhe agjentëve të huaj, që futen në vendet e tyre me dhjetëra mijë nga jashtë, po kundër popullit dhe komunistëve, të cilët nuk pranojnë tradhtinë. Kështu në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e ish-demokracisë popullore po mbushen burgjet dhe kampet e përqendrimit. Revizionistët e bëjnë gogol dhe e akuzojnë Partinë e Punës të Shqipërisë për terror, kurse në të vërtetë në vendet e tyre ka terror, dhe këtë ata e kanë të shkruar edhe në statutin e partisë. Atë që Titoja e bën fshehtazi, Zhivkovi që është shërbëtori më i përulur i N. Hrushovit e deklaroi hapur në statutin e Partisë Komuniste të Bullgarisë, ku thuhet se, ata

që nuk ndjekin vijën e tij, janë «dogmatikë» dhe «sektarë», prandaj duhet të përjashtohen menjëherë nga partia, pavarësisht nëse kanë luftuar dhe e kanë mbushur gjoksin me dekorata. Kështu revizionistët bullgarë kanë filluar të bëjnë spastrime në parti. Kjo tregon se ata e kanë gjendjen pisk dhe janë të dobët, prandaj nuk mund të përdorin armën e drejtë të partisë për t'i edukuar e për t'i bindur njerëzit, por arrestojnë, burgosin, internojnë. Pra, diktatura e proletariatit përdoret nga revizionistët modernë kundër komunistëve të vërtetë dhe për t'i hapur rrugë ideologjisë borgjeze në partitë dhe në vendet e tyre. Por demagogjia e revizionistëve i ka kaluar kufijtë. Në qoftë se më parë kishte pak njerëz që e kuptonin tradhtinë e revizionistëve, sot janë mijëra, kurse nesër do të bëhen qindra mijë, pavarësisht nga terrori i tërbuar. Komunistët e kanë njohur terrorin në luftën kundër kapitalit e fashizmit dhe nuk u është trembur syri.

Me demaskimin që i ka bërë Partia e Punës e Shqipërisë, grupit të Hrushovit nuk i shkojnë punët mirë në të gjitha drejtimet. Përpara disfatave që ai ka pësuar, komunistët e shëndoshë dhe ata që ishin gënjer në fillim po ngrihen, çështja e revolucionit ecën gjithnjë përpara, pse, sa më tepër shtypje të ketë, aq më shumë revolucioni shkon në ngritje. Kështu do të fillojë përsëri revolucioni në Bashkimin Sovjetik, sepse ashtu sikurse kapitalistët dhe revizionistët nuk e lëshojnë kursesi vetë pushtetin. Elementët revolucionarë tani po njihen, po gjejnë njëri-tjetrin dhe po organizohen. Në Bashkimin Sovjetik, megjithëse agjencia hrushoviane forcohet çdo ditë e më shumë, hidhen trakte me emrin «Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit So-

vjetik». Në vendet e tjera, si në Bullgari, flasin hapur kundër politikës së Zhivkovit jo vetëm populli, po ka edhe nga njerëzit e tyre.

Në këto momente përpara nesh dalin detyra të mëdha. Partia jonë ka mbajtur kurdoherë barrë të rëndë mbi supe dhe do të mbajë gjersa këta tradhtarë të shkatërrohen plotësisht, sepse revizionistët modernë janë aleatë të imperializmit dhe kanë si qëllim të degjenerojnë marksizëm-leninizmin dhe komunizmin. Ky është drejtimi kryesor që imperializmi amerikan i ka dhënë revizionizmit hrushovian. Në shumë çështje kryesore N. Hrushovi është puqur me imperializmin amerikan dhe do të shkojë duke u lidhur gjithnjë e më ngushtë për të diskredituar socializmin. Ai i ka hedhur baltë kohës së Stalinit; sipas tij, këtë kohë e karakterizonin gjoja terrori dhe vrasjet dhe se socializmi sot po ndërtohet kudo, në Indi nga Nehru, në Egjipt nga Naseri e në Irak nga Arefi, bile për socializmin lufton Gi Moleja në Francë etj. Kjo do të thotë të diskreditosh socializmin dhe të predikosh ndërtimin e socializmit në gjirin e kapitalizmit.

Të gjitha fjalët që thotë Hrushovi për çarmatim janë bluf. Këtë e di mirë edhe imperializmi amerikan. Me këtë Hrushovi do t'u thotë të tjerëve që çarmatosuni ju, kurse unë të kem edhe armë edhe bomba. Ai mendoi se me veprimet e tij do të gjunjëzonte Partinë dhe vendin tonë, po planet e tij dështuan, sepse Partia jonë ka një eksperiencë të madhe në luftën kundër armiqve.

Pra, të jeni të gëzuar që merrni sot taserat e reja të Partisë. Kjo taserë është e vogël, por në të përmbli-

dhet dhe simbolizohet e gjithë lufta e ashpër që ka bërë populli ynë, të cilin e ngriti në këmbë Partia. Partia e mësoi popullin si duhet të luftojë dhe të bashkohet, çfarë ideali duhet ta udhëheqë, me çfarë mjetesh shpirtërore dhe morale duhet të luftojë për të mposhtur armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm. Në këtë luftë të madhe, në të cilën komunistët u bënë pishtarë, Partia jonë shkroi faqe të lavdishme. Këtu në Shkodër kanë luftuar për përhapjen e ideve komuniste, komunistë të vjetër, si Qemali, Vasili, Vojo dhe qindra të tjerë, të cilët u hodhën me guxim në luftën çlirimtare qysh në ditët e para dhe dhanë jetën në lulen e rinisë. Emrat e tyre dhe të të gjithë shokëve tanë janë shkruar në këtë tesarë të vogël, këtu janë shkruar fshatrat që u dogjën, vendet dhe gërxhet ku është luftuar. Këtu janë shkruar veprat e mëdha të Partisë: krijimi i çetave partizane, i brigadave, i divizioneve, i korparmatave, krijimi i kuadrove tanë të dalë nga gjiri i klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, të cilët nuk ishin të përgatitur si oficerët e armiqve në shkolla dhe akademi, po që Partia i mësoi si të luftonin, të rrethonin armikun dhe ta asgjësonin, i bëri të aftë ta mundnin atë.

Atdheu u çlirua. Ata që luftuan me armë zbritën nga malet, por edhe ata që nuk morën pushkën e s'dolën në mal, luftuan në qytet. I gjithë populli luftoi. Edhe një sabotim i vogël, edhe një pengesë sado e vogël që i shkaktohej armikut në punën e tij, ishte një ndihmë e madhe për luftën tonë të drejtë. Pas Çlirimit vendi ishte i shkatërruar dhe i djegur, por ata që kishin luftuar dhe ata që nuk kishin marrë armët u mobilizuan menjëherë për rindërtimin e vendit, i ci-

li ndryshoi pamjen brenda një kohe të shkurtër. Armiqve të shumtë iu tregua vendi. U vendos drejtësia e duhur. Partia ishte e rreptë kundër armiqve të popullit dhe e gjerë për ata që u bindeshin ligjeve të tij dhe të Partisë. Nga një anë ndërtohej socializmi dhe nga ana tjetër edukoheshin njerëzit që kishin gabuar.

Në sajë të politikës së drejtë të Partisë sonë u brumos një dashuri e madhe për Bashkimin Sovjetik, për Stalinin dhe për të gjitha partitë e tjera komuniste që luftuan kundër fashizmit e filluan ndërtimin e socializmit. Vija e drejtë e Partisë sonë bëri të arrijmë sukseset dhe të mirat që gëzojmë sot. Pra të gjitha këto, që nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, shkatërrimet e saj dhe sukseset që kemi arritur në ndërtimin socialist të vendit, janë të shkruara në këto fletë të vogla që ka tesera e Partisë.

Njëzet vjet kanë kaluar nga koha e Çlirimit të vendit. Sa pak fabrika kishim atëherë dhe sa shumë kemi sot! Sa e sa të tjera do të kemi në të ardhmen. Ju do të shihni më shumë se jeni të rinj, po edhe ata që janë sot në moshën 50 vjeç, do të rrojnë akoma dhe do të shohin se brenda 20 vjetëve do të bëhen shumë ndërtime në vendin tonë sa sot nuk mund të imagjinohen. Plani pesëvjeçar që po hartohet është një plan madhështor. Kur realizuam planin e parë pesëvjeçar në disa harta me drita, një këtu dhe një atje, tregonim fabrikat e ndërtuara gjatë kësaj kohe. Ndërsa tani, po ta marrësh hartën e Shqipërisë, do të shikosh se ajo është e mbushur plot me drita, kurse me fabrikat që do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit të ardhshëm, harta do të mbushet e gjitha me drita të kuqe.

Në bujqësi janë arritur gjithashtu suksese të mëdha në kolektivizim, në tharje kënetash, në vepra uj-tëse, në mekanizim. Po t'i krahasojmë këto me të kaluarën, gjendja ka ndryshuar si dita me natën. Investimet e pesëvjeçarit të ardhshëm do të jenë jashtëzakonisht të larta dhe rritja e rendimentit në prodhimet bujqësore do të bëjë që populli të furnizohet akoma më mirë. Vetëm me ndërtimin e uzinës së plehrave kimike ne do t'i japim një hop të madh bujqësisë. Do të shtohet numri i traktorëve, i buldozerëve dhe i mjeteve të tjera për të shfrytëzuar kudo mundësitë e ujitjes etj.

Në taserën e Partisë janë shkruar sukseset tona në revolucionin kulturor. Në të gjithë vendin sot ka shkolla që nga filloret e gjer te universiteti. Më parë kuadrot e lartë numëroheshin me gisht, kurse sot në çdo fabrikë, ashtu sikurse në stacionin e zooteknisë, gjejmë një numër të madh kuadros të lartë, të dalë nga dyert e universitetit ose të instituteve tona. Kjo u bë e mundur sepse Partia u dha mundësinë njerëzve të mësojnë, pasi pa mësim, pa dituri nuk mund të shkohet përpara.

Kur shkon në fabrika, ndien një gëzim të madh, sepse shikon që ato ndodhen në duart e sigurta të njerëzve që e duan zanatin. Miq që vijnë në Shqipëri, habiten për punën e popullit tonë dhe u thonë njerëzve të tyre: mësoni nga shqiptarët, pse këta bëjnë gjëra të mrekullueshme. Ata shohin në kuadrot tanë shkathtësinë dhe vendosmërinë e tyre në punë. Edukimi i kuadrove me frymën që t'i shërbejnë popullit është një problem me rëndësi. Këta, pasi mbarojnë shkollat, duhet t'i përvishen punës për të ngritur në kategori më

të larta edhe punëtorët, duke u mësuar atyre teorinë. Të tillë njerëz edukon Partia jonë.

Ka ardhur koha që nga shkollat tona të larta, të ditës e të natës, dalin çdo vit mbi një mijë kuadro të lartë. Megjithatë kjo është e pamjaftueshme. Kohët e fundit Byroja Politike mori vendim që të ngrihen një sërë institutesh të larta kërkimore-shkencore, të cilat do t'i japin hov të madh zhvillimit të shkencës sonë. Shkollat kanë për detyrë të nxjerrin kuadro të lartë të përgatitur në teori dhe në praktikë për t'u hedhur në frontin e madh të prodhimit, kurse ata më të mirët, që janë më të dalluar në matematikë, në fizikë e në kimi, do të kalojnë në institutet kërkimore-shkencore, ku do të ndihmohen nga specialistët më me eksperiencë. Ne kemi të tillë, të vjetër dhe të rinj. Atje Partia do t'u hapë perspektiva të bëjnë përpjekje për të zgjeruar prodhimin në të gjitha degët e ekonomisë dhe për të zgjidhur shumë probleme që i dalin përpara zhvillimit të vendit tonë. Kështu, për shembull, për të përmirësuar tokat që kanë shumë aciditet, duhet ditur sa dhe çfarë plehu t'u hedhësh, po kjo nuk mund të bëhet në mënyrë mekanike. Prandaj institutet tona shkencore do të studiojnë në mënyrë shkencore sa azotik ose fosforit u duhet hedhur këtyre tokave, në mënyrë që të marrim nga ato jo 10 kv grurë për ha, por më shumë. Këto institute do të studiojnë edhe shumë çështje të tjera, si për mineralet e rralla, do të bëjnë kërkime, zbulime etj. Në të ardhmen do të ngrihen institute të tjera shkencore, të cilat do të shërbejnë si bazë për krijimin e Akademisë së Shkencave në vendin tonë.

Pra, në taserën e Partisë janë të shkruara e ardh-

mja e ndritur e Shqipërisë, ndërtimi i socializmit dhe i komunizmit, lufta që kemi për të zhvilluar kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, si dhe lufta që duhet të bëjmë kundër mbeturinave të huaja që ekzistojnë në ndërgjegjen e njerëzve, të cilat, kur puna e Partisë dobësohet, ngrenë krye, nxiten nga elementi armik në vend, nga kleri dhe nga radiot e huaja. Përpara kësaj situate, puna e Partisë duhet të jetë më e madhe, më e zgjuar dhe më e organizuar.

Ne nuk duhet të kënaqemi me sukseset që kemi arritur, po duhet të hidhemi në ofensivë për ta forcuar edhe më shumë Partinë, për të ngritur akoma më lart lavdinë e popullit tonë, për të realizuar sa më mirë të gjitha detyrat që na ngarkon Partia jonë e lavdishme, të cilat do të sjellin bollëk dhe plot gëzime për popullin tonë.

Të jesh anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë është një nder i madh se mbi supet e saj ka rënduar dhe rëndon një barrë e rëndë, por vështirësitë nuk i përkulin komunistët, përkundrazi i bëjnë ata edhe më të guximshëm. Duke i kalitur anëtarët e saj me parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, Partia u thotë atyre: Përpara, gjithnjë përpara!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

UDHËHEQJA E PARTISË NË RRETH T'I PËRGJIGJET NIVELIT TË KUADROVE — NDIHMA E SAJ TË JETË SA MË EFEKTIVE

*Diskutim në byronë e Komitetit të Partisë
të Rrethit të Shkodrës*

21 qershor 1964

Gjatë këtyre ditëve që vizitova rrethin tuaj, ne biseduam së bashku për një sërë problemesh, shkëmbyem mendime dhe përfituam nga njëri-tjetri. Tani që po largohem, dëshiroj të theksoj edhe disa çështje.

Shkodra është një rreth bujqësor dhe industrial, prandaj edhe puna e udhëheqjes së Partisë është e domosdoshme të jetë e diferencuar. Këtyre dy sektorëve të rëndësishëm ju duhet t'u kushtoni kujdes të veçantë. Qyteti i Shkodrës është një qendër e rëndësishme industriale dhe bujqësore. Këtë del që udhëheqja e Partisë dhe e pushtetit në rreth duhet të dijë t'i drejtojë mirë si qytetin, ashtu edhe fshatin, në mënyrë që punët të shkojnë gjithnjë përpara. Për të dyja këto çështje ju duhet të bëni përpjekje shumë të mëdha.

Në përpjekjet dhe në luftën që bëni, ju keni sukse-

se, po keni edhe vështirësi e të meta, të cilat nuk mund të zhduken menjëherë. Por udhëheqja e rrethit duhet të kuptojë mirë se kohët kanë ndryshuar, prandaj duhet të ndryshojë edhe stili i punës së saj. Kjo është e domosdoshme, këtë e kërkon përparimi i vendit tonë në përgjithësi dhe i rrethit tuaj në veçanti.

Më parë këtu kishte një industri të vogël, kurse tani shikojmë që kjo është zgjeruar mjaft, prandaj udhëheqja e rrethit duhet të ngrihet në nivelin e kësaj industrie. Po kështu edhe bujqësia ka përparuar dhe duhet të udhëhiqet në nivelin e këtij përparimi. Kjo ka rëndësi jo vetëm për ju, po për të gjitha rrethet, si dhe për Komitetin Qendror të Partisë dhe për Qeverinë. Pra duhet ecur me një ritëm dhe stil pune që t'i përgjigjet këtij përparimi. Në rast se më parë ne interesohehim edhe për gjëra të vogla, për të cilat ishim të detyruar, pse kuadrot tanë kishin një nivel të ulët dhe ishte e domosdoshme që shokët të merreshin edhe me to, tani nuk është më ajo situatë, ne kemi përgatitur kuadro për të gjithë sektorët, prandaj shokët duhet të ndërrojnë edhe kuptimin lidhur me metodën e punës.

Në këtë drejtim ju duhet të përmirësoni punën edhe në kooperativat bujqësore. Ne do t'i japim bujqësisë më shumë ndihma materiale, me kredi, por duhet të forcojmë edhe çështjen e drejtimit në bazë.

Nga ana organizative ne i kemi përcaktuar mirë format e drejtimit në ekonomi, në administratë, në shkollat etj. Përveç kësaj, për drejtimin e të gjithë sektorëve tani kemi siguruar kuadro të nivelit të mesëm në përgjithësi, po kemi edhe kuadro që kanë një ekspe-

riencë të gjatë në punë. Po ta shikojmë çështjen në këtë mënyrë, nuk duhet më të procedojmë si më parë, po në të gjitha hallkat duhet që shokëve t'u japim përgjegjësi dhe kompetencat që u takojnë. Këtë problem duhet ta zgjidhim në bazë të vendimeve të Komitetit Qendror dhe të Qeverisë. Vështirësitë që u dalin kuadrove në punë e sipër, ata duhet t'i zgjidhin dhe t'i përballojnë me forcat e tyre, prandaj t'i mësojmë njerëzit e bazës si të mobilizohen e të luftojnë me vështirësitë dhe të zhdukin ndjenjën e mungesës së përgjegjësisë. Ndryshe nuk mund të kemi përparimin që dëshirojmë. Partia ka punuar në këtë drejtim, po shikojmë se ekzistojnë akoma të meta të një metode të vjetër drejtimi.

Drejtimi është një kompleks i tërë me karakter politik, teknik dhe administrativ. Këto çështje nuk janë të ndara me nene, po të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, se asnjëri nuk mund të thotë që unë jam teknik e nuk më intereson politika, ose unë jam në administratë dhe nuk më interesojnë të tjerat, këto koncepte sjellin pasoja të dëmshme. Prandaj duhet të arrijmë t'i edukojmë kuadrot, në radhë të parë, si njerëz politikë që bazohen në ideologjinë e Partisë. Në qoftë se njerëzit edukohen me këtë frymë, dhe këtë duhet ta bëjë Partia, atëherë realizimi i detyrave dhe kapërcimi i vështirësive do të jenë më të lehta.

Duke i mësuar kuadrot, duke u dhënë atyre përgjegjësi, komiteti i Partisë dhe komiteti ekzekutiv do të shpëtojnë nga gjërat e vogla dhe do të bëjnë një punë më të kualifikuar. Pra, siç e thashë, udhëheqja duhet t'i përgjigjet nivelit të kuadrove, që tashmë janë

rritur. Ne e shikojmë në konferencat e Partisë që, kur ndonjëri thotë diçka të re, pjesëmarrësve iu zgjohet interesi, kjo ndodh sepse ata duan gjëra të reja, si në përmbajtje ashtu dhe në formë. Prandaj mbledhjet nuk duhen bërë për të shtruar të njëjtat gjëra, që janë thënë shumë herë më parë, por për të diskutuar probleme të rëndësishme që e preokupojnë Partinë.

Udhëheqja e Partisë në rreth duhet të ketë parasysh që ndihma e saj të jetë efektive. Ajo duhet të jetë në lidhje të ngushtë me drejtuesit e ndërmarrjeve, kooperativave dhe institucioneve të ndryshme, ku ka njerëz që e njohin teorinë dhe praktikën e punës. Kontaktet dhe bisedat me ta, problemet që ata ngrenë, janë një shkollë e madhe për udhëheqjen. Kjo nuk do të thotë që udhëheqja e Partisë të dijë procesin e çdo makinerie në ndërmarrje, po që ajo të njihet me ata që janë specialistë dhe me problemet e tyre kyç, kjo është detyrë e saj. Për shembull, drejtuesi i Partisë në rreth mund të vejë në fabrikën e duhanit një herë në muaj, ose edhe një herë në tre muaj, por, kur të vejë, ai duhet të dijë se çfarë problemesh do të shikojë dhe për këto të japë edhe ndonjë ndihmë. Kështu, nga njëra anë ai zgjeron njohuritë e tij dhe, nga ana tjetër, ndihmon fabrikën. Në këtë mënyrë ai ngre autoritetin e Partisë dhe të udhëheqjes së saj në bazë.

Kjo që thashë, është një nga format e punës së udhëheqjes. Një çështje tjetër është që drejtuesit të mësojnë jo vetëm në praktikë, por edhe në teori. Po si do ta bëjnë këtë?

Orientimet e Partisë jepen nëpërmjet vendimeve të Plenumit të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike

dhe të Sekretariatit. Këto orientime zbërthehen dhe konkretizohen në vendimet dhe në urdhëresat e Qeverisë e deri në urdhëresat e ndërmarrjeve, prandaj ato nuk kanë vetëm karakter thjesht teknik dhe administrativ. Çdo vendim ose urdhëresë e Qeverisë është zbërthimi i orientimeve të Komitetit Qendror, ato kanë anën politike, ideologjike, financiare dhe administrative. Prandaj, ashtu siç studiohen udhëzimet e Partisë, duhet të studiohen edhe vendimet e urdhëresat e Qeverisë, pse edukimi politik dhe ideologjik nuk bëhet vetëm me anën e artikujve të «Zërit të popullit». Mirëpo, mund të thuhet, si mund të futen në kokë qindra vendime e urdhëresa të Qeverisë? Në këto ju duhet të bëni vetë njëfarë seleksionimi. Byroja e komitetit të Partisë të rrethit përbëhet prej disa anëtarësh, prandaj secili duhet të dijë mirë jo vetëm vendimet e Partisë, po edhe disa nga vendimet dhe urdhëresat e rëndësishme të Qeverisë. Ne themi se udhëheqja është kolektive, prandaj kërkohet që secili anëtar i udhëheqjes në rreth të dijë përmbajtjen politike dhe ideologjike të çështjes.

Këtë gjë e theksoj sepse konstatohet që ligjet e urdhëresat i di vetëm juristi që punon në ministri apo në ndërmarrje. Kurse ne duhet të arrijmë që punëtorët të dinë të gjitha ligjet e urdhëresat që kanë të bëjnë me sektorin e punës së tyre. Në qoftë se ne e drejtojmë propagandën e Partisë jashtë këtyre ligjeve dhe urdhëresave, të cilat janë zbatimi i vijës së Partisë në jetë, propaganda jonë bën punë në hava. Caktimi i një juristi në ndërmarrje nuk ka si qëllim të hedhë në arbitrazh një ndërmarrje tjetër, kjo është vetëm një anë

e vogël e problemit, kryesorja është që me anën e juristit t'u mësojmë punëtorëve të njohin ligjet e shtetit të tyre. Prandaj edhe në këtë drejtim duhet të mendojmë më mirë për ta kualifikuar punën e drejtuesve. Këtë duhet ta mendojë secili në rrugë të drejtë, në mënyrë që të dijë të gjitha direktivat e Partisë dhe të Qeverisë për sektorin e vet.

Pastaj nuk duhet thënë që sekretari i komitetit të Partisë të studiojë vetëm çështjet teorike. Puna e tij është shumë e gjerë. Në rast se do të studiojë, për shembull, çështjen e fesë, ai mund të lexojë veprat që kanë shkruar Marks, Engelsi, Lenini e Stalini dhe këto t'ua përshtatë kushteve të vendit. Kjo është njëra anë, por që nuk është e mjaftueshme. Po çfarë duhet të bëjë? Ai nuk është nevoja të mësojë teorinë e bakrit, se një gjë e tillë i përket inxhinierit, por të dijë disa gjëra të një niveli më të lartë, që, kur të vejë në bazë, të thotë diçka të re. Kur sekretari i parë konstaton se inxhinieri ka boshllëk në një drejtim, interesohet të gjejë ndonjë material dhe, kur shkon në ndërmarrje, bisedon me të në mënyrë shoqërore. Kështu vepron edhe për sektorët e tjerë.

Pra ka disa mënyra për të ngritur nivelin e punës së udhëheqjes. Për të bërë të gjitha këto, duhet të mbahet gjithnjë parasysh lidhja e teorisë me praktikën, puna e zyrës me shkuarjen në bazë. Puna e udhëheqjes është një punë e rëndë, por po të dish t'i përcaktosh dhe t'i konkretizosh si duhet detyrat, do t'i shikosh më mirë rezultatet e saj. Në radhë të parë, udhëheqja duhet të luftojë kundër burokratizmit. Për shembull, ne tani për mbledhjet e Byrosë Politike dhe të Sekretaria-

tit caktuam disa rregulla¹. Kështu raportet nuk do të na paraqiten si deri më sot nga 20 faqe, duke i bërë propagandë udhëheqjes. Kur i paraqitet udhëheqjes raport për një çështje, problemi duhet të trajtohet qysh në fillim, pa frazeologji, duke treguar ku janë të metat dhe çfarë masash propozohen të merren. Edhe projektvendimet nuk do të paraqiten me 10 faqe, duke bërë përsëritjen e atyre që thuhën në raport. Tani trajtimi i problemeve bëhet konkretisht, ashtu sikurse edhe udhëheqja duhet të jetë konkrete.

Materiale të tilla përgatiten në një kohë më të shkurtër dhe u lihet mundësi shokëve që të thellohen dhe të vrasin mendjen për çështjet që janë parashtruar, të mendojnë se çfarë mund t'i thonë Partisë për ta ndihmuar, të konsultohen dhe të bisedojnë me masat. Po kështu diskutimet duhet të jenë konkrete. Këtë duhet ta bëjë edhe Partia në bazë.

Udhëheqja e Partisë në rreth të ketë gjithashtu parasysh që aktivet, seminarët 3-4 ditore, mbledhjet mujore me sekretarët e organizatave-bazë t'i konsiderojë një punë shumë serioze dhe jo sa për të shkuar radhën. Ato duhet të vlerësohen si mbledhje ku udhëheqja i armatos kuadrot e Partisë që të kryejnë vetë, me iniciativë dhe me guxim detyrat që u ngarkon Partia. Mbledhjet që bëhen me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë duhet të shkëputen nga dhënia menjëherë e shumë detyrave dhe e porosive, nga të cilat ata nuk mësojnë asgjë.

Para se të bëhen këto mbledhje, udhëheqja e Par-

¹ Shih vëllimin 26, f. 395.

tisë duhet të mendojë se çfarë do t'u japë shokëve, temën që do të zhvillohet. Në parim komiteti i Partisë i cakton temat në fillim të vitit, kjo është një gjë e mirë, por një temë edhe mund të ndryshohet sipas situatës që krijohet më vonë. Për shembull, në qoftë se merret vendim për të zhvilluar me kuadrot një temë mbi marrëdhëniet e vendit tonë me vendet e tjera, byroja, pasi gjykon se ky problem është aktual, ngarkon një shok për të zhvilluar bisedën, i cili përgatitet duke marrë për bazë të dhënat e reja dhe trajton vetëm çështjet kryesore, pa qenë nevoja të prekë gjithçka.

Komiteti Qendror ka menduar që në seminarët të mos zhvillohen 7-8 tema brenda 3-4 ditëve, pasi kjo do të thotë që pjesëmarrësit t'i zërë gjumi, prandaj është më mirë të bëhen 2, 3 deri në 4 tema të përgatitura si duhet, me fakte dhe me konkluzione, në mënyrë që shokëve t'u lihet kohë të mendojnë e të diskutojnë për të plotësuar temat e zhvilluara. Në këto mund të bëhet edhe kritikë lidhur me të metat që ka për problemin që trajtohet.

Vihet re se mbledhjet mujore me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë nuk përgatiten si duhet. Kur po diskutohej kjo çështje në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror, ne shfaqëm mendimin se mbledhjet duhen bërë një herë në muaj, sepse sekretarët e organizatave-bazë të Partisë kanë nevojë për ndihmë, po këtë duhet të dimë ta organizojmë.

Nga përmirësimi i punës së Partisë varet edhe përmirësimi i punës në organet e pushtetit. Është e vërtetë se ne kemi përparime në këtë çështje, po duhet akoma më shumë ta përmirësojmë punën e udhëheq-

jes së Partisë dhe të pushtetit. Këtu ka rëndësi çështja e ndarjes së problemeve që duhet të marrë në shqyrtim byroja e komitetit të Partisë të rrethit dhe komiteti ekzekutiv. Komiteti Qendror ka kohë që praktikon një metodë pune të drejtë në këtë çështje. Problemet kryesore dhe që kanë rëndësi politike i merr në shqyrtim Byroja Politike, pavarësisht se materialet mund të jenë përgatitur nga ministrinë ose Kryesia e Këshillit të Ministrave, për këto Qeveria nuk vendos pa i parë Byroja Politike. Kurse problemet e tjera i merr në shqyrtim Qeveria ose Kryesia e Këshillit të Ministrave. Në qoftë se në problemet që merr në shqyrtim Qeveria del një gjë e rëndësishme, që duhet të merret edhe mendimi i Byrosë Politike, ajo vendos që t'ia kalojë Byrosë Politike. Kështu duhet të veprohet edhe në rrethe.

Natyrisht, gama e problemeve të komitetit ekzekutiv duhet të jetë më e madhe nga ajo e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit, pse pushteti është leva e Partisë, që është ngarkuar me drejtimin konkret të problemeve të industrisë, të bujqësisë, të financës etj. Komitetin ekzekutiv duhet që Partia, udhëheqja e saj, ta frymëzojë në drejtimin më konciz, të rregullt, dhe jo ta zëvendësojë atë. Pastaj kryetari i komitetit ekzekutiv së bashku me shefat e seksioneve duhet të dinë t'u ndajnë mirë punën njerëzve. Por kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ka përgjegjësinë e tij, mirëpo për gjërat kryesore, që ai e gjykon se është e nevojshme, t'i diskutojë me sekretarin e parë të Partisë, duhet të vejë e t'i bisedojë me të.

Ju duhet të preokupoheni për shumë gjëra, po dua

të theksoj këtu nevojën e një lufte të veçantë kundër vjedhjeve, shpërdorimeve dhe dëmtimeve të pasurisë së popullit. Në radhë të parë, në këtë drejtim, duhet forcuar puna edukative. Në përgjithësi rezulton se nuk ka rritje në këtë drejtim, por, po ta marrim çështjen më konkretisht, del se në shumë fusha kemi dëmtime të pasurisë shtetërore, të cilat arrijnë në dhjetëra milionë lekë. Këto dëmtime vijnë, përveç të tjerave, edhe nga mungesa e edukatës, nga mosvlerësimi si duhet i materialeve etj.

Baza për të luftuar këto shfaqje negative është ngritja e ndërgjegjes së njerëzve, sepse vetëm me masa administrative nuk arrihen rezultatet e duhura, po krahas kësaj duhet të marrim edhe disa masa të tjera. Kjo çështje është studiuar dhe së shpejti Qeveria do ta marrë në shqyrtim. Ne duhet të shkojmë me parimin që në administratë, në kooperativë, në ndërmarrje etj., të kuptohet mirë se çdo drejtues nuk ka vetëm përgjegjësi morale para Partisë dhe popullit për detyrën që i është ngarkuar, por ka njëkohësisht edhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë materiale. Prandaj përgjegjës nuk është vetëm ai që bën dëmin, por edhe punonjësit e tjerë ku ndodh ky dëmtim. Kur flas për këtë përgjegjësi materiale, s'kam parasysh vetëm vjedhjet, po çdo gjë, tërë gamën e dëmtimeve, si për shembull, kur lihet materiali i painventarizuar, kur makina lihet jashtë, në vend që të sigurohet brenda, kur tubat hidhen dhe shpërdorohen, kur dilet deficit e suficit etj., etj. Kurse sot çfarë vihet re? Për këto s'ka përgjegjësi as drejtori as zëvendësdrejtori as financieri,

po vetëm ai që vjedh ose dëmton. Këtë të metë duhet ta korrigjojmë.

Përgjegjës shtetëror në një ndërmarrje është drejtori dhe pastaj vijnë me radhë gjithë të tjerët. Shteti i ka ngarkuar ata me detyrë të administrojnë e të drejtojnë një pasuri të caktuar dhe për këtë janë plotësisht përgjegjës para kolektivit dhe organizatës së Partisë, e cila ndihmon që drejtimi i ndërmarrjes ose i fabrikës të bëhet në mënyrë të përsosur. Në qoftë se vërtetohen dëme, atëherë duhet të mbahet qëndrim ndaj drejtuesve.

Të marrim çështjen e skarcitetit në prodhim. Ai që merret me kontrollin e cilësisë, lejon që prodhimet të dalin skarco, pse s'ia kanë shtrënguar as drejtori, as punëtorët. Kurse këtij i duhet thënë që po le kaq skarcitet, do të marrësh këtë rrogë, prandaj duhet të mbajë shënim se cila pjesë e prodhimit ka difekte dhe kush e ka punuar detalin, pastaj të kërkojë që t'i ulet paga për dëmin që ka sjellë. Në rast të kundërt t'i paguajë drejtori. Po u bë kështu, atëherë s'kalojnë më skarcitetet. Konstatojmë se ata që tejkalojnë normat, marrin më shumë, kurse kur prodhimi del me skarco, të gjitha bien në kurriz të shtetit. Kjo nuk është aspak e drejtë.

Në qoftë se dikush del suficit, ai duhet të përgjigjet për atë që i ka marrë popullit, kurse kur del deficit, duhet parë se mund t'i ketë marrë të hollat për vete. Ndaj njerëzve të tillë duhet të mbajmë qëndrim të prerë.

Këto që thashë tregojnë se duhet punuar mirë nga ana politike dhe administrative. Për të mbyllur këto

shtigje, duhen marrë jo vetëm masa administrative, po në radhë të parë masa edukative të përshtatshme, në mënyrë që të rritet ndërgjegjja e njerëzve për ruajtjen e pasurisë së përbashkët. Po kështu duhet të ngrihen më lart vigjilenca, kontrolli dhe ndihma. Kontrolli nuk duhet kuptuar vetëm nga lart, sepse, po nuk u vendos kontroll e disiplinë e rreptë nga poshtë, masat që mendohet të merren, nuk do ta bëjnë si duhet efektin e tyre.

Tani rrethet janë bërë njësi të mëdha ekonomike, industriale, bujqësore dhe administrative. Mundet dhe është e sigurt se edhe organikat ekzistuese nuk u përgjigjen detyrave që kanë rrethet. Për këtë qëllim organikat e qendrës duhet të ngushtohen dhe të rriten ato të rretheve. Prandaj në përshtatje me kushtet dhe zhvillimin e rrethit duhet të ndërtohen e të forcohen edhe seksionet pranë komiteteve ekzekutive dhe t'u përcaktohen atyre mirë detyrat, pastaj të shkurtohen edhe statistikat.

Pra, ne duhet të shikojmë çështjen që të bëjmë disa shkurtime në qendër dhe të forcojmë bazën, duke i lënë në kësaj disa kompetenca më të gjera në drejtim të ekonomisë. Në këtë mënyrë do të rritet më tepër përgjegjësia e bazës.

Të gjitha këto probleme, të cilat do t'i studiojmë së bashku me ju, do të sjellin atë që thashë më parë, që nuk do të kesh kohë të merresh me cikërrima.

Më poshtë shoku Enver Hoxha foli për disa çështje të zhvillimit botëror dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, për luftën e drejtë dhe parimore

të PPSH kundër imperializmit e revizionizmit dhe për lindjen e forcimin e partive dhe të grupeve marksiste-leniniste në botë.

Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

SKUADRAT E RENDIMENTIT TË LARTË T'Ë SHËRBEJNË NGRITJES SË MËTEJSHME TË BUJQËSISË NË PËRGJITHËSI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

29 qershor 1964

Jam dakord me diskutimet që u bënë në këtë mbledhje. Ne duhet të dalim këtej me disa konkluzione. Ky duhet të jetë edhe pikësynimi i mbledhjes së Sekretariatit. Kjo nuk do të thotë se ne s'jemi në korent për problemet që sillen këtu, por puna është që në fund, pas diskutimeve, të dalim me disa përgjithësime. Çfarë mund të përgjithësojmë në këtë rast?

Skuadrat e rendimentit të lartë dhe brigadat e punës socialiste nuk i kemi krijuar dhe nuk duhet t'i krijojmë si qëllim në vetvete, domethënë sa për të rea-

¹ Përveç çështjeve të tjera, në këtë mbledhje u diskutua edhe «Mbi punën e organizatave të Partisë dhe të rinisë për përhapjen e eksperiencës së përparuar në bujqësi dhe në blegtori».

lizuar parullën që të kemi skuadra të rendimentit të lartë ose brigada të punës socialiste, por i kemi krijuar me qëllim që e gjithë bujqësia jonë të ngrihet në nivelin e bujqësisë socialiste, pse «behari nuk vjen me një lule». Mirëpo konstatohet se këtyre çështjeve nuk u kushtohet rëndësia e duhur, se shikojmë që nuk po krijohen brigada të tjera të punës socialiste ose skuadra të rendimentit të lartë. Gjithashtu mjaftohet vetëm me numrin e atyre që janë krijuar dhe nuk ndiqen më tej se si venë punët në to e ç' rezultate arrihen.

Edhe për raportin që na ka paraqitur Drejtorja e Bujqësisë, kisha një vërejtje. Sipas mendimit tim në këtë raport ka vetëm shifra nga fillimi e deri në fund. Ne s' kemi nevojë të na jepen kaq shumë shifra, po duam të na thuhet konkretisht se cilat çështje venë mirë e cilat jo dhe të nxirren konkluzione. Këtu duhet të shënohen cilat janë të mirat e që duhen përgjithësuar dhe cilat janë të metat, me qëllim që t'i luftojmë, kurse gjëra të tilla në këtë raport nuk ka. Prandaj ju, shokët e ftuar të rretheve, mos i trajtoni kështu problemet, duke u mbytur në shifra, por kapuni pas çështjeve kryesore dhe nxirrni konkluzione.

Ne duhet të punojmë për ngritjen e skuadrave e të brigadave të reja, sepse këto janë një shembull i mirë, por nuk duhet të mbështetemi vetëm në to, por të ngremë të gjithë bujqësinë në një nivel më të lartë. Këtu u fol, midis të tjerash, për rezultatet e arritura në Mat në drejtim të skuadrave të rendimentit të lartë. Kjo është një gjë e mirë. Por ne duam që e gjithë bujqësia e rrethit të Matit të ngrihet në një nivel të lartë.

Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë edhe krijimi i skuadrave të rendimentit të lartë.

Rëndësi ka, gjithashtu, të luftohet formalizmi që vihet re në lëvizjen e skuadrave të rendimentit të lartë. Kur i ngremë këto skuadra ose këto brigada, duhet të kemi parasysh edhe kushtet e barabarta të tyre. Në qoftë se nisemi nga parimi që këto skuadra të rendimentit të lartë ose brigada të punës socialiste edhe kur i vëmë në kushte të barabarta me të tjerat, bile edhe në kushte më të këqija, arrijnë të rritin rendimentin e prodhimeve bujqësore, atëherë ne mund të themi se ia kemi arritur qëllimit.

Në qoftë se skuadrave të rendimentit të lartë u jepet toka më e mirë e kooperativës, pleh etj., atëherë duhet t'u bëhet edhe zbritja në bazë të privilegjeve që u janë dhënë. Në rast se ky rendiment arrihet në saje të punës së tyre, pa u bërë ndonjë privilegj, atëherë hallall u qoftë! Këtë çështje e ngrita me qëllim që rritja e rendimentit të mos vijë nga favoret që mund t'u bëhen këtyre skuadrave, por nga një punë e organizuar, e ndërgjegjshme, me disiplinë etj. Çështja që në këto skuadra ose brigada grumbullohen njerëzit më të mirë, duhet parë me kujdes dhe të merren masa. Në rast se në këto skuadra do të marrin pjesë njerëzit më të mirë, atëherë mos vallë duhet t'u japim këtyre edhe traktorë më tepër etj.?! Kjo sjell më pas edhe çështjen e shpërblimit. Kështu krijohen gjëra të rrezikshme. Prandaj këtyre skuadrave ose brigadave duhet t'u heqim favoret dhe kështu ato vetëm në saje të punës dhe të përpjekjeve të tyre do të jenë vërtet skuadra ose brigada të pararojës.

Del pyetja: Çfarë duhet të krijojmë më parë, brigadat e punës socialiste apo skuadrat e rendimentit të lartë? Mua më duket se brigadat e punës socialiste janë kryesorja dhe pastaj vijnë skuadrat e rendimentit të lartë. Ne kemi thënë që të krijojmë brigadat e punës socialiste me parullën: «Të punojmë, të mësojmë dhe të jetojmë në mënyrë socialiste». Kryesorja këtu është që të punojmë në mënyrë socialiste, kurse të tjerat janë kushte ndihmëse, të cilat çojnë në rritjen e prodhimit dhe që të krijohet mirëqenia e punonjësve. Këto duhet të ndihmojnë për mobilizimin e tyre. Në skuadrat e rendimentit të lartë të mësohet agroteknika, pavarësisht nëse pjesëmarrësit e tyre shkojnë ose jo në shkollë. Këtu, pra, është dallimi. Në qoftë se ndryshimi midis brigadës së punës socialiste dhe skuadrës së rendimentit të lartë qëndron vetëm në çështjen që të parët venë në shkollë dhe të dytët ndjekin kurset agroteknike, atëherë duhet parë se mos kështu krijojmë paralelizma të panevojshëm, vetëm duke ndryshuar emrin, prandaj të shikohen më mirë këto çështje.

Duhet menduar më tepër që të vihen përpara detyrave komitetet ekzekutive të rretheve, pasi nuk del mirë roli që nevojitet të luajnë organet e pushtetit në ndihmën që duhet t'u japin këtyre brigadave ose skuadrave. Ne kemi vite që po flasim se organet e pushtetit duhet të marrin mirë në dorë punën e skuadrave të rendimentit të lartë, por kjo gjë nuk po bëhet akoma. Mos vallë këtë punë do ta bëjë drejtpërdrejt Partia? Në këtë rast Partia nuk e kryen si duhet rolin e saj, sepse nuk aktivizon komitetin ekzekutiv që të punojë për këto çështje, por merr përsipër detyra që nuk i ta-

kojnë. Kur flasim për rendimentin e lartë të prodhimit, kjo punë u përket, në radhë të parë, organeve të pushtetit. Edhe punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë duhet të venë në bazë që të ndihmojnë nga afër, por detyrat do të kryhen, në goftë se secili do të bëjë punën e tij.

Çështja e marrjes së rendimenteve të larta është kryesisht detyrë e komiteteve ekzekutive. Po atëherë çfarë duhet të bëjë Partia? Ajo ka një përgjegjësi jashtëzakonisht të rëndë, punën edukative që duhet zhvilluar me njerëzit, pse sikurse u tha, ajo nuk duhet të lejojë që njerëzit të realizojnë një normë e gjysmë, duke e bërë punën shkel e shko.

Ne kemi pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve seksionet e bujqësisë dhe ndërmarrje të tjera, që kanë lidhje me organet lokale të pushtetit. Prandaj këto organe, ashtu siç interesohen për ndërmarrjet, duhet të interesohen edhe për kooperativat bujqësore. Kryesisë së kooperativës bujqësore, megjithëse është një organ i zgjedhur, komiteti ekzekutiv duhet t'i kërkojë nëpërmjet kryetarit dhe agronomëve realizimin e rendimenteve etj., ose duhet ta bëjë këtë nëpërmjet këshillit popullor të fshatit. Ne shkojmë sot drejt krijimit të kooperativave të bashkuara, duke eliminuar organizimin e pushtetit të lokalitetit, prandaj duhet të kemi parasysh edhe çështjen e zbatimit të detyrave të tjera. Në drejtim të kuadrit të kihet parasysh që kryetari i këshillit popullor të fshatit të ketë nivel të lartë, në mënyrë që të luajë si duhet rolin që i përket. Ne themi që të aktivizohen këshilltarët dhe kjo është e drejtë. Por një nga drejtimet ku mund të aktivizohen këta është edhe krijimi

i skuadrave të rendimentit të lartë, këtu ka detyra edhe komiteti ekzekutiv.

Këto çështje duhet të theksohen mirë nga ana e Partisë, në mënyrë që lëvizja e brigadave të punës socialiste dhe e skuadrave të rendimentit të lartë të forcohet e të zgjerohet edhe më tepër në të ardhmen.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

SHKURTIME NË SHPENZIME TË BËJMË, POR PA ULUR NIVELIN E JETESËS SË POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

1 korrik 1964

Është e drejtë që në universitet të venë në radhë të parë nxënës nga gjimnazet, por të venë edhe nxënës të zgjedhur nga teknikumet. Ne duhet t'i parashi-kojmë mirë këto çështje. Në qoftë se pas vitit 1965 do të hapim përsëri një ose dy fakultete të reja, atëherë do të detyrohemi të marrim kontingjent edhe nga teknikumet, natyrisht pasi të marrim nga gjimnazet. Për nxënësit e shkollave profesionale kemi nevojë, se janë kuadro të mesëm, teknikë, që shkojnë drejtpërdrejt në prodhim.

Për të plotësuar nevojat që ka universiteti, tani që kemi më shumë mundësi materiale, mund të hapim të

1 Një nga çështjet që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo e shpenzimeve të buxhetit të shtetit për masat social-kulturore dhe mundësitë për kursime në këtë sektor.

tjera shkolla të mesme dhe të dërgojmë më shumë njerëz në to. Do të vijë koha që hyrja në universitet të bëhet me konkurs, por sot për sot ne do të marrim maturantët që mbarojnë me nota më të mira, kurse nga teknikumat të lejojmë të shkojnë në universitet e në shkolla të larta çdo vit një numër i kufizuar nxënësish. Po kështu të studiohen edhe një herë kriteret e dhënies së bursave në bazë të të ardhurave të familjes.

Ne nuk duhet të nisemi vetëm nga parimi që të bëjmë shkurtime, për të mos harxhuar të holla edhe atje ku është e nevojshme. Prandaj unë nuk jam dakord të suprimojmë dërgimin e kontingjenteve në shkollë për përgatitjen e ndihmësmjekëve. Të kemi vërtet parasysh çështjen që të mos na dëmtohet akumulacioni, po ne nuk duhet të lejojmë që të ketë edhe mungesa në shërbim të popullit. Përse na u krijua gjithë ky akumulacion? Pikërisht se ne tani kemi përgatitur njerëz të mësuar, kuadro, që dinë të punojnë. Jam dakord që t'i shtrijmë këmbët sa kemi jorganin, por popullit mos t'ia presim ndihmën. Këto gjëra duhet t'i shikojmë me kujdes.

Të marrim një shembull tjetër: Për të sëmurët që do të vijnë nga fshati në qytet, shpenzimet do të bëhen, sepse ata kanë nevojë për krevatin, ushqimin etj. Por po erdhën të gjithë të sëmurët e fshatit në qytet, atëherë do të ketë patjetër më tepër shpenzime, si rrjedhim do të shtohen personeli i shërbimeve dhe nevojat materiale. Por në spitalet e qyteteve të mos shtrohen vend e pa vend. Spitalet ne duhet t'i kemi dhe t'i mbajmë mirë, të kenë mjekë specialistë dhe mjete të nevojsh-

me. Këtu mund të vijnë të sëmurë edhe nga fshati sa të bëjnë vizita e analiza dhe, ata që kanë nevojë, të shtrohen, kurse të tjerëve t'u shërbejnë spitalet e lokaliteteve. Ndryshe duhet të parashikojmë që spitalet e qyteteve të zgjerohen.

Çështja e ndihmës së nënës dhe e fëmijës është mjaft delikate, dhe nuk mund ta gjykojmë jashtë kuadrit të nivelit të jetesës së masave. Këto ndihma ne i kemi dhënë në momente të nevojshme për të përmirësuar jetën e njerëzve, i kemi dhënë veçanërisht për fëmijët. Vështirësitë që na dolën, i kapërcyem, natyrisht pa e ngritur dhe pa e ulur nivelin e jetesës, por duke qëndruar në vend dhe ky është një sukses i madh.

Tani nuk mund të vendosim mbi këtë çështje pa shqyrtuar planin pesëvjeçar, nuk është mirë gjithashtu të shkojmë me mendimin e Komisionit të Planit, sipas të cilit gjatë planit të ri pesëvjeçar s'mund të ngrihet niveli i jetesës së popullit veçse 2 për qind. Me këtë ne nuk kemi qenë dakord dhe, kur e bëmë një vërejtje të tillë, na u tha se mund të ngrihej deri në 10 për qind! Prandaj duhet ta studiojmë mirë se sa do ta ngremë nivelin e jetesës, pastaj të përcaktojmë disa nga çështjet që na paraqiten.

Sakrificat e popullit mund të bëjnë, po situatën politike duhet ta kemi kurdoherë parasysh, sepse kemi akoma vështirësi të mëdha, jemi para një propagande dhe agjitacioni të madh të armikut. Pse neve na bën përshtypje ulja e rrogave dhe ngritja e çmimeve në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e ish-demokracisë popullore ku në fuqi kanë ardhur revizionistët? Sepse atje ndodhen në situata të vështira. Ne të bëjmë shkurtime shpenzimesh,

po atje ku duhet. Prandaj këto shkurtime t'i peshojmë mirë dhe t'i shohim në lidhje me situatën, se jemi një vend socialist që luftojmë kundër imperializmit dhe revizionizmit.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KUR POPULLI ZBATON NJË VIJË TË DREJTË, S'KA FORCË QË E LËKUND DHE E MPOSHT

*Nga biseda me miq belgjianë të Shoqatës së Miqësisë
Belgjikë-Shqipëri*

6 korrik 1964

Pas përshëndetjeve të rastit dhe si zënë vend të gjithë të pranishmit, fjalën e merr shoku Enver Hoxha:

Ju falënderoj personalisht ju, përfaqësues të Shoqatës së Miqësisë Belgjikë-Shqipëri, qëllimi i së cilës është t'i bëjë të njohur popullit belg jetën, luftën dhe përpjekjet e popullit shqiptar. Edhe ne nga ana jonë do t'ia bëjmë të njohur popullit shqiptar jetën, historinë dhe sukseset e popullit tuaj.

Ju keni ardhur në vendin tonë me zemrën e njerëzve përparimtarë dhe do ta kuptoni drejt realitetin tonë. Sigurisht Shqipëria akoma nuk e ka nivelin e jetesës së disa vendeve të zhvilluara, por, në qoftë se do të kishit ardhur këtu më përpara, tani do ta përcaktonit edhe më mirë përparimin e madh që ka bërë vendi ynë në krahasim me të kaluarën. Sigurisht ky është rezultat i luftës çlirimtare të popullit tonë, i sakrificave të

mëdha që ka bërë ai, i vijës së drejtë të Partisë sonë dhe i punës heroike plot vetëmohim të popullit shqiptar. Ne jemi të kënaqur me përparimet që janë realizuar në vendin tonë, por çdo vit që kalon shikojmë se duhet të bëjmë edhe më shumë. Tërë këto realizime të gjithanshme që keni parë, populli ynë i ka arritur vetë dhe perspektivën e ka shumë të qartë. Te ne është kapërcyer me sukses ajo fazë e paraluftës, kur analfabetizmi sundonte në mbi 80 pë qind të popullsisë. Tani ne kemi përgatitur kuadro që e kuptojnë dhe e njohin realitetin, janë të lidhur ngushtë me popullin dhe punojnë për t'ia përmirësuar atij jetën.

Partia jonë i edukon të gjithë njerëzit me ndjenjën fisnike të punës. Ne mundohemi që të gjithë ta kuptojnë drejt nocionin e punës dhe të përpiqen të punojnë mirë, që karakteri i njeriut të formohet në punë e sipër dhe jo vetëm me anën e leksioneve e mbledhjeve etj. Këto forma nuk kanë munguar të bëhen dhe, në të ardhmen, do t'i perfeksionojmë më tej, por kryesorja është që edukimi të bëhet në punë. Populli shqiptar gjithnjë e ka dashur punën dhe ka punuar me gjithë shpirt, por të gjitha të këqijat e feudalizmit dhe pushtimet e huaja e kanë penguar shumë në rrugën e tij për të ecur përpara. Kur filluam Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, ajo nuk u drejtua vetëm kundër pushtuesve të huaj, por edhe kundër pushtetit të feudo-borgjezisë, kundër të gjitha atyre forcave reacionare që ishin në shërbim të armiqve të jashtëm. Këtë luftë kundër prapambetjes dhe forcave regresive e antipopullore ne e thelluam pas vendosjes së pushtetit popullor. Dhe e vërteta është se suksese të shumta kemi

arritur dhe suksese të tjera do të realizojmë në të ardhmen.

Duhet pasur parasysh se veçanërisht industrinë e kemi filluar nga hiçi. Por me politikën e drejtë të Partisë gjendja e vendit, gjatë periudhës së pasçlirimit, ka ndryshuar. Partia jonë ka ndjekur një vijë të drejtë në çështjen e investimeve, në industri, në bujqësi, në fushën e arsimit, të kulturës etj. Në vendin tonë nuk ka zhvendosje të popullsisë, sikurse ndodh në vendet e ish-demokracisë popullore, sepse, përveç të tjerave, kemi pasur kurdoherë parasysh që fshati të mos zbrazet dhe është evituar fryrja e qyteteve. Në këtë çështje kemi qenë shumë të matur, kemi balancuar forcat dhe tani ecim pa ndërprerje gjithnjë përpara në bazë të planeve të hartuara me kujdes si në zhvillimin e industrisë, ashtu edhe në zhvillimin e bujqësisë.

Partia jonë, si Parti e vërtetë marksiste-leniniste, kurdoherë është nisur e do të niset nga parimi se socializmi ndërtohet duke u mbështetur në forcat e veta. Faktori i brendshëm kurdoherë mbetet faktori kryesor dhe më i rëndësishmi në revolucion. Kjo do të thotë se edhe gjatë periudhës së ndërtimit të socializmit puna e popullit është faktori kryesor që i ngre veprat, se pa këtë punë asgjë s'mund të bëhet, se edhe makineria e ardhur nga jashtë do të mbetet në diell.

Rruga që ndjekim ne bën që në drejtimet kryesore të ekonomisë të jemi mirë dhe të ecim me qartësi e me vendosmëri përpara. Planet tona të ardhshme të ndërtimit të hidrocentraleve, të fabrikave e të uzinave janë mjaft të gjera. Do të ndërtojmë vepra të reja

industriale, miniera të reja. Kështu për vendin tonë në këtë fushë hapet një perspektivë e gjerë. Kjo kërkon që të shtojmë më tepër transportin, veçanërisht atë hekurudhor. Edhe këto vija të pakta hekurudhore që keni parë në vendin tonë, i ka ndërtuar pushteti popullor. Por tani, në kushtet e krijuara, kërkohet t'i zgjerojmë hekurudhat, sidomos në Jug, nga Lushnja, Fieri e Vlora, sepse tani jo vetëm janë krijuar kudo kooperativa të mëdha bujqësore, por po ngrihen qendra të fuqishme industriale, pra kudo duket një zhvillim i madh i prodhimit. Në një të ardhme të afërt, ne do të kemi një bujqësi intensive, gjë që do të kërkojë edhe më shumë transport. Tani për tani pjesën më të madhe të transportit e përballojmë me kamionë. Në qytetin e Fierit do të ndërtojmë një uzinë për prodhimin e plehrave azotike, aty afër është qendra e madhe e naftës sonë, më tej ajo e prodhimit të sodës kaustike etj.

Në pesëvjeçarin e ardhshëm do t'i japim një rëndësi shumë të madhe bujqësisë, e cila gjer tani është zhvilluar shumë ngadalë, sepse, veç të tjerash, nuk kemi akoma plehra kimike. Kur t'i sigurojmë këto, atëherë bujqësia jonë do të bëjë një përparim të madh, veçanërisht në rritjen e rendimenteve. Në këtë drejtim ne jemi akoma pas dhe kemi për të mësuar edhe nga eksperiencia e vendit tuaj. Si rezultat i këtyre transformimeve dhe i kujdesit të vazhdueshëm të Partisë e të pushtetit popullor është përmirësuar vazhdimisht mënyra e jetesës së masave tona punonjëse.

Shumë sëmundje shoqërore që kanë pasë ekzistuar, pas Çlirimit i kemi luftuar dhe i kemi likuiduar me sukses. Te ne tani nuk ka më sifiliz e malarje, sëmundje

këto që dikur ishin shumë të përhapura. Ne kemi marrë masa të shumta për mbrojtjen e shëndetit të popullit, duke hapur mjaft qendra shëndetësore të vogla gjer në fshatrat më të largëta. Në të gjitha qendrat e mëdha të banimit ne kemi spitale, ku të sëmurët shtrohen e kurohen pa pagesë. Në të njëjtën kohë, bëjmë përpjekje në drejtim të profilaksisë, me qëllim që t'i edukojmë punonjësit me një kulturë të mirë higjieno-sanitare; gjithashtu përpiqemi që njerëzit tanë të edukohen, të mos abuzojnë me të mirat që janë pronë e të gjithë popullit, të mos shpërdorjnë ilaçet dhe vëmë re se në këtë drejtim ka një përparim të madh.

Për forcimin e shëndetit të masave punonjëse kemi hapur edhe shumë shtëpi pushimi. Në këto institucione pushojnë me dhjetëra mijë punonjës dhe fëmijë. Gjithashtu për fëmijët janë organizuar nëpër qytete qendra pushimi ditore, të cilat frekuentohen mjaft prej tyre.

Sidoqoftë ne kemi akoma shumë për të bërë në çdo drejtim. Në radhë të parë ne duhet të përpiqemi të përmirësojmë edhe më tepër jetesën e punonjësve. Ky është qëllimi i Partisë sonë dhe në çdo pesëvjeçar niveli i jetesës së popullit shqiptar është rritur. Vështirësi kemi pasur këta 3-4 vjet për shkak të bllokadës së revizionistëve, megjithatë e kemi ruajtur nivelin e jetesës të vitit 1960 dhe kemi bërë përpjekje që në pikëpamje sasiore prodhimi të jetë më i madh. Populli ynë i pa drejt situatën dhe vështirësitë që na u krijuan, ishte i ndërgjegjshëm për to dhe i vendosur për t'i kapërcyer. Megjithatë në treg nuk pati mungesa, populli gjente atje gjithçka që prodhohej në vend. Ato

që nuk i gjente vazhdimisht, ishin vetëm artikujt e importit. Në mbledhjet masive populli u ngrit dhe, pa marrë parasysh propagandën e revizionistëve, u shpreh se qe gati të shtrëngonte edhe rripin, po të ishte nevoja, por nuk do të gjunjëzohej.

Ndodhi kjo sepse vija e Partisë sonë ishte dhe është e drejtë, sepse populli e ka përqaftuar atë me bindje dhe e mbron me vendosmëri të plotë. Ai e di që përpara ka shumë vështirësi për të kapërcyer, ndaj po punon më shumë e më mirë. Ai e di që duhet të bëjë sakrifica e heroizma në këto kohë të vështira dhe është i disiplinuar dhe i organizuar, kurse te revizionistët sundon anarkia, atje lulëzon revizionizmi për të denaturuar socializmin.

Ne kemi besim se do ta shohim vendin tonë të zhvilluar dhe armiqtë tanë, imperializmi dhe revizionizmi modern me Hrushovin në krye, do të humbasin dhe do të dështojnë. Ata duken sikur janë të fortë, por, përkundrazi, janë shumë të dobët. Faktet tregojnë vetëm dobësimin e tyre. Revizionistët kanë akoma një forcë të madhe ekonomike dhe ushtarake, por nuk kanë zemrën dhe forcën e popujve, nuk kanë me vete ndjenjat e zjarra revolucionare të popujve dhe të komunistëve.

- Populli ynë nuk ka frikë nga armiqtë dhe të mos kesh frikë nuk do të thotë të jesh i madh në numër. Rëndësi ka të jesh i qartë për vijën tënde të drejtë, se vetëm kështu e mbron me vendosmëri këtë vijë. Dhe kur një popull zbaton një vijë të drejtë marksiste-leniniste dhe është i qartë për perspektivën e rrugës që ka përpara, s'ka forcë që e lëkund dhe e mposht, ndryshe ai bie shpejt në kthetrat e propagandës armike.

Ne mendojmë se veprimtaria e shoqatave të miqësisë me Shqipërinë, që janë krijuar në Francë, në Itali, në Belgjikë etj., luan një rol shumë të madh si për t'i bërë të njohura këto suksese të popullit shqiptar në vendet e tyre, ashtu edhe për të ushqyer shtresat popullore të vendeve të ndryshme me ide përparimtare revolucionare.

Ne përpiqemi t'ua bëjmë të njohur miqve tanë të kaluarën e Shqipërisë. Borgjezia është përpjekur dhe përpiket që kjo e kaluar të mos njihet. Populli shqiptar, sado i vogël, ka ndihmuar dhe ka dhënë kontributin e tij gjatë shekujve në historinë e njerëzimit. Ky nuk është një supozim, por një realitet, që është dokumentuar e dokumentohet vazhdimisht, pavarësisht se armiqtë tanë e kanë falsifikuar të vërtetën ose e kanë lënë në errësirë. Të marrim, për shembull, kulturën e vjetër greke. Kjo është një kulturë e gjerë, krenaria e njerëzimit. Por pa qenë megalomanë, në atë kohë ka ekzistuar edhe kultura e popujve të tjerë, ndër të cilat edhe kultura e të parëve tanë. Në qoftë se Herodoti, Homeri, Straboni do të studioheshin me kujdes, del se në veprat e tyre gjendet edhe historia, jeta dhe e kaluara e të parëve tanë, që quheshin «barbarë» nga grekët, jo në kuptimin e tanishëm të kësaj fjale, por në kuptimin e njerëzve që nuk flisnin gjuhën greke të asaj kohe. Shumica e studiuesve të vendeve kapitaliste me qëllim e kanë injoruar krejtësisht këtë fakt. Por ka pasur dhe ka edhe nga ata studiues të huaj që i kanë qëndruar besnikë së vërtetës. Kështu, kohët e fundit një studiues francez ka bërë një studim dhe ka botuar një libër me anën e të cilit

shtron hipotezën dhe përpiket të shpjegojë historinë e etruskëve nëpërmjet gjuhës shqipe. Atëherë autoritetet e larta të shkencës linguistike e historike, nga italianët e gjër. te gjermanët etj., e quajtën këtë një sakrilegj. Ata thonë se gjuha etruske është e pashpjegueshme, ndërsa studiuesi francez thotë se është e shpjegueshme nëpërmjet shqipes. Sipas historisë së grekëve dhe romakëve del se etruskët nuk kanë ardhur nga Veriu, por nga Ballkani, bile një pjesë e tyre ka vajtur edhe në Spanjë. Nuk është çështja këtu se ne duam të akaparojmë kulturën e etruskëve, por qoftë edhe hedhja e kësaj hipoteze, pavarësisht se cila do të jetë e vërteta shkencore, tregon se në botë ka pasur e ka edhe njerëz përparimtarë që janë interesuar për popullin tonë, kanë shkruar e shkruajnë vepra, të frymëzuar nga dashamirësia e miqësia për të. Në qoftë se e keni lexuar poetin e shquar anglez Bajronin, ai në veprën e tij poetike «Çajld Harold» këndon me gjithë shpirt edhe për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ka pasur studiues të huaj, linguistë, arkeologë, historianë etj. që e kanë admiruar popullin tonë dhe ky, nga ana e tij, i ka respektuar e i respekton ata.

Ne kemi filluar dhe do të vazhdojmë t'i studiojmë të gjitha dokumentet e vjetra, ku është shkruar historia e popullit tonë gjatë regjimit feudal dhe pushtimeve të ndryshme. Kjo punë e shoqëruar edhe me rrugë e burime të tjera studimore dhe e mbështetur në metodologjinë marksiste-leniniste të analizës e të interpretimit të fakteve, do të bëjë që të kuptohet më mirë lufta dhe vlera e popullit tonë kundër okupatorëve dhe feudallëve, trimëria, atdhedashuria, patriotizmi i thellë dhe

të gjitha virtytet e tjera të larta të tij. Mund të thotë dikush se në vija të përgjithshme këto janë të njohura. Kjo është e vërtetë. Sikur të marrim historinë e popullit francez, belg, rus, bullgar etj. do të shihet se janë të njëjtat klasa që i kanë shtypur popujt dhe me të njëjtat metoda. Por tani metodat e shtypjes janë më të stërholluara, ato thithin më shumë gjak nga popujt. Veçse secili popull në këtë kuadër të përgjithshëm ka veçoritë e tij konkrete. Kështu, literatura jonë është diçka origjinale, muzika jonë gjithashtu, teatri ynë vërtet është i ri, por në të reflektohen e tanishmja dhe e kaluara pozitive e popullit tonë. Ne e kemi ruajtur dhe e kemi shfrytëzuar me kujdes traditën tonë, gjithçka pozitive të së kaluarës dhe me të kemi edukuar e edukojmë brezin e ri. Në gjithë këtë punë ne kemi luftuar e luftojmë si ato zakone, koncepte e tradita të së kaluarës që u ka ikur koha, që janë bërë të dëmshme, ashtu edhe shfaqjet moderne, dekadente, dekurajuese.

Armiqtë tanë thonë se Shqipëria është një vend i mbyllur. Kjo nuk është e vërtetë. Vendi ynë është i hapët, por për miqtë, për njerëzit e mirë, për literaturën përparimtare dhe jo për armiqtë e kulturën dekadente. Ne dimë të vlerësojmë kush është e mirë dhe kush është e keqe në kulturën borgjeze. Atë që është vërtet e mirë, ne e vlerësojmë si të tillë dhe mendojmë se ajo i përket gjithë njerëzimit. Socializmi nuk mund të ndërtohet e të zhvillohet, si të thuash, nga *tabula rasa*, pa u mbështetur e pa u ndihmuar në gjithçka pozitive të së kaluarës. Por duhet pasur kujdes që në këtë të kaluar të luftohet çdo gjë e keqe dhe regresive. Ne marrim atë çka është e mirë nga kultura

botërore. Përse t'u imponojmë masave tona punonjëse gjërat e këqija? Këto ne i pastrojmë nga ambienti ynë dhe mendojmë se veprojmë drejt. Për këtë na thonë se jemi «dogmatikë», «sektarë», «të prapambetur», «konservatorë», «barinj» etj. Le të thonë ç'të duan, ne vazhdojmë rrugën tonë të drejtë. Shqipëria është e hapët dhe do të vazhdojë të jetë kurdoherë e hapët për miqtë që vijnë te ne me qëllime të mira e me zemër të hapët.

Është e ligjshme të jemi vigjilentë e të mbrohemi me të gjitha forcat, se ne jemi të rrethuar nga të gjitha anët me armiq të shumtë të egër dhe të fortë, si nga pikëpamja ekonomike, ashtu dhe nga ajo ushtarake. Ata, armiqtë tanë imperialistë e revizionistë, kanë shumë mjete në dispozicion, na kërcënojnë, por vendi ynë është vendi i shqiptonjave dhe nuk ka frikë. Në qoftë se ata duan të na copëtojnë me thonj, ne u themi atyre se nuk na mungojnë kthetrat e shqiptonjës. Sot ne jetojmë në shekullin e triumfit të marksizëm-leninizmit, kur popujt po zgjohen, po ngrihen në luftë e në revolucion, po e godasin çdo ditë e më tepër në lule të ballit imperializmin, revizionizmin dhe gjithë reaksionin.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

EDUKIMI I PUNONJËSVE ME MORALIN KOMUNIST ËSHTË PROBLEM KYÇ

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 13-të
të KQ të PPSH¹*

9 korrik 1964

Shokë,

Mendoj se ishte i nevojshëm një Plenum i Komitetit Qendror ku të rriheshin probleme të rëndësishme mbi forcimin e punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve. Këto çështje nuk janë të reja. Me të tilla probleme kyç Partia jonë është marrë që kurse lindi, merret vazhdimisht çdo ditë dhe do të merret shumë edhe në të ardhmen. Ajo i ka trajtuar dhe i trajton këto në mënyrë revolucionare, në baza klasore marksiste-leniniste, në një kompleks të tërë, në forma të ndryshme dhe lidhur ngushtë me jetën e Partisë dhe të të gjithë vendit. Me punën e palodhur të komunistëve janë arritur suksese të mëdha

1 Plenumi i 13-të i KQ të PPSH, që u zhvillua prej 7-9 korrik 1964, diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi forcimin e mëtejshëm të punës ideologjike të Partisë për edukimin komunist të punonjësve».

në këtë drejtim dhe kjo punë e mirë për ngritjen ideologjike dhe edukimin komunist të punonjësve ka qenë leva kryesore e të gjitha sukseseve që ka arritur populli ynë në çdo lëmë të veprimtarisë së tij, nën drejtimin e Partisë.

Ju kujtohet të gjithëve fillimi i punës. Kur flitej për punën ideologjike, njerëzit e Partisë e konsideronin këtë një çështje shumë të nevojshme, por të vështirë, të koklavitur. Ata e gjenin të vështirë t'i futeshin teorisë, mendonin se kjo ishte kryesisht çështje e njerëzve të mësuar, se kjo ishte vetëm çështje konceptesh filozofike abstrakte. Por Partia ua zhduku atyre këtë frikë. Ne u thamë shokëve se teoria revolucionare është e lidhur ngushtë me praktikën revolucionare, se teoria ka dalë nga praktika dhe u shërben njerëzve si drejtim, si orientim në luftë për një jetë më të mirë, socializmin, për ndërtimin e tij, për krijimin e njeriut komunist, me virtyte të larta, që do ta drejtojë këtë ndërtim dhe do ta kryejë tok me tërë popullin dhe në krye të popullit. Ne i orientuam shokët se, përveç mësimit në shkollat e ndryshme, që do t'u hapte atyre horizonte të gjera diturie dhe eksperience, puna e përditshme, kujdesi dhe dashuria për të, jo vetëm do të krijonte të mirat, jo vetëm ishte strumbullari i ndërtimit të socializmit, por do të bënte që njerëzit të kuptonin më mirë e më qartë edukimin themelor klasor, teorinë marksiste-leniniste, ligjet e zbuluara prej saj, do të mësonin se si t'i zbatonin këto ligje në kushtet e vendit tonë, në etapat e ndryshme të zhvillimit tonë revolucionar. Ky orientim i Partisë ka qenë shumë i drejtë, prandaj ka dhënë kaq rezultate të mira.

Nuk shkuam nga rruga që të krijojmë më parë kuadro të mësuar me teori dhe pastaj këta të fillonin edukimin e njerëzve, por shkuam nga rruga e punës dhe e mësimit, mësimit në shkollë dhe njëkohësisht në punë. Kështu krijuam kuadro me shkollë, të dalë nga puna dhe të lidhur ngushtë me punën, krijuam dashurinë për mësimit nga shkollë e madhe e punës dhe në të dy drejtimet në i kalitëm njerëzit me teori e me shkencë, me kulturë të përgjithshme e speciale. Dhe, ajo që ka rëndësi të madhe, në i mësuar njerëzit në masë të zbatonin në jetë parimet bazë të teorisë marksiste dhe të moralit komunist sikur të kishin mbaruar kurset teorike thjesht marksiste ose shkollë politike, pavarësisht se shumë prej tyre, disa herë, nuk e dinin se kështu ata në fakt mendonin, jetonin e luftonin si komunistë.

Detyra e Partisë është që këtë punë ta çojë akoma më përpara, ta ngrejë vazhdimisht në një nivel akoma më të lartë. Është e ligjshme që sukseset të na gëzojnë, të mbështetemi në to për të përmirësuar punën, por është gjithashtu e domosdoshme të shohim në sy e pa frikë të metat e punës sonë në këto drejtime, të shohim gabimet dhe këto t'i ndreqim.

Këtë qëllim ka ky Plenum i Komitetit Qendror dhe ky është një qëllim i madh.

Edukimi i punonjësve me normat e moralit komunist për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste është një nga detyrat më të mëdha e më të rëndësishme të Partisë, është problem i gjerë dhe i koklavitur, por është problem kyç. Po e mbajtëm mirë në dorë këtë kyç, po e mbajtëm të ndritur dhe të pastër, s'ka derë që të mos çelim; po e lamë të ndryshket, dyert mbeten mby-

llur. Kjo është një figurë e thjeshtë, por, që t'i arrihet kësaj, duhet një luftë e madhe për edukimin e njerëzve, një luftë e madhe e së resë përparimtare, kundër së vjetrës prapanike, një luftë e rreptë e ideologjisë marksiste-leniniste kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste.

Ky problem i gjerë u trajtua në forma orientuese për veprim dhe u ilustrua me shumë shembuj pozitivë dhe negativë nga jeta, në raportin që mbajti shoku Ramiz. Dëskutimet e shokëve rreth çështjeve dhe detyrave që shtronte raporti jo vetëm e plotësuan dhe e ilustruan akoma më mirë atë, por treguan preokupimin e nevojshëm dhe ndjenjën e plotë të përgjegjësisë, frymën e kritikës dhe të autokritikës për problemet që u shtruan dhe për detyrat e reja që vihen para Partisë. Kjo do të bëjë që puna edukative me komunistët dhe me masat e popullit të marrë një hov të madh.

Duke bërë konkluzionet për këto probleme të rëndësishme që u prekën dhe, si kurdoherë, u tregua unanimet i plotë për të gjitha çështjet, do të jetë e vështirë për mua të mos bëj disa përsëritje, por do të përpiqem të flas shkurt.

Rëndësia e punës dhe qëndrimi i ri ndaj saj

Çështja e parë që dua të theksoj është çështja e punës dhe e qëndrimit ndaj saj.

Nocioni punë ka anën e vet praktike, por ka edhe anën e vet teorike shumë të rëndësishme. Parimi socialist «Kush nuk punon nuk ha», nuk ka vetëm kup-

timin material ekonomik, por ka edhe një kuptim të thellë teorik dhe moral.

Puna krijon të mirat materiale. Këto të mira i krijojnë njerëzit me punën e tyre dhe për të mirën e tyre. Karakteri i punës, mënyra dhe organizimi i saj, vendi i njerëzve në punë, shpërndarja e fryteve të punës, përcaktohen nga fakti se në duart e kujt janë mjetet e prodhimit.

Njerëzit, duke punuar me tru dhe fizikisht, krijojnë e zhvillojnë shkencat e ndryshme, zbulojnë të fshehtat e natyrës, pasuritë e saj, shpikin dhe perfeksionojnë makina të shumëllojshme, zbulojnë ligje të reja etj. Por kush përfiton nga këto dhe në ç'shikallë përfitojnë masat e gjera të popullit, sa rëndësi u vihet këtyre vlerave, ç'prioritet i jepet njerës apo tjetrës, sa zhvillim i jepet këtij ose atij sektori, në ç'drejtim përdoren krijimet e mrekullueshme të punës dhe të mendjes së njeriut, të gjitha këto varen nga sistemi shoqëror.

Qëllimi im këtu nuk është të flas për sistemin socialist dhe për atë kapitalist, për epërsinë e sistemit socialist mbi atë kapitalist dhe për luftën që ne po bëjmë dhe do të bëjmë deri në shkatërrimin e plotë të sistemit kapitalist dhe triumfin e socializmit dhe të komunizmit. Por dua të theksoj këtu atë rol të madh dhe atë kuptim të thellë të punës për të cilin kanë folur Marksi dhe në mënyrë të posaçme Engelsi, në një nga veprat e tij të njohura. Puna krijoi njeriun, ajo lindi bashkë me njeriun, puna e zhvilloi atë fizikisht, e transformoi, i krijoi mendimin, gjykimin, ua zhvilloi ato etj. Jeta e njeriut, pra, nuk mund të kuptohet jashtë punës, ose e shkëputur nga puna, qoftë puna fizike, qoftë

puna mendore, qoftë të dyja së bashku të harmonizuara. Prandaj puna dhe njeriu janë të pandarë. Puna e bën të rrojë njeriun, e zhvillon, e forcon, e zbukuron. Pa punë njeriu fishket, si fizikisht ashtu dhe nga ana e intelektualit.

Kuptimi i drejtë marksist-leninist i rëndësisë së punës dhe, si pasojë, qëndrimi i ri ndaj saj është një problem jetik i dorës së parë dhe vendimtar për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit proletar, është kyçi për çlirimin, edukimin dhe krijimin e njeriut tonë socialist.

Populli ynë kurdoherë e ka dashur punën dhe e do atë, ai ka punuar tërë jetën e tij dhe kjo e ka mbajtur gjallë. Prandaj shekujt, mjerimet, regjimet skllavëruese nuk e kanë zhdukur dot atë. Nuk thotë kot populli «puna është nder e lavdi». Kjo parullë e drejtë e popullit në vendin tonë socialist ka marrë një kuptim të thellë dhe zbatohet gjerësisht në jetë. Vetë zhvillimi i vrullshëm i ekonomisë socialiste, i arsimit dhe i kulturës, sukseset e mëdha morale dhe materiale që ka korrur populli ynë, vërtetojnë më së miri sa lart janë ngritur kuptimi dhe rëndësia që i japin njerëzit tanë punës. Kjo u detyrohet frymëzimit të madh, edukimit të drejtë që ka zhvilluar dhe zhvillon Partia me anëtarët e saj dhe me masat e gjera të popullit.

Mirëpo s'duhet të harrojmë se në kuptimin e punës, në qëndrimin ndaj saj, në edukimin nga ana e Partisë të njerëzve me dashurinë për punën ka edhe boshllëqe të mëdha, ka pengesa që duhen luftuar, ka pengesa objektive, ka pengesa subjektive shumë më të vështira për t'i kapërcyer, për zhdukjen e të cilave du-

het një punë edukative akoma më e madhe, më e thellë, e vazhdueshme dhe e gjatë nga ana e Partisë.

Mbeturinat fetare, pikëpamjet borgjeze mbi punën, mbeturinat e koncepteve të vjetra feudale e të fiseve, konceptet e vjetra konservatore mbi familjen, mbi marrëdhëniet e pjesëtarëve të familjes në mes tyre, të familjes dhe të shoqërisë, të burrit dhe të gruas, të prindërve ndaj fëmijëve, koncepti i pronës private dhe rrjedhimet e kësaj të tij në shoqërinë socialiste e të tjera si këto kanë lënë mbresa të thella në ndërgjegjen e njerëzve. Forca e traditës, e zakonit, përpjetet t'i ruajë ato, qoftë edhe në forma të zbehta, dhe kur gjen terren të përshtatshëm, kur nuk gjen rezistencë dhe luftë të rreptë nga e reja, nga përparimtarja, nga një punë metodike dhe edukative e shumanshme individuale dhe masive njëkohësisht, atëherë këto mbeturina të së kaluarës, këto koncepte feudalo-borgjeze, ngrenë krye, shfaqen, trashen dhe pengojnë ecjen përpara të shoqërisë socialiste.

Formimi i njeriut të ri, ky problem i gjerë i rëndësishëm dhe i koklavitur, nuk mund të kuptohet dhe nuk duhet shkëputur kurrë nga çështja e punës, nuk duhet të konceptohet kurrë jashtë punës.

Kur themi se ky person është një punëtor i mirë, me këtë nuk kuptojmë vetëm ose kryesisht faktin se ai realizon e tejkalon normat e planin, por kuptojmë, gjithashtu, se ai është i ndërgjegjshëm për punën e tij, se është i guximshëm, i ndershëm, i disiplinuar në punë, mbron ligjet socialiste, sillet mirë në familje e në shoqëri etj. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ky person

është i përsosur, është krejt i zhveshur nga mbeturinat mikroborgjeze dhe nuk duhet kalitur më tej.

Kështu është dhe me një kolektiv më të gjerë. Kur themi se kjo ndërmarrje punon mirë, me këtë kuptojmë se njerëzit atje në përgjithësi punojnë mirë, jo vetëm sepse realizojnë detyrat e shtruara në plan, por, krahas kësaj, sepse janë edukuar nga Partia me ndjenjën e punës, me normat morale e ligjet e shoqërisë socialiste. Kjo prapë nuk do të thotë se çdo gjë është e përsosur në këtë ndërmarrje, se të gjithë punëtorët e kësaj ndërmarrjeje janë zhveshur nga mbeturinat mikroborgjeze, nga morali borgjez dhe se nuk duhet preokupuar më tej për kalitjen e njerëzve. Një kalitje e tillë do të arrihet në punë dhe nëpërmjet punës, pasi puna është ajo forcë revolucionare që transformon njeriun, botën dhe shoqërinë, është strumbullari i jetës, puna e zbukuron njeriun fizikisht dhe moralisht, ajo është pasqyra më e qartë ku shihen të mirat dhe të këqijat e tij.

Thashë, dhe mendoj se nuk bëj gabim, se puna për njeriun është strumbullari i jetës, është pikëmbështetja e tij më e fuqishme. Nga mosdashja e punës, nga neveritja dhe largimi prej punës, nga mospasja qartë e rëndësisë dhe e rolit shoqëror të punës në socializëm, rrjedhin të këqija të mëdha që e prishin njeriun fizikisht dhe moralisht. Një person që ka koncepte të tilla për punën dhe mban qëndrim të tillë ndaj saj, ai është një parazit, dembel, përpigjet të rrojë në kurriz të të tjerëve, do të vjedhë tjetrin dhe shoqërinë, është armiku i kolektivit, i rregullit e i disiplinës, është përkrahës i fesë dhe i të këqijave të saj, është bartës dhe

nxitës i konservatorizmit etj. Mungesa e dashurisë për punën është burimi i veseve të këqija, kurse dashuria për punën është burimi i cilësive të mira. Puna të ngre nga çdo pikëpamje, të mëson zanat dhe të jep dituri të vlefshme, të bën të tillë që, me ndërgjegje të pastër, të respektosh normat që ka caktuar shoqëria socialiste, të krijoj ndjenjën e vërtetë të forcës kolektive, solidaritetin në punë, të kalit dashurinë e zjarrtë për atdheun, për mbrojtjen dhe përparimin e tij, të kalit ndjenjën e drejtësisë, të mbrojtjes të së drejtës kundër shkelësve të saj, të mpreh vigjilencën për të mbrojtur djersën tënde dhe të kolektivit, frytin e punës nga vjedhësit, sabotuesit, njerëzit e pandërgjegjshëm etj.

Ndërgjegjja e lartë socialiste lind në punë, edukimi komunist i punonjësve bëhet nëpërmjet punës. Ato, pra, janë të lidhura me njëra-tjetrën. Në punë Partia ka krijuar dhe ka edukuar njerëz të mrekullueshëm, që numërohen me qindra mijë, të cilët, me një hov madhështor, ndërtojnë socializmin. Në ballë të tyre qëndrojnë komunistët, anëtarët e Partisë sonë të lavdishme. Në shembullin dhe nën drejtimin e tyre po bëhen mrekullira, po kalitet njeriu i ri. Puna e Partisë dhe puna e palodhur, plot heroizma, plot mençuri dhe sakrifica e punonjësve të pararojës janë bërë shembull e flamur, frymëzim i madh për të gjithë popullin shqiptar. Këto janë thesaret më të mëdha të atdheut dhe këto thesare ne duhet t'i ruajmë e t'i shtojmë, t'i ruajmë nga barrerat e këqija, nga pluhuri e nga ndryshku.

Me gjithë sukseset e mëdha që kemi në punë, kemi edhe dobësi dhe shfaqje të shëmtuara, të cilat Partia, si kurdoherë, i ka vënë në dukje; ajo ka inkurajuar

anët e mira dhe i ka luftuar e do t'i luftojë pa mëshirë anët e këqija, të metat dhe gabimet e njerëzve dhe të punës së tyre.

Edukimi i njerëzve me moralin komunist është, pra, gjëja kryesore nga më të rëndësishmet. Ai që vjedh, ai që shkel ligjet e shtetit, të Partisë dhe të shoqërisë sonë, ai që shkel moralin komunist, ai që gënjen etj., ai s'ka lindur i tillë, atij i është prishur ndërgjegjja, sepse tek ai kanë influencuar më shumë morali borgjez, mbeturinat mikroborgjeze dhe ka influencuar më pak edukimi komunist i Partisë dhe i shoqërisë. Detyra e Partisë ka qenë dhe mbetet t'i edukojë njerëzit, t'i riedukojë ata që gabojnë, të mos i lërë të shkojnë më tej në degjenerimin e tyre dhe krimbi që ata i bren të mos kalbë dhe të mos infektojë të tjerët. Partia e ka për detyrë të dorës së parë të pastrojë nga ndërgjegjja e njerëzve të gjitha të këqijat e trashëguara nga borgjezia.

Format që ne përdorim për edukimin e njerëzve me moralin komunist, kanë dhënë rezultate të kënaqshme, por fakti që ne kemi edhe gjëra të këqija, duhet të na bëjë të mendojmë seriozisht mbi efikasitetin e këtyre formave dhe metodave, që nga ato edukative dhe deri tek ato administrative, të cilat gjithashtu janë edukative, duhet të na bëjë të ndërgjegjshëm për të zhvilluar deri në fund luftën klasore kundër të këqijave.

Format e punës sonë edukative janë në parim të drejta, por në zhvillimin dhe në zbatimin e tyre janë larg të quhen të përsosura: ato shumë herë vuajnë nga formalizmi, shumë herë janë arkaike dhe të përcipta. Ato nuk përpunohen nga Partia në thellësi, në dina-

mizmin e jetës, nuk bëhet përpjekja e duhur për t'i lidhur me jetën dhe, kur lidhen, kjo bëhet në mënyrë të përgjithshme dhe disa herë nëpërmjet një rutine të neveritshme. Në këto të meta serioze të punës sonë e kanë burimin luftimi i dobët i veseve të këqija dhe shfaqja e mbeturinave mikroborgjeze. Ne kemi hedhur shumë parulla të drejta, si për shembull, «t'ua bëjmë vjedhësve jetën të pamundur». Mirë, edhe ua kemi bërë, edhe kemi edukuar njerëz, edhe kemi dënuar me të drejtë, po kur shohim se akoma vidhet, bile edhe nën hundën e organeve të Partisë dhe të shtetit, kjo tregon se në atë qendër pune ku ngjasin këto, puna e Partisë është e dobët, e përciptë. Duhet, pra, të shkundemi fort në këtë drejtim.

Mirë është të bëjmë propagandë ateiste. Por shpeshherë flasim për këtë gjoja shkencërisht, them gjoja pasi kemi mbetur në disa leksione të përgjithshme e të vjetruara, pasi, për të luftuar konceptet fetare, mendojmë se është e mjaftueshme të shpjegojmë nga se shkaktohet shiu, ç'është bubullima etj., etj. Por në fakt kooperativistët e Vorës, dhe bashkë me ta komunistët, e gjejnë të natyrshme dhe jo të dëmshme që nusen ta mbulojnë me thes të kuq, ta hipin mbi kalë dhe të kalojnë me ceremoni në rrugën nacionale. Ose për kooperativistët e Peshkopisë është e natyrshme që nusja e re duhet të qëndrojë një vit brenda në shtëpi pa punë. Ose ka komunistë, pa le fshatarë, që mbajnë ramazan e kreshmë, që bëjnë synet djemtë, ose i pagëzojnë fëmijët e tyre në kishë etj., etj.

Edukimi komunist i punonjësve për t'i kalitur ata me veti të larta dhe për të pastruar ndërgjegjen e tyre

nga mbeturinat e së kaluarës dhe veset e këqija, duhet të bëhet në vendin e punës, dhe konkretisht duke përdorur për këtë ligjet dhe urdhëresat e shtetit, direktivat dhe vendimet e kongreseve të Partisë, të plenumeve të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Qeverisë. A bëhet si duhet, a bëhet në mënyrë sistematike kjo punë nga ana e Partisë, a përdoren të gjitha format dhe mjetet për këtë edukim komunist? Jo. Ka shumë boshllëqe. Njerëzit i edukojmë me moralin komunist për të ndërtuar socializmin e komunizmin dhe, që të arrihet me sukses ky ndërtim, ne i edukojmë ata ideologjikisht, moralisht, teknikisht, gjatë gjithë ndërtimit të socializmit. Ky ndërtim ndjek ligjet bazë, që na i mësojnë Marksisi, Engelsi, Lenini, Stalini. Kjo është teoria mëmë, të cilën, në radhë të parë dhe në vijat kryesore, komunistët duhet ta zotërojnë. Studimi dhe zotërimi i saj si duhet dhe nga të gjithë, natyrisht, ka vështirësi, prandaj Partia ka çelur shkolla të degëve të ndryshme, ka përgatitur tekste të përshtatshme, ka përgatitur dhe po përgatit vazhdimisht kuadro për mësimin e teorisë dhe zbatimin e saj në jetë. Por në këtë drejtim duhet të bëhen përpjekje akoma më të mëdha për zotërimin e teorisë.

Duke u bazuar në teorinë marksiste-leniniste, ne po ndërtojmë në vendin tonë konkretisht socializmin dhe nuk e ndërtojmë as keq, as gabim. Është tjetër të kesh vështirësi dhe të meta, por është tjetër të thuash që vemi në komunizëm, siç thonë hrushovianët, por që në realitet po kthehen në kapitalizëm. Ne kemi vështirësi, kemi të meta, por vija jonë çon në mënyrë të sigurt në socializëm dhe në komunizëm.

Socializmin ne e ndërtojmë duke pasur parasysh kushtet tona, dhe, për t'ia arritur këtij qëllimi të madh, Partisë dhe Qeverisë u është dashur të lëshojnë shumë direktiva, të bëjnë shumë ligje, të nxjerrin urdhëresa etj. për çdo etapë të veçantë, për çdo drejtim të veçantë, për çdo sektor pune të veçantë. Këto kanë gjetur zbatim në jetë dhe në punë, e reja ka zëvendësuar të vjetrën dhe janë arritur rezultatet që ne gëzojmë sot.

Këtë proces zhvillimi në gjithë dinamizmin e vet, të bazuar në ligjet e materializmit historik, shkencëtarët tanë duhet dhe kanë filluar ta pasqyrojnë në tekstet shkollore dhe në veprat e tyre, duke u bazuar në ndërtimin konkret të socializmit në vendin tonë, në kushtet tona. Ky është dhe duhet të bëhet një material teorik i domosdoshëm, mbi të cilin në radhë të parë është e domosdoshme të thellohen të gjithë komunistët. Kjo është një bazë tjetër e rëndësishme ku duhet të mbëshetet edukimi komunist i punonjësve. Prandaj Partia të përgatitë vazhdimisht materiale të tilla, duke menduar njëkohësisht format më të përshtatshme të mësimi dhe të edukimit.

Këto përgjithësime teorike, ideologjike që përmena më sipër, janë formuluar në ligjet, urdhëresat, direktivat që jepen çdo ditë dhe që rregullojnë punët tona të përditshme, sjelljet tona, qëndrimet tona ndaj punës, fabrikës, pronës socialiste, pronës private, fesë, me një fjalë, ndaj të gjitha fenomeneve dhe aspekteve të jetës. Në këto, në kuptimin e drejtë e të plotë, në zbatimin revolucionar e të përpiktë të tyre, varet çdo gjë: edhe prodhimi, edhe ndërgjegjja edhe edukimi i njerëzve. Çdo ligj, çdo direktivë, çdo urdhëresë e Qe-

verisë ka anën teknike të saj, por ka edhe anën teorike, ideologjike, morale e politike. Njerëzit duhet të edukohen përditë me këtë kompleks të madh. Po e kuptoi mirë Partia atë dhe po punoi mirë në drejtimin e edukimit të njerëzve me këtë kompleks, atëherë punët do të shkojnë shumë mirë. Këtu e kanë burimin edhe të mirat, edhe të këqijat. Duhet të pohojmë se Partia nuk i shikon kurdoherë si duhet të dyja anët e çështjes. Anën teknike, me gjithë të metat që ka, ajo e shikon më mirë, ndihmon që punonjësit ta përvetësojnë, kurse anën teoriko-ideologjike, edukative dhe morale të ligjit e të urdhëresës, ajo ka raste që e ka nënvleftësuar dhe këtu duhet të gjejmë burimin e të metave serioze, të prishjes së ndërgjegjes, të shkeljes së ligjeve e të moralit komunist. Pa reflektuar thellë njerëzit e Partisë për të shpjeguar çdo ligj e urdhëresë (dhe këto janë me qindra e me mijëra), pa u përgatitur seriozisht, dhe në radhë të parë sekretarët e Partisë, për to, si për anën teknike ashtu edhe për anën morale dhe ideologjike, do të thotë të bësh punë shkel e shko, sa për të kaluar radhën. Një interesim i tillë nuk duket, megjithëse të gjithë flasin se Partia e ka për detyrë. Sekretarët e Partisë, punonjësit e Partisë duhet ta marrin seriozisht në dorë këtë punë nga më të rëndësishmet, nga më efikaset të Partisë.

Këtu një diskutant kërkoi që nga Komiteti Qendror dhe nga Qeveria t'u dërgohen rrethëve më tepër materiale të përgatitura. Qoftë aparati i Komitetit Qendror, qoftë ai i Qeverisë duhet ta përmirësojnë punën në këtë drejtim. Por, shokë, duhet të kemi parasysh edhe një gjë: se nuk jemi më në stadin foshnjor, që rrethet të presin që Komiteti Qendror dhe Qeveria

t'u dërgojnë edhe gjellën, edhe lugën, sepse kështu atyre do t'u duhej të mblidhnin në qendër me qindra kuadro të lartë për të përgatitur ushqimin e bazës. Kjo nuk do të ishte as e drejtë, as e mundshme. Një gjë e tillë bëhej përpara, kur s'kishim kuadro, kurse tani në rrethe kemi me qindra e mijëra të tillë që Partia i ka përgatitur me një edukatë të lartë teknike dhe morale. Komitetet e Partisë duhet të kujdesen në mënyrë sistematike që këta kuadro të punojnë në mënyrë të organizuar për çështjet e edukimit të punonjësve, për përgatitjen e materialeve e të leksioneve të nevojshme sipas specialitetit që zotërojnë. Këtë çështje ne duhet ta zgjidhim në mënyrë revolucionare. Nuk duhet të bëhet pengesë çështja e shpërblimeve apo e honorareve, të cilat ne i kemi vendosur dhe duhet t'i zbatojmë drejt në praktikë. Po kur është fjala për përgatitjen e një leksioni apo të një materiali të domosdoshëm për edukimin e punonjësve dhe të komunistëve, këtu as mund të flitet për honorare. Njerëzit tanë janë gati të japin edhe gjakun për popullin, kur e lyp nevoja. Prandaj Partia e ka për detyrë revolucionare që teknikët, specialistët, mjekët dhe kuadrot e tjerë që kanë mbaruar shkollat t'i edukojë që të mos i zërë gjumi për të kryer detyrën gjer në fund dhe, kur është nevoja, të rrinë jo 8 e 12 orë, por edhe 18 orë për të bërë, veç punës së zakonshme, edhe punën shoqërore, një leksion apo diçka tjetër që ka lidhje me zanatin e tyre. Partia duhet t'i edukojë ata që kurrë të mos nisen nga interesi material personal, por kryesisht nga interesi i përgjithshëm i shoqërisë. Duke punuar në këtë frymë, do të zhdukim te ne ndonjë prirje

të dëmshme, sado të vogël, që tani po trashet aq shumë në Bashkimin Sovjetik.

Të kemi parasysh, gjithashtu, se edukimi nuk bën efekt në rast se përgatitim një leksion jashtë kohës, vendit, ose nevojës. Ka leksione me tema të përgjithshme, por, të lësh pas dore ushqimin e përditshëm të punonjësve, është një metodë pune që duhet të braktiset sa më parë. Prandaj me punë edukative duhet të merret e gjithë Partia, duke përfshirë edhe punonjësit komunistë të pushtetit. Ata janë anëtarë të Partisë dhe nuk duhet të mendojnë aspak se janë thjesht administratorë, teknokratë dhe nuk kanë të bëjnë me edukimin komunist të punonjësve. Kur punohet një ligj, një urdhëresë, duhet të punohet imtësisht nga të gjitha anët dhe në këtë drejtim të punojnë Partia, dhe, nën udhëheqjen e saj, pushteti, bashkimet profesionale, rinia, gruaja, e të gjithë, në mënyrë të organizuar, të harmonizuar.

Kurdoherë është theksuar dhe e ritheksojmë se ligjet kryesore duhet të njihen jo vetëm nga juristët, por nga të gjithë, dhe në radhë të parë nga komunistët. Të gjitha ligjet e urdhëresat që janë të lidhura ngushtë me një lloj pune, me një sektor etj., punonjësit, dhe në radhë të parë komunistët, duhet t'i njohin mirë e t'i kenë të qarta. Nuk duhet të kënaqemi me një të shpjeguar, duhet të rikthehemi shumë herë në to, dhe sidomos në ato më të rëndësishmet dhe veçanërisht në ato ku ka thyerje, ku ka shkelje.

Kemi theksuar dhe ritheksojmë se kuadrot e Partisë dhe të pushtetit ngarkohen me gjëra që nuk u përkasin dhe që duhet t'i kryejnë të tjerët, merren me shumë gjëra dhe harrojnë kryesoret, u mungon

shumë herë metoda e mirë dhe disiplina në punë dhe nuk bëjnë sa duhet përpjekje për përmirësimin e punës së tyre. Metoda në punë është një levë e rëndësishme. Këtë të mos e harrojmë. Në qoftë se e marrim përsipër të mësojmë të tjerët, duhet ta kemi vetë një metodë të tillë pune.

Prandaj, shokë, siç po e shohim, kemi shumë për të bërë në drejtim të edukimit komunist të punonjësve. Në qoftë se ne e edukojmë mirë punonjës në punë, me punë, me ligjet e punës e të socializmit, punonjësi edhe jashtë saj do të dijë të sillet si një njeri i ri, megjithëse edukimi i tij duhet të vazhdojë edhe jashtë punës.

Kapitulli i edukimit të punonjësve me moralin komunist është kapitulli më i madh, më i lavdishëm dhe më i koklavitur i veprimtarisë së Partisë. Shifrat, realizimet, normat, rendimentet varen nga njerëzit, nga puna dhe nga ndërgjegjja e tyre. Sa më të edukuar të jenë këta, aq më të mëdha janë realizimet, aq më të vogla janë dëmtimet, aq më pak do të kemi shfaqje të këqija në punë dhe në shoqëri.

E tërë kjo pasqyron nivelin e punës sonë të Partisë. Në të gjitha drejtimet komunistët duhet të jenë në ballë, të jenë shembull, figura e pastër e tyre të ndritë.

Komunisti duhet të jetë ekzigjent ndaj vetes, në qoftë se do që të kërkojë nga të tjerët, duhet të mbajë kurdoherë një qëndrim kritik ndaj jetës dhe punës së tij. Komunisti duhet të jetë i ndershëm, i guximshëm, i sakrificës, këmbëngulës në detyrë, në punë, në mësim, në qoftë se do që këto t'ua mësojë të tjerëve. Komunisti duhet të jetë i pastër, të neveritë dhe t'i luftojë pa mëshirë privilegjet për vete dhe për të tjerët,

të jetë kundër punës së lehtë, kur ai mund dhe duhet të bëjë një punë më të lodhshme, komunisti kurrë të mos abuzojë qenien anëtar partie, ose pozitën që atij i ka besuar Partia. Komunisti duhet të luftojë ashpër vjedhësit, abuzuesit e pasurisë së përbashkët, të luftojë me këmbëngulje më parë në veten e tij mbeturinat që rrjedhin nga prona private, që të mundë të luftojë me sukses edhe në të tjerët, paragjykimet fetare, mbeturinat patriarkale, tendencat e tarafeve, përkrahjet e sëmura, favoret, egoizmin personal, mendjemadhësinë dhe arrogancën.

Shokët tanë komunistë kanë merita të mëdha në të gjitha këto drejtime, ata janë një pasqyrë e ndritur për punonjësit, por ky Plenum i veçantë për këto çështje të na shërbejë që t'i kalitim më tej këto virtyte, të zhdukim të metat dhe gabimet që vërtetohen akoma në punën tonë.

Revolucioni ynë Popullor u arrit me gjak e me sakrificë, ai u arrit sepse e udhëhoqi Partia e armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste, u arrit sepse Partia zhvilloi një luftë gjigande të armatosur kundër pushuesve dhe borgjezisë. Ne do t'i qëndrojmë përjetë besnikë revolucionit proletar dhe, megjithëse në vendin tonë nuk ekzistojnë më klasa antagonistë, ne do të vazhdojmë me forcë të madhe luftën e klasave kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja në ndërgjegjen e njerëzve, sepse kjo është një çështje e madhe parimore e marksizëm-leninizmit, që ka të bëjë me sigurimin e fitores së plotë të socializmit.

Për ta bërë si duhet këtë luftë, ashtu si na ka mësuar dhe siç ka vepruar kurdoherë Stalini, ne duhet të-

mbështetemi fort në klasën punëtore, në masat e gjera punonjëse dhe në doktrinën marksiste-leniniste në luftën për fitoren e socializmit, për forcimin e vazhdueshëm të diktaturës së proletariatit. Stalini, si nxënës besnik i Leninit, gjatë gjithë jetës së tij, qoftë në periudhën e revolucionit qoftë në atë të ndërtimit të socializmit, si në fushën e teorisë ashtu dhe me veprimet e tij konkrete, ka punuar pareshtur për forcimin e diktaturës së klasës punëtore dhe e ka përdorur atë drejt në luftën për likuidimin e klasave shfrytëzuese në Bashkimin Sovjetik, në luftën kundër mbeturinave dhe ideologjisë së tyre, kundër grupeve oportuniste, trockiste, buhariniste e tradhtarëve të tjerë të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të socializmit e të komunizmit. Është gjithashtu merito e madhe e Stalinit që i pari pa rrezikun e titizmit, kësaj agjente të imperializmit amerikan, dhe dha alarmin e drejtë historik kundër kësaj murtaje, që kishite për qëllim likuidimin e fitoreve të socializmit, likuidimin e partive komuniste e punëtore, likuidimin e diktaturës së proletariatit. Pikërisht sepse Stalini bënte një luftë të tillë të lavdishme, parimore dhe të pagabuar në mbrojtje të çështjes së komunizmit, kundër tij u ngrit banda renegate e Hrushovit dhe e revizionistëve të tjerë modernë, të cilët, duke sulmuar egërsisht Stalinin, në fakt sulmojnë marksizëm-leninizmin.

Të lidhim sa më ngushtë punën mendore me punën fizike

Dëshiroj të theksoj disa gjëra mbi punën mendore dhe punën fizike. Këtu duhet të ruhem nga konceptet borgjeze dhe nga ato formaliste e vulgare. Ka koncepte që nënvleftësojnë, bile edhe e përbuzin punën fizike dhe mbivlerësojnë punën mendore; ose anasjelltas, që nënvleftësojnë punën mendore dhe mbivlerësojnë punën fizike. Që të dyja s'janë marksiste. Si puna mendore ashtu edhe puna fizike në themel të tyre kanë një gjë të përbashkët, punën. Edhe njerëzit e punës fizike edhe ata të punës mendore punojnë, krijojnë, djersijnë, lodhen dhe njëkohësisht forcohen, kaliten, përtërihen. Por nga konceptet e gabuara që përmenda më lart, shumë herë arrihet në arsyetime të thjeshta, jo të shëndosha, konservatore dhe, pra, të dëmshme, si për shembull, ai që punon me krahë ose fizikisht lodhet më shumë, kurse ai që punon me tru lodhet më pak; ose ai që punon fizikisht s'është e domosdoshme të lodhë mendjen, se për të ka kush e lodh mendjen; kurse atij që bën një punë mendore, meqë gjoja lodhet më shumë, duhet t'i krijohet edhe ndonjë privilegj. Natyrisht, duhet thënë që të tilla gjykime, të tilla krahasime, s'bien erë marksizëm.

Mbeturinat e këtyre koncepteve borgjeze është e kotë të themi se nuk ekzistojnë, ku më shumë e ku më pak, në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Këto mund të qëndrojnë të heshtura për një kohë, por ngrenë krye në rast se nuk punon pareshtur dhe me sistem Partia.

Në shoqërinë tonë socialiste, ku feudo-borgjezia është shpartalluar politikisht dhe ekonomikisht si klasë

dhe ku u bëhet një luftë e pamëshirshme mbeturinave dhe ideologjisë së saj, klasat antagonistë janë zhdukur (dhe kjo, natyrisht, nuk duhet kuptuar se është zhdukur lufta e klasave kundër elementëve të klasave të shpronësuarra dhe atyre që degjenerojnë, kundër mbeturinave e shfaqjeve të huaja që e kanë prejardhjen pikërisht nga shoqëria e vjetër me klasa, nga shtetet kapitaliste dhe imperialiste që na rrethojnë dhe që bëjnë çdo ditë e çdo orë presion, nga përhapja e revizionizmit modern që përpiqet të shkatërrojë socializmin). Në shoqërinë tonë socialiste, pra, ku është zhdukur shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, puna socialiste ka çliruar njeriun tonë nga të gjitha prangat që e robëronin. Puna fizike e ajo mendore kanë marrë një kuptim të ri, si në brendinë ashtu edhe në format dhe në organizimin e tyre. Në vendin tonë socialist punën fizike nuk e ndan më si më parë një mur nga puna mendore, megjithëse në fakt ekzistojnë akoma ndryshime esenciale në mes tyre. Në vendin tonë as që mund të konceptohet se ata që punojnë në fabrika apo në ara punojnë vetëm fizikisht dhe mendja e tyre, intelekti i tyre nuk punon. Nuk mund të konceptohet se këta janë automatë. Klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse bëjnë në mënyrë të kombinuar punë fizike dhe punë mendore. Socializmi bën që edhe fshatari i thjeshtë, në punën e tij, të mos veprojë në mënyrë mekanike, por edhe të mendojë, të ketë parasysh agroteknikën, metodat e përparuara, të krijojë. Vetë agroteknika dhe metodat e përparuara nuk arrihen pa një punë mendore, ashtu sikundër nuk mund të mendohet që këto të mbeten të pandryshuara dhe se nuk duhet të zhvillohen më tej me një punë eksperi-

mentale dhe mendore. Prandaj këtu Partisë i vihet si detyrë e madhe që në klasën punëtore dhe në fshatarësinë punonjëse të luftojë mbeturinat e tendencave të vjetra prapanike të punës së paktë mendore. Partia duhet t'i vërë rëndësi zhvillimit të intelektit të punëtorëve dhe të fshatarëve. Puna fizike e lidhur ngushtë me punën mendore do të krijojnë njeriun e vërtetë komunist.

Nga ana tjetër, kur flasim për inteligjencien tonë të re, ose më thjesht për punëtorët e mendjes, Partisë gjithashtu i dalin detyra shumë të mëdha. Partia, me punën e saj edukative, duhet të rrënjosë thellë në inteligjencien tonë konceptin e bashkësisë së interesave të saj me ato të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse, duhet t'i bëjë asaj të qartë se ajo nuk mund ta kryejë misionin e saj në shoqërinë socialiste pa u lidhur ngushtë me aktivitetin e masave punonjëse, pa vlerësuar rëndësinë dhe rolin e punës fizike.

Në të njëjtën kohë, kur flasim për inteligjencien tonë, duhet të kemi parasysh edhe disa të dhëna që nuk ekzistonin në të kaluarën. Sot nuk mësojnë si përpara vetëm një kategori njerëzish, por mësojnë të gjithë, pa përjashtim, pavarësisht nga prejardhja e tyre shoqërore. Mësimi është edhe ai «punë»; dhe kur themi punë mendore, të mos harrojmë se disa organe fizike hyjnë në veprim intensivisht, lodhen, sëmuren, ashtu siç lodhen muskujt, mushkëritë ose kockat gjatë punës fizike. Dhe këto janë truri, nervat, zemra, organe shumë më delikate se muskujt. Mësimi është bërë një ushqim për të gjithë, është bërë një punë për të gjithë. Dhe askush s'mund të rrojë dot pa këtë punë mendore të nevojshme, të domosdoshme për jetën. Duke e shikuar, pra, nën

këtë prizëm konceptin e punës mendore, Partia duhet të luftojë pikëpamjet vulgare të nënvleftësimit të saj, si një çështje thjesht të rehatshme. «Ky është një koncept ouvrierist» siç e ka quajtur Marks, ose, si të thuash, që të quhesh punëtor, duhet të mbash një kasketë.

Kur ne ta kemi kuptuar drejt këtë nocion të punës, atëherë do të na hapen përpara horizonte të gjera pune dhe përgjegjësi të mëdha. Në këtë drejtim Partia ka detyra të rënda dhe të lavdishme për të kryer. Për shembull, të marrim të voglin që kur fillon të vejë në shkollë dhe derisa mbaron shkollën e lartë. Kjo është një etapë vendimtare për jetën e tij dhe për atdheun tonë socialist, sepse këtu hidhen bazat e njeriut të ri socialist. Ta ndjekim atë në këtë etapë. Detyra e tij numër një është të mësojë dhe të mësojë mirë. Fakti i të mësuarit mirë apo keq do të thotë nëse ai punon mirë ose punon keq. Kjo është një lloj sikur thua ky punëtor punon mirë ose keq. Që të dyve Partia u ka krijuar mundësitë, mjetet, rregullat dhe ligjet e përshtatshme sipas natyrës së punës. Që të mësojnë mirë fëmijët, derisa mbarojnë shkollën, duhet t'i mësojmë të duan punën. Puna e tyre kryesore, të mos harrojmë, është puna mendore, që përmban në vetvete edhe punën fizike, deri edhe te loja që në fakt është një lodhje fizike, por që në format e saj përgatit shkathtësinë e tyre për punën e ardhshme të kombinuar fizike dhe mendore, përveç kalitjes së shëndetit. Kur djali ose vajza rritet dhe e kupton ndryshe realitetin e jetës, kur piqet, atëherë fillon me programet e reja edhe puna fizike në shkollë, derisa ai ose ajo mbaron shkollën e lartë. Por, po të ishin të mjaftueshme këto gjëra që ne kemi krijuar, atëherë pse të gjithë fë-

mijët nuk punojnë mirë, nuk mësojnë mirë? Diçka këtu na pengon. Duket se puna e Partisë në këtë drejtim, në përgjithësi, është e pamjaftueshme dhe e njëanshme. Puna e Partisë me shkollat, puna me nxënësit e studentët nuk qëndron aq te kujdesi për anën teknike materiale, që nga shkumësi e deri te laboratorit, sesa, në radhë të parë, te puna e thellë edukative, morale, ideologjike, revolucionare me rininë.

Mjaft kuadro partie nuk interesohen fare për shkollën, disa interesohen për godinën dhe bankat, disa të tjerë, kur venë në shkollë, pyesin për notat. Interesohen, pra, vetëm për shifrat, tundin kokën me kënaqësi kur janë të mira dhe, kur janë të këqija, vrenjtin vetullat e thonë në mënyrë doktorale: «Shumë keq, shumë keq!». Ky s'është interesim për shkollën. Që kjo punë të kryhet mirë, Partia duhet të bëjë një kthesë serioze, duhet të ndihmojë më shumë e më mirë mësuesit e pedagogët, jo vetëm për bankat, por si të japin mësimin, si të lidhen më mirë me nxënësit, si të zhvillohen e të interpretohen mësimet e tekstet nga mësuesit dhe nga nxënësit etj. Gjatë gjithë kohës së shkollës dhe nëpërmjet lëndëve Partia duhet të rrënjosë në të rinjtë konceptin e punës, të insistojë në këtë gjë. Sa kanë rëndësi në fabrikë rregulli dhe pastërtia, disiplina dhe ndershmëria, po aq rëndësi, bile edhe më shumë, kanë ato në bankën e shkollës, sepse atje fillon të formohet njeriu i ri. Partia duhet të rrënjosë kudo, e veçanërisht në shkollë e në mësim, metodën e mirë të punës. I theksoj këto gjëra, sepse kanë rëndësi të pallogaritshme.

Por puna edukative e Partisë për krijimin e ndjenjës së dashurisë dhe të respektit për punën te të rinjtë

nuk fillon dhe mbaron në shkollë. Ajo duhet të fillojë dhe të vazhdojë në familje dhe në jetën shoqërore.

Partia duhet të bëjë një punë të gjerë edukative dhe bindëse me prindërit për edukimin jashtëshkollor të fëmijëve. Disa prindër, dhe ndër ta edhe disa komunistë, nuk interesohen fare për fëmijët, për jetën e tyre, për punën e tyre. Ata thonë «babai të blen librin dhe kalemin, babai të ushqen, shkolla le të të mësojë dhe hajde ecë përpara, se unë e bëra detyrën». Partia duhet ta bëjë të qartë se ato ose ata që veprojnë kështu, s'e kanë bërë aspak detyrën. Për edukimin e fëmijëve prindi duhet të interesohet për çdo gjë, t'u mësojë atyre rregullin, ndershmërinë, dashurinë për punë, për mësim, për atdheun, për Partinë, për shkollën, t'i mësojë si të sillen brenda e jashtë shtëpisë, t'i edukojë me respektin e dashurinë për të tjerët, me ndjenjën e heroizmit e të sakrificës, t'u zhdukë dembellëkun. Prindi duhet të kuptojë ndjenjat e të riut dhe, sipas natyrës e moshës së tij, t'i gjejë edhe ilaçin, jo të jetë brutal kur s'duhet dhe i butë kur duhet të jetë i rreptë. Dhe për këto gjëra nuk mjafton vetëm që të japë shembullin me jetën e tij, por është i detyruar t'ua mësojë me këmbëngulje fëmijëve të tij. Si mund të pranohet që një komuniste, bile edhe me ish-profesion mësuese, duke mos u interesuar për fëmijën e vet, vete në shkollë dhe i thotë mësuesit: «Si është e mundur, zoti mësues, t'i vinit vajzës sime notën 2¹? Edhe reaksionare të kishte qenë një tresh mund t'ia vinit të shkretën!».

1 Sipas sistemit të vjetër me pesë nota, nota 2 ishte pakaluese, kurse nota 3 kishte kuptimin mjaftueshëm.

Prindi për edukimin e fëmijëve duhet të mposhtë deri edhe ndjenjat e tij të natyrshme. Edhe kur ai vjen i lodhur me të vërtetë nga puna, duhet të evitojë që të thotë përpara fëmijës «jam i lodhur», sepse dashur pa dashur krijon një kuptim të keq për punën te fëmija. Fëmijët duhet t'i shikojnë prindërit në shtëpi të punojnë, të merren me punë, prindërit t'i futin dhe ata në punë, t'u tregojnë për të mirat e punës dhe jo të kënaqen me punën praktike që është caktuar në programet e shkollave. Kjo duhet bërë edukatë në çdo familje.

Të mendojmë seriozisht, shokë, për këto çështje, sepse këto janë çështje të rëndësishme partie; por s'mjafton të mendojmë, duhet të punojmë, të gjejmë format më të përshtatshme, t'i zhvillojmë këto forma dhe t'i vëmë në jetë më mirë se deri tani.

Po lidhem tani me idenë e parë. A mund të konceptohet në shoqërinë tonë socialiste që njeriu i mësuar, inteligjencia jonë, punëtorët e mendjes të mbyllen në «kullën e fildishtë» dhe të mos lidhen me jetën, me praktikën, të mos e lidhin punën mendore me punën fizike? Në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet. Merrni cilindo punonjës që ne e cilësojmë të punës mendore që të mos jetë i lidhur me jetën praktike, me punën fizike, me fabrikën, me arën etj. Po t'i hedhim një sy jetës 23-vjeçare të Partisë sonë, ne mund të themi me kre-nari se ajo ka bërë një punë kolosale, të lavdishme, në këtë drejtim kyç. Ne jemi në rrugë të drejtë dhe do të shkojmë duke i forcuar punën dhe situatën.

Duke përfunduar me këtë çështje të kuptimit të

drejtë të punës fizike dhe mendore, dua të shtoj se ne duhet të kemi të qartë në cilat shtresa mund të na paraqiten më shumë rreziqe të zhvillimit të mbeturinave dhe shfaqjeve të huaja. Këto mbeturina mund të shfaqen ose të zhvillohen ku më shumë e ku më pak në të gjitha shtresat, por ato mund të shfaqen më lehtë dhe më shpejt veçanërisht në inteligjencien. Ndjenja e superioritetit, e komandimit, e më të zotit, e më të diturit, e më të mësuarit, e egoizmit personal, e punës individuale dhe, si rrjedhim i këtyre, fodullëku, arroganca, burokratizmi, rehatllëku e të tjera të këqija mund të shfaqen më lehtë në këto shtresa sesa në të tjerat, të cilat gjithashtu nuk janë të paprekshme.

Pse ka rrezik më shumë në inteligjencien që të shfaqen mbeturinat borgjeze? Arsyeja s'është vetëm se ato janë më të natyrshme për këtë shtresë të shoqërisë, por edhe sepse në regjimin tonë socialist, një periudhë e tërë e formimit të njeriut, domethënë që kur është kalama dhe derisa mbaron shkollën, megjithëse gjatë kësaj periudhe punon duke mësuar, kjo është, si të thuash, një periudhë përgatitore për të, për të kaluar në jetë. Ai mëson si prodhohet, por vetë nuk prodhon të mira, ai rron dhe rritet me të mirat që i prodhon puna e prindit dhe e shoqërisë; është, si të thuash, njëfarë paraziti dhe shoqëria jonë socialiste e pranon këtë fakt, këtë sakrificë, këtë përjashtim nga rregulli.

Në shoqërinë tonë socialiste, në këtë shtresë të inteligjencies që përgatitet, hyjnë si ata me prejardhje nga klasa punëtore ashtu dhe ata nga klasat e tjera, prandaj gjatë kësaj periudhe përgatitore rreziqet paraqiten

për të gjithë. Mund, dhe kjo në përgjithësi është kështu, që në ata të rinj gjendja e prindërve të të cilëve është punëtor të ketë më pak shfaqje të mbeturinave bor-gjeze dhe më shumë në ata të rinj prindërit e të cilëve janë fshatarë ose intelektualë. Prandaj merr një rëndësi të jashtëzakonshme periudha përgatitore gati njëzetvjeçare e të rinjve dhe e të rejave me kuptimin e drejtë të punës, me kuptimin e jetës e të shoqërisë socialiste, me njohjen e rolit udhëheqës të klasës punëtore, me qëndrimin komunist ndaj punës dhe ndaj jetës. Në këtë periudhë përgatitore të inteligjencies sonë socialiste shumë gjëra varen nga shkolla, nga metodat pedagogjike, por nuk ka më pak rëndësi përgatitja e saj jashtë shkollës, në shtëpi dhe jashtë shtëpisë, në shoqëri. Shkolla nuk duhet të bëjë dallime, por në shkolla ka fëmijë që në familjet e tyre nuk i kanë akoma të gjitha kushtet e nevojshme për të mësuar si duhet, prandaj ajo duhet t'u krijojë atyre një ambient sa më të përshtatshëm për mësim. Shkolla këta duhet t'i ndihmojë më shumë. Po për ata që kushtet në familje i kanë më të përshtatshme, duhet të kihet kujdes që këto kushte të shërbejnë për një formim të mirë të të riut dhe jo të krijojnë ndjenja të huaja për edukatën komuniste, ndjenjën e komoditetit, të superioritetit, të fodullëkut etj. Në qoftë se Partia e merr në dorë si duhet këtë edukim bazë dhe përdor për këtë qëllim të gjitha format, sukseset tona do të jenë akoma më të mëdha në të gjitha drejtimet. Kur i riu futet në jetë, dua të them në punë, Partia duhet ta vazhdojë edukimin e tij nëpërmjet punës.

Shokë, edukimi i brezit të ri duhet të jetë një nga

preokupimet më të mëdha të Partisë, sepse brezi i ri nuk e ka bërë luftën, nuk e ka njohur egërsinë e push-tuesve dhe të feudo-borgjezisë, dredhitë e tyre, shtypjen, masakrat që i kanë bërë popullit tonë. Ai këto i lexon në libra. Shumica e të rinjve dhe e të rejave, dhe sidomos rinia e ardhshme, nuk mund ta konceptojnë aq lehtë si ka qenë jeta e fshatarësisë sonë në të kaluarën kur shikojnë dhe do të shikojnë më mirë më vonë, zhvillimin e mrekullueshëm të bujqësisë, ata nuk mund ta konceptojnë dot si duhet jetën e dikurshme të punëtorëve tanë, kur shohin vendin plot me fabrika, me centrale elektrike, me shkolla. Partia duhet t'ua bëjë të qartë vazhdimisht se këto janë frytet e revolucionit tonë popullor të arritura me luftë, me sakrifica të mëdha nga klasa punëtore dhe nga fshatarësia, se këto janë arritur me një luftë të ashpër klasash, me luftë të ashpër kundër imperializmit, revizionizmit. Në këtë mënyrë Partia të mbajë kurdoherë gjallë në rininë tonë frymën e revolucionit, ta bëjë rininë besnike të revolucionit, besnike të Partisë marksiste-leniniste, të klasës punëtore, të ideologjisë së saj. Dhe që të arrihet si duhet kjo, duhet që me një punë të palodhur edukative revolucionare të zhdukim çdo mbeturinë të së kaluarës nga ndërgjegjja e rinisë.

Kjo, natyrisht, nuk është një punë e lehtë, por është një punë edukative e gjatë, e përhershme dhe plotësisht e mundshme. Të peshojmë rezultatet e mëdha që ka arritur Partia, të mbështetemi në to dhe të ecim përpara. Kuptimi i drejtë i kësaj çështjeje, krijimi i një edukate të tillë, qoftë në klasën punëtore ose në inteligjencien, do të sjellë zhdukjen e shumë veseve të këqija,

mbeturima të së kaluarës që na pengojnë, që na dëmtojnë në ecjen tonë përpara drejt socializmit dhe komunizmit. Të mos harrojmë për asnjë moment rrethimin kapitalist dhe revizionist me helmin e tij, që nga predikimi i zhdukjes së diktaturës së proletariatit, zhdukjes së luftës së klasave, transformimit të partisë së proletariatit në një parti borgjeze dhe deri te predikimet e tyre jezuite të pacifizmit, të humanizmit borgjez, të individualizmit borgjez etj. Të gjitha këto ushtrojnë dhe do të ushtrojnë presione të mëdha mbi njerëzit tanë. Duke pasur gjithashtu parasysh kohën relativisht të shkurtër të formimit komunist të njerëzve tanë dhe ekzistencën akoma të gjallë për një kohë të gjatë të mbeturinave borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve, Partia kudo, kurdoherë, por veçanërisht me intelektualet dhe punonjësit e administratës, duhet të bëjë një punë edukative këmbëngulëse, një luftë të ashpër klase me mbeturinat që shfaqen në këto shtresa, sidomos për shkak të natyrës së punës së tyre akoma jo të gërshtuar si duhet me punën fizike. Dhe për shkak të pozitive drejtuese që atyre u janë besuar, po të mos luftohen të metat dhe gabimet që shfaqen në ta, mund të degjenerojnë lehtë. Prandaj është e domosdoshme që puna e tyre të jetë nën kontrollin dhe ndikimin ideologjik të vazhdueshëm të Partisë dhe të klasës punëtore. Këto shtresa Partia duhet medoemos t'i bëjë të ecin me hovin revolucionar të klasës punëtore, të jenë besnike të kësaj klase në të gjithë punën e tyre, në ndjenjat, në aspiratat e tyre.

Edukimi komunist i punonjësve bëhet gjithashtu nëpërmjet veprave letrare, veprave të artit, të teatrit,

të muzikës etj. Duke i vlerësuar drejt këto vepra, Partia duhet të preokupohej jashtëzakonisht për to dhe sidomos për krijuesit e tyre.

Interesimi i kujdesshëm i Partisë për njerëzit e kësaj kategorie do të bëjë që ne të kemi vepra të bukura, revolucionare, ushqim të shëndetshëm dhe frymëzues për punonjësit tanë. E kundërta do të na sjellë humbje të pallogaritshme. Armiku i klasës e njeh mirë ndikimin e letërsisë dhe të arteve në ndërgjegjen e njerëzve, ai i ka parasysh kurdoherë pikat e dobëta të kësaj shtrese të inteligjencies dhe prandaj bën përpjekje kolosale që të ndikojë për të keq në të, ta thyejë, ta çarmatosë, ta bëjë vegël kundër revolucionit. Asgjë nuk duhet t'i shpëtojë syrit të mprehtë revolucionar të Partisë. Njerëzit tanë të kulturës dhe të arteve në përgjithësi janë me veti të larta partie, ata janë patriotë, luftojnë me mish e me shpirt për ndërtimin e socializmit, japin vepra të mira e të bukura. Por të mos harrojmë se ka edhe të atillë që çoroditen, që kanë lakra në kokë. Në përgjithësi në ta punon fantazia, mjaft kanë prirje të ëndërrojnë shumë, të stërhollojnë, të kombinonjë, të fabrikonjë disa herë edhe gjëra të paqena dhe, duke pasur parasysh se si intelektualë kanë prirje të theksuara t'u pëlqejë mendja e tyre dhe të komandojnë, Partia kurdoherë duhet të ndikojë për të mirë në punën e tyre, në imagjinatën dhe në ëndrrat e tyre.

Metoda më e mirë dhe shpëtimtare për ta është lidhja me jetën konkrete, me të mirat dhe brengat e popullit, sesa me brengat e një imagjinate të krimbur e të sëmurë të ndonjë pseudoshkrimtari që na nxjerr

njëfarë simiteje të mykur, duke u mbyllur në dhomë, dhe kërkon të na e shesë si safi bukë gruri.

Çështja e lidhjes së shkrimtarëve me jetën e popullit, me realitetin tonë socialist, është një çështje e madhe, që ka të bëjë drejtpërsëdrejti me zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë sonë në rrugë të drejtë.

Njohja e jetës së popullit, e realitetit, është një proces i ndërlikuar dhe bëhet në forma e në rrugë të ndryshme. Partia duhet të ketë një mbikëqyrje prej nëne për shkrimtarët dhe t'u japë të kuptojnë se brenda mbyllur në dhomë, ose në qytetin e tyre, puna krijuese nuk do të ketë rezultate të mira. Ajo duhet t'i bindë shkrimtarët që ta ndiejnë nevojë të brendshme të shkojnë në bazë, atje ku luftohet, punohet e prodhohet, të marrin kontakte të gjalla me njerëzit, të rrojnë me hallet, problemet e dëshirat e tyre, të shohin nga afër, të prekin transformimet e mëdha që janë bërë në jetën e vendit dhe në ndërgjegjen, psikologjinë, botëkuptimin e njerëzve tanë. Dhe kjo bëhet jo duke vajtur në ndonjë rreth për katër-pesë ditë, por duke ndenjur atje një kohë të gjatë, gjashtë muaj dhe më shumë po qe nevoja. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se shkrimtari nuk është si inxhinieri, i lidhur me një objekt të caktuar të patundshëm, por ai, sipas konceptit të veprës që ka për të shkruar, mund të ketë nevojë të lëvizë, të shkojë nga një vend në tjetrin, nga një rreth në tjetrin.

Mendoj se duhet të jemi të rreptë në shtypjen e letërsisë dhe të vënies në skenë të pjesëve që nuk e meritojnë, që s'janë edukuese. Në këtë drejtim ka lëshime të dëmshme. Deri tek unë vijnë letra nga disa

që kanë pretendime t'u botohen edhe krijimet që s'kanë as vlerën më të vogël. Ngandonjëherë Ndërmarrja e Botimeve, ose redaksitë e revistave letrare, nuk janë parimore, nisen nga ideja që të mos i prishin qejfin këtij ose atij autori dhe nuk mendojnë se ç'dëm u sjellin interesave të popullit dhe vetë autorëve duke botuar vepra me dobësi ideore.

Shteti ynë i demokracisë popullore ka ngritur shtypshkronja, teatro e librari për t'i shërbyer edukimit ideologjik e kulturor të masave punonjëse dhe jo për të botuar e për të përhapur vepra që s'vlejnë dhe që s'e meritojnë. Ai që bën vepra të tilla, le t'i ruajë në «dyqanin» e tij, në «dollapin» e shtëpisë. Në dëshiron që t'i botohen, duhet të mendojë mirë, drejt dhe të nxjerrë me të vërtetë vepra edukative.

Kjo nuk mund të konsiderohet, siç na akuzon borgjezia, një letërsi ose art i drejtuar, i komanduar. Partia jonë i frymëzon, i edukon njerëzit për t'i dhënë popullit, si në çdo sektor, ashtu edhe në art e kulturë, vepra të bukura, realiste, të lidhura me popullin, të punuara për kënaqësinë dhe edukimin e tij.

Vlera e kohës dhe përdorimi si duhet i saj

Çështja tjetër që dua të theksoj është çështja e kohës, vlera dhe përdorimi si duhet i saj.

Kur flasim për jetën e njeriut, për punën, ne nuk mund të mos flasim gjithashtu për kohën që ai ka në dispozicion. Koha nuk mund të shkëputet nga jeta dhe nga puna. Kur populli thotë se «koha është flori», këtu ai fut një përmbajtje të thellë jo vetëm materiale-eko-

nomike, por edhe morale e filozofike. Me këtë, nga njëra anë, ai shpreh vlerësimin e madh të kohës, të cilën e krahason me floririn, dhe nga ana tjetër shpreh faktin që kohën mund ta shndërrojë në flori jo kushdo, por vetëm ai që di ta përdorë drejt.

Në raportin që u paraqit, përveç të tjerave, flitet dhe për kohën e humbur në punë, në fabrika, në ara, në shkolla, në administratë, kohë që, me të drejtë, vlerësohet në miliona lekë të mira materiale që nuk i erdhën ekonomisë kombëtare, dhe, si pasojë, punonjësit nuk përfituan nga koha që humbi kot. Pse kjo kohë u la të humbasë kot? Faji qëndron në dobësitë e organizimit e të disiplinës në punë, vendosjes së normave, në mjekët që japin edhe kur s'duhet receta e raporte për leje etj., etj. Ne mund të vazhdojmë të numërojmë edhe shumë shkaqe të tjera. Detyra është të marrim masa serioze që t'i zhdukim ato. Por të mos harrojmë se ekzistojnë disa shkaqe të mëdha subjektive, psikologjike, morale, që shkaktojnë shkeljen e normave të disiplinës në punë, që shkaktojnë humbjen e kohës në punë. Po nuk i kuptuam si duhet këto, po nuk krijuam norma të reja morale me anën e një pune të gjërë edukative, atëherë do të jetë vështirë që të arrijmë atë që ne dëshirojmë. Një nga këto norma të reja morale është që të gjithë njerëzit punonjës të kuptojnë vlerën e kohës dhe nevojën e përdorimit të mirë të saj. Kjo është një detyrë e madhe e Partisë, që duhet marrë seriozisht. Nuk e kanë të gjithë të qartë vlerën e kohës dhe nuk e lidhin atë si duhet me punën, nuk e matin punën me kohën, as kohën nuk e vlerësojnë me rezultatet e punës. Në këtë drejtim duhet të punojmë

intensivisht, që të rrënjosim në njerëzit një edukatë të re, një koncept të ri mbi kohën dhe të zhdukim konceptet e vjetra. Po të pyesësh një fshatar sa larg është ky fshat nga ai fshat, ai të thotë: «një vrap pele», dhe ky vrap mund të vazhdojë 4 orë; po të pyesësh fshatarin e Tiranës pse s'i heq misrat nga ara, ai të thotë: «kemi kohë», dhe gjatë kësaj kohe ai vete në pazar të shesë disa vezë, ose një barrë me karthija; t'i thuash një nxënësi pse s'mëson, ai të thotë: «kam kohë» dhe në kohën që duhet të mësojë luan, kurse në kohën që duhet të luajë shtrihet në hije dhe ëndërron; kur u thua drejtuesve të ndonjë ndërmarrjeje pse nuk morët masa për realizimin e planit, ata të thonë: «është e vërtetë, por do ta kapim më vonë kohën e humbur». Me shembuj mund të zgjatemi sa të duash, por duhet të nxjerrim konkluzionet dhe të marrim masat praktike dhe edukative që këto mentalitete të gabuara mbi këtë problem t'i zhdukim.

Në numrin e fundit të gazetës «Puna» kjo çështje kaq e madhe ishte ngritur shumë mirë nga një punëtor. Në letrën e hapur drejtuar kësaj gazete ai kritikonte një shokun e vet që vinte me 10 minuta vonesë në punë. Kur ia vinin në dukje këtë të metë, shoku u përgjigjej si pa gjë të keq: «S'bëhet kiameti për dhjetë minuta». Ne i përgëzojmë autorin e letrës, si dhe punonjësit e gazetës «Puna» që e botuan atë, dhe mendoj që këtë çështje ata duhet ta bëjnë objekt të një fushate serioze, në mënyrë që ky problem i madh të rrihet nga të gjitha anët dhe të zbërthehet esenca morale dhe edukative e tij.

Kudo ku punohet në vendin tonë janë përcaktuar

norma pune, të llogaritura me kohën. Këto çdo ditë perfeksionohen për të mirën e ekonomisë dhe për shëndetin e punonjësve, por megjithatë nuk zbatohen mirë kudo. Është lehtë të bëjmë përmirësime teknike, ekonomike e organizative për realizimin e normave, por është më e vështirë të bëjmë që të kuptohen dhe të zbatohen si duhet këto nga të gjithë njerëzit. Këtu hyn çështja e krijimit të një ndërgjegjeje të lartë, e zhvillimit më tej të qëndrimit socialist ndaj punës. Punonjësi, që e kupton mirë rëndësinë e punës dhe të kohës, e kupton, e pranon idenë e disiplinës, e cila vendoset për diçka të nevojshme, të arsyeshme, të domosdoshme: për jetën e njeriut, për punën e tij. Disiplina socialiste nuk është kërbaçi, por bindja, vetëdija që njerëzit të veprojnë, të punojnë brenda disa caqeve, disa rregullave, disa ligjeve shtetërore dhe normave të shoqërisë socialiste, të cilat nuk e ulin aspak personalitetin dhe nuk zhdukin as të drejtat, as iniciativën e tyre. Që të mund të kuptohet si duhet rëndësia e kohës dhe të përdoret mirë kjo, përveç disiplinës së ndërgjegjshme në punë, duhet të vendoset kudo, dhe në radhë të parë në ndërgjegjen e njerëzve, ndjenja e rregullit. Të vësh rregull si duhet në jetë, në punë, në kohë, s'është një gjë që mësohet me një leksion të thatë, ose me ndonjë këshillë në të kaluar e sipër.

Kjo është një edukatë e tërë, që Partia duhet ta rrënjosë që nga të rinjtë deri te pleqtë. Duhet t'i mësojmë njerëzit të përdorin në mënyrë racionale kohën: në punë dhe jashtë punës, në shkollë dhe jashtë shkolles; ta bëjnë një natyrë të dytë çështjen që kur është koha e punës të punojnë me të gjitha forcat e tyre me-

ndore dhe fizike, të jenë të disiplinuar, të respektojnë normat dhe ligjet e punës; kur është koha e pushimit të pushojnë, kur vjen koha e leximit të lexojnë, kur vjen koha që të venë në teatro, në kinema, ose në sport, të venë, kur vjen koha për të fjetur të flenë. Ata, po të duan, le të caktojnë kohë edhe për të ëndërruar, por rëndësi ka dhe përse e kur ëndërron njeriu, sepse, në rast se rri në zyrë, bën gjoja sikur punon, por thur ëndrra të kota, ai s'është njeri realist, merret me punë boshe, e shkon dëm kohën në kurriz të shoqërisë. Duke e kapur, pra, demin nga brirët, duke e bërë çështjen e shfrytëzimit racional të kohës një objekt të madh të punës edukative të Partisë, ne do të zhdukim shumë dëme serioze që pësojmë në ekonomi dhe në fushat e tjera të jetës.

Për çështjet e punës dhe të kohës shteti ka caktuar norma, ligje, rregullore, të cilat Partia vetë dhe të gjithë punonjësit duhet t'i njohin dhe t'i zbatojnë mirë, duhet të njohin si anën praktike e teknike ashtu edhe anën e tyre të rëndësishme edukative ideologjike dhe politike. Të kemi parasysh se pa kuptimin e drejtë të së dytës, e para nuk mund të zbatohet si duhet. Sa rëndë gabohen ata shokë të Partisë, të pushtetit, të bashkimeve profesionale, të rinisë, të gruas që nuk i vënë sa duhet rëndësi kësaj ane të madhe, anës edukative! Dhe ky edukim te ne bëhet dhe do të bëhet kryesisht në frontin e punës, lidhur me punën. Të mendosh se mund t'i arrihet këtij qëllimi me ndonjë referat teorik ose pedagogjik, që s'e lidh gjë me punën dhe me kohën, kjo është e kotë, sepse kjo është një punë fare boshe.

Prandaj, shokë, me gjithë punën e madhe që ka bërë Partia me njerëzit, përpara kemi një punë akoma më të madhe për të bërë, për të kalitur më tej ndër-gjegjen socialiste të njerëzve tanë, për të forcuar rregullin, disiplinën në punë, në jetë etj.

Si duhet ta kuptojmë dhe ta zbatojmë kritikën dhe autokritikën

Lidhur me këto që thashë dua të flas pak edhe si duhet ta kuptojmë dhe ta zbatojmë kritikën dhe autokritikën.

Ndryshe nga armët e tjera, arma e kritikës dhe e autokritikës jo vetëm mund të të vrasë (në këtë drejtim ne nuk duhet ta përdorim kurrë), por mund edhe të të shërojë, mund të të shpëtojë nga të këqijat (në këtë drejtim, dhe vetëm për këtë qëllim ne duhet ta përdorim).

Për t'ia arritur qëllimit të mirë, varet se si përdoret nga gjithsecili kjo armë. Kjo nuk është aq e lehtë, atë duhet të mësojmë ta përdorim dhe ta perfeksionojmë. Kritika e autokritika s'është një armë «materiale», si pushka që i mëson mekanizmin, stërvit syrin, i vë plumbin dhe heq këmbëzën. Jo. Arma e autokritikës dhe e kritikës marksiste-leniniste është diçka tjetër, krejt e ndryshme nga e para, shumë e komplikuar, sepse ka të bëjë me shumë faktorë moralë, psikologjikë, politikë, ekonomikë, të gërshetuar ngushtë njëri me tjetrin, sepse lidhet me periudha kohe dhe momente të ndryshme etj. Duhet të orientohesh drejt në këtë labirint, në këta faktorë, rrethana e momente që

më të shumtën e herës nuk janë materialë, disa herë janë të faktuar e disa herë jo të faktuar dhe pastaj të heqësh këmbëzën. Populli thotë se, për të hequr këmbëzën, duhen dy pendë që. Atëherë duhet të kemi parasysh sa serioze është për ne marksistët çështja e kritikës dhe e autokritikës. Vështirësitë që hasen në këtë drejtim nuk janë një mur i pakapërcyeshëm, ato mund dhe duhet t'i kapërcejmë, dhe që t'i kapërcejmë, ka shumë mënyra. Unë do të radhis këtu disa prej tyre që, nga eksperiencia e jetës së Partisë, na kanë shërbyer në përmirësimin e kësaj arme të fuqishme.

Duhet të kemi kurdoherë parasysh të ruajmë esencën edukative të kritikës. Kritika s'duhet të ketë kurrë karakter dërrmues, hakmarrës, ajo kurrë s'duhet të bëhet me prapamendime, ose me qëllime të këqija denigrimi, ofendimi, e sidomos në bazë të falsifikimit dhe të shpifjes. Kritika duhet të jetë kurdoherë shoqërore, jo kryesisht nga toni, por sidomos nga përmbajtja, për qëllimin që bëhet.

Kritika duhet të jetë e peshuar mirë, që t'i bëjë efekt të kritikuarit dhe gjithë kolektivit që e dëgjon, i cili duhet të edukohet dhe ai me këtë kritikë. Ajo duhet të jetë e argumentuar me fakte konkrete, bindëse e të drejta dhe kurdoherë e shoqëruar me konkluzione edukative morale, politike, ideologjike.

Çështja nuk është vetëm që i kritikuari të mos dalë nga mbledhja i dërrmuar, i përbuzur, krejt i dekurajuar, por të dalë i forcuar, i qartë, i ngrohtë dhe me besim se kritika i bëri mirë dhe ai do ta ndreqë gabimin. Çështja është gjithashtu të arrihet që kritika që i bëhet një shoku të bëjë efekt në të gjithë. Ajo të shër-

bejë për të kritikuar indirekt edhe disa të tjerë që kanë gabime në vetvete dhe, me këtë rast, të dalin me autokritikë spontane, të ndershme, marksiste, pavarësisht se nuk janë objekt i drejtpërdrejtë i kritikës së bërë. Në këtë mënyrë kritika kundrejt njërit merr në esencë një karakter edukativ shoqëror. Veç asaj, forma e drejtë shoqërore e kritikës (dhe kjo s'ka të bëjë aspak me kritikën e zbehtë, të butë e sa për formë), i jep me të vërtetë Partisë rolin e mëmës së rreptë, por me zemër të gjerë, me dashuri të thellë për fëmijët e saj.

Kritikuesi nuk duhet të udhëhiqet në kritikën e tij nga vendi i tij në Parti, ose në shtet, por nga pozita partie; nuk duhet të udhëhiqet nga mendjemadhësia dhe ndjenja e epërsisë së tij intelektuale, ose të njeriut që i di të gjitha, që është i pagabueshëm në mendimet e tij. Kritikuesi duhet të dijë të ruajë partishmërinë në kritikë, të ruajë thjeshtësinë e komunistit, të ruajë gjakftohtësinë, të luftojë rrëmbimin dhe të përdorë logjikën e fortë marksiste që i japin faktet që kritikon dhe pjekuria e eksperiencës së tij, që di t'i shfrytëzojë si duhet këto të dhëna, për ta bërë kritikën me të vërtetë me përmbajtje marksiste, me formë marksiste, me të vërtetë edukative.

Përdorimi i kritikës me vend e pa vend, i kritikës së zbehtë, kur duhet të jetë e fortë dhe e fortë kur s'është rasti i tillë, në vend që të edukojë, bën shumë herë efektin e kundërt. Kjo armë e fuqishme edukuese për njerëzit duhet të përdoret drejt, të perfeksionohet, t'i vihet kujdesi më i madh nga kuadrot dhe të mos shkohet me këtë armë pa kurrfarë përgjegjësie si në dasmë, të mos lejohet të bëhet ajo një rutinë e dëmshme

ose demoralizuese, shtypëse, shqetësuese për njerëzit, por të jetë një nga armët edukuese, mobilizuese nga më revolucionaret të Partisë.

Kundër kritizerëve të sëmurë që e kanë «kritikën» në majë të gjuhës, që e përdorin atë pa vend, ose që shpifin, duhet të merren masa, masa partie, masa kritike të forta; atyre që e keqpërdorin këtë armë duhet t'u bëhet një kritikë e ashpër.

Rëndësi të madhe ka edhe kuptimi i drejtë i autokritikës. Autokritika marksiste-leniniste s'ka asgjë të përbashkët dhe të ngjashme me «rrefimin» të priftit. Njeriu i ndershëm, qoftë ky komunist ose pa parti, që mund të gabojë dhe që gabon në jetë (dhe për këtë s'ka imunitet), nuk ka frikë të njohë gabimin e tij, në qoftë se ai ka besim në drejtësinë e kolektivit, në drejtësinë e Partisë, në drejtësinë e ligjeve të shtetit, në qoftë se ai ka besim në drejtësinë e gjyqimit të shokëve, të forumeve, në dashurinë dhe në kujdesin e vazhdueshëm të këtyre për njeriun, në qoftë se atje ku ai punon, jeton, militon i janë krijuar kushte të atilla që të flasë lirisht për gabimin ose për fajin që ka bërë. Këto kushte janë të domosdoshme, në qoftë se duam që autokritika të bëhet një armë e fuqishme edukuese për njerëzit. Këto kushte në përgjithësi Partia i ka krijuar, por duhet t'i përmirësojmë, t'i perfeksionojmë kudo në organizatat e saj, në organet drejtuese, në qendrat e punës e të prodhimit, në administratë etj.

Autokritika bolshevike zhvillohet atje ku edhe kritika është bolshevike. Të dyja influencojnë në njëra-tjetrën për të mirë, por edhe për të keq, kur ato s'janë bolshevike.

Në qoftë se kritika bazohet në fakte jobindëse, ose në shpifje, në qoftë se kritika bëhet duke u nisur nga fryma e pozitës ose me gjaknxehtësi etj., atëherë ai që ka për të bërë autokritikë ose do të shtanget, ose do të revoltohet dhe do të humbasë durimin, ose instinktivisht do të përpiqet të mbrohet, i udhëhequr nga disa mbeturina mikroborgjeze, si inati, ruajtja e personalitetit të tij etj., gjë që ia nxit vetë fakti se ai ka shkelur ligjin dhe moralin komunist i shtyrë pikërisht nga mbeturina të tilla. Derisa një person ka bërë një gabim ose faj, diçka nuk është në rregull në ndërgjegjen e tij, në botëkuptimin e tij dhe për t'ia ndrequr, për t'ia spastruar këtë diçka, nuk mund dhe nuk duhet të përdorim ato diçkara që janë të gabuara, nuk duhet të nisemi nga ato pozita që e kanë shtyrë pikërisht atë të bjerë në gabime.

Si pas kritikës që i është bërë një personi, ashtu edhe pas autokritikës që ai bën, Partia lipsët më tepër se kurrë t'i qëndrojë afër, të gjithë njerëzit t'i qëndrojnë afër, sepse personi në fjalë ka nevojë të ndiejë kujdesin dhe ngrohtësinë e Partisë, drejtësinë e saj, drejtësinë e kritikës. Ai ka më shumë se kurdoherë nevojë për këtë, të mos harrojmë se ai është në konvaleshencë. Kritika dhe autokritika është hapi i parë i shërimit, por s'është shërimi i plotë, dhe në qoftë se e lëmë atë me kaq ose në fatin e vet, mjaftohemi t'i shënojmë këto në dokumentet e tij të komunistit, duke menduar se kështu e kemi mbaruar punën, të jemi të bindur se nuk veprojmë drejt dhe mund të kemi rezultate të hidhura.

Partia dhe çdo komunist duhet të njohin natyrën e

shokëve, ndjenjat, karakterin dhe aftësitë e tyre, sepse këto luajnë një rol të madh në përdorimin e drejtë të kritikës dhe të autokritikës. Mund të ndodhemi dhe do të ndodhemi përpara lloj-lloj tipa njerëzish, se të gjithë s'janë prerë me një gërshërë. Për shembull, kemi përpara një njeri të ndershëm që ka gabuar, por që s'është në gjendje ta analizojë thellë gabimin e tij, ai s'ka prirje të flasë gjatë dhe lirisht, por e kupton thellë kritikën dhe mjaftohet duke i pranuar hapur, ndershmërisht dhe thjesht gabimet. S'mungojnë nga ata që i kërkojnë atij me këmbëngulje «të thellohet» në gabimet, se «ka fshehur» gjëra edhe kur ai nuk ka fshehur. Ose kemi përpara një njeri jo të ndershëm, por që di të fshehtë gabimet, një njeri të gjuhës dhe që kur e zë në gabim, s'mungon të bëjë një autokritikë të gjatë, të stërholluar, të rafinuar, por që dhe vetë nuk i beson asgjëje nga ato që thotë. S'mungojnë nga ata syleshë që mbeten të kënaqur nga autokritika e tij «e shkëlqyer». Dhe kështu ndaj të parit vazhdon dyshimi i sëmurë dhe i jepet pak përkrahje, kurse ndaj të dytit fitohet besim i dëmshëm dhe njerëzit shkujdesen për veprimet e tij të këqija, që, pa dyshim, do t'i bëjë edhe në të ardhmen.

Prandaj çështja e kritikës dhe e autokritikës s'është një gjë e thjeshtë dhe nuk duhet kuptuar ngushtë. Me këtë dua të them se njerëzit duhet të kritikohen ose të bëjnë autokritikë jo vetëm kur bëjnë faje dhe jo vetëm në mbledhje të posaçme. Kjo është një anë e kritikës dhe e autokritikës, por s'është e tëra.

Duhet të evitohet faji. Kjo është një çështje kryesore dhe, që të evitohet faji, duhet të mësohen njerëzit

për ta përdorur si duhet këtë armë, duhet të zhvillohet kritika dhe autokritika në punë, gjatë punës, në forma të ndryshme. Të krijohet në shkallë të gjerë një edukatë e tillë. Si mund të krijohet kjo edukatë? Gjatë punës, kudo që punohet dhe luftohet, njerëzit, komunistët dhe ata pa parti mund të bëjnë gabime. Prandaj të gjithë duhet të shfaqin lirisht, me kurajë, pa kurrfarë druajtjeje mendimin e tyre kritik mbi punën dhe në interes të punës; përpara kujtdo qoftë, përpara eprorit dhe vartësit, të kenë guximin të bëjnë vërejtjet e tyre të mira ose jo të drejta; të kritikojnë boshllëqet dhe të mos presin mbledhjen, të japin mendimin e tyre para zbatimit dhe pas zbatimit të detyrave. Eprorët t'i dëgjojnë këto kritika me vëmendje, pa fodullëk dhe pa mendimin se ata vetë dinë çdo gjë; dhe jo vetëm t'i dëgjojnë me vëmendje sugjerimet dhe këshillimet e vartësve, por t'u japin të drejtë zjarr për zjarr kur ata kanë të drejtë; të njohin zjarr për zjarr se mendimi i tyre ishte i gabuar (këtu eprori bën autokritikë) dhe se vartësit kishin të drejtë.

Në një punë të tillë gërshetohen kritika dhe autokritika, kështu shmangen gabimet, ndreqen dhe edukohen njerëzit në punë e sipër, luftohen mbeturinat e këqija, servilizmi, frika nga eprori, frika se hakmerret ndokush, ose se merret me sy të keq po të guxojë të bëjë vërejtje dhe, nga ana tjetër, luftohen arroganca, mendjemadhësia, burokratizmi etj. Të gjitha këto vese janë të huaja për komunistët dhe burimi i shumë të këqijave.

Vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet ajo edukatë e shëndoshë në përdorimin e drejtë dhe me vend

të armës së kritikës dhe të autokritikës që na duhet neve komunistëve për të zhdukur shumë nga të metat dhe veset e këqija.

Por nuk duhet lejuar të abuzohet nën maskën e kritikës dhe të autokritikës, siç ngjet në shumë raste. Shumë njerëz përpiqen t'i shpëtojnë përgjegjësisë për krimet dhe dëmtimet e rënda që i shkaktojnë ekonomisë, për shkeljen flagrante të ligjeve të shtetit, të rregullave të shoqërisë e të normave të moralit komunist, duke bërë nga një «autokritikë» sa për të kaluar radhën. Ne nuk duhet të ngurrojmë në asnjë mënyrë në këto raste për t'i kaluar fajtorët përpara drejtësisë, ku të marrin dënimin e merituar. Nuk duhet lejuar asnjë qëndrim i butë; duhen dënuar gjithashtu edhe të gjithë ata që trillojnë një mijë e një rrethana lehtësuese për vjedhësit, dëmtuesit e shpërdoruesit e pasurisë socialiste, të cilët, me ndërgjegje ose pa ndërgjegje, bëjnë punën e elementëve kundërrevolucionarë, janë mbështetje e armikut të jashtëm dhe të atij të brendshëm, u shërbejnë mbeturinave të atyre klasave armike dhe të asaj ideologjie kundër të cilave ne zhvillojmë luftën e klasave, vëmë në veprim armët e diktaturës së proletariatit.

Vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë si kurdoherë do të triumfojë mbi imperialistët dhe revizionistët modernë

Shokë,

Vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë, vendosmëria dhe heroizmi për zbatimin në jetë të kësaj vije

nga komunistët dhe nga gjithë populli ynë, uniteti i çeliktë i Partisë dhe i popullit rreth Partisë është ajo forcë e madhe që na çon përpara në suksese, është ajo forcë e madhe që na bën të guximshëm në përleshjet me armiqtë e ndryshëm të socializmit dhe të vendit tonë. Realiteti është ky: armikun e kemi kurdoherë parasysh, atë e luftojmë pa mëshirë dhe ai nuk na tremb dhe nuk do të na trembë kurrë. Ai po merr tatëpjetën dhe ne fitojmë. Fakt është, dhe jeta provoi, se analizat e Partisë sonë mbi situatën ndërkombëtare dhe gjendjen në lëvizjen komuniste u vërtetuan të drejta, se masat dhe lufta e Partisë sonë u vërtetuan të drejta, efikase. Ato frymëzuan e mobilizuan popullin tonë, ato kanë gjetur aprovim dhe përkrahje të shumë komunistë në botë në luftën e përbashkët kundër imperializmit dhe kundër revizionizmit modern, të udhëhequr nga Hrushovi dhe Titoja, dy kryetradhtarët e marksizëm-leninizmit, të çështjes së socializmit e të komunizmit.

Lufta vazhdon e rreptë dhe do të vazhdojë për një kohë akoma të gjatë kundër tradhtarëve hrushovianë, titistë e agjentëve të tjerë të borgjezisë dhe të imperializmit. Kjo luftë nuk na tremb, por na forcon. Ne jemi të përgatitur dhe duhet të vazhdojmë të përgatitemi nga çdo anë, nga ana ekonomike, nga ana e mbrojtjes, nga ana ideologjike dhe nga ana politike. Ekonomia jonë duhet të zhvillohet me vrull, me ritmet e caktuara, planet duhet të realizohen dhe të tejkalohen me temp të lartë. Të forcojmë organizimin në punë, disiplinën, të zhdukim të metat që vërtetohen dhe që numëruam këtu në këtë plenum. Ekonomia duhet të zhvillohet pa ndër-

prerje dhe, që të arrihet kjo, duhet të punohet ushtarakisht: me shpirt ushtarak, me temp ushtarak, me disiplinë ushtarake. Nuk mund të na lejohet neve, popullit të një vendi të vogël, të rrethuar nga kaq armiq të tërbuar, në mes të Evropës, ku është ngritur një furtunë e një rrebesh që na kërcënojnë, të punojmë qoftë edhe pak në mënyrë të shthurur, ose të tolerojmë lëshime, shkelje, nën frymën e njëfarë liberalizmi ose demokracie false, që fryjnë e shpërndajnë me të madhe imperializmi dhe revizionizmi modern.

Prandaj, shokë, Parti dhe popull, si kurdoherë dhe më shumë se kurdoherë, duhet të jemi në këmbë dhe çdo gjë të ecë si sahat. Çdo gjë që mbetet mangut, çdo gjë që priset, çdo gjë që vidhet, çdo gjë që nuk prodhohet është një minus i madh për jetën tonë, për mbrojtjen e atdheut tonë dhe një plus që u shtohet përpjekjeve të shumta e të pareshtura të armiqve tanë. Prandaj nuk na lejohet t'i shohim këto gjëra me lehtësi dhe të mos marrim masa.

Në disa parti komuniste e punëtorë të Evropës fryn crë e liberalizmit, e hapjes së portave për idetë borgjezo-kapitaliste. Renegatët e marksizmit, Hrushov, Tito e të tjerë si këta, po shkojnë me vrap drejt imperializmit, drejt aleancave me të, ata po degjenerojnë vendet e tyre në vende kapitaliste. Në Evropën e mbarsur me revizionizëm qëndrojnë si kështjellë e pamposhtur e socializmit vendi dhe Partia jonë, dhe ne, ushtarët e kësaj Partie e të këtij vendi të lavdishëm, e kemi për detyrë jetike ta mbrojmë këtë kështjellë, të thyejmë valët e armikut dhe të fitojmë. Kapitalizmi botëror dhe agjenturat e tij në gjirin e klasës punëtorë në çdo kohë

janë përpjekur, përpiqen dhe do të përpiqen edhe në të ardhmen të pengojnë me çdo mjet që klasa punëtore të marrë fuqinë dhe të varrosë përgjithmonë kapitalizmin. Klasa punëtore udhëhiqet në këtë luftë gjigande historike nga pararoja e saj e organizuar, partia komuniste. Vetëm një parti e udhëhequr nga ideologjia e klasës punëtore, nga marksizëm-leninizmi, një parti që i qëndron deri në fund besnike kësaj ideologjie, mund ta krycë me sukses misionin e saj, revolucionin proletar, vendosjen e diktaturës së proletariatit, ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Prandaj kapitalizmi botëror ka luftuar dhe lufton vazhdimisht t'i degjenerojë partitë marksiste-leniniste, t'i transformojë ato në parti socialdemokrate, fashiste etj. dhe mundësisht t'i likuidojë krejtësisht. Po t'ia arrijë këtij qëllimi, s'ka dyshim që ai arrin një fitore, por sidoqoftë kjo do të jetë një fitore e përkohshme, pasi kapitalizmi është i dënuar të varroset nga klasa punëtore.

Lufta e lavdishme e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinit, bëri të dështojnë të gjitha planet djallëzore, intervencionet e armatosura dhe luftërat e përgjakshme që imperializmi shpërtheu për të zhdukur Revolucionin e Madh të Tetorit, Partinë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik, socializmin në Bashkimin Sovjetik.

Pas vdekjes së Leninit, dhe duke ndjekur me besnikëri mësimet e tij, Stalini, në radhë të parë, kaliti partinë bolshevike. Kjo, natyrisht, nuk i leverdiste kapitalizmit botëror, jo vetëm për faktin vendimtar që Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik do të

vazhdonte të ekzistonte, por sepse në shembullin e saj po formoheshin, po ndërtoheshin, po kaliteshin në revolucion partitë e tjera marksiste-leniniste. Imperializmi botëror, me atë amerikan në krye, nuk i hodhi armët, por farkëtoi armë të reja për të luftuar socializmin, dhe, në radhë të parë, partitë marksiste-leniniste. Revizionizmi modern është një nga këto armë djallëzore të imperializmit.

Grupi tradhtar i Hrushovit nuk u ngrit kot kundër Stalinit. Ai u ngrit kundër tij, sepse Stalini ishte arkitekti që e çoi më tej porosinë e Leninit, për kalitjen e Partisë Komuniste (bolshevike) të Bashkimit Sovjetik; dhe këtë parti tradhtari N. Hrushov ka marrë përsipër ta degjenerojë, ta likujdojë. Me tezën mbi «partinë e të gjithë popullit», pavarësisht nga rrobat e leckosura teorike që përpiqet t'i veshë asaj Hrushovi, i është futur punës të likujdojë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pasi vetëm kështu do t'i hapë rrugën kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik.

Për likuidimin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik Nikita Hrushovi edhe këtu ndjek besnikërisht grupin renegat të Beogradit.

Partia jonë ka në këtë drejtim një eksperiencë të hidhur, që para 20 vjetësh. Neve na kujtohet lufta e titistëve në radhët tona, që synonte me çdo kusht të likujdonte Partinë tonë, ta fshihte atë në Frontin Nacionalçlirimtar, ta hidhte në ilegalitet, megjithëse me luftë ajo doli nga ilegaliteti, me një fjalë, kërkonte ta bënte Partinë tonë luftarake marksiste-leniniste një front të gjerë, një parti pa shpirt, pa ideologji. Titistët tradhtarë dhe agjentët e tyre në radhët tona u thyen keqas;

ne fituam pasi kishim edhe ndihmën shpëtimtare të Stalinit. Titistët që në atë kohë e transformuan parti-në e tyre, e likuiduan atë, ata 20 vjet më parë e bënë Partinë Komuniste të Jugosllavisë «parti të të gjithë popullit», siç e quan Hrushovi sot parti-në e tij. U duk qartë ku e çoi Titoja vendin e tij me këtë «parti të të gjithë popullit». Në këtë rrugë po përpiqet ta çojë dhe Hrushovi Bashkimin Sovjetik me këtë «parti të të gjithë popullit». Frazat e bujshme mbi «ecjen për në komu-nizëm» dhe pseudoteoritë e tij marksiste s'mund të gë-njejnë veçse budallenjtë; dhe ne, që kemi respekt për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe që ruajmë për ta një dashuri të sinqertë themi dhe jemi të bindur për këtë, që popujt sovjetikë s'janë budallenj. Do të vijë koha që popujt e Bashkimit Sovjetik t'ia këpusin kokën gjarpër-it që i ka zënë befaz në grykë.

Partia jonë marksiste-leniniste, e kalitur në luftëra të pareshtura do ta ketë kurdoherë parasysh luftën e Leninit dhe të Stalinit për bolshevizimin e partisë dhe për ruajtjen e pastërtisë së radhëve të saj, në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

Prandaj, momentet në të cilat jetojmë, të mos i harrojmë, të mos nënvleftësojmë rreziqet, të jemi vi-gjilentë dhe të pamëshirshëm ndaj armiqve. Të mos harrojmë se armiqtë tani për tani nuk na sulmojnë me pushkë, por me radio, me filma, me gazeta, me spiunë, me ideologji, me nxitjen e mbeturinave mikroborgjeze etj., etj. Lufta jonë duhet të qëndrojë kurdoherë në ni-velin e duhur, e ashpër, e papërkulur kundër këtyre ar-miqve.

Mbrojtja e vendit tonë nga ana ushtarake, përgati-

tja e përsosur e ushtrisë, përgatitja ushtarake, e gjithanshme e popullit, duhet të vazhdojnë me ritme të pandërprera dhe në një nivel të lartë teknik dhe politiko-ideologjik. Metoda e kësaj përgatitjeje t'i frymëzojë punonjësit në punë, t'i frymëzojë ata me luftën për precizion, për disiplinë në punë, të ngjallë dhe të kalitë ndjenjën e rregullit, të heroizmit, të sakrificës. Partia duhet të punojë intensivisht për forcimin dhe për kalitjen ideopolitike dhe ushtarake të ushtrisë. Popullin ta lidhim ngushtë me ushtrinë dhe me armën e sigurimit.

Në frontin e politikës dhe të ideologjisë lufta vazhdon më e rreptë se kurrë kundër revizionistëve modernë. Dhe ne kemi suksese të mëdha në këto fusha vendimtare.

Në demaskimin e mëtejshëm të hrushovianëve, tivistëve dhe shokëve të tyre tradhtarë ne po korrим suksese. Radhët tona forcohen, të atyre dobësohen, shthurren, ata pësojnë disfata. Banda e Hrushovit jo vetëm ndodhet nën zjarrin tonë, të marksistë-leninistëve dhe të revolucionarëve të të gjithë botës, por influenca e saj mbi grupimet e revizionistëve të tjerë po dobësohet. Dhe s'mund të ndodhte ndryshe. Shumë prej tyre, për arsye të ndryshme, nuk i binden si më parë shkopit të dirigjentit; disa jo sepse janë kthyer në rrugën e drejtë, përkundrazi, por sepse duan të lidhen drejtpërdrejt me imperialistët e ndryshëm dhe nuk pranojnë më ndërmjetësinë e Hrushovit. Ne gëzohemi kur vëmë re se disa kanë filluar t'i shohin më qartë tradhtinë e Hrushovit, synimet nacionaliste e të shovinizmit të shtetit të madh që ndjek ai, se po realizojnë ku qëndron e vërteta. Natyrisht, vetëm rruga parimore, marksiste-le-

niniste ndjekja e saj me konsekuencë do të jetë për këta rruga e shpëtimit të vërtetë, ajo e sigurimit të pavarësisë, e ndërtimit me sukses të socializmit, e zbrapjes së kërcënimeve dhe të shantazheve hrushoviane, të dredhive titiste dhe të rrezikut të imperializmit.

Nikita Hrushovi kërkon njëkohësisht, nga një anë, të përfundojë përcarjen e komunizmit, që e filloi me aq zell dhe egërsi; nga ana tjetër, të mbajë nën drejtimin e tij ata që e pasuan në këtë rrugë të tradhtisë. Mirëpo ky nxënës besnik i Titos dhe i ideologjisë borgjeze kreu me sukses të parën, por nuk mund të arrijë dot me sukses të dytën. Strategjia e imperializmit amerikan dhe e agjenturës së tij, titizmit, kishte për qëllim të nënshtronte ideologjikisht dhe politikisht udhëheqjen revizioniste të Bashkimit Sovjetik me Hrushovin në krye, të përçante kampin e socializmit, të dobësonte fuqinë e shtetit sovjetik dhe të ulte prestigjin e madh të tij në botë. Tradhtari Hrushov u shërbeu dhe u shërben imperializmit amerikan dhe titizmit në këtë punë.

Ky ka qenë plani i vjetër i imperializmit që pas Luftës së Dytë Botërore dhe ai e përdori agjenturën e tij titiste për t'u infiltruar në demokracitë e reja popullore, për të marrë partitë nga brenda, më parë në Ballkan, pastaj në Evropën Qendrore dhe më vonë të vihej kundër Bashkimit Sovjetik. Në këtë ndërmarrje tradhtarë titistët bënë çmos dhe u maskuan në fillim, por më kot, sepse Stalini i madh, partia bolshevike dhe partitë komuniste e punëtore të vendeve tona ua shkaktërruan planet. Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore të Evropës dhe të Azisë ishin si një

bllok i vetëm, sepse ata zbatonin dhe udhëhiqeshin nga marksizëm-leninizmi dhe kishin besim të plotë të Bashkimi Sovjetik, të Partia Komuniste (bolshevike) e Bashkimit Sovjetik, të Stalini. Tani kryetradhtari Hrushov çirret për unitet. Por të kuptohemi, për çfarë uniteti bën fjalë ai? Për unitet me marksistë-leninistët? Jo. Ai e di mirë që unitet midis revizionistëve dhe marksistë-leninistëve nuk do të ketë kurrë. Por ai do unitet në mes të revizionistëve dhe unitet nën drejtimin e Hrushovit. Por kjo është një ëndërr që s'do të realizohet kurrë, sepse me gjithë rrugën e qëllimet e tyre të për-bashkëta kundër marksizëm-leninizmit e vendeve tona socialiste, «blloku» i tyre i përngjet një shporte me karavidhe që po grihen njëra me tjetrën, në të mirën e imperializmit. Imperializmi amerikan, nga ana e tij, bën çmos që revizionistët të grinden në mes tyre, të thellojnë kontradiktat që i brejnë dhe të futen sa më thellë nën zgjedhën e tij. Imperialistët amerikanë dhe Titoja, gjithashtu, përpiqen për të dobësuar dhe për të neutralizuar influencën e N. Hrushovit mbi revizionistët e tjerë, për t'i futur këta nën influencën e tyre (plani i vjetër i Titos para 1948-s). Dhe për t'ua arritur këtyre qëllimeve, Titoja përdor ndaj revizionistëve të tjerë, sipas nevojës, si kartën e imperializmit amerikan ashtu edhe atë të N. Hrushovit. Në rast se Hrushovi ushtron presione ekonomike mbi revizionistët e tjerë, atëherë Titoja vë përballë garancinë me dollarët amerikanë; në rast se Hrushovi ushtron presion ushtarak, shantazhe e kërcënime ndaj tyre, Titoja vë përballë si garanci forcën, shantazhet dhe kërcënimet e imperializmit amerikan.

Në këtë koniunkturë tradhtie janë futur krerët revizionistë.

Këta tradhtarë janë të dënuar, sepse me veprimet e tyre kriminale ata po nxitin rezistencën e ashpër të marksistë-leninistëve dhe të popujve të tyre. Marksistë-leninistët, të gjithë njerëzit e ndershëm çdo ditë që kalon po e shohin gjithnjë e më qartë të vërtetën, ata po organizojnë luftën kundër tradhtarëve revizionistë, dhe kjo luftë do të kurorëzohet me sukses — marksizëm-leninizmi do të fitojë mbi revizionistët modernë dhe mbi imperialistët.

Vazhdimisht gazeta «Zëri i popullit» mban në korrent mbi zhvillimin e ngjarjeve dhe edukon Partinë e popullin. Janë publikuar shumë artikuj bazë që përbëjnë një ushqim të madh e të shëndoshë për Partinë dhe për popullin.

Por dua të theksoj këtu se në disa rrethe, në disa organizata partie, ose të masave, në qendra pune, punimi i këtyre materialeve bazë kaq të nevojshme dhe të domosdoshme për kalitjen ideologjike dhe politike nuk është organizuar si duhet nga Partia. Në disa vende kënaqen vetëm duke i lexuar qoftë edhe disa herë artikujt, disave u pëlqejnë kuriozitetet, kënaqen me replikat e drejta dhe me logjikën e fortë marksiste-leniniste të përdorimit të fakteve. A është e lejueshme të ngjasë kjo? Në asnjë mënyrë. Duhet ta përmirësojmë më tej punën dhe s'duhet të kënaqemi me ngritjen politike dhe ideologjike që kanë arritur njerëzit tanë, duhet ta thellojmë dhe ta mprehim atë më tej.

Unë i kam udhëzuar shokët e agjitacionit e të propagandës të Komitetit Qendror të marrin masa, të re-

komandojnë forma të përshtatshme, të përmbledhin, të klasifikojnë, të rishtypin artikuj bazë të gazetës «Zëri i popullit» për këto çështje dhe këto të bëhen një mbështetje e gjallë edukimi ideopolitik.

Aktualisht hrushovianët i preokupon çështja e mbajtjes së mbledhjes së komunizmit ndërkombëtar, siç e quajnë ata. Dihen tanimë qëllimet tradhtarë të grupit të Hrushovit lidhur me këtë mbledhje. Ai përpiqet të bëjë një mbledhje të papërgatitur, të nxituar, me qëllim që të përçajë edhe zyrtarisht lëvizjen komuniste, të dënojë partitë marksiste-leniniste, të sanksionojë qëllimet e veta për likuidimin e socializmit dhe afirmimin e integrimin me imperializmin.

Qëndrimi i Partisë sonë ndaj një mbledhjeje të tillë është i njohur. Ne kundërshtojmë kategorikisht këtë komplot të ri, të rrezikshëm, të N. Hrushovit dhe ky komplot do të dështojë me turp për bandën hrushoviane. Partia jonë është luftëtare e vendosur për forcimin e unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, po për çfarë uniteti? Ne jemi për një unitet marksist-leninist. Këtë unitet e ka dëmtuar rëndë grupi i Hrushovit, veprimtaria e tij tradhtarë. Prandaj për të rivendosur unitetin, për të bërë një mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste, që t'i shërbejë këtij qëllimi të lartë, duhet një punë e gjerë përgatitore. Dhe Partia jonë e ka shpjeguar publikisht se si duhet bërë kjo.

Por hrushovianët edhe në radhët e tyre kanë shumë kontradikta lidhur me «mbledhjen». Disa e duan mbledhjen, disa nuk e duan; disa duan ta konsumojnë deri në fund përçarjen, disa duan të vazhdohet kështu me demagogji gjoja «hë se u morëm vesh sot, hë se do

të mierremi vesh nesër» dhe kështu, hap pas hapi, të realizojnë integrimin paqësor të socializmit në kapitalizëm. Disa të tjerë nuk duan t'i përgatitin krevatin N. Hrushovit për një hegjemoni të re ideopolitike; disa duan të jenë vetë kaposhë në luftën kundër marksizëm-leninizmit.

Detyra jonë është të ndjekim kurdoherë me kujdes të gjitha manovrat e revizionistëve hrushovianë, të luftojmë me vendosmëri kompletet që përgatitin, të jemi krah për krah me partitë e tjera që qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, në ballë të luftës kundër armiqve të marksizëm-leninizmit, të mbrojmë fort parimet, të mbështetemi kurdoherë në parimet, të zbatojmë me heroizëm vijën e drejtë të Partisë sonë dhe ne do të fitojmë.

Ne duhet të jemi vigjilentë, sepse veprimtaria tradhtarë e Hrushovit bëhet gjithnjë e më e rrezikshme. Grupi hrushovian përditë e më shumë po radhitet përkrah imperialistëve amerikanë në luftën kundër socializmit, kundër popujve, kundër çlirimit të tyre, kundër paqes. Ju jeni në dijeni nga shtypi i huaj mbi propozimin e fundit të N. Hrushovit për krijimin e një force policore të Kombeve të Bashkuara. Kjo është një tradhti tjetër e turpshme e revizionistëve hrushovianë. Hrushovi, për t'u mburrur, i ka veshur vetes shumë profesione: që nga bariu e minatori deri te babai i raketave dhe specialisti i gjithanshëm! Tani duket se vendosi të marrë përsipër një profesion të ri, atë të xhandarit ndërkombëtar. Tani e tutje revizionistët hrushovianë jo vetëm do të vazhdojnë të sabotojnë lëvizjet çlirimtare të popujve, siç kanë bërë deri më sot, por do të organizoj-

në forca speciale policore për të shtypur me zjarr e hekur, për të vrarë e për të djegur çdo popull, çdo vend, çdo patriot që do të guxojë të luftojë për liri e pavarësi, kundër imperializmit.

Por asgjë nuk e shpëton as imperializmin as lakejtë e tij, revizionistët hrushovianë, nën çfarëdo rrobe që të vishen: të pseudokomunistit, të pacifistit apo edhe të xhandarit ndërkombëtar. Popujt dhe komunistët e botës po e shtojnë përditë e më shumë luftën e tyre fitimtare, e cila do të shkallmojë si imperialistët ashtu edhe revizionistët modernë, qofshin këta të markës hrushoviane apo titiste. Partia jonë do të vazhdojë, si në të kaluarën, bile akoma më me vendosmëri, luftën e saj të drejtë për triumfin e çështjes së madhe të komunizmit. Dhe në këtë rrugë ne kemi arritur e do të arrijmë fitore gjithnjë më të mëdha.

Ky Plenum është një fitore tjetër në vargun e fitoreve të mëdha që po korr çdo ditë Partia jonë e lavdishme, populli ynë heroik.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 172 (4254), 19 korrik 1964

Botohet, me ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

PARTIA JONË ECËN SYPATREMBUR NËPËR VALET E STUHITË E KOHËS DHE FITON

*Fjala në Plenumin e 13-të të KQ të PPSH me rastin
e shpërndarjes së tesarave të reja anëtarëve
të Plenumit*

9 korrik 1964

Të dashur shokë,

Këtë seancë ne po e bëjmë për të shpërndarë tesarat e reja të Partisë. Këto momente janë solemne, pse sot jo vetëm po marrim tesarat e reja dhe ndiejmë të gjithë një gëzim të madh e të papërshkruar, por edhe se tani ne e shikojmë Partinë tonë marksiste-leniniste më të fortë se kurrë, e shohim atë të ketë kaluar nëpërmjet kaq rreziqesh pa e përkulur asnjëherë flamurin e saj të lavdishëm të marksizëm-leninizmit, e shohim Partinë tonë të ecë në këtë rrugë të lavdishme plot luftëra e sakrifica me një zemër të çeliktë dhe mendje të kthjellët, e shohim të ketë fituar besimin e plotë të popullit shqiptar, dashurinë e tij të madhe dhe besnikërinë e pakufishme ndaj saj. Këtë Partia jonë e ka me-

rituar plotësisht. Ajo është e vogël, po heroike. Ajo qëndron në radhët e para të partive marksiste-leniniste, e frymëzuar me ndjenjat e internacionalizmit proletar, dhe u bën ballë me heroizëm, me vendosmëri e zgjuarsis, armiqve të tërbuar të popujve, imperialistëve, me imperializmin amerikan në krye, dhe shërbëtorëve të tij, revizionistëve modernë. E tillë është Partia jonë, prandaj i gjithë populli ynë krenohet dhe përgjërohet për të.

Ne gëzohemi veçanërisht sot që po marrim në dorë teserat e reja, edhe për faktin se shohim që Partia jonë ecën në rrugën e drejtë të zbatimit të normave marksiste-leniniste, sepse vija e saj politike, ideologjike dhe organizative në drejtim të pranimeve në Parti është zbatuar normalisht në rrugë të drejtë. Kjo do të thotë se në Partinë tonë janë futur me të vërtetë njerëzit që e meritojnë të jenë anëtarë të kësaj Partie. Këtë meritë ata e kanë fituar me luftë, me përpjekje, me djersë e me gjak, ata janë dalluar për të qenë anëtarë partie, për ta pasur këtë dokument të vogël që simbolizon marksizëm-leninizmin, ideologjinë e klasës punëtore, diktaturën e proletariatit, vuajtjet, historinë e lashtë, gjakun e shokëve tanë e të ardhmen e popullit shqiptar.

Partia jonë është e fortë si çeliku, ajo ecën sypatrembur nëpër valët e stuhitë e kohës më e fortë se kurrë dhe fiton, ajo shkatërron armiqtë, sepse gjatë gjithë jetës ka ditur t'i zgjedhë anëtarët e saj nga njerëzit më të mirë e më të devotshëm të çështjes së Partisë dhe të popullit, nga ata njerëz që mbi çdo gjë vënë interesat e larta të Partisë dhe të popullit. Kjo na gëzon

pa masë ne, ushtarët e Partisë, anëtarët e saj që po marrim sot taserat e reja.

Në, si ushtarë të Partisë dhe të popullit tonë, si kurdoherë dhe me konsekuencë, do të vëmë të gjitha forcat për të realizuar ëndrrat shekullore të popullit shqiptar, për të zbatuar vijën e drejtë të Partisë sonë të lavdishme.

Të jemi, si kurdoherë, shokë, në ballë të luftës. Në radhë të parë të ruajmë si beben e syrit unitetin e çeliktë të Partisë që nuk ka shembull, që është kalitur me gjakun e popullit dhe të shokëve tanë, me djersën e njerëzve të punës me komunistët në krye. Uniteti i Partisë është gjëja kryesore. Këtë unitet armiqtë përpiqen ta dobësojnë, por ata kanë dështuar dhe kurdoherë do të dështojnë se e tillë është Partia jonë, i pathyeshëm është uniteti i radhëve të saj. Kështu e kuptojnë këtë çështje të gjithë anëtarët e Partisë, i gjithë populli shqiptar.

Ta ruajmë të pastër vijën e drejtë të Partisë sonë, ta zhvillojmë atë në mënyrë revolucionare sikurse na porosit Partia, sikurse na porositi edhe ky Plenum i Komitetit Qendror. Të kryejmë çdo detyrë që na ngarkon Partia me heroizëm, me pëjekuri, me sakrifica, me të vetmin qëllim që popullin ta bëjmë të lumtur e të gëzuar, atdheun të paprekshëm, që edhe ne të ndihmojmë që në botë të fitojnë socializmi dhe komunizmi.

Unë si komunist i premtoj Partisë, i premtoj Plenumit, juve, të dashur shokë, se në çdo rast e në çdo moment do të vë të gjitha forcat në shërbim të Partisë, për forcimin e unitetit të saj, për zbatimin e vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste dhe së bashku me ju,

me popullin gjer në fund sa të kem jetën, do të luftoj për çështjen e madhe të Partisë, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Pastaj shoku Enver Hoxha u shpërndau me radhë taserat e Partisë anëtarëve të Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

MARKSIZËM-LENINIZMI I BËN NJERËZIT TË KENË KOKË TË KTHJELLËT DHE ZEMËR TË FORTË

Nga biseda me një komuniste australiane

10 korrik 1964

Pasi shoku Enver Hoxha e priti me përzemërsi mysafiren komuniste dhe e pyeti si po i kalonte pushimet në Shqipëri, vazhdoi:

Përpara ne nuk jemi njohur me shokët e partisë suaj me përjashtim të Sharkit¹. Në fillim ai mbante një qëndrim pak a shumë korrekt me ne. Por më vonë, ju e dini më mirë se ne, Sharki e ktheu fletën, tradhtoi.

Ne e njohim luftën që keni bërë dhe po bëni ju kundër grupit revizionist të Sharkit. Natyrisht, në luftën tuaj ju keni dhe vështirësi. Vështirësitë ju i hasni sidomos për faktin se revizionistët janë më të organizuar, ata kanë në dorë aparatin e partisë. Por ju këto vështirësi po i kaloni dhe, duke u mbështetur kurdo-

1 L. Sharki — në atë kohë Sekretar i Përgjithshëm i PK të Australisë, që u vu në shërbim të plotë të revizionistëve të Moskës.

herë te busulla e pagabueshme, marksizëm-leninizmi, do të ecni më përpara.

Gjithashtu jemi në dijëni për mbrojtjen që ju i keni bërë Partisë sonë që lufton kundër revizionizmit modern, kundër gjithë veprimtarisë së madhe armiqësore të Nikita Hrushovit. Ne ju falënderojmë veçanërisht për mbrojtjen që i keni bërë Partisë sonë brenda radhëve të partisë suaj. Nga Viktória filloi lufta juaj, por zjarri i saj do të shpërndalet gradualisht në të gjithë Australinë. Ja ç'bën marksizëm-leninizmi kur mbrohet e zbatohet me konsekuencë e kurdoherë. Ndryshe, kushdo që largohet nga marksizëm-leninizmi, largohet nga rruga e drejtë, bie në prehrin e borgjezisë.

Shqipëria është larg nga Australia, por me ju komunistët australianë dhe me popullin tuaj ne e ndiejmë veten afër. Në Australi ka mjaft emigrantë shqiptarë, të cilët janë njerëz patriotë dhe, sado që përbëjnë atje një koloni të vogël, neve na bie detyra t'i vëmë në lidhje me ju. Ata kanë ardhur prej kohësh në Australi dhe janë shpërndarë andej-këtej nëpër vendin tuaj dhe ka prej tyre që kanë krijuar atje familje. Disa prej tyre, pas Çlirimit, të shtyrë nga malli i madh që kanë për atdheun, e kanë vizituar Shqipërinë, disa të tjerë tani janë riatdhesuar dhe nga këta ka që i kam pritur dhe unë. Bashkatdhetarët tanë flasin me admirim për popullin australian, për njerëzit, për punëtorët e vendit tuaj. Më erdhi një herë një prej tyre që kishte një dyqan të vogël. Ai më tregoi se përpara kishte pak klientë, por kur Partia e Punës e Shqipërisë filloi luftën kundër Hrushovit, dyqani i tij i vogël u bë një qendër e propagandës shqiptare, sepse atje shkonin jo vetëm

klientët e zakonshëm, por edhe shumë të tjerë dhe e pyesnin se ku ndodhet Shqipëria, sa e madhe është ajo, si shkojnë punët në Shqipëri etj.

Ju luftoni kundër revizionizmit dhe socialdemokratëve njëkohësisht. Ne këtë e konsiderojmë si shumë të rëndësishme për fitoren e marksizëm-leninizmit në Australi. Socialdemokracia te ju ka hedhur rrënjë prej kohësh, prandaj lufta që bëjnë marksistët e vërtetë sot në Australi dhe në Zelandën e Re ka rëndësi për vendet anglo-saksone. Në Angli dhe në vendet e tjera anglo-saksone partitë komuniste kanë rënë në duart e revizionistëve, që, hapur ose në mënyrë të fshehtë, bashkëpunojnë me armiqtë e marksizmit. Kjo duket qartë. Tani revizionistët në këto vende janë nën zjarrin e goditjeve si të marksistë-leninistëve, ashtu edhe të socialdemokracisë. Por forca e marksizëm-leninizmit do të shtohet, do të bëhet më e madhe, pavarësisht se tani partia juaj është e vogël. Marksizëm-leninizmi do të bëjë që pjesa e shëndoshë e partisë që sot kryesohet nga Sharki, do të vijë me ju, pjesa tjetër do të bëhet apendiks i partisë socialdemokrate, gjer në shkrirjen me të. Nuk ka si të ndodhë ndryshe. Përpara këtyre dy forcave, revizionistët do të kapitullojnë, domethënë grupi udhëheqës do të shkojë me armiqtë, kurse elementët e shëndoshë, ata që e duan marksizmin, do të vijnë me ju. Prandaj lufta e marksistë-leninistëve në Australi, lufta e shokëve të Zelandës së Re, merr një rëndësi shumë të madhe.

Ju keni një eksperiencë të madhe në luftën kundër socialdemokratëve, kundër taktikës dhe demagogjisë së tyre, sepse jeni, si të thuash, në luftë të përditshme

me këta elementë. Kur filloi luftën Partia jonë, në Shqipëri nuk kishte parti socialdemokrate dhe, si pasojë, populli shqiptar nuk ishte përpunuar ideologjikisht me pikëpamjet e socialdemokracisë. Kudo Partia jonë në këtë drejtim gjeti një terren të pastër, prandaj vija e saj marksiste-leniniste u përqaftua shpejt nga populli. Natyrisht, për këtë ndihmoi edhe momenti nacional. Lufta kundër pushtuesve të ne u gërshetua me luftën kundër mbeturinave të feudalizmit dhe të borgjezisë. Ajo gjeti një terren të përshtatshëm, sepse në Shqipëri nuk ekzistonin parti të tjera, prandaj Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare mori hov të madh në sajë të vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Por tani ka rëndësi të madhe fakti që edhe ne, edhe ju, kush më parë e kush më pas, e pamë rrezikshmërinë e madhe të revizionizmit modern me Hrushovin e Titon në krye. Në qoftë se ne e pamë këtë rrezikshmëri njëçikë më përpara se ju, nuk do të thotë se ne jemi më të zgjuar se ju, në asnjë mënyrë nuk mund të mendojnë kështu marksistët. Ne e dimë se kjo ndodhi për arsye të kontakteve më të ngushta që kishte Partia dhe vendi ynë me Titon dhe me Hrushovin. Për këtë arsye Partia jonë i kuptoi më shpejt se ju qëllimet, idetë, tradhtinë dhe intrigat e tyre.

Rëndësi të madhe ka tani çështja që ne të organizojmë fuqimisht luftën kundër revizionistëve modernë, të jemi vigjilentë dhe konsekuentë në këtë luftë, për arsye se lëvizja komuniste ndërkombëtare nuk ka parë gjer më sot armiq kaq të rrezikshëm sa këta. Lufta e marksistëve sovjetikë me Leninin dhe Stalinin në krye

kundër trockizmit, buharinizmit dhe armiqve të tjerë, ishte e lavdishme. Ata hapën perspektivën dhe u dhënë një eksperiencë të madhe partive komuniste dhe punëtorë në luftën kundër armiqve. Por tani revizionistët kanë në duart e tyre shtete të tëra. Në kohën e saj partia bolshevike me Stalinin në krye nuk i la këta armiq të vinin në fuqi, por pas vdekjes së Stalinit ata erdhën në krye dhe po përdorin për qëllimet e tyre armiqësore forcën e shtetit të madh sovjetik, mjetet e tij të mëdha ekonomike, financiare, armatimet, shantazhin atomik, e, mbi të gjitha, demagogjinë. Prandaj revizionistët janë sot jashtëzakonisht të rrezikshëm. Megjithatë ata janë të dobët.

Është e drejtë të thuhet se Partia jonë fitoi një eksperiencë të madhe në luftën kundër revizionizmit modern. U mpreh shumë vigjilenca e saj në luftën 20-vjeçare kundër revizionistëve jugosllavë dhe gjatë kësaj kohe Partia dhe populli ynë panë në praktikën e marrëdhënieve me Jugosllavinë rrezikun e revizionizmit, panë konkretisht në jetë fytyrën e vërtetë të revizionistëve, se ata ishin tradhtarë të marksizëm-leninizmit, shovinistë dhe nacionalistë të tërbuar. Partia dhe populli ynë, jo vetëm në kohën e Stalinit, por edhe më pas, ishin të lidhur ngushtë me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe me popullin sovjetik. Këto ishin nga ana jonë lidhje me të vërtetë vëllazërore, internacionaliste. Një dashuri të madhe kishte në Partinë e në popullin tonë për Bashkimin Sovjetik. Por megjithëkëtë Partia jonë, në vijën e Hrushovit, (jo vetëm në vijën e përgjithshme ndërkombëtare, por veçanërisht në marrëdhëniet me vendin tonë), vërente disa qëndrime që

nuk tingëllonin drejt. Kur Hrushovi filloi të afrohet me Titon, atëherë ne e kuptuam se punët s'qenë mirë. Për ne ishte aq e qartë tradhtia e Titos, sa, që në hapin e parë që bëri Hrushovi për afrimin me këtë klikë, reaguam. Ne i bëmë menjëherë një letër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, në të cilën shpreheshim se nuk ishim dakord për këtë afrim.

Më vonë Hrushovi u përpoq të na merrte me të mirë, jo vetëm nëpërmjet «ndihmave» ekonomike, por bënte sikur na jepte të drejtë për qëndrimet tona ndaj jugosllavëve. Ishim njëherë në Moskë ku ndodheshin për pushim edhe Rankoviçi me Kardelin. Ne, me udhëheqësit jugosllavë, ishim, si të thuash, thikë më thikë, sepse ata ishin nga ana tjetër e barrikadës. Megjithatë Hrushovi bëri si bëri dhe na mblodhi në një drekë, ku filloi nga demagogjia. Ai i tha Rankoviçit se «ju nuk i keni punët mirë me shqiptarët», por Rankoviçi nga ana e tij iu përgjigj Hrushovit se «fajtorë për këtë janë shqiptarët». «Jo, iu drejtua Hrushovi, fajtorë jeni ju, jugosllavët, sepse ju dërgoni agjentë dhe spiunë në Shqipëri». Rankoviçi i dha atëherë përgjigje, se «kështu thoni ju, por, në qoftë se dëshironi, mund t'i bisedojmë këto gjëra». «Nuk është nevoja, ndërhyra unë. Për ne çdo gjë është e qartë». Qëllimi i Hrushovit ishte të na fërkonte krahët, të na merrte me të mirë që të rregulloheshim me jugosllavët.

Pastaj ngjarjet që u zhvilluan më tej na bindën plotësisht se Hrushovi dhe shokët e tij ishin tradhtarë. Qysh para vitit 1960 në udhëheqjen e Partisë sonë ishte marrë disa herë në diskutim qëndrimi i Hrushovit. Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Byroja Politike

ishin plotësisht të qartë për të, por pritnin momentin, sepse marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe miqësia me të ishin një çështje e madhe për ne. Ne e ndienim fare mirë fatkeqësinë e madhe që kishte ndodhur në Bashkimin Sovjetik, i cili kishte rënë në duar tradhtarësh, por në marrëdhëniet tona me grupin e Hrushovit ne ecnim të matur dhe me pjekuri marksiste-leniniste. Nga ana e tij, Hrushovi përgatiste plane kundër nesh. Por vigjilenca e Partisë sonë ishte shumë e madhe. Këtë e vinte re Hrushovi dhe e shihte se nuk e kishte aq lehtë të vepronte kundër Shqipërisë. Kur erdhi puna që ai organizoi komplotin e tij në Bukuresht, atëherë Partia jonë gjykoj se nuk mund të ecej më tej me të, se duhej t'i thuhej Hrushovit «ndal!». Për Partinë tonë momentet ishin vendimtare dhe jashtëzakonisht të vështira në çdo drejtim. Por komunistët janë kurdoherë optimistë dhe kurajozë. Të tillë i bën ata marksizëm-leninizmi. Ky i bën njerëzit të jenë të kthjellët nga koka dhe zemrën ta kenë si çeliku, t'i peshojnë mirë situatat, pastaj të veprojnë. Komiteti Qendror i Partisë sonë e gjykoj çështjen nga të gjitha anët, ai parashikoi që do të kishim luftë me Hrushovin dhe vendosi ta përballojmë këtë luftë. Vendit tonë, përveç armiqve rreth kufijve tanë dhe imperialistëve amerikanë, anglezë e të tjerë, iu shtua edhe veprimtaria armiqësore e Hrushovit. Me gjithë vështirësitë jashtëzakonisht të mëdha të krijuara, ne vendosëm të vazhdonim luftën tonë dhe të mos dorëzoheshim para asnjë presioni a kërcënimi të tij.

Ne parashikuam se shumë njerëz në botë do të na quanin «të marrë», «aventurierë», por Partia jonë gjy-

koi se ata që do të mendonin kështu, do të gabonin. Pavarësisht se jemi një popull dhe një Parti e vogël, me ne është marksizëm-leninizmi, prandaj me ne do të jetë edhe fitorja. Në qoftë se Shqipëria do të sulmohet, ne do t'i përgjigjemi çdo armiku dhe ata nuk do të jenë në gjendje të na mposhtin. Prandaj, porsa na sulmoi Hrushovi në Kongresin e 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ne hapëm zjarr kundër tij.

Për vendimin që morëm, ne ishim të sigurt dhe mbështeteshim në Partinë tonë, Parti 23-vjeçare, por me një unitet të çeliktë, dhe te populli ynë me tradita revolucionare. Një fjalë të thotë Partia jonë, i gjithë populli ngrihet në këmbë. Hrushovi e dinte këtë. Në saje të lidhjeve të ngushta e të sinqerta që kishim përpara me Bashkimin Sovjetik, Hrushovi dinte shumë mbi vendin tonë, ai njihte mbi të gjitha vendosmërinë dhe besnikërinë e Partisë dhe të popullit tonë ndaj çështjes së marksizëm-leninizmit, prandaj bëri çmos që të na likuidonte, por nuk ia arriti dot qëllimit. Ai humbi dhe është fakt se, në luftën që shpalli kundër Partisë sonë, pësoi disfatë.

Por një disfatë të tmerrshme po pëson ai tani, kur në luftën kundër revizionizmit modern kanë dalë hapur parti dhe grupe të tjera marksiste-leniniste. Ai vazhdon të humbasë dhe fundi i tij është i sigurt, klika e tij do të diskreditohet dhe do të thyhet.

Ju e dini ç'rëndësi të madhe ka organizimi i partisë në rrugën marksiste-leniniste. Kjo është një çështje vendimtare, prandaj është e drejtë ajo që bëni ju për forcimin e partisë, për forcimin e lidhjeve me klasën punëtore, me sindikatat, me masat e popullit pu-

nonjës për aleancë me krahun e majtë të socialdemokracisë, me të gjithë njerëzit e ndershëm, sepse vetëm kështu do t'i bëni ballë këtij rreziku të madh që ekziston. Duhet të jemi realistë për qëndrimin e hrushovianëve dhe të titistëve, për aleancat e tyre me socialdemokratët dhe me imperialistët amerikanë. Këto lidhje përbëjnë një rrezik që kërcënon marksizëm-leninizmin, revolucionet proletare, luftërat nacionalçlirimtare dhe çështjen e paqes.

Revizionizmi kërcënon marksizëm-leninizmin, ai lufton kudo në botë, por koka dhe zemra e tij është në Evropë, këtu është kështjella e tij. Imperializmi amerikan tani bën të gjitha përpjekjet për t'i ndihmuar revizionistët modernë që këta të ndihmojnë politikën dhe strategjinë amerikane. Prandaj, të gjitha forcave përparimtare në botë u vihet detyrë e madhe të forcojnë situatën në vendet e tyre. Neve na vihet detyrë t'i kalitim njerëzit dhe të godasim çerdhen e revizionistëve në Evropë me Hrushovin, Titon, Gomulkën, Kadarin e shokët e tyre në krye. Evropa është mbarsur me revizionizëm, prandaj duhet të bëjmë që të dështojë.

Partia jonë mendon që partitë marksiste-leniniste në radhë të parë të kalitin njerëzit e tyre, komunistët, luftëtarët e pararojës, pastaj të bindin dhe të bëjnë për vete të gjithë ata që janë të vakët e të lëkundshëm dhe që dashurinë për Bashkimin Sovjetik, për partinë e madhe të Leninit dhe të Stalinit e shohin me syrin oportunist e sentimental. Ne, marksistë-leninistët, e duam më shumë se kushdo popullin sovjetik, atdheun e Leninit dhe të Stalinit. Oportunistët fshihen nën maskën e dashurisë për Bashkimin Sovjetik, por marksistët

e dinë se Bashkimi Sovjetik mund të shpëtohet vetëm duke luftuar tradhtarët revizionistë.

Po të shikojmë veprimtarinë e partive tona, do të konstatojmë se ato kanë bërë një punë të madhe e internacionaliste, kanë demaskuar Hrushovin dhe revizionistët e tjerë dhe, në sajë të kësaj lufte, janë korrur suksese të mëdha, gjë që ka sjellë si pasojë të krijohen mjaft parti e grupe të reja marksiste-leniniste në shumë vende. Ky është një sukses kolosal. Demaskimi i politikës tradhtare të Hrushovit, të Titos dhe të klikave të tjera revizioniste ndihmon që në grupimet revizioniste të fillojë shisioni¹. Kjo tregon se ata, megjithëqë janë në rrugë tradhtare, nuk janë të bashkuar kurdoherë nën drejtimin e shkopit të dirigjentit. Kjo është pozitive dhe në favorin tonë. Pavarësisht se Gomulka, Kadari, Novotni, Ulbrihti, Torezi, Toliati etj. janë në të njëjtën rrugë, midis tyre ka hyrë grindja dhe nga kontradiktat e tyre ne duhet të përfitojmë.

Sikurse e dini, Partia jonë në Bukuresht, e veçanërisht në Moskë, u sulmua prej të gjithë revizionistëve, por ne i dhamë përgjigje vetëm Hrushovit dhe vazhduam luftën kundër klikës së Titos. Revizionistët e disa vendeve të tjera na sulmuan dhe bënë çmos që ne t'i sulmonim edhe ata, por ne nuk i atakuam ata me emër dhe vazhdojmë të mos i atakojmë, pavarësisht se në propagandën tonë i demaskojmë pikëpamjet e tyre revizioniste.

Mendojmë se sot momentet janë revolucionare. Në këto momente suksese do të ketë edhe partia juaj e sa-

1 Scission (frëngj.) — përçarje.

pokrijuar. Bindja juaj është se ajo do të zmadhohet. Edhe Partia jonë, që u themelua në kushte revolucionare dhe jopaqësore, e filloi jetën dhe veprimtarinë e saj me pak shokë, me 200 veta, por brenda një kohe të shkurtër arriti të bëhet një parti e fortë. Partia e Sharkit është e mbytur në revizionizëm. Partia juaj u krijua në kushte revolucionare, prandaj, siç na mëson marksizëm-leninizmi, ajo, duke zbatuar drejt ideologjinë tonë fitimtare, do të ngrihet e do të zgjerohet vazhdimisht.

Ne dëshirojmë të kemi lidhje sa më të ngushta me marksistë-leninistët e botës. Shokët tanë e kanë të vështirë të vijnë në Australi, por nuk ekskludohet të vijnë ndonjëherë. Ne ju lutemi dhe këtë t'ua thoni edhe shokëve, që Shqipërinë, marksistë-leninistët e vërtetë australiane ta konsiderojnë si shtëpinë e tyre. Ne e dimë që ju, veçanërisht tani, keni shumë punë, por dërgimi i komunistëve australiane në Shqipëri do të ndihmojë që të këmbejmë përvojën dhe të përfitojmë nga njëri-tjetri. Edhe shoku Hill kur të vijë ndonjëherë në Evropë, dëshirojmë që të kthehet edhe në Shqipëri.

Ju pushuat, bëtë edhe disa vizita, por ne dëshirojmë t'ju themi se në vendin tonë kemi edhe boshllëqe. Është e vërtetë që ne kemi shumë suksese, por kemi dhe të meta e vështirësi, por edhe prej këtyre mësojmë. Veç asaj, dimë dhe jemi të sigurt që kur vijnë nga jashtë shokë komunistë si ju dhe na i shikojnë dobësitë e të metat dhe na i vënë këto në dukje, edhe kjo është një ndihmë për ne. Ne e dimë që ju çdo gjë te ne e shikoni me zemër të hapët, si marksistë. Po të krahasoj-

më, për shembull, Melburnin dhe qytetet e tjera tuaja me tonat, është e qartë se ndërtesat, fabrikat etj. kanë ndryshime. Te ju ato janë shumë më të mëdha dhe më të bukura, por çështja është që te ju ato janë në duart e kapitalistëve, kurse në Shqipëri çdo gjë është në duart e popullit.

Komunistja australiane, pasi e falënderoi shokun Enver Hoxha për këtë takim të rëndësishëm, midis të tjerash tha:

Në të ardhmen, kur të vijnë shokët tanë në Shqipëri do t'u tregojnë njerëzve tuaj edhe si është jeta në kapitalizëm. Ajo që na intereson neve më shumë është të njohim pikërisht popullin tuaj dhe komunistët shqiptarë. Mua më interesojnë më shumë se çdo gjë njerëzit, si përparojnë ata, si përmirësojnë jetën, si luftojnë kundër bllokadës revizioniste, si një fshatar arriti të bëhet inxhinier etj. Nëpërmjet këtyre fenomeneve ne shikojmë socializmin te ju.

Ne dëshirojmë ta vizitojmë vendin tuaj, populli juaj është i mrekullueshëm. Kur takohemi me të, marrim forca. Është mirë të bësh banjë çdo ditë në detin tuaj, por nuk është kjo kryesorja për ne marksistët, për ne ka rëndësi të takohemi me njerëzit.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe politikisht, edhe ideologjikisht ne kemi nevojë të këmbejmë eksperiencë. Dhe midis shokëve tuaj ka nga ata që kanë eksperiencë të madhe edhe në ekonomi. Për shembull, delet «Merinos» australiane janë me famë botërore. Është i famshëm vendi juaj në drejtim të blegtorisë. E dëgjuar është, gjithashtu, edhe greva e madhe e punëtorëve austra-

lianë, e qethësve të deleve në vitin 1870. Prandaj dijeni se, shokët australianë, kur të na vijnë për vizitë, do t'i «shfrytëzojmë» edhe nga kjo anë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**HRUSHOVIT NE NUK I FËRKOJMË KRAHËT, POR
I THEMI POPULLIT SOVJETIK: JA KU E KE
ARMIKUN!**

Nga biseda me ambasadorin e ri të RD të Vietnamit

11 korrik 1964

SHOKU ENVER HOXHA: Jemi jashtëzakonisht të gëzuar që erdhët në Shqipëri, shoku ambasador. Shpresojmë ta ndieni veten mirë, si në atdheun tuaj.

AMBASADORI VIETNAMEZ: I nderuari shoku Enver Hoxha, sot kam nderin e madh të takohem me Ju. Më lejoni të përfitoj nga ky rast për t'ju sjellë përshëndetjet më të nxehta të shokut Ho Shi Min. Ju lutem, gjithashtu, të pranoni edhe nga ana ime përshëndetjet më të nxehta dhe respektin tim më të madh!

Gjatë kohës që kam ardhur në Shqipëri kam vënë re se Partia e Punës, Qeveria dhe Ministria juaj e Punëve të Jashtme tregojnë një kujdes të madh për ne, përpiqen të na sigurojnë kushte sa më të mira dhe ju premtoj se unë do ta plotësoj detyrën time për forcimin e mëtejshëm të miqësisë dhe të bashkëpunimit midis

dy vendeve tona. Në Shqipëri ne e ndiejmë veten si në shtëpinë tonë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit shumë! Kështu duhet shoku ambasador. Ju jeni komunist si dhe ne. Ne e kuptojmë përse ju e ndieni veten si në shtëpinë tuaj. Tani ne s'bëjmë gjë tjetër veçse ju ritheksojmë të njëjtën gjë. Me ju, shokë vietnamezë, ne nuk kemi protokoll. Protokollin së bashku mund ta zbatojmë vetëm për disa ceremoni zyrtare, kurse për të gjitha rastet e tjera ne mund të takohemi e të bisedojmë si miq e shokë. Ne do të jemi të gëzuar të kemi me ju, sa herë të jetë nevoja, takime shoqërore, vëllazërore. Ju keni mendimet tuaja, ne kemi mendimet tona, le t'i këmbëjmë ato bashkërisht.

Për ne pastaj ka rëndësi çështja që ju të merrni takim me njerëzit e vendit tonë, të shkoni kudo, të njiheni me Shqipërinë, me popullin tonë, me fshatarët, me punëtorët, me komunistët, të interesoheni për çdo gjë për të cilën do të keni nevojë dhe që ju intereson. Pyesni, takohuni me njerëzit tanë dhe do të gjeni kurdoherë ngrohtësi, do të jeni të mirëpritur nga të gjithë. Këto jua them se populli ynë ka një dashuri të madhe për popullin tuaj, se është një popull trim, punëtor që ka vuajtur shumë, ashtu si edhe ne.

Ne i mbajmë në dijeni popullin dhe Partinë mbi ngjarjet që zhvillohen në Vietnam. Të gjitha raportet e rezolutat e Komitetit Qendror të Partisë suaj dhe deklaratat qeveritare të Ministrisë suaj të Punëve të Jashtme ne i kemi botuar në shtyp me qëllim që Partia dhe i gjithë populli ynë të njihen me to.

Populli ynë ruan me simpati kujtimet mbi vizitën e Presidentit tuaj, shokut Ho Shi Min. Para pak javësh ishte në vendin tonë një delegacion me shokë nga Vietnami i Jugut. Edhe unë pata rastin të takohesha dhe të bisedoja me ta. Por rëndësi më të madhe kanë pasur takimet që bëri ky delegacion me punonjësit e vendit tonë. Shokët e delegacionit u folën hollësisht punonjësve tanë mbi gjendjen në Vietnamin e Jugut, mbi luftën, vështirësitë, fitoret.

Pasi ambasadori mik e falënderoi shokun Enver Hoxha për këtë takim dhe e informoi shkurt mbi punët në Vietnamin e Veriut dhe mbi gjendjen në Vietnamin e Jugut e mori fjalën

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit për ato që më informuat dhe ju përgëzoj për sukseset! Këto na gëzojnë jashtëzakonisht!

Edhe ne, siç do ta shikoni vetë me sytë tuaj, jemi duke ndërtuar mjaft vepra industriale, por rëndësi të madhe i kemi vënë bujqësisë. Tani ne jemi në vitin e katërt të pesëvjeçarit të tretë, njëkohësisht po përgatitim projektin e planit të ardhshëm pesëvjeçar.

Me kohë kemi filluar nga punimet në sektorin e bonifikimeve, po ato përbëjnë një volum të madh pune, prandaj do të na duhet që punimet t'i vazhdojmë edhe në pesëvjeçarin e ardhshëm, në të cilin mendojmë t'i mbarojmë thuajse të gjitha këto vepra. Për ndërtimin e tyre na është dashur shumë kohë. Kemi rreth 15 vjet që kemi filluar nga puna për bonifikimin e fushave. Njëkohësisht me këtë po aktivizojmë punimet edhe në drejtim të ujitjes dhe synojmë të arrijmë që të ujitim

60 deri 65 për qind të sipërfaqes së tokave tona. Këtë pesëvjeçar jemi duke ndërtuar edhe dy uzina, njëra për prodhimin e plehrave azotike dhe një tjetër për plehrat fosfatike. Përfundimi i këtyre dy veprave do të jetë një ndihmë e madhe për bujqësinë, duke marrë parasysh se tani tokave pothuajse nuk u hedhim fare pleh kimik.

Në sektorin e industrisë jemi duke hedhur bazat e para të metalurgjisë, po ecim drejt zhvillimit të mëtejshëm të industrisë së naftës, të rafinimit të saj në vend. Po përpiqeni për shfrytëzimin e gazit metan dhe për ndërtimin e disa fabrikave, si të çimentos etj.

Lufta e Partisë sonë, si e të gjitha partive të tjera marksiste-leniniste, është një luftë e drejtë. Marksistë-leninistët e kanë tashmë të qartë se cila është fytyra e vërtetë e revizionistëve modernë, e grupeve tradhtarë të Hrushovit e të Titos me shokë. Në luftë me këta tradhtarë u kalitën marksistët dhe kjo është një fitore e madhe.

Në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, atje ku revizionistët janë në krye të partive, kanë dalë revolucionarë të vërtetë marksistë-leninistë, të cilët u grupuan dhe në disa prej këtyre vendeve u krijuan parti të reja të vërteta marksiste-leniniste. Kjo është një fitore e madhe. Në këtë luftë ka pasur edhe njerëz, të cilët jo se ishin të këqij, por akoma nuk shikonin qartë luftën e Partisë sonë dhe të partive të tjera marksiste-leniniste. Kjo luftë i bëri ata të kuptojnë realitetin dhe të forcohen. Edhe kjo ka një rëndësi të madhe. Kur ne forcohemi, grupimet revizioniste me Hrushovin në krye vazhdojnë

të shturen, domethënë krerët e partive të tjera revizioniste, si Gomulka, Kadari e të tjerë nuk i binden më shkopit të dirigjentit si përpara. Kjo është e natyrshme. Nuk mund të ketë unitet midis revizionistëve. Në mes tyre ka hyrë krimbi që i bren përbrenda. Marksistë-leninistët me punën e me qëndrimet e tyre revolucionare dhe veprimtaria armiqësore e vetë revizionistëve do të bëjnë që nga radhët e këtyre të fundit të shkëputen ata që kanë qenë të gabuar.

Kështu, tani shohim se udhëheqësit e një partie që në vitin 1960 u bashkuan me Hrushovin kundër nesh, i kanë pushuar sulmet kundër Partisë së Punës të Shqipërisë. Kjo është një gjë pozitive nga ana e tyre. Por tek ata ka edhe shumë anë negative. Ata janë centristë, por në fakt janë në pozita politike dhe ideologjike revizioniste. Nga njëra anë nuk na sulmojnë ne, por nga ana tjetër ata u drejtohen amerikanëve, lëvdojnë Titon, përpiqen të bëjnë një politikë prej akrobatësh, gjë që mund të jetë shumë e rrezikshme për ta.

Kjo është një formë e përçarjes në grupimin revizionist. Do të zhvillohen në të ardhmen edhe forma të tjera. Këtë do ta shkaktojë lufta e drejtë e partive marksiste-leniniste. Këtë e shkakton dhe do ta shkaktojë edhe vetë rruga tradhtarë e revizionistëve modernë, veprimtaria e tyre armiqësore ndaj socializmit, siç janë afrimi i Hrushovit me imperialistët amerikanë, politika e tij e shtetit të madh, goditja që ai i bën Stalinit, afrimi i tij me klikën e Titos, shkatërrimi i ekonomisë sovjetike, përfaqimi i mënyrës borgjeze kapitaliste të jetesës, domethënë degjenerimi i jetës së popullit etj. E

gjithë politika tradhtare e Hrushovit ka shkaktuar dhe do të shkaktojë revoltë në radhët e marksistëve dhe të popullit sovjetik, që po shikojnë se ku po i çon Hrushovi. Prandaj ai dhe pasuesit e tij ndodhen në pozita jashtëzakonisht të vështira dhe këto vështirësi do të shtohen për ta, gjë që do të jetë në favor të marksizëm-leninizmit. Por ne duhet të jemi kurdoherë në ballë të luftës, sepse në këtë mënyrë ndihmojmë për ta shpëtuar Bashkimin Sovjetik nga katastrofa. Kjo ka rëndësi të dorës së parë, sepse tani atdheut të lavdishëm të Sovjetëve i janë vërsulur për ta shkatërruar imperialistët amerikanë dhe agjenturat e tij, hrushovianët dhe tistët.

Në momentet e vështira që kalonin popujt, Lenini, Stalini dhe partia e bolshevikëve i erdhën në ndihmë njerëzimit. Në këto momente kaq të vështira që po kalojnë sot popujt sovjetikë dhe partia e Leninit dhe e Stalinit duhet që ne, si marksistë, t'i ndihmojmë ata për ta kapërcyer këtë fatkeqësi të madhe që u kanë sjellë revizionistët modernë. Kështu mendon Partia jonë. Ne e duam shumë popullin sovjetik, ne i duam shumë marksistët e vërtetë sovjetikë. Partia jonë e shtron kështu problemin: do t'i fërkojmë krahët N. Hrushovit, këtij armiku të madh të Bashkimit Sovjetik, apo duhet t'i themi popullit sovjetik: ja ku e ke armikun! Ne jemi të sigurt se është më mirë t'i tregojmë realitetin popullit sovjetik, sepse kështu kryejmë detyrën tonë internacionaliste.

Nikita Hrushovi zhvillon një propagandë të madhe kundër nesh, por kjo nuk do të vazhdojë për një kohë të gjatë. Populli sovjetik, më vonë, do ta kuptojë edhe

më mirë luftën që bëjnë sot partitë marksiste-leniniste, bashkë me të cilat edhe Partia e Punës e Shqipërisë, kundër grupit të Hrushovit.

Marksistë-leninistët kanë kurdoherë parasysh strategjinë, por përdorin edhe taktika sipas situatave, me qëllim që këto t'i shërbejnë strategjisë së përgjithshme, pa u trembur asnjëherë nga lufta e armiqve. Armiku ka qëllimet e tij, ka edhe ai strategjinë dhe taktikat e veta. Por këto ne nuk na trembin, ne jemi marksistë dhe i kuptojmë ato më mirë. Armiqtë tremben nga marksistët. Taktikat dhe strategjia e tyre nuk mund të fitojnë përpara strategjisë dhe taktikave të marksistëve. Këtë e di mirë Hrushovi. Ai ka qenë një armik i fshehtë që për shumë vjet me radhë ka punuar nën rrogë, prandaj i njeh mirë strategjinë dhe taktikat e komunistëve. Është fakt se, duke i njohur këto, rrëshqet çdo ditë e më shumë në llumin e tradhtisë dhe nuk ka si të veprojë ndryshe. Ai ka përdorur të gjitha dredhitë, të gjitha demagogjitë dhe tani i ka zbrazur të gjithë fishekët. Fisheku i fundit që i ka mbetur tani, është t'i zgjatë dorën imperializmit amerikan, dhe drejt tij po shkon.

Lufta kundër këtyre armiqve është akoma e vështirë, nuk do të mbarojë me sot me nesër. Do të kalojnë vite pa të arrihet shkatërrimi i tyre, se kundërrevolucionarët nuk e lënë lehtë pushtetin. Do të duhet të bëhet një tjetër revolucion në Bashkimin Sovjetik, do të derdhet përsëri gjak, nuk ka si të bëhet ndryshe. Kjo do të ndodhë në mos sot, nesër.

Ne e kuptojmë mirë situatën tuaj. E rëndësishme është që të gjitha taktikat, edhe tonat, edhe tuajat në

luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, me Hrushovin në krye, të udhëhiqen vetëm nga marksizëm-leninizmi e t'i shërbejnë vetëm çështjes së madhe të revolucionit, të socializmit, të popujve.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

**TE SQAROJME TË LEKUNDURIT, TË LUFTOJME
KUNDËR ATYRE QË JANE TË VENDOSUR
NË RRUGËN E TRADHTISË**

Bisedë me një shok marksist-leninist nga Austria

24 korrik 1964

Takimi u zhvillua në një shtëpi pushimi në Durrës. Shoku Enver Hoxha e priti në mënyrë të përziermërt mysafirin dhe i uroi këtij mirëseardhjen.

Pastaj midis tyre u zhvillua një bisedë e ngrohtë shoqërore.

SHOKU ENVER HOXHA: Si jeni me shëndet? A e patë ndopak Shqipërinë? Si vete puna me gazetën tuaj «Rote fane»? A ju del koha të veni nëpër krahina e qytete të tjera të Austrisë?

Pasi bashkëbiseduesi u përgjigj, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Jemi të gëzuar që na jepet rasti të takohemi me një shok marksist-leninist nga Austria. Kontaktet e drejtpërdrejta na bëjnë të njihemi edhe më mirë, megjithëse ne njihemi edhe më parë me pikëpamjet e njëri-tjetrit.

Ne jemi në dijëni të luftës që ju, si marksistë-leninistë, po bëni prej kohësh, veçanërisht në këto momente të vështira, kur sidomos në Evropë ka ngritur krye revizionizmi modern. Me guximin tuaj marksist-leninist ju i vlerësuar drejt ngjarjet që ndodhën në partinë tuaj të vjetër dhe mbajtët qëndrimin e duhur. Një gjë e tillë ishte e domosdoshme të bëhej, sidomos kur partë se udhëheqja e partisë kishte shkarë në revizionizëm.

Partinë tonë ne e kemi vënë në dijëni për punën dhe për luftën që po bëni ju në Austri, për përpjekjet tuaja, qoftë në Komitetin Qendror, qoftë në komitetet e partisë dhe në të gjitha organizatat e saj. Ardhja juaj në Shqipëri, takimet me komunistët e popullin tonë dhe fjalët tuaja të ngrohta revolucionare na kanë ndihmuar, sepse edhe Partia jonë është një brigadë që merr pjesë në këtë luftë të madhe që po zhvillohet sot për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për shkatërrimin e revizionizmit. Ne që luftojmë për këtë qëllim të lartë, nuk jemi pak, por jemi shumë dhe çdo ditë që kalon edhe më shumë bëhemi.

Revizionistët kanë vetëm një shumicë relative, ata janë vetëm disa grupe në udhëheqje partish, të cilat, natyrisht, kanë edhe përkrahësit e tyre brenda në këto parti. Por ne jemi të bindur, jo vetëm nga sa dimë, por edhe duke gjykuar si marksistë-leninistë, se atje ku sundojnë grupet revizioniste, atje ka patjetër edhe marksistë-leninistë të vendosur. Ka të tjerë që nuk janë aq të guximshëm, ka edhe që janë të lidhur me grupet revizioniste në mënyrë sentimentale, ekonomike etj. Prandaj neve na vihet detyra të

sqarojmë të lëkundurit dhe të luftojmë vetëm ata që janë të vendosur në rrugën e tradhtisë. Kjo luftë synon t'i demaskojë revizionistët, t'i izolojë dhe t'i bëjë të pafuqishme pikëpamjet e tyre demagogjike. Me një fjalë, në saje të luftës së madhe të marksizëm-leninizmit, revizionistët të shkojnë sa më parë drejt shkatërrimit të tyre të plotë.

Neve, shqiptarëve, na ka dalë nami se gjoja nuk jemi diplomatë, nuk ditkemi nga protokolli, i themi gjërat prerë. Racionale në këtë është vetëm kjo: kur ne shohim se, bie fjala, kjo letër është e bardhë, themi hapur se është e bardhë dhe jo e zezë. E kam fjalën se mendimet tona, vlerësimet që bëjmë për çdo gjë, ashtu sikurse edhe për komunistët e vërtetë marksistë-leninistë të Austrisë i bëjmë në mënyrë të paanshme dhe i themi hapur.

Atë që keni bërë tani ju në Austri, brenda një kohe aq të shkurtër, ne e vlerësojmë si një punë të madhe. E them këtë se pas Luftës së Dytë Botërore ne nuk kemi parë ndonjë aktivitet të dalluar të Partisë Komuniste të Austrisë. Nuk e kam fjalën për aktivitetin e saj të viteve të fundit, kur ajo i është nënshtruar plotësisht revizionizmit.

Lufta juaj ka ngjallur interesim jo vetëm në Austri, por edhe në vende të tjera. Agjencitë e huaja flasin për punën tuaj dhe vetë N. Hrushovi është detyruar t'ju përmendë ju të paktën duke ju quajtur «renegatë», ashtu sikurse na ka quajtur edhe ne. Por ne jemi marksistë-leninistë, kurse renegat i marksizëm-leninizmit dhe agjent i imperializmit është vetë Hrushovi me beniaminët e tij. Nuk jemi ne që po diskre-

ditohemi në sytë e masave popullore dhe të komunistëve, por janë revizionistët modernë ata që po demaskohen dhe luftohen kudo e më shumë. Prandaj ju, shokë austriakë, nuk duhet t'ju dëshpërojë çështja se tani jeni pak. Nuk do të jetë larg koha kur edhe ju, duke përvetësuar dhe duke zbatuar me zell marksizëm-leninizmin do të bëheni shumë, sepse rruga që keni ndjekur dhe po ndiqni, metoda juaj e punës dhe e luftës shpejt do të japin fryte.

Për mendimin tonë është i favorshëm fakti që në Austri nuk ka grupe të tjera marksiste-leniniste veç jush. Kurse në vendet e tjera, si për shembull, në Francë, në Itali etj., ka mjaft grupe, shumica e të cilave kanë pikëpamje të drejta, me sa dimë ne, dhe besojmë se ato do t'i ballafaqojnë pikëpamjet e tyre duke ia nënshtruar një analize të thellë marksiste-leniniste, duke ruajtur gjithçka është e vlefshme e duke hedhur poshtë çdo pikëpamje të huaj. Kështu ato do të shkojnë drejt unifikimit. Sigurisht, për t'ia arritur kësaj, duhet një punë e madhe nga ana e marksistë-leninistëve, duhet vendosmëri dhe principialitet i lartë komunist. Kurse juve, meqë jeni i vetmi grup marksist-leninist në Austri, ju dalin përpara detyra të mëdha.

Ju e njihni gjendjen në Austri, jeni të qartë politikisht e ideologjikisht, njihni popullin tuaj, njerëzit tuaj, klasën punëtore, njihni influencat e huaja imperialiste, autoritetin e partive të tjera etj., etj. Në një koniunkturë të tillë duhet ta zhvillonin ju aktivitetin revolucionar.

Ne e kuptojmë preokupimin tuaj për çështjen e

formimit të partisë¹. Në një vend, po të mos ketë një parti me të vërtetë marksiste-leniniste, atje nuk mund të ketë revolucion. Nga ana tjetër, imperialistët, revizionistët modernë, trockistët, titistët, hrushovianët përpigën t'i likuidojnë partitë marksiste-leniniste dhe të shuajnë revolucionin. Ndaj formimi i partisë ka rëndësi vendimtare. Gjithashtu ne mendojmë se, po aq sa ka rëndësi të madhe formimi i partisë, aq rëndësi ka edhe zgjedhja e momentit për ta krijuar atë. Prandaj duhet pasur kujdes për të zgjedhur momentin e përshtatshëm për një gjë të tillë, në mënyrë që krijimi i partisë të bëhet me të vërtetë një ngjarje e rëndësishme dhe kjo të ndihmojë që rreth partisë të grumbullohen të gjithë revolucionarët.

Edhe përpara se të formohej Partia jonë, në Shqipëri kishte një numër grupesh, të cilat, në përgjithësi, nuk kishin pikëpamje të drejta. Ishin bërë edhe para vitit 1941 orvatje për krijimin e partisë, por nuk kishin pasur sukses dhe vetëm pas pushtimit të Shqipërisë u krijua momenti më i përshtatshëm për themelimin e Partisë. Pushtuesit nga ana e tyre u përpoqën të vepronin me anë të partisë fashiste, reaksioni i brendshëm gjithashtu u përpoq të krijonte partinë e vet, por këto përpjekje dështuan. Kurse ne, në ato momente të përshtatshme, krijuam Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe Partia jonë u bë Parti udhëheqëse.

Sipas eksperiencës dhe mendimit tonë nuk duhet të ecet nga parimi që të jemi shumë pa të krijohet

¹ Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Austrisë u formua më 12 shkurt 1967.

partia. Po të jetë momenti i përshtatshëm edhe me pak komunistë, por të vendosur, mund të krijohet partia, sepse radhët e saj do të shtohen me luftëtarët më të mirë që do të dallohen në punë dhe në aksione konkrete.

Edhe Partia jonë, kur u formua më 1941, e vogël ishte, me 200 anëtarë. Vendi ynë atëherë ishte i pushuar nga fashistët italianë, prandaj si detyrë kryesore e Partisë shtrohej çështja e çlirimit kombëtar. Në atë kohë i duhej bërë thirrje popullit për luftë të armatosur, për revolucion, për çlirim nga i huaji dhe me kushttrimin që lëshoi Partia, populli u ngrit në këmbë.

Vija e Partisë sonë ishte e drejtë. Shumë nga ne atëherë nuk i dinim teoritë e mëdha, ishim njerëz të thjeshtë, por parimet kryesore të marksizmit i njihnim dhe u mbështetëm në eksperiencën e madhe të PK (b) të BS, në mësimet e Leninit dhe të Stalinit, sido që në atë kohë nuk kishim lidhje të drejtpërdrejtë me Bashkimin Sovjetik dhe me PK (b) të BS. Misioni ushtarak sovjetik erdhi në Shqipëri vetëm në gusht të vitit 1944. Megjithatë e gjithë lufta jonë, zhvillimi i saj, organizimi i Partisë, agjitacioni, propaganda, të gjitha ishin të lidhura me luftën e BRSS dhe mbështeteshin në parimet e marksizëm-leninizmit, duke ua përshtatur gjithçka kushteve konkrete të vendit tonë. Partia jonë, sido që ishte e re, diti të orientohej, prandaj edhe u rrit nga viti në vit. Në radhë të parë, ajo rriti radhët e saj. Ne e kuptuam që rritja e Partisë, kalitja e saj bëhej vetëm në luftë, ndaj që në fillim u vumë në ballë të luftës.

Në lidhje me këtë problem, rëndësi të madhe kanë

edhe propaganda e organizimi i gjithë punës. Propagandë mund të bëhet, por në qoftë se nuk organizohet puna, e frymëzuar nga një qëllim i madh për të krijuar me të vërtetë bazën e Partisë, kjo propagandë do të jetë pa objekt. Prandaj duhet punuar që këtë propagandë ta përvetësojnë njerëzit, ta përhapin dhe të shohim ku janë luftëtarët më të mirë, të cilët do të organizohen. Po të bëhet si duhet edhe puna organizative, atëherë krijimi i Partisë është vënë plotësisht në vijë.

Ju thashë më parë se ju e njihni më mirë gjendjen e vendit tuaj. Por ne, në bazë të eksperiencës sonë, mendojmë se sa më shumë të lidhen marksistë-leninistët me popullin, sa më shumë baza të krijojnë, aq më i lehtë do të jetë për ta krijimi i partisë. Ne nga ky parim u nisëm për krijimin dhe për forcimin e Partisë sonë. Kjo çështje kishte rëndësi të madhe për t'ua bërë të njohur masave programin dhe qëllimin tonë, për t'i bindur ato mbi rëndësinë e madhe të misionit të lartë që do të kryente Partia, për t'i bërë, pra, masat për vete e për t'i udhëhequr në revolucion. Për këtë, Komiteti Qendror mendoj të shkonim në popull, në radhë të parë tek ata elementë të klasës punëtore që ishin më të përparuar. Te ne ka ndihmuar shumë fakti që fshatarësia jonë ruante tradita të shquara patriotike, prandaj Partia mendoj që ne, anëtarët e saj, të shkonim në fshat dhe atje, duke u mbështetur në këto tradita patriotike, ta bënim fshatarësinë me vete e ta ngrinim në luftën e madhe për çlirim. Si në qytet edhe në fshat një punë të veçantë ne bëmë me rininë.

Rinia është një forcë e madhe revolucionare, ajo shkon më me guxim e entuziazëm pas revolucionarëve, ajo e kupton dhe e përfaqon më shpejt vijën politike e ideologjike të partisë marksiste-leniniste. Por që të arrihet kjo, që Partia ta bëjë për vete rininë, është e rëndësishme që ta edukojë atë, t'i qëndrojë afër, ta udhëheqë me kujdes e largpamësi, ta bëjë, pra, krah të djathtë të saj. Pikërisht këto pati parasysh Partia jonë në punën e saj të madhe me rininë. Ne menduam se nëpërmjet të rinjve do të fusnim në lëvizje më të rriturit në moshë, edhe pleqtë, sepse, në qoftë se djali hidhej në luftë, do të tërhiqej me siguri edhe babai. Ne shfrytëzuam çdo zakon e traditë të mirë popullore, bile dhe lidhjet familjare e çdo mundësi tjetër për të bërë për vete njerëzit. Te ne kanë ekzistuar dhe ekzistojnë lidhje të ngushta, respekt e dashuri reciproke midis prindërve dhe fëmijëve, midis të moshuarve dhe të rinjve. Partisë iu desh të punonte shumë në këto kushte që djemtë dhe vajzat të ishin nën influencën e saj dhe t'u shpjegonin edhe prindërve, me urtësi e me durim, nevojën e bashkimit rreth Partisë, për luftën kundër pushtesve dhe tradhtarëve. Me vijën politike që ndiqte Partia për çlirimin kombëtar, i madh e i vogël te ne ishin dakord, prandaj, duke e sqaruar e duke e bindur popullin për drejtësinë e kësaj vije, ne bëmë një punë shumë të madhe.

Se si duhet bërë kjo në Austri, këtë e dini ju vetë, por ne mendojmë se qëllimi i çdo partie apo grupi marksist-leninist duhet të jetë që të tërheqë sa më shumë njerëz me vete, elementët më të mirë revolu-

cionarë, nga radhët e Partisë së vjetër Komuniste, të cilët kanë eksperiencë, autoritet dhe influencë në masat. Nëse ndër të vjetrit ka shokë me eksperiencë e prestigj që nuk janë të qartë dhe tregohen të lëkundur, atëherë duhet luftuar që të sqarohen, të binden e të vihen në pozita marksiste-leniniste. Por kur ka prej tyre që janë të vendosur në rrugën revizioniste, atëherë të lahen hesapet me ta e ju të ecni me guxim e me vendosmëri përpara. Kjo është njëra anë. Ana tjetër, dhe më kryesorja, është zhvillimi i punës mbi baza të reja. Cilat janë këto baza të reja? Në radhë të parë, klasa punëtore. Klasikët e marksizëm-leninizmit kanë theksuar se kur partia e klasës punëtore nuk mbështetet, nuk krijon baza dhe nuk fut influencën e saj në klasën punëtore dhe në sindikatat, atëherë lufta e saj do të jetë e vështirë dhe e ngadalshme. Ky mësim ka vlerë të veçantë, sidomos për vendet e industrializuara, si për shembull, Austria.

Socialdemokracia te ju është me mjekër, bile atje edhe ka lindur, prandaj, vështirësitë për të futur ideologjinë marksiste-leniniste në sindikatat e punëtorëve te ju, do të jenë të shumta.

Ne nuk dimë sa influencë kanë revizionistët në sindikatat austriake, por, pavarësisht nga kjo dhe pavarësisht sa influencë kanë atje edhe socialdemokratët, (dhe sigurisht që kanë influencë të madhe), përsëri marksistët e kanë për detyrë të depërtojnë thellë në sindikatat e punëtorëve. Ata duhet të punojnë edhe më shumë, sidomos në radhët e punëtorëve të rinj, te të cilët do të gjejnë njerëz të shëndoshë e të pastër.

Në fillim të jetës së Partisë sonë çdo komunist,

pavarësisht nga niveli ideologjik e organizativ që kishte, por me një vendosmëri të madhe, ishte njëkohësisht propagandist, organizator dhe komandant reparti. Për këtë arsye udhëheqja e Partisë sonë në fillim ishte e shpërndarë në rrethe, cilido nga anëtarët e Komitetit Qendror ishte ose kuadër drejtues në komitetet qarkore të Partisë, ose komandant apo komisar batalioni, brigade, divizioni. Të gjithë ishim në bazë, në terren, atje punonim dhe luftonim.

Edhe ju tani në shumë vende të Austrisë keni shokë të vendosur. Të gjithë ata mund të bëhen propagandistë dhe organizatorë të çështjes së madhe të revolucionit. Natyrisht kjo punë do të bëhet më mirë në qoftë se edhe gazeta juaj do të forcohet më tej. Shtypi marksist-leninist ka rëndësi të madhe, sidomos te ju. Ne kemi përshtypje të mira për gazetën «Rote fane», dhe disa nga artikujt e saj i botojmë në shtypin tonë.

Ne e kuptojmë drejt preokupimin tuaj për të ngritur më tej nivelin ideoteorik e shkencor të gazetës, me qëllim që ajo të luajë rolin e duhur për sqarimin e masave, për t'i bërë ato të ndërgjegjshme politikisht dhe ideologjikisht. Natyrisht, kjo arrihet me punë e me përpjekje të vazhdueshme duke pasur parasysh sidomos shembullin e madh të klasikëve të marksizëm-leninizmit — Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinut, të cilët kanë qenë edhe publicistë të mëdhenj, themeluesit dhe udhëheqës të shquar të shtypit të ri revolucionar. Gjithashtu, ne mendojmë se është mirë që ju të bisedoni edhe me shokë të tjerë të grupeve apo partive të reja marksiste-leniniste, që vitet e fun-

dit kanë fituar njëfarë eksperience në çështjen e krijimit, organizimit dhe drejtimit të shtypit marksist-leninist.

Se si do ta zgjidhni ju këtë çështje, kjo është puna juaj, por ne mendojmë se krahas anëtarëve të partisë mund të ketë edhe patriotë e njerëz përparimtarë pa parti që mund të aktivizohen të shkruajnë. Kjo mund të krijojë edhe fillimin e disa mbështetjeve e aleancave antiimperialiste brenda në Austri të disa njerëz përparimtarë. Natyrisht ju e dini më mirë këtë çështje dhe lufta e përpjekjet konkrete do t'ju mësojnë se si gazeta «Rote fane» të marrë jo vetëm formën e duhur për partinë, por edhe për të rrahur drejt ato probleme politike që i interesojnë publikut austriak.

Kryesorja është të mbrohet marksizëm-leninizmi, të demaskohen e të shpartallohen revizionistët modernë, këta shërbëtorë të urryer të imperializmit e të reaksionit. Ky është misioni ynë. Ne jemi optimistë, të tillë kemi qenë edhe përpara, por tani jemi ca më tepër. Revizionistët janë dinakë, të poshtër, por, janë edhe frikacakë, po t'u qëndrosh grusht.

Ka shumë nga ata udhëheqës partish që kanë kontradikta me N. Hrushovin, por ky punon me djallëzi dhe i komprometon. Të marrim, për shembull, Moris Torezin. Ai erdhi në Shqipëri dhe bisedoi me ne përpara Mbledhjes së Moskës të vitit 1960. Në përgjithësi nuk patëm shumë kundërshtime me të, ai i aprovoi qëndrimet tona kundër revizionistëve modernë. Për revizionistët jugosllavë, Torezi tha se ishte e tepërt të diskutohej: «Udhëheqësit jugosllavë

me Titon në krye, pohoi ai, janë tradhtarë». Mirëpo këto qëndrime si dhe shumë të tjera, Torezi pastaj i ndryshoi, Hrushovi e komprometoi. Kështu Torezi ra në batakun revizionist. Prandaj çështja e demaskimit të Hrushovit dhe e gjithë revizionistëve modernë është vendimtare.

Sikurse e dini, disa parti na sulmuan në Bukuresht e në Moskë, por ne nuk u jemi përgjigjur, kundërsulmuam vetëm Hrushovin se dinim që ai ishte dhe është kryesori. Gjithashtu ne mendonim se rruga e tij e tradhtisë do të shihej shpejt ose vonë edhe nga të tjerët, se kontradiktat në mes tyre do të thelloheshin, ndaj pritëm. Ata hoqën ambasadorët, na prenë kreditë e akorduara me marrëveshje zyrtare, pa përmendur këtu shpifjet dhe sulmet politike e ideologjike. Dhe jeta vërtetoi atë që menduam ne. Më pas, ndonjë nga ato parti që na sulmoi në Bukuresht e në Moskë, pranoi se kishte gabuar ndaj nesh, se vija e Partisë sonë ishte e drejtë dhe Hrushovi është një tradhtar. Ky është një sukses i qëndrimit të drejtë të Partisë sonë, por pavarësisht nga kjo, ne u thamë atyre se ashtu siç na dënuan publikisht, po ashtu të bëjnë autokritikë publike, të pranojnë hapur zotimet e tyre ndaj nesh. Por gjer tani ata këtë gjë nuk e kanë bërë.

Se çfarë do të ngjasë më tej, do të rrojmë e do ta shikojmë. E vërteta është se kontradiktat në mes tyre do të shtohen, tradhtia do të zhvillohet dhe marksistë-leninistët dhe popujt do të kuptojnë më qartë tradhtinë e Hrushovit, Novotnit, Gomulkës, Ulbrihtit e të tjerëve. Këto kontradikta të paevitueshme, nga

njëra anë, do të sjellin forcimin e marksizëm-leninizmit dhe, nga ana tjetër, do t'i përçajjnë e do t'i diskreditojnë më keq revizionistët modernë.

Tani së fundi, edhe Hrushovi ngriti në Varshavë çështjen se «imperialistët amerikanë nëpërmjet ndihmës ekonomike përpiqen të na përçajjnë». Natyrisht, ai këtë nuk e tha për të goditur imperializmin amerikan, por për të sulmuar indirekt ata që kanë kundërshtime me Hrushovin dhe kanë kërkuar kredi nga SHBA. Partia jonë mendon se ky veprim i atyre shteteve, që nga njëra anë thonë se ndërtojnë socializmin dhe nga ana tjetër i shtrijnë dorën imperializmit, është i gabuar. Ata këtë nuk e kanë drejt, pasi kjo është një nga çështjet parimore të marksizmit kundër revizionizmit titist, hrushovian etj., të cilët me dollarët e amerikanëve ndërtojnë gjoja socializmin. Prandaj, të jesh kundër Hrushovit, të kuptosh qëllimet e tij dhe të kërlesh kredi nga SHBA, këto janë krejt kontradiktore, nuk ecin bashkë.

Ne mendojmë se gjatë këtyre pak vjetëve i kemi forcuar pozitën tonë, kemi korrur shumë fitore, por ka shumë rëndësi të gjallërohet akoma më tepër lufta kundër revizionizmit në Evropë, mbasi këtu është koka e revizionizmit dhe në disa vende ai është në fuqi. Ndaj të gjithë ne, marksistë-leninistët, e kemi për detyrë t'i godasim pareshtur revizionistët. Partia jonë i vë një rëndësi të madhe çështjes që të jemi sa më shumë dhe sa më mirë të organizuar, të jemi në gjendje të njohim vështirësitë dhe dobësitë e mëdha që kanë dhe do të kenë revizionistët dhe t'i godasim pa ndërprerje. Ne mendojmë se ata duhet të demasko-

hen edhe ideologjikisht, edhe politikisht. Ata zhvillojnë një propagandë të madhe me disa formulime të rafinuara ideologjike, me të cilat kërkojnë të helmatisin marksistët, të devijojnë edhe luftën tonë me veprimet e tyre. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë sonë mendon se gjëja kryesore është të demaskojmë gjithë veprimtarinë e revizionistëve, çdo akt e fjalim të tyre politik, çdo orvatje, çdo afrim në rrugë anti-marksiste, çdo plan e synim të tyre kundërrevolucionar.

Po të ndjekësh propagandën e Moskës, do të shohësh, se ajo është bërë e neveritshme. Në qoftë se ke lexuar disa vjet më parë një artikull mbi bashkëzistencën paqësore, formulimet e tij vazhdojnë akoma të përsëriten. Mos vallë nuk janë të zotë revizionistët të nxjerrin një artikull të ri? Jo, ata janë të zotë, por tendenca është që të ambientohet e të pajtohet lëvizja komuniste ndërkombëtare me formulimet e tyre. Të marrim Traktatin e Varshavës, ku formalisht Shqipëria është anëtare, por në fakt është përjashtuar. Ne e dimë se në mbledhjet e këtij traktati që kanë bërë revizionistët, kanë vendosur të na sulmojnë, por, po të duan, le ta provojnë. Ky traktat ka mbetur më tepër si shantazh kundër nesh e ndonjë tjetri sesa kundër imperializmit. Vetë ky traktat brehet nga kontradiktat e brendshme.

Nga ana tjetër, revizionistët modernë i preokupon fakti si t'i rregullojnë lidhjet me Gjermaninë Perëndimore, me një fjalë, si ta sakrifikojnë Republikën Demokratike Gjermane dhe do ta sakrifikojnë, megjithëse përpiqen të ruajnë disa forma. Axhubei, dhëndri i Hru-

shovit, deklaroi se neve nuk na duhet një traktat paqeje, i firmosur nga diplomatët, por të bëjmë një pakt me Gjermaninë Perëndimore, të hapim portat, të vemë e të vijmë me gjermanët e perëndimit. Gomulka, që është një nacionalist dhe revizionist i tërbuar, kërkon sigurime nga SHBA vetëm për kufirin Oder-Najse. Po ta sigurojë këtë, ai është gati ta lërë në dorën e amerikanëve Republikën Demokratike Gjermane. Edhe Novotni, po të sigurojë krahinën e Sudetëve, është gati që Ulbrihti të dalë menjëherë në pension!

Ja, pra, të tilla kontradikta e brejnë stanin revizionist. Partia jonë mendon se duhen demaskuar këto qëndrime, sepse përbëjnë një rrezik të madh për Evropën, për popujt dhe për lirinë e tyre. Që do të ketë kontradikta në mes revizionistëve, kjo s'ka diskutim, por marksistëve nuk u lejohet të mos luftojnë, nuk u lejohet të frikësohen, ndryshe i bëhet një dëm i madh lëvizjes revolucionare ndërkombëtare.

Të vijmë te çështja e atyre që thonë se «e duan» Bashkimin Sovjetik, ndaj sipas tyre «s'duhet të dalim hapur kundër tradhtisë së Hrushovit». Po si e duan ata Bashkimin Sovjetik, që të bëhet si Jugosllavia, që atje të shtypen revolucionarët? Jo, ne Bashkimin Sovjetik e duam që të çlirohet nga tradhtia. Natyrisht, këtë çlirim do ta bëjnë vetë sovjetikët. Ata me Leninin dhe Stalinin i kanë ndihmuar revolucionarët në vendet e tjera, tani ka ardhur koha që revolucionarët e vërtetë kudo në botë të ndihmojnë sovjetikët. Në këtë drejtim ne përiqemi të bëjmë detyrën tonë.

I gjithë aktiviteti i Hrushovit ka për qëllim të discreditojë e të shkatërrojë socializmin, të shkurorëzojë

marksizëm-leninizmin. Çështjes së rritjes së nivelit të jetesës në Bashkimin Sovjetik Hrushovi i bëri bujë të madhe, gjë që e shfrytëzuan imperializmi amerikan dhe borgjezia kundër socializmit. Dihet se ka vende kapitaliste me një nivel të lartë jetese, për shembull, në Austri niveli i jetesës është i lartë. Edhe në SHBA ka njerëz që rrojnë mirë, por harrohet që atje shumica vuajnë, bile ka miliona njerëz pa punë, harrohet se mirëqenien e tyre kapitalistët e kanë ngritur me gjakun dhe me djersën e popujve. Me një fjalë, themelore është se kush e ka fuqinë në dorë në një vend, se në favor të kujt shkojnë të mirat materiale, kush i prodhon e kush i zotëron ato.

Ç'ka bëri Hrushovi për këtë problem? Ai tha se brenda pesë vjetëve do t'i tejkalonte SHBA, kurse ky ishte një bluf. Ai jo vetëm nuk i tejkaloi SHBA po tani kërkon edhe ndihmë prej tyre, duke diskredituar kështu veten dhe Bashkimin Sovjetik. Mbrëmë televizioni italian transmetoi një bisedim që zhvillohej me përfaqësues të agjencive të shtypit amerikan, të TASS-it, AFP-së dhe BBC-së. Ishte i mjerueshëm qëndrimi i «djalkës» sovjetik. Bisedën e filloi francezi me disa fjalë të përgjithshme pa e sulmuar sovjetikun, pastaj foli ai i TASS-it, tamam si ndonjë fëmijë që nuk ka fare haber nga politika, përsëriti disa gjëra bajate me disa formulime të përgjithshme. Pastaj filloi amerikani. Ky që nga fjala e parë e gjer tek e fundit, me një fytyrë të qeshur, e bëri Bashkimin Sovjetik leckë nga të gjitha anët, duke folur që nga «krimet» e Stalinit e deri te buka që sovjetikëve nuk u mjafton. Sovjetiku u zu

ngushtë e s'qe në gjendje të jepte asnjë përgjigje. Ja, pra, ku të çojnë blofet e revizionistëve modernë!

Nga ana tjetër, me çorganizimin e madh në bujqësi dhe në industri, revizionistët modernë përpiqen të shkatërrojnë fitoret e socializmit në fshat dhe në qytet. Në fshat po krijojnë një shtresë të gjerë kolkozianësh të pasur, domethënë kulakësh. Ky është një proces i vazhdueshëm. Edhe në industri janë duke u adoptuar format titiste. Ata mund t'u veshin për maskim plot gjëra teorike këtyre që po bëjnë, por qëllimin e kanë të krijojnë shtresat e punëtorëve të pasur. Titoja e ka bërë më parë këtë dhe ka rivendosur kapitalizmin. Në Jugosllavi sundojnë njerëzit e pasur në fshat e kudo, bile në masë po shpronësojnë fshatarët, si në favor të fermave shtetërore që janë pasuri e klikës në fuqi, ashtu dhe në favor të kulakëve që kanë një fuqi të madhe në ekonominë bujqësore. Kulakët që kanë në dispozicion makineri dhe kapitalizmi shtetëror po e rrënojnë bashkërisht fshatarësinë e varfër dhe po çojnë drejt braktisjes në masë dhe shpopullimit të shumë fshatrave. Me një fjalë, po polarizohet fshatarësia në Jugosllavi. Të njëjtën gjë po bën edhe Hrushovi, duke ndjekur eksperiencën e Titos. Kjo është një humbje e madhe, por edhe një mësim i madh për ne marksistë-leninistët.

Prandaj të gjithëve, neve marksistëve dhe gjithë partive tona, na vihet detyrë e madhe që të edukojmë vazhdimisht klasën punëtore, fshatarësinë dhe inteligjencien të mos shkëputen nga revolucioni, nga ideologjia e klasës punëtore, të jenë të lidhur ngushtë me të. Ne vazhdimisht kemi zhvilluar një punë të tillë intensive, kemi bërë mjaft mbledhje të Komitetit Qendror

ashtu sikurse ishte edhe mbledhja e fundit e këtij muaji¹.

Populli ynë gjatë shekujve ka vuajtur shumë, atë e kanë shtypur e gjakosur vazhdimisht, ai është ngri-tur në luftë e në revolucion dhe më së fundi, nën udhë-heqjen e Partisë, fitoi dhe tani po ndërton socializmin, përmirëson jetën. Partia përpiqet që këtë hov revolu-cionar, këto sakrifica e vuajtje populli të mos i harrojë, se kurdoherë ekziston rreziku i madh i restaurimit kapi-talist. Ai duhet t'i gëzojë frytet e socializmit, por edhe të mos harrojë që këto u arritën me sakrifica dhe përpë mund të rrezikohen. Populli ynë e rrëzoi pushtetin e vjetër reaksionar e antipopullor, mori fuqinë në dorë, shpronësoi feudo-borgjezinë dhe realizoi hap pas hapi një sërë transformimesh të rëndësishme politike, eko-nomike, shoqërore etj. Gjatë këtij procesi revolucio-nar, populli i pushkatoi armiqtë më të këqij të tij, ata që i kishin lyer duart me gjakun e popullit e qenë maj-mur me djersën dhe mundin e tij. Këto veprime u bënë drejt, populli ata i gjykoi dhe u dha dënimin e meri-tuar se ishin me të vërtetë gjakpirës. Por, megjithëse feudo-borgjezia u shpronësua dhe armiqtë e popullit u likuiduan si klasë, fizikisht nuk u likuiduan të gjithë, ekzistojnë akoma mbeturina të klasave armike dhe ideologjia e këtyre klasave, që na rrezikojnë akoma. Në të kaluarën janë kultivuar shumë zakone e tradita jo të mira që e kishin burimin te klasat e pasura dhe te push-tuesit e huaj. Bazën sociale të atyre zakoneve dhe tra-ditave të huaja e zhduku vendosja e pushtetit popullor,

¹ Shih më këtë vëllim f. 118.

por mbeturinat e atyre zakoneve ekzistojnë akoma në ndërgjegjen e njerëzve, ndaj për çrrënjosjen e tyre është bërë e bëhet një luftë e vazhdueshme dhe konkrete. Partia jonë ka luftuar dhe lufton që populli të ngrejë vazhdimisht nivelin e jetesës, por duke pasur parasysh që të mos ketë diferencime të mëdha, sidomos midis atyre që prodhojnë të mirat materiale dhe punonjësve të administratës. Ne kemi synuar dhe synojmë kurdoherë që të ngrihet niveli material e kulturor i popullit dhe të ngushtohen sa më tepër diferencimet në paga.

Ne, gjithashtu, kemi vënë të gjitha forcat që njerëzit e administratës të lidhen sa më mirë me punën praktike, duke kryer punën drejtpërsëdrejti në prodhim.

Në bazë të vendimeve të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror tani në shtypin tonë flitet vazhdimisht për luftën që duhet bërë kundër mbeturinave të së kaluarës, për qëndrimin socialist ndaj punës e pronës, për edukatën ideologjike e politike të njerëzve etj., dhe ka një entuziazëm të madh në gjithë popullin e Partinë. Ne shikojmë se në momentet e vështira që kemi kaluar, mobilizimi i Partisë dhe i popullit ka qenë aq i madh saqë janë përballuar me sukses bllokadat që na janë bërë dhe janë arritur fitore si asnjëherë tjetër.

Planin e drithërave këtë vit do ta realizojmë në grurë, misër, gjithashtu do ta realizojmë edhe në pambuk, duhan etj. Kurse plani i sheqerit do të tejkalohet. Edhe në industri do ta realizojmë e do ta tejkalojmë planin. Kudo ka një mobilizim e entuziazëm të madh.

Partia na mëson t'i vëmë rëndësi të madhe edukimit komunist të rinisë se ajo nuk e ka njohur të ka-

luarën dhe vuajtjet e popullit. Ata që janë tani 20-vjeçarë nuk kishin lindur kur populli luftonte kundër pushtesve nazifashistë dhe tradhtarëve të vendit. Ju e patë diçka Shqipërinë, por, po ta kishit parë si ishte ajo përpara, ç'mjerim e ç'varfëri e madhe sundonte këtu, do t'i kuptonit më mirë ndryshimet që kanë ndodhur te ne. Edhe të rinjtë tanë nuk mund ta marrin me mend se si ishte gjendja e vendit tonë në të kaluarën, këtë ata e lexojnë nëpër libra. Prandaj, ne përpiqemi që të rinjtë dhe të rejat, njerëzit e afërt e besnikë të Partisë, të marrin një edukatë revolucionare, të njohin mirë të kaluarën dhe përpjekjet e popullit, të luftojnë vazhdimisht për këtë popull, atij t'ia kushtojnë punën, djersën, vrullin dhe entuziazmin e tyre. Partia po i kalit ata të bëjnë me sukses luftën për ndërtimin e socializmit, të punojnë e të djersijë seriozisht, të kaliten e të brumosen në punë.

Partia jonë ka tanimë një eksperiencë të mirë në drejtim të edukimit të njeriut të ri. Ne kemi punuar e punojmë që ta ruajmë kurdoherë të pastër figurën moralo-politike të komunistëve e të punonjësve, të ruajmë kurdoherë të gjallë e të fuqishëm shpirtin luftarak e sulmues të njerëzve tanë, të të rinjve dhe të moshuarve. Te ne kritikohet ashpër çdo shfaqje vetëkënaqësie, mburrjeje apo rehatie, sepse revolucioni s'kryhet në një ditë apo në një vit, prandaj njerëzve dhe sidomos komunistëve u duhet të luftojnë gjer në fund.

Krah për krah me të moshuarit, me ata që bënë Luftën e lavdishme Antifashiste Nacionalçlirimtare, një kontribut të madh për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit ka dhënë e jep brezi i ri. Partia, duke u

qëndruar afër këtyre njerëzve të rinj, duke i brumosur me idealet e saj, duke i kalitur përmes punës, shkollës, aksioneve revolucionare, u ka hapur atyre të gjitha dyert për të ecur përpara, për ta bërë më të bukur e më të begatshëm atdheun socialist. Është e vërtetë që këta të rinj nuk kanë marrë pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare për arsye moshe, bile mund të mos jenë as anëtarë partie, por vite me radhë ata kanë shkuar vepër më vepër nëpër pesëvjeçarët, kanë qëndruar larg gruas e fëmijëve dhe kanë punuar për t'i lulëzuar këto fusha pjellore dikur kënetat.

Sot, pra, bëhet një luftë e madhe midis ideologjisë marksiste nga njëra anë dhe ideologjisë borgjeze e mbe-turinave mikroborgjeze, nga ana tjetër. Tetë orë në ditë flasin radiot e huaja kapitaliste në gjuhën shqip kundër Shqipërisë. Ato propagandojnë muzikën e tyre të shfrenuar, artin e tyre dekadent, mënyrën perëndimore të jetesës. Ne i kuptojmë synimet e tyre korruptuese, ndaj Partia ka luftuar dhe lufton kundër kësaj veprimtarie dhe ka arritur suksese në edukimin revolucionar të rinisë. Po si e kemi bërë ne këtë punë? Duke propaganduar e duke përhapur, në radhë të parë, vlerat më të mira të artit, të kulturës, të muzikës sonë kombëtare, duke u dhënë një zhvillim të madh artit dhe letërsisë sonë të realizmit socialist. Nga ana tjetër, kemi zgjedhur e zgjedhim gjërat më të mira nga arti, letërsia, muzika dhe kultura botërore, pra, atë pjesë të kulturës përparimtare, e cila përbën një thesar për të gjithë.

Në këtë drejtim është treguar e tregohet kujdes më i madh, sepse s'ka gjë më të rrezikshme sesa ta mbushësh kokën e rinisë me kalbësirat borgjezo-revi-

zioniste, prandaj Partia është përpjekur t'i japë popullit e sidomos rinisë një ushqim të shëndoshë marksist-leninist.

Për këto arsye në rininë tonë e ca më tepër në Parti nuk kanë zënë vend pikëpamje të huaja. Partinë e kemi të pastër, të fortë dhe dinamike, me një nuhatje të thellë ideopolitike. Në punë, në jetë edhe njerëzit më të thjeshtë, në qoftë se dëgjojnë apo shohin një person që nuk vepron mirë, kërkojnë sqarime prej tij; e kritikojnë, e ndihmojnë të vihet në rrugë të drejtë dhe, kur nuk korrigjohet, i tregojnë vendin. Kështu veproi Partia jonë edhe me Hrushovin.

Ne kishim shumë vjet që po luftonim me pikëpamjet dhe me veprimet antimarksiste të tij, por këtë nuk e bëmë publikisht. N. Hrushovi, si dinak, na fërkonte krahët, por ne nuk e besonim, ndiqnim me vigjilencë veprimet e tij dhe ecnim përpara në rrugën tonë. Kur erdhi çështja në Bukuresht e në Moskë, ne thamë se çdo gjë me të kishte mbaruar dhe se tani duhej luftuar me domosdo hapur. E vështirë ishte situata, se parashikuam që do të na luftonte, por ne do të luftonim deri në fund. Parashikuam, gjithashtu, se mund të sulmoheshim edhe ushtarakisht. Edhe këtë ua thamë Partisë dhe popullit dhe të gjithë u bëmë një grusht i vetëm rreth Partisë. Hrushovianët na quajtën «nacionalistë». Shumë nga letrat e tyre ne nuk i kemi botuar, por në letrat tona të përgjigjes, që janë të shumta, dhe ia kemi drejtuar Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, shihet pikërisht preokupimi marksist-leninist i Partisë dhe i popullit tonë për Bashkimin Sovjetik. Në këto letra dhe dokumente të tjera ne, duke vënë në dukje gabimet dhe veprimet

e tyre revizioniste, u kemi bërë thirrje edhe N. Hrushovit, edhe KQ të PK të BS, duke u thënë ku po shkoni, kthehuni se jeni në rrugë të gabuar, ndaluni se po bini në greminë. Por këto faza tani janë kaluar, tanimë është e qartë se Hrushovi dhe grupi i tij s'mund të bëjnë kurrë kthesë, ata janë vënë plotësisht në rrugën e revizionizmit, janë bërë armiq të betuar të marksizëm-leninizmit. Këto dokumente do të jenë të vlefshme nesër për popullin sovjetik, për popujt e tjerë, për marksistë-leninistët që të shohin se si Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar, në krizën më të rëndë që kalonte lëvizja komuniste ndërkombëtare, nuk u trembën, por mbrojtën me konsekuencë e guxim marksizëm-leninizmin, çështjen e drejtë të popujve e të revolucionit. Një pjesë të këtyre materialeve ne i kemi shfrytëzuar, por do të vijë koha edhe për botimin e plotë të tyre.

Pastaj mysafiri, pasi e falënderoi shokun Enver Hoxha për këtë bisedë, midis të tjerash tha:

Jam shumë i gëzuar që ju, shokë shqiptarë njihni veprimtarinë tonë në Austri. Me këtë rast mendoj të them dy gjëra: Nderi kaq i lartë që po më bëni mua u përket të gjithë marksistë-leninistëve të Austrisë. Dua t'ju them se sukseset tona në Austri nuk kanë shkuar aq përpara sa duhet të kishin shkuar. Në Austri ka një grup marksist-leninist që ecën përpara, por ne jeni akoma nxënës. Ne nga ana jonë do të përpiqemi ta bëjmë edhe më të fortë luftën tonë dhe me kalimin e kohës kemi besim se do t'ia arrijmë qëllimit për të cilin luftojmë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit! Urojmë shëndet e suksese në luftë e në punë për çështjen tonë të përbashkët, për çështjen e madhe të revolucionit e të komunizmit!

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas shënime-
ve të mbajtura në këtë takim
që gjenden në AQP*

•

**NJERIU ËSHTË NJË «MAKINË» E KOMPLIKUAR
DHE DELIKATE QË, PO TË MBAHET MIRË,
JETON E PUNON GJATË**

*Nga biseda me një delegacion të shëndetësisë
të RP të Kinës*

4 gusht 1964

Pasi u përshëndetën, shoku Enver Hoxha i stoi miqtë të uleshin. Pastaj ai i pyeti për shëndetin e tyre, shprehu gëzimin që ishin mirë dhe zhvilloi me ta një bisedë të përzemërt.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju falënderoj nga zemra për ndihmën që dhatë, duke shkëmbyer eksperiencën me mjekët tanë!

Gjatë qëndrimit tuaj në Shqipëri ju keni punuar shumë dhe jeni lodhur. Mjekët tanë janë të kënaqur nga puna juaj dhe kanë përfituar nga eksperiencia, nga metoda e punës suaj.

Më parë, ndonjë nga mjekët tanë thoshte se aparatet e institucioneve shëndetësore të ne «janë pak si të vjetra», por, duke parë zotësinë tuaj në përdorimin e

tyre, del qartë se nuk janë të vjetra aparaturat, por duhet më shumë aftësi për t'i vënë ato në lëvizje.

Duke bërë vizita e duke përcaktuar diagnoza, ju arritët në konkluzione të përbashkëta me mjekët tanë.

Mundet edhe të keni dëgjuar nga mjekët tanë se te ne ka nga ata që nuk janë të bindur sa duhet ndaj këshillave të mjekëve. Mund të ketë edhe ndonjë rast të tillë, por në përgjithësi veprohet ashtu si thonë mjekët. Secili shëndetin duhet ta shikojë jo vetëm si një gjë personale, por si një çështje që u përket popullit dhe Partisë.

Këshilla e mjekëve për të prerë duhanin është plotësisht e drejtë dhe duhet ta zbatojmë. Edhe cigaren do të përpiqem ta lë, por jo menjëherë. Ja, gjer tani unë s'kam pirë asnjë cigare, por meqë na erdhën miq, duhet ta pimë nga një! Duhani është shumë i dëmshëm. Mjekët duan të mirën e shëndetit kur këshillojnë të mos e pimë atë.

A mund të na thoni, të dashur miq, profesorë e mjekë, a i vizituat spitalet tona dhe çfarë përshtypje ju bënë? Në lëmin e shëndetësisë ne kemi akoma shumë për të bërë. Është e vërtetë që vendi ynë ka bërë përparime në krahasim me të kaluarën, dhe është bërë shumë për shëndetin e popullit, por detyrat që na shtrohen janë të mëdha.

Profesori kinez, pasi e falënderoi shokun Enver Hoxha për këtë takim si dhe për pritjen e ngrohtë që u qe rezervuar kudo në Shqipëri, tha:

«Në Tiranë ne vizituam spitalet, klinikën, institucionet profilaktike, shtëpinë e nënës dhe të fëmijës. Përveç Tiranës shkuam edhe në Durrës, në Shkodër,

në Koplik dhe në Krujë. Gjatë vizitave tona këtu na ka bërë përshtypje zhvillimi i madh që ka marrë shëndetësia pas Çlirimit të vendit. Numri i kuadrove është shtuar me shpejtësi. Një rëndësi e madhe u është dhënë punës profilaktike dhe luftimit të sëmundjeve epidemike, kështu, për shembull, malarja është zhdukur dhe tuberkulozi është kufizuar shumë. Përshtypja jonë është se ju jeni një vend që bën një punë shumë të madhe për shëndetin e popullit. Natyrisht ne s'kemi parë shumë thellë, por, me sa vumë re, te ju punohet shumë dhe shumë mirë. Në këtë drejtim ne mendojmë se duhet të mësojmë nga ju.

Gjatë vizitave që bëmë në spitalet e Tiranës, vumë re se shokët këtu punojnë jo vetëm për luftimin e sëmundjeve, por edhe për përgatitjen e kuadrit dhe bëjnë edhe punë shkencore. Në këtë drejtim ju keni arritur suksese. Ne jemi të sigurt se në të ardhmen do të keni suksese edhe më të mëdha.

Gjatë kësaj kohe ne u njohëm dhe mësuam nga mjekët shqiptarë. Kjo krijoi një bazë të mirë për lidhjet tona në të ardhmen, të cilat do t'i forcojmë për ngritjen e nivelit të mjekësisë.

Ne kemi dëshirë të madhe që lidhjet e punës në lëmin e shëndetësisë të forcohen edhe më shumë midis dy vendeve tona në mënyrë që të mësojmë nga njëri-tjetri.

SHOKU ENVER HOXHA: Patjetër, lidhjet tona në këtë fushë do të forcohen më shumë. Kjo do të jetë për ne një ndihmë e madhe.

PROFESORI KINEZ: Ne kemi qëndruar në ven-

din tuaj më pak se dy muaj, por kudo, gjatë kësaj kohe, e kemi ndierë veten si në shtëpinë tonë. Dashurinë e ngrohtë dhe të singertë ne e ndiemë në Tiranë, në Durrës, në Shkodër dhe në Krujë. Këtë ne nuk do ta harrojmë kurrë dhe, kur të kthehemi në atdhe, do t'ua themi edhe shokëve tanë. Ne pamë këtu se shokët shqiptarë, populli heroik shqiptar, nën udhëheqjen e drejtë dhe të urtë të Partisë së Punës, luftojnë me guxim, duke mbajtur lart flamurin e marksizëm-leninizmit. Shqipëria është një vend heroik, dhe i gjithë komunizmi ndërkombëtar i drejton sytë drejt këtij shembulli të madh.

'SHOKU ENVER HOXHA: Ju faleminderit për këto ndjenja të zjarrta që shprehët për popullin tonë dhe veçanërisht për punonjësit e shëndetësisë!

Të jeni të sigurt se njerëzit tanë të shëndetësisë do ta zhvillojnë më gjerë dhe më thellë bashkëpunimin me punonjësit e shëndetësisë të RP të Kinës. Ne do të bëjmë përpjekje për të përfitur sa më shumë nga shkenca juaj e shëndetësisë, që te ju ka marrë një zhvillim shumë të madh dhe që në të ardhmen do të zhvillohet edhe më shumë. Ne, shqiptarët, e ndiejmë veten të afërt me popullin kinez. Kështu na mëson marksizëm-leninizmi dhe Partia jonë. Populli shqiptar e ka parë dhe e sheh popullin kinez si një popull vëlla, si një shok të luftës, të lirisë, të urtë dhe internacionalist.

Ne mësojmë dhe do të mësojmë shumë nga ju, deri në metodat e punës shkencore. Puna e shokëve të mjekësisë kineze, që kanë ardhur në vendin tonë, është një punë shembullore, veçanërisht për punonjësit e

shëndetësisë. Njeriu është një «makinë» e komplikuar dhe delikate, që, po të mbahet mirë, jeton e punon gjatë.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TE GJITHË MARKSISTË-LENINISTËT DUHET TE ZHVESHIN SHPATËN KUNDER REVIZIONIZMIT MODERN

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste
(marksiste-leniniste) të Australisë*

13 gusht 1964

Mirë se erdhët në Shqipëri, shokë të dashur të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë! Ne ju presim me gëzim!

Krijimi i Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë ka qenë një fitore për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe një humbje e madhe për revizionistët, me në krye Hrushovin.

Ne kemi marrë të gjitha materialet tuaja. Jemi njohur gjithashtu me përpjekjet që ju, shokët marksistë-leninistë australianë, keni bërë për mbrojtjen e Partisë sonë të Punës. Për këtë ne ju falënderojmë, në radhë të parë, sepse ju, sikurse të gjithë ne, mbronim me këmbëngulje marksizëm-leninizmin kundër revizionizmit modern dhe se në këtë luftë të drejtë revolucionare,

ju i keni bërë një mbrojtje të drejtë Partisë sonë që u sulmua nga revizionistët modernë!

Me sa kemi dijani, tani në partinë tuaj puna po forcohet vazhdimisht, kurse partia e Sharkit po dobësohet. Vërtet ju, si parti e re që jeni, keni përpara vështirësi të shumta, por ato do të kapërcehen.

Edhe ne kemi qenë të paktë në fillim, por, duke parë të kaluarën, vështirësitë që kemi hasur e që kemi kapërcyer në rrugën tonë dhe sukseset që kemi arritur, jemi optimistë edhe për konsolidimin e partisë suaj, sepse kemi në duar armën e pagabueshme, marksizëm-leninizmin, që na ndriçon rrugën. Sigurisht, në rritjen dhe në forcimin e Partisë sonë ka influencuar edhe momenti nacional, kur, si rezultat i pushtimit fashist, shpërtheu si kurrë më parë urrejtja e përgjithshme kundër pushtuesve dhe gatishmëria e masave për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, por duhet thënë që ne kishim edhe një popull luftarak. Edhe sot, kur lëvizja revolucionare është në ngritje, partitë e reja që krijohen nga ndarjet me revizionistët, do të kenë një rritje të shpejtë. Klasës punëtore dhe elementëve të shëndoshë, që gjenden akoma nën ndikimin e revizionistëve, do t'u hapen sytë dhe forcat e shëndosha do të grumbullohen në partitë e reja marksiste-leniniste që po krijohen.

Partia jonë është një parti që lindi dhe u kalit në luftë, duke qenë vazhdimisht në krye të popullit. Edhe rruga jonë për ndërtimin e socializmit është gjithashtu një betejë e madhe, sepse duhej krijuar një bazë ekonomike e shëndoshë, në një kohë kur ekonomia jonë ishte shkatërruar krejtësisht nga lufta; nga ana tjetër,

duhej bërë edukimi i gjithanshëm i popullit politikisht dhe ideologjikisht. Këto detyra të rëndësishme Partia jonë i shtroi me guxim e me vendosmëri dhe arriti rezultate të kënaqshme.

E gjithë periudha njëzetvjeçare e ndërtimit të socializmit në vendin tonë nuk ka kaluar me lehtësi. Ndërtimi i socializmit është bërë në luftë të paprerë kundër presioneve dhe synimeve djallëzore të imperia- lizmit amerikan, monarko-fashistëve grekë, neofashis- tëve italianë dhe revizionistëve jugosllavë. Të gjithë këta, gjatë periudhës së ndërtimit të socializmit kanë zhvilluar kundër vendit tonë një luftë të paskrupullt, jo vetëm nga ana politike dhe ideologjike, por duke organizuar edhe lloj-lloj komplotesh e diversionesh, duke hedhur diversantë nga ajri dhe nga toka. Kështu Partisë sonë i është dashur të luftojë në të gjitha fron- tet. Kjo luftë e pandërprerë revolucionare na ka dhënë mësim të mëdha, na ka forcuar shumë, na ka kalitur me vështirësitë dhe na ka rritur vigjilencën; kjo bëri që në Partinë e në popullin tonë jo vetëm të mos zinte vend tradhtia hrushoviane, por të ishim edhe të për- gatitur për të përballuar situatën e rëndë, të krijuar nga revizionistët e Moskës, dhe e përballuam.

Pasi i njohu miqtë australianë me transformimet e gjithanshme ekonomiko-kulturore që janë bërë në vendin tonë gjatë 20 vjetëve çlirim, me vështirësitë e hasura si rrjedhim i bllokadës së egër ekonomike të organizuar nga revizionistët, si dhe me perspektivat e mëdha që i hapen ndërtimit socialist të vendit në të ardhmen, shoku Enver Hoxha vazhdoi:

Në saje të unitetit të Partisë me popullin, në vendin tonë u arrit një mobilizim i tillë që nuk ishte parë ndonjëherë. Kjo i detyrohet vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë. Kështu u bë e mundur që ne jo vetëm të mbanim nivelin e jetesës që kishim më parë, por edhe ta rritnim atë, në një kohë kur në Bashkimin Sovjetik, në Bullgari, dhe në vendet e tjera revizioniste filluan të ngriheshin çmimet. Sot ne jemi edhe më mirë se më parë. Në vendin tonë nuk pati asnjë reperkusion ekonomik dhe asnjë pakënaqësi në popull. Përkundrazi vija e drejtë e Partisë bëri që populli ynë të çelikoset edhe më tepër në luftën për përballimin e vështirësive. Ne do t'i realizojmë detyrat tona, si në industri ashtu edhe në të gjitha kulturat bujqësore. Të gjitha këto i detyrohen mobilizimit të madh të Partisë dhe të popullit.

Partia jonë është luftarake, militante, që udhëhiqet e lufton në bazë të marksizëm-leninizmit. Revizionistët modernë na akuzojnë për «dogmatikë», për «kriminelë», se në Partinë tonë «s'ka demokraci» e të tjera, e të tjera. Por të gjitha këto nuk zënë vend. Ne e dimë që ju në një moment u ndodhët në vështirësi nga shpifjet që revizionistët kishin përhapur kundër nesh, gjer te vrasja e asaj «gruas me barrë», Liri Gegës. Është e vërtetë që ligjet tona e kanë dënuar atë grua, por ajo nuk ka qenë shtatzënë. Në spitalin tonë ndodhen raportet mjekësore, të cilat vërtetojnë se ajo nuk mund të lindte. Ajo dhe burri i saj pas shumë fajesh të rënda u kapën kur po arratiseshin dhe u dënuan ashtu si e meritonin, sepse ishin agjentë të Titos dhe armiq të betuar të popullit e të Partisë sonë. Edhe origjina e

kësaj shpifjeje është e jugosllavëve. Kur ishim një herë te Hrushovi, para se të prisheshim me të, ai na tha se do të ishte mirë që të mos e kishim dënuar atë grua. Kur ne i treguam veprimtarinë e saj armiqësore, që kishte zhvilluar kundër Partisë dhe popullit tonë, Nikita Hrushovi na u përgjigj, duke thënë: «Mirë, po ja që flasin jugosllavët». Domethënë se Hrushovi mori dhe bëri të vetën tezën e revizionistëve jugosllavë.

Kjo grua veç veprimtarisë së mëparshme antiparti ishte një nga krerët e komplotistëve të kurdisur prej Titos dhe Hrushovit pas Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të cilët kishin për qëllim të rrëzonin udhëheqjen e Partisë sonë. Në atë kohë ne bënim përgatitjet për Kongresin e 3-të të Partisë dhe po zhvillohej Konferenca e Partisë e qytetit të Tiranës. Ambasada jugosllave, në bashkëpunim me njerëzit e Hrushovit, organizoi punën që në konferencën e Partisë të qytetit të Tiranës të dilnin këta persona dhe të atakonin vijën e drejtë të Partisë dhe udhëheqjen e saj. Por e gjithë konferenca e Partisë u ngrit në këmbë, i demaskoi dhe i shpartalloi plotësisht, sepse këta ishin armiq. Ata pohuan para Partisë veprimtarinë e tyre. Disa prej tyre pohuan se ishin agjentë të organizuar të jugosllavëve dhe të sovjetikëve. Midis tyre ishte edhe kjo grua së bashku me burrin e saj.

Me gjithë veprimtarinë e saj të gjatë dhe të vazhdueshme antiparti, ne shumë herë e kemi ndihmuar, ia kemi bërë të qartë se ku e çonin veprimet e saj, e kemi mbajtur bile edhe në punë me përgjegjësi, por ajo, duke qenë agjente e Titos, e vazhdoi veprimtarinë

e saj deri në tentativë për arratisje, krimi më i rëndë ndaj atdheut.

I them këto për të treguar se Partia jonë zbaton me rigorozitet normat marksiste-leniniste në të gjitha drejtimet dhe pikërisht kjo është arsyeja që revizionistët nuk kanë mundur dhe nuk do të mundin kurrë që Partinë tonë ta përçajné.

Objektivi kryesor i Partisë sonë ka qenë dhe është që t'i edukojë anëtarët e saj me ideologjinë marksiste-leniniste dhe me shpirtin revolucionar, dhe kësaj de-tyre i kemi kushtuar të gjitha forcat. Tani te ne sekretarët e Partisë dhe kuadro të tjerë të saj e të pushtetit kanë kryer Shkollën e Lartë të Partisë. Për sekretarët e organizatave-bazë kemi organizuar shkollën njëvjeçare të Partisë. Gati të gjithë anëtarët e Partisë marrin pjesë në format e arsimit në Parti. Kjo gjë e ka forcuar shumë përgatitjen ideologjike dhe politike jo vetëm të Partisë, por edhe të të gjithë popullit. Kështu mund të themi se populli ynë është i ngritur mirë politikisht dhe me gjithë propagandën e shfrenuar që bëjnë armiqtë tanë ndaj nesh, megjithëse kundër vendit tonë flasin 24 radiostacione të huaja në ditë, në emisione të posaçme në gjuhën shqipe, prapëseprapë kjo propagandë armiqësore nuk ka bërë efekt në popullin tonë.

Populli dëgjon edhe muzikën e huaj. Por ne jemi përpjekur që kulturës dekadente borgjeze t'i vëmë përballë letërsinë, artin e kulturën tonë popullore. Gjatë viteve të pushtetit popullor në vendin tonë janë zhvilluar e janë përhapur në një shkallë të gjerë muzika popullore, folklori, teatri ynë popullor dhe estradat tona, janë zhvilluar në mënyrë të gjithanshme letërsia

dhe arti ynë i realizmit socialist. Këto mjete të fuqishme të edukimit komunist të njeriut, në situatat e vështira që kalojmë, kanë milituar kundër pikëpamjeve ideologjike të huaja që depërtojnë nëpërmjet radios e televizionit, u kanë dhënë gjithashtu një hov edhe artit e kulturës sonë socialiste. Kuptohet që kjo është bërë dhe bëhet pa nënvleftësuar vlerat e kulturës përparimtare botërore, sepse, po të vepronim ndryshe, do të bënim gabim.

Ne kemi sot dramën tonë kombëtare, operën dhe baletin tonë. Këto gjëra mund të jenë të zakonshme për ndonjë vend tjetër, por unë i theksova, se në vendin tonë të gjitha këto i ka bërë Partia, se para Çlirimit te ne s'ka pasur asgjë të tillë.

Përveç kësaj, e gjithë vija jonë praktike në ndërtimin e socializmit, të gjitha ligjet dhe urdhëresat e shtetit tonë përshkohen fund e krye nga ideologjia marksiste-leniniste, janë ndërtuar organizativisht në rrugën e drejtë socialiste. Njerëzit tanë edukohen në mënyrë të gjithanshme, si në shkollë, ashtu edhe në punën praktike, në bazë të marksizëm-leninizmit. Kjo është arsyeja që ne i kapërcyem e po i kapërcejmë me sukses të gjitha këto vështirësi të mëdha dhe Partia jonë nuk u lëkund e s'do të lëkundet përpara punës armiqësore të imperialistëve dhe të revizionistëve modernë.

Në këto situata neve na është dashur të forcojmë edhe mbrojtjen tonë, ushtrinë tonë, sepse pa ushtrinë, pa përgatitjen ushtarake të të gjithë popullit Republika Popullore e Shqipërisë do të kishte vështirësi të mëdha. Për këtë arsye Partia i ka dhënë rëndësi të madhe çësht-

tjes së përgatitjes së gjithë popullit për mbrojtje, në tërësi dhe përgatitjes politiko-ushtarake të kuadrit në veçanti. Pothuaj të gjithë kuadrot tanë të ushtrisë kanë mbaruar akademi, kurse i gjithë populli ynë është i armatosur. Në rast rreziku i gjithë populli inkuadrohet në formacione ushtarake. Kjo ka bërë që të gjitha provokacionet e huaja në kufijtë tanë të marrin kurdoherë përgjigjen e merituar.

Natyrisht neve na është dashur të bëjmë shumë sakrifica, por përpara çështjes së lirisë së atdheut, çdo sakrificë në këtë drejtim është e vogël. N. Hrushovi, duke pasur si qëllim që të zbatonte planet e tij djallëzore, pengonte ardhjen e armëve sipas marrëveshjeve që kishim nënshkruar dhe i shkeli ato. Kështu, ai ndryshe nga ç'veprohej në kohën e Stalinit që armatimet na jepeshin gratis, pengoi dërgimin e armëve të lehta, armët e rënda na i preu fare, kurse për sa i përket bazës së Vlorës, disa nga nëndetëset që na ishin dhënë sipas marrëveshjes, na u rrëmbyen. Qëllimi i tij ishte që ushtria jonë të dobësohej. Revizionistët hrushovianë arritën deri atje sa të pyesnin gjeneralët e ushtrisë sonë se me kë do të qëndronte ushtria, me Bashkimin Sovjetik apo me Partinë e Punës, siç bëri ambasadori sovjetik, por ai e mori përgjigjen që meritonte¹.

Ndofta s'ka kohë, por mund të shikoni filmin që është marrë në bazën e Vlorës pas largimit të sovjetikëve, ku duket se sa barbarisht janë sjellë atje oficerët sovjetikë, deri edhe fotografinë e Leninit e kanë çjerrë. Të tillë njerëz kishin sjellë ata këtu. Atje arriti

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 375-376.

puna sa mund të qëlloheshim me armë, por gjakftohësia jonë, e ushtarëve dhe e oficerëve tanë, bëri që të evitoheshin incidentet e rënda.

Të gjitha këto që thashë tregojnë se situata jonë ka qenë dhe është e shëndoshë dhe vështirësitë e rritjes i kemi kapërcyer dhe me siguri do t'i kapërcejmë kurdoherë me sukses.

Tani çështja që na preokupon të gjithëve është lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit. Lufta kundër revizionizmit modern është e gjatë dhe nuk do të mbarojë brenda një kohe të shkurtër. Por është një sukses i madh për komunizmin ndërkombëtar që Partia juaj e re, Partia jonë dhe shumë parti e grupe të tjera marksiste-leniniste në botë gjenden në një radhë kundër revizionizmit modern dhe kundër imperializmit, me në krye imperializmin amerikan.

Për Partinë tonë çështja e revizionizmit modern, si një rrezik i madh që kërcënonte komunizmin ndërkombëtar, ka qenë e qartë shumë më përpara se viti 1960. Te revizionistët jugosllavë dhe te qëndrimet e udhëheqjes sovjetike, pas vdekjes së Stalinit, ne kemi parë shtrembërimet ideologjike dhe metodat organizative të revizionistëve në shërbim të imperializmit. Ekspierienca që kishte fituar Partia jonë në luftën shumëvjeçare kundër revizionistëve jugosllavë bëri që ajo të përkujtojë qysh në fillim se grupi i Hrushovit po shkonte në një rrugë antimarksiste. Kjo na bëri që t'i shihnim me sy kritik veprimet e N. Hrushovit qysh pas vdekjes së Stalinit dhe ardhjes së tij në fuqi. Më parë ne Hrushovin e njihnim vetëm me emër. Në mbledhjet që kemi pasur me udhëheqjen e Partisë Komuniste të

Bashkimit Sovjetik në kohën e Stalinit, kanë qenë Molotovi e të tjerë, kurse Hrushovi jo. Pas vdekjes së Stalinit ai përdori taktikën duke mos dalë menjëherë haptas kundër tij. Veprimi i tij i parë antimarksist ishte vajtja e tij në Jugosllavi. Këtë Partia jonë atëherë e kundërshtoi dhe i dërgoi një letër Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, ku i thoshte se ne nuk ishim dakord që Hrushovi të shkonte në Jugosllavi, sepse Titoja është tradhtar i marksizëm-leninizmit. Kjo e bëri Partinë tonë të ishte vigjilente dhe të kuptonte se këtu kishte diçka që nuk ishte në rregull.

Kështu, vija e Partisë sonë gjatë asaj periudhe ka qenë: miqësi me Bashkimin Sovjetik dhe vigjilencë ndaj këtyre nuancave të huaja që vinim re në veprimet e Hrushovit. Se si u zhvilluan ngjarjet më vonë, nuk është nevoja t'ju flas gjatë, sepse ju i dini të gjitha ato që ndodhën.

Në Bukuresht, Komiteti Qendror i Partisë sonë, qysh para se të fillonte mbledhja, e kuptoi se nga Hrushovi po organizohej një komplot i madh kundër marksizëm-leninizmit, kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë sonë. Në këto rrethana Komiteti Qendror i Partisë sonë vendosi t'i kundërshtonte dhe t'i godiste hapur pikëpamjet dhe veprimet revizioniste të udhëheqjes hrushoviane, megjithëse e dinte se një gjë e tillë do të sillte kundërshtimin e shumicës dërrmuese të partive që merrnin pjesë në mbledhje. Kështu Partia jonë mbajti atë qëndrim që ju e dini si në Bukuresht dhe në Mbledhjen e Moskës.

Kundërshtimet tona ne i shfaqëm brenda normave

marksiste-leniniste, nuk folëm publikisht, përkundrazi, ato që patëm i thamë në mbledhjet ndërkombëtare, si në Bukuresht dhe në Moskë. Por, kur N. Hrushovi na sulmoi hapur, edhe ne lëshuam bateritë kundër tij. Po a bëmë mirë kështu? Ne mendojmë se bëmë shumë mirë që filluam luftën kundër këtij tradhtari të marksizëm-leninizmit. Duhet thënë se edhe pas mbledhjeve të Bukureshtit e të Moskës Partia jonë nuk ka pasur as më të voglën shpresë se ky grup tradhtar do të bënte kthesë. Bindja jonë ishte e plotë se ata janë tradhtarë dhe se do të shkonin gjithnjë e më thellë në rrugën e tradhtisë në vijën politike, ideologjike, ekonomike etj. Dhe ashtu doli. Koha provoi se ne nuk u gabuam në vlerësimet dhe në parashikimet tona.

'Por Partia jonë nuk e ndjeu kurrë veten të izoluar. Ajo kishte besim se marksistë-leninistët, të gjithë komunistët e vërtetë ishin me ne. Prandaj ne nuk e ndiemë veten të izoluar, por akoma më të fortë.

Për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, kjo që ndodhi ka të keqen e saj, por ka edhe anën e mirë, se kjo plagë u zbulua dhe kundër saj filloi operacioni.

Udhëheqësit sovjetikë na sulmuan, por Partia jonë nuk u tremb se e dinte që, duke u sulmuar ne, sulmoheshin të gjithë marksistë-leninistët. Sulmit të tyre ne iu përgjigjëm me kundërsulm, por nga kjo nuk u erdhi mirë revizionistëve dhe, me gjithë shpifjet kundër nesh, radhët tona u shtuan, sepse rruga e tradhtisë së N. Hrushovit po bëhej më e qartë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Taktika që përdor sot N. Hrushovi gjoja «për unitet» dhe «për pajtim», blofi për mbësh-

tetjen e mbledhjes së Moskës¹, presionet ekonomike, shantazhet etj. nuk e mashtrojnë Partinë tonë dhe nuk e përkulin, përkundrazi ne ishim dhe jemi të sigurt se këtyre renegatëve, me këto veprime, do t'u dalë akoma më shumë boja.

Lufta që bëjnë Partitë tona solli përçarje në stanin revizionist. Ne duhet të përfitojmë nga përçarja dhe nga kontradiktat e tyre. Kërkesa për mbledhjen tregon se Hrushovit i ka ardhur litari në grykë. Me këtë ai kërkon që të mbajë në fre të gjithë revizionistët e tjerë. Por kë të mbajë? Veçse pleshtat, pasi revizionistët, brendapërbrenda i brejnë kontradikta të mëdha. Por ai synon edhe diku tjetër që të shkojnë në mbledhje edhe partitë që akoma s'kanë dalë hapur dhe këtë vajtje ai ta shfrytëzojë për interesat e tij.

Tani shtrohet çështja: a mund të ketë unitet midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë? Jo, në asnjë mënyrë dhe asnjëherë! Nuk mund të krijohet kurrë unitet midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve modernë. Kush pretendon për një unitet të tillë ai s'është marksist-leninist i vërtetë, por oportunist.

A ka vend për bisedime në mes partive dhe a duhet të marrim pjesë në bisedime? Ne kemi qenë gjithnjë për bisedime, por të kuptohemi, vetëm në rrugën mark-

1 N. Hrushovi në korrik të vitit 1964 në mënyrë arbitrare e të jashtëligjshme vendosi të thirrej në Moskë një mbledhje e veçantë e partive revizioniste që ecnin pas gjurmëve të tij, mbledhje e cila, sipas Hrushovit, do t'i shërbente «zgjdhjes së mosmarrëveshjeve dhe forcimit të unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste». Kjo u shty për shkak të kontradiktave që ekzistonin në stanin revizionist.

siste-leniniste. Këtë ne e kemi deklaruar hapur në mbledhje, në artikuj të ndryshëm në shtyp si dhe në mjaft letra që i kemi dërguar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Në këto dokumente, në kohën kur Hrushovi na sulmonte, ne i jemi drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik duke i thënë se grupi i Hrushovit ashtu siç guxoi të na sulmonte në mënyrë shpifëse, po ashtu ai duhet të marrë guximin t'i pranojë e t'i dënojë botërisht qëndrimet e veprimet e tij antimarksishte dhe të vihet në rrugën marksiste-leniniste. Por ai vazhdoi të na sulmonte dhe nuk donte ta dëgjonte zërin tonë të drejtë. Partia jonë i ka zbatuar të gjitha rregullat marksiste-leniniste që duhet të përdoren ndërmjet partive, por të gjitha përpjekjet tona për ta sjellë atë në rrugë të drejtë kanë dështuar. Hrushovi ka arritur gjer në prerjen e marrëdhënieve diplomatike me vendin tonë. Kështu që rruga e bisedimeve e N. Hrushovit me ne, në fakt, është prerë.

Qëndrimi i Partisë sonë ndaj partive të tjera revizioniste gjithashtu është i qartë. Megjithëse ne u sulmuam edhe nga partitë e tjera revizioniste, Partia jonë goditi vetëm kryesorët — grupin tradhtar të N. Hrushovit dhe të Titos, kurse të tjerëve nuk iu përgjigj. Megjithëkëtë ata nuk bënë as çapin më të vogël për bisedime, por ndoqën Hrushovin, duke injoruar propozimet e Partisë sonë për bisedime dhe duke mos pushuar sulmet shpifëse e armiqësore. Pra, edhe partive të tjera revizioniste ne nuk u kemi asnjë borxh.

Qëllimi i revizionistëve modernë ishte që ne të gjunjëzoheshim, të pushonim polemikën, të viheshim

në rrugën e tradhtisë dhe në këtë mënyrë ata të vazhdonin punën e tyre revizioniste. Por Partia jonë nuk mund ta pushonte polemikën dhe as mund të shkonte në rrugën e tradhtisë.

Revizionistët modernë thonë që të bisedojmë dhe të biem dakord për ato çështje që na bashkojnë. Partia jonë ka pikëpamje të kundërta me revizionistët në të gjitha çështjet dhe asgjë nuk na bashkon me ta. Pra, mbledhja për «unitet» është një bluf për t'iu nënshtruar revizionistëve modernë. Ata na akuzojnë ne si «përçarës», kurse përçarës nuk jemi ne, por ata, sepse N. Hrushovi me rrugën e tij kapitaliste dhe borgjeze e përçau kampin socialist dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Na akuzojnë se përçajmë partitë revizioniste, domethënë sikur Partia jonë jep urdhra që të krijohen partitë e reja marksiste-leniniste dhe këto të mbrojnë marksizëm-leninizmin, kurse një gjë të tillë marksistë-leninistët e bëjnë vetë. Kështu bëtë edhe ju, marksistë-leninistët australianë, pyetët vetë mendjen dhe zemrën tuaj, hodhët poshtë pikëpamjet revizioniste e kapitullante të Sharkit me kompani dhe krijuat Partinë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë. Në këtë rrugë ne u gjendëm në një vijë me ju dhe s'ka se si të jetë ndryshe.

Ne mendojmë se lufta e Partisë sonë dhe e partive të tjera marksiste-leniniste ka bërë që të dobësohen pozitat e revizionistëve modernë, sidomos të Hrushovit dhe të Titos, por megjithatë ne kemi akoma për të bërë një luftë të madhe kundër tyre, sepse ata kanë fuqi politike, ekonomike dhe ushtarake. Prandaj Partia jonë mendon se lufta dhe përpjekjet tona duhet të shumëfi-

shohen, se uniteti ynë duhet të çelিকoset, se partitë tona dhe vendet socialiste, me ato forca dhe mundësi që kanë, duhet t'u vijnë në ndihmë të gjithë marksistë-leninistëve.

Bindja jonë për fitoren e marksizëm-leninizmit është e plotë. Brenda këtyre katër vjetëve ne arritëm të gjitha këto suksese, prandaj të gjithë marksistë-leninistët duhet të zhveshin shpatën kundër revizionistëve, të cilët sulmojnë marksizëm-leninizmin dhe bashkëpunojnë me imperializmin. Çështjet që preokupojnë njerëzimin nuk mund e nuk duhet të merren në kuptimin e ngushtë të interesit nacional. Të marrim, për shembull, Partinë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë. Ju e sulmuat hapur Hrushovin dhe partinë revizioniste të Sharkit. Mos vallë është pa rreziqe lufta juaj? Jo, sepse ju keni të bëni atje me imperializmin, më borgjezinë dhe me revizionistët. Atëherë si mund të justifikohet mosdalja hapur kundër revizionizmit të një partie që është në fuqi, siç bëjnë disa parti sot? Por do të vijë ajo kohë kur edhe këto parti do ta luftojnë haptas revizionizmin, sepse veprimet tradhtarë e komplotiste të Hrushovit do t'i detyrojnë ato të mbajnë një qëndrim të prerë.

Dalja hapur e partisë suaj dhe e Partisë Komuniste të Zelandës së Re kundër revizionizmit hrushovian, ka një rëndësi të madhe, sepse ju jeni parti të popujve anglo-saksonë. Po kështu ka rëndësi edhe qëndrimi marksist-leninist i Partisë sonë, e cila ndodhet në Ballkan, në Evropë.

Hrushovi dhe revizionistët e tjerë modernë, mos-

marrëveshjet e mëdha politike e ideologjike në gjirin e lëvizjes komuniste kërkojnë t'i paraqesin si çështje «të racizmit». Për ne ata thonë se marrim urdhra nga Pekini, kurse me daljen hapur të partisë suaj, të Partisë Komuniste të Zelandës së Re dhe të Partisë Komuniste të Brazilit kundër N. Hrushovit bëhet më e qartë për të tjerët se këtu nuk është çështja «e racizmit», por çështja e madhe e mbrojtjes së marksizëm-leninizmit.

Vendet tona ndodhen larg njëri-tjetrit, por ne e ndiejmë veten afër jush, prandaj dëshira jonë është që të shkëmbejmë mendime, të shkëmbejmë delegacione. Ta konsideroni vendin tonë si shtëpinë tuaj dhe sa herë që të keni mundësi, të vini si ju, ashtu edhe shokë të tjerë të udhëheqjes së partisë e të sindikatave.

Kryetari i delegacionit, pasi foli mbi përshtypjet shumë të mira gjatë vizitave nëpër vendin tonë, ku iu forcua akoma më shumë bindja për drejtësinë e vijës së PPSH, vazhdoi:

Jam shumë i gëzuar që ndodhem këtu në mes jush. Ne kemi një admirim shumë të madh për Partinë tuaj që ka qenë objekt akuzash nga revizionistët më shumë se kushdo tjetër. Lufta e Partisë suaj është një luftë heroike dhe ju, shoku Enver, jeni një militant marksist-leninist i shquar.

Lufta kundër revizionizmit modern solli një erë të re në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Në luftë kundër revizionizmit Partia e Punës e Shqipërisë jep një kontribut të madh. Partisë së Punës të Shqipërisë historia i ngarkoi një rol shumë të madh dhe këtë rol ajo po e kryen si duhet.

Unë jam i lumtur që pata mundësinë të vija këtu dhe për këtë ju falënderoj shumë!

SHOKU ENVER HOXHA: Rëndësi ka çështja që ne jemi në unitet të plotë. Ne kemi shumë respekt për Partinë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë. Ne ju falënderojmë shumë për vlerësimin që i bëtë Partisë sonë! Ky është për ne një nder dhe një inkurajim i madh. Partia jonë s'ka bërë asgjë më tepër se ç'duhet të bënin marksistë-leninistët. Në këtë rast ne kemi dhënë vetëm kontributin tonë modest. Ju sigurojmë se Partia jonë do të jetë kurdoherë në luftë kundër imperializmit dhe revizionizmit modern, do të jetë solidare me partitë marksiste-leniniste dhe me të gjithë marksistë-leninistët në botë. Partia jonë do të jetë kurdoherë e papërkulur në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

TA BËJMË POGRADECIN NJË MARGARITAR TË VENDIT TONË

Fjala para popullit të Mokrës në mitingun e organizuar me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të rrethit të Pogradecit

30 gusht 1964

Të dashur patriotë dhe patriote të Mokrës,

Ju sjell përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë, të Këshillit të Ministrave, të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë dhe të miat personale, me rastin e festës suaj, 20-vjetorit të çlirimit të rrethit të Pogradecit, si dhe me rastin e festës së madhe të popullit tonë, 20-vjetorit të Çlirimit të Atdheut që po afron! Festa juaj është e gëzueshme dhe ka rëndësi për gjithë Shqipërinë, ajo është pjesë e luftës për çlirim të të gjithë popullit tonë, që luftoi për shekuj me radhë kundër otomanëve dhe pushtuesve të tjerë. Populli shqiptar ndien gëzim dhe kënaqësi që me forcat e veta doli fitimtar mbi armiqtë. Një çerek shekulli luftoi ai, duke pasur në krye Heroin tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotin, kundër pushtimit turk për të jetuar i lirë. Për shekuj me radhë, brez pas brezi, populli

shqiptar luftoi pa u përkulur për lirinë e pavarësinë e tij.

Për çështjen e madhe të lirisë e të pavarësisë së atdheut, populli ynë rroku armët nën thirrjen e Partisë edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Dhe frytet e kësaj lufte, të këtyre përpjekjeve e sakrificave të panumërta, të gjakut të bijve dhe të bijave të tij që ranë në fushën e nderit, u kurorëzuan me sukses.

Ne që jemi mbledhur këtu, e kemi të gjallë kujtimin e ditëve heroike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Mokra jonë është një krahinë me tradita luftarake. Dikur, disa shekuj më parë, ajo ka qenë një nga krahët e sigurt të Skënderbeut. Që këtej u derdhën kushedi sa herë ushtritë e heroit tonë të lavdishëm mbi ushtritë e Sulltanit në fushë të Domosdovës dhe i shpartalluan ato me turp. Edhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në gjurmët e traditave të lashta luftarakë, Mokra u bë një nga qendrat e Lëvizjes sonë, të udhëhequr nga Partia jonë marksiste-leniniste e Punës. Këtu u formua organizata e Partisë e Pogradecit që u bë bërthama e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në krahinën e Mokrës. Këtu punoi dhe luftoi Heroi i Popullit Reshit Çollaku, me të cilin unë jam takuar në Sllatinë. Te Reshiti unë njoha një shok të hedhur, të gatshëm, të vendosur deri në fund për çështjen e popullit. Dhe ai u ngrit, u rrit e u formua në luftën tonë çlirimtare. Këtej nga Mokra dolën me dhjetëra e dhjetëra djem e vajza në çetat dhe në batalionet partizane.

Në këtë ditë feste të gëzueshme ne me përulje të thellë përkujtojmë bijtë e popullit që dhanë jetën për liri, që ranë për të mos vdekur kurrë. U vra Reshiti,

mentos etj., etj. që janë ngritur e do të ngrihen do të plotësojnë gjithmonë e më mirë nevojat gjithnjë më të mëdha të ekonomisë sonë popullore.

Gjatë pesëvjeçarit që po kalojmë ndërtimi industrial po bëhet në një masë të tillë që do të krijojë mundësi që objektet e ndërtuara dhe këto që po ndërtojmë të bëhen një bazë e fuqishme për ekonominë tonë në të ardhmen. Këtë pesëvjeçar ne do të nisim të ngremë industrinë metalurgjike, sepse kemi mineral hekuri në rrethin tuaj, në atë të Librazhdit dhe në rrethin e Korçës. Ne tani po hedhim bazat e para të industrisë sonë të hekurit. Vendi ynë, siç e shihni, po ecën përpara, por pa çimento, pa hekur nuk mund të përballosh ndërtimet e mëdha. Objektet e rëndësishme që po ngrihen, do të përballojnë nevojat e planeve të ardhshme.

Planet tona synojnë gjithashtu në përmirësimin e mëtejshëm të bujqësisë. Nuk do të jetë larg koha kur te ne do të bonifikohen të gjitha fushat, do të vihen në shfrytëzim toka të reja buke, do të shtohet mjaft sasia e plehut natyral e kimik, do të rritet numri i pendëve të qeve për fuqi tërheqëse, do t'i jepet rëndësi zhvillimit të kullotave, do të shfrytëzohen më mirë tokat e bukës. Me këto masa të rëndësishme do të bëhet i mundshëm shtimi i rendimenteve, pra rritja e prodhimeve bujqësore. Bujqësia jonë i ka të gjitha mundësitë të ecë përpara në rrugën e intensifikimit, në rrugën e krijimit të bollëkut, të një jete më të mirë e më të begatshme për popullin.

Plani i ardhshëm pesëvjeçar do të synojë në përpunimin e mëtejshëm të bujqësisë. Brenda këtij pesëvjeçari do të mbarojë bonifikimi i të gjitha fushave, do të

përfundojnë uzinat e plehrave kimike, do të modernizohet më tej bujqësia. Rëndësi e madhe do t'i jepet edhe përmirësimit të kullotave. Ky do të jetë një nga pesëvjeçarët më të rëndësishëm për sektorin e bujqësisë.

Njëkohësisht do të ngrihen edhe vepra të tjera industriale. Ne kemi ngritur deri tani hidrocentrale, por me pesëvjeçarin e ardhshëm do të fillojë ngritja e hidrocentralit më të madh të vendit tonë, ai i Vaut të Dejës në rrethin e Shkodrës. Në pesëvjeçarët e ardhshëm, duke shkrirë hekurin në vend, do të bëhet e mundshme të prodhojmë motorë elektrikë më të lirë dhe më të mirë për fshatin. Tani jemi duke zbuluar vendburime të reja naftë. Për këtë qëllim do të ngremë një rafineri të re. Ne kemi zbuluar gjithashtu fusha me gaz metan për shfrytëzimin e të cilit duhen ndërtuar fabrika. Nëntoka jonë fsheh edhe minerale të tjera të vlefshme.

Të gjitha këto na bëjnë të shohim qartë se lufta që zhvilloi populli ynë nën udhëheqjen e Partisë, gjaku që u dërdh rrëke nga bijtë më të mirë të popullit, nuk shkoi kot, u sigurua pavarësia, u sigurua e ardhmja e ndritur e vendit tonë. Gjatë këtyre 20 vjetëve, Partia u ka bërë ballë armiqve dhe ka fituar. Kjo për ne është, e qartë, sepse populli është në fuqi, Shqipëria ecën përpara, se në krye ka një Parti heroike, të drejtë, të përbërë nga njerëz të thjeshtë. Prandaj, vëllezër dhe motra, t'i ruajmë si sytë e ballit këto fitore, unitetin Partipopull ta çimentojmë çdo ditë e më shumë.

Ne kemi shumë miq dhe shokë në botë. Bashkimi Sovjetik i Leninit dhe i Stalinit ka qenë një nga miqtë tanë më të mëdhenj. Por atje tani sundon një klikë tradhtarësh me N. Hrushovin në krye. Partia jonë ishte

e para që i vuri gishtin kësaj plage. Për këtë, ju e dini çfarë masash u morën kundër nesh nga tradhtarët revizionistë hrushovianë, po Shqipëria jo vetëm nuk u përkul, por qëndroi e patundur dhe ballëllart, eci me nder e përparoi.

Sot Hrushovi është demaskuar, kurse Partia e Punës e Shqipërisë nderohet me respekt në të gjithë botën. Eksperienca e luftës dhe e veprimtarisë së Partisë sonë studiohet nga të gjithë. Kjo u arrit në saje të mençurisë së Partisë, të pjekurisë së saj, e cila bëri çdo gjë hapur dhe drejt. Revizionistët në fillim të luftës së tyre u frynë si turfanda, kurse sot Nikitën me shokë nuk i pyet njeri.

Lëvizja antirevizioniste po rritet në të gjithë botën. Hrushovi dhe Titoja e shohin të vështirë karrigen e tyre që po kërcet nga pesha e rëndë e luftës së popujve dhe e forcave revolucionare marksiste-leniniste kudo në botë.

Shokë,

Ju e dini se N. Hrushovi ka deklaruar se do të bëjë një mbledhje gjoja për t'u bashkuar, siç pretendon ai, për të krijuar unitetin e kampit socialist. Mirëpo ai është futur në një rrugë pa krye, e cila do ta diskreditojë edhe më tepër. Këto momente kanë rëndësi të madhe, sepse revizionizmit i doli boja, iu çorr maska. Puna e madhe, lufta e forcave marksiste-leniniste në botë, po sjellin një ngritje të vrullshme të revolucionit. Në shumë vende të botës janë krijuar grupe e parti të reja marksiste-leniniste, po dalin gazeta dhe botime revolu-

cionare, po zgjerohet kudo fronti antiimperialist dhe antirevizionist. Do të vijë dita që partitë revizioniste do të asgjësohen dhe në vend të tyre kudo masat do të udhëhiqen me sukses nga partitë marksiste-leniniste.

Propaganda e Hrushovit dhe e Titos kundër luftërave të popujve ka qenë dhe është e madhe, por kundër predikimeve të N. Hrushovit, kundër planeve luftënxitëse të imperializmit amerikan, popujt janë ngritur kudo në luftë. Në luftën e tyre të drejtë, sado pengesa dhe sabotime që të bëjnë revizionistët, popujt do të fitojnë me siguri.

Përpara kësaj gjendjeje, ne duhet të forcojmë akoma më shumë radhët tona, unitetin e çeliktë rreth Partisë. Ta duam me gjithë shpirt Partinë e Punës, ta mbrojmë atë si sytë e ballit nga armiqtë e tradhtarët. Anëtarët e Partisë të jenë në ballë të luftës për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Ata duhet të jenë kurdoherë në ballë të popullit dhe të luftojnë për interesat e tij. Ne komunistët duhet të bëjmë çdo sakrificë për interes të popullit dhe të atdheut. Prandaj ne, anëtarët e Partisë, të ruajmë dhe të forcojmë çdo ditë e kurdoherë lidhjet me të. Nocienin për të qenë kurdoherë të gatshëm për të bërë çdo sakrificë për popullin, e ka pasur gjithmonë parasysh Partia jonë dhe ajo do t'i forcojë lidhjet e saj me popullin akoma edhe më shumë në të ardhmen.

.Detyrat tona, lufta dhe përpjekjet tona janë të mëdha, qoftë në lëmin e brendshëm, qoftë në atë të jashtëm. Por në këtë luftë të shenjtë ne nuk jemi vetëm, se kemi përkrah të gjithë popujt e njerëzit përparimtarë të botës. Armiqtë tanë do të dështojnë në planet e

tyre, megjithatë ne duhet të jemi në çdo kohë vigjilente, të ruajmë si sytë e ballit kufijtë tanë të shenjtë, të ruajmë pavarësinë e atdheut dhe fitoret e arritura me aq gjak e sakrifica. Socializmin populli ynë e ndërton kryesisht vetë, prandaj ne, shokë, do të shkojmë me siguri përpara, se na udhëheq Partia jonë e lavdishme, se ne kemi një Ushtri Popullore revolucionare, vigjilente e syptrembur, se kemi një popull trim, liridashës dhe punëtor.

Shokë,

Puna është nder i madh për çdo njeri. Ajo krijon jo vetëm një kënaqësi të madhe ekonomike, por edhe gëzim e kënaqësi shpirtërore. Dembelin nuk e do njeri. Ai që punon, është i gëzuar shpirtërisht, dhe, kur je i gëzuar shpirtërisht, edhe shëndeti është më i mirë. Ne shohim me gëzim që edhe në fshatrat tona ka përparime të mëdha. Lindjet në vendin tonë janë nga më të lartat në të gjithë Evropën. Kjo nuk vjen vetëm për arsye se Partia shtoi institucionet shëndetësore, mjekët, por edhe sepse njerëzit tanë i kaliti puna, lufta me natyrën, se u shtua mirëqenia e gjithë punonjësve. Njerëzit në punë janë bërë më optimistë, ata nuk kanë frikën e së nesërme, nuk kanë frikë për jetën e fëmijëve se do t'u mbeten pa bukë. Njeriu që sot punon, ka besim te puna e tij, te djersa e munda e tij.

Mendoj se edhe në Mokër, që të ecet edhe më shpejt përpara, duhet të shfrytëzohen të gjitha kushtet e mundshme dhe, në radhë të parë, të forcohet e të mbahet më mirë sektori i blegtorisë. Tokat e bukës që

keni, t'i punoni më mirë, të punoni që të shfrytëzoni për ujitje gjithë përrrenjtë etj. Komiteti Qendror i Partisë do të marrë masa që në mënyrë të veçantë të shfrytëzohet çdo burim uji në malësi. Por edhe iniciativa të mëdha në këtë drejtim mund të marrë vetë populli dhe organizatat e Partisë dhe të arrihet që të mbushet krahina me ara të gjelbëruara, të krijohen pyje me arra e gështenja etj.

Në këtë festë ne nuk jemi mbledhur për t'u mburrur për ato që kemi bërë, po për të kujtuar luftën që bëmë, për t'i thënë rinisë si kemi luftuar e si kemi punuar ne për të arritur deri më sot në këto përparime që po shohim dhe të frymëzohemi që të punojmë edhe më mirë në të ardhmen.

Të frymëzuar nga patriotizmi i baballarëve dhe i nënave, në radhë të parë ju, të rinj dhe të reja, të kuponit se çdo gjë bëhet për ju. Të gjitha planet, të gjitha përparimet, bëhen që rinia të rrojë më mirë, më e lumtur, më e gëzuar. Rinia është mbështetja kryesore e popullit dhe e Partisë. Baballarët tuaj janë gati të bëjnë çdo sakrificë, mjafton që ju të mësoni dhe të jeni kurdoherë revolucionarë. Dhe për këtë ju keni si detyrë t'u përgjigjeni përpjekjeve të prindërve tuaj me punë të palodhur. Mësoni nga rruga e vështirë nëpër të cilën kemi kaluar, ndiqni rrugën e urtë që ju thotë Partia!

Sot, me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Pogradecit, unë ju uroj nga zemra fitore edhe më të mëdha dhe ju siguroj se ndihmën e Partisë dhe të Qeverisë do ta keni gjithnjë. Ta bëjmë Pogradecin një qendër të bukur, një margaritar të vendit tonë. Në të ardhmen në këtë qytet do të ngrihen hotele, do të krijohen më shumë

parqe, sepse çdo ditë e më tepër do ta vizitojnë e do të pushojnë në të njerëzit e Shqipërisë. Prandaj, punoni që të thahen moçalet që janë në afërsi të qytetit, vendi rreth e përçark të pyllëzohet, të asfaltohen rrugët, të mbahen ato pastër etj.

Me rastin e kësaj feste, vëllezër dhe motra, edhe një herë ju uroj suksese në punë, shëndet dhe gëzime në familjet tuaja!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

JETEN E PARTISË TA SHOHIM NË DINAMIZMIN E SAJ

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1964

Dëshiroj të them edhe unë disa mendime për forcimin e punës organizative të Partisë. Vendimet e herëpashershme që janë marrë nga Byroja Politike ose Sekretariati për forcimin organizativ të Partisë në drejtim të shtrirjes së pranimeve të reja, të masave ndëshkimore, në gjithë kompleksin e çështjeve, janë zbatuar dhe po zbatohen nga baza dhe udhëheqja në rrethe dhe në qendër. Megjithatë, duhet të theksoj problemin që si ne, edhe shokët në rrethe e në bazë të reflektojnë më shumë dhe më thellë mbi direktivat e Partisë për çështjet organizative, të cilat kanë dalë nga nevojat dhe nga analizat e punës së Partisë. Ne jemi në gjendje ta bëjmë

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi përbërjen e Partisë, pranimet dhe masat ndëshkimore. Janë thirrur në raport komitetet e Partisë të rretheve Durrës e Burrel.

këtë gjë. E kam fjalën për shokët që punojnë në sektoret e organizimit, për instruktorët dhe sekretarët e komiteteve të Partisë, të cilët tani kanë një eksperiencë të madhe partie dhe shumë prej tyre kanë kryer shkolla dhe kanë shkuar e punojnë në rrethe e në bazë.

Le të marrim çështjen e pranimeve në Parti. Sikurse shihet edhe në raport, vazhdohet të pranohen shumë nëpunës, megjithëse ata që janë pranuar, e meritojnë, pasi kanë dhënë prova. Mirëpo nuk duhet të harrojmë atë që është kryesore, bazën e Partisë, klasën punëtore dhe fshatarësinë. Prandaj, për këto direktiva që ka dhënë Komiteti Qendror, ne duhet t'i bëjmë të ndërgjegjshme organizatat-bazë mbi kuptimin e vërtetë të ndërtimit të Partisë, të bazës kryesore të përbërjes së saj jo vetëm aktualisht, por edhe në të ardhmen.

Parimet dhe kriteret mbi pranimet në Parti të mbrohen kurdoherë me zgjuarsi në rrugën marksiste-leniniste dhe të zbatohen drejt. E them këtë se ka edhe njerëz që bëjnë lëshime në zbatimin e direktivave. Kjo vjen se këta influencohen, kush më shumë e kush më pak, nga ideologjia e huaj borgjeze e revizioniste. Lufta e klasës vazhdon, armiku vepron, këto të mos i harrojmë. Jeta tregon se edhe njerëz, që kanë luftuar dhe që kanë punuar mirë, të ndodhur nën presionin ideologjik të armikut, me kalimin e kohës, dalngadalë degjenerojnë. Ka edhe njerëz, të cilët, me gjithë punën e madhe të Partisë, e zbutin luftën e klasave. Prandaj, Partia të përpiqet t'i forcojë dhe t'i edukojë njerëzit, që të jenë deri në fund zbatues konsekuentë të vijës së Partisë, të parimeve dhe të direktivave të saj.

Direktivat e Partisë të studiohen, të kuptohen e të

zbatohen drejt, jo në mënyrë shabllone e të përgjithshme. Organizata e Partisë e kombinatit të tekstileve «Stalin», për shembull, duhet ta kuptojë se do të jetë më mirë që ajo të pranojë në radhët e saj disa punëtorë me karakteristika të shëndosha të klasës dhe me garancitë e duhura, sesa të pranojë një llogaritar me shkollë të lartë, i cili, megjithëse nuk punon keq, nuk ka karakteristikat e punëtorit, shpirtin e klasës, që më vonë mund edhe t'i fitojë.

Ose të marrim organizata të tjera partie ku kryhen punë më të rënda. Punëtorët që bëjnë punë të rënda, kaliten dhe përgatiten më mirë për një luftë të gjatë konsekuente në mbrojtje të vijës së Partisë sesa një intelektual, që porsa ka mbaruar universitetin, ndonëse ky punon shumë mirë dhe meriton të hyjë edhe në Parti, por që në raport me punëtorin, ai duhet të presë akoma. Se sa kohë do të presë për të hyrë në Parti, këtë le ta gjykojë organizata-bazë.

Një punëtor që ka punuar në mënyrë heroike në minierë për disa vjet, duhet të pranohet në Parti më parë se ai universitari, i cili duhet të kalitet disa vjet pastaj të shihet çështja nëse mund të pranohet ose jo. Në qoftë se ai është i mirë, Partia ta mbajë afër, por kur vjen puna të diskutohet për ta pranuar në Parti, komunistët të mos nisen nga fakti se ka kryer studimet e larta dhe ta pranojnë. Ky i ri mund të jetë edhe drejtues në një ndërmarrje ekonomike ose institucion dhe punon mirë, por s'është e thënë që të pranohet medocmos edhe në Parti. Minatori që pranohet në Parti, mund të mos ketë sa duhet shkollë, po ai është njeri i vendosur për Partinë, punon në rrugën e Partisë duke

përballuar çdo sakrificë, e kupton drejt vijën e Partisë dhe është shtyllë për Partinë. Ai do të shërbejë, sot dhe nesër, i vendosur që vija e Partisë të zbatohet kurdoherë drejt dhe, nëse ka ndonjë që kërkon ta lëkundë, ai e ka atë forcë, guxim dhe vendosmëri që t'i thotë: ndal, se ti ke harruar ç'ka qenë përpara Shqipëria, ke harruar vuajtjet e popullit tonë, punën e madhe që duhet të kryejmë akoma, për ta bërë edhe më të lumtur jetën e popullit. Prandaj në qoftë se pranohen më shumë nëpunës, kjo duhet të na bëjë të reflektojmë mirë.

Afatin për stazhin e kemi caktuar dhe atë duhet ta respektojmë. Po edhe kjo lyp nga organizatat-bazë një kujdes dhe një kuptim të thellë. Stazhi është caktuar jo pa baza, jo më kot, po ai në të ardhmen edhe mund të ndryshojë. Këtë e them se më duket sikur ka ardhur koha që për disa kategori stazhi mund të shikohet. Këtë problem, natyrisht, ta studiojmë me hollësi, se lidhet me forcimin e jetës së Partisë, me ngritjen ideologjike të njerëzve. Elementët e klasës punëtore që vijnë në Parti duhet të përballojnë me të vërtetë jo vetëm barrën e rëndë të komunistit në momentet aktuale, por të jenë sidomos në gjendje të përballojnë çdo situatë tjetër më të rrezikshme që mund të ndodhë eventualisht në të ardhmen. Ne po bëjmë një luftë shumë të vështirë kundër ideologjisë borgjeze dhe rrymave të revizionizmit modern. Në këto situata, t'i frymëzojmë mirë organizatat-bazë dhe të mos harrojmë pranimin në Parti të elementëve punëtorë. Mundet që stazhin të mos e ndryshojmë tani për tani, por në praktikë të mos harrojmë çështjen e pranimin të punëtorëve, forcimin e orga-

nizatës-bazë. Jetën e Partisë ta shohim në dinamikën e saj.

Në këto çështje, një rol të madh luan puna e Drejtorisë së Organizimit, e të gjitha drejtorive të tjera të aparatit të Komitetit Qendror dhe veçanërisht seksionet e organizimit në komitetet e Partisë. Ato tani kanë fituar një eksperiencë të madhe, por duhet të themi, se këto seksione, sekretarët që merren me çështje organizative, si dhe sekretarët e tjerë të komiteteve të Partisë, duhet të largohen nga një punë rutinë, burokratike statistikore. Kam përshtypjen se tani seksionet e organizimit kanë përmirësuar metodën e punës dhe kanë disa rezultate. Po kjo nuk është e mjaftueshme. Ato duhet të thellohen më shumë në punën e tyre dhe ne duhet të mendojmë se si të shfrytëzohen më mirë nga ana e tyre materialet që kanë të bëjnë me çështjet e jetës së Partisë, siç janë, protokollet, kartoteka e Partisë etj., se si t'i bëjmë shokët e këtyre seksioneve që të mos jenë burokratë, të presin vetëm sa të regjistrojnë ndonjë të dhënë që u shkon dhe shumë rrallë ose kur u kërkohet të nxjerrin ndonjë studim, që edhe ky shpesh nuk është i plotë. Me sa duket, te këta shokë nuk është rrënjosur si duhet një koncept i drejtë për detyrën e tyre dhe të kenë një plan të studiuar pune, t'i ngrënë probleme udhëheqjes etj.

Metoda e punës ka rëndësi të madhe. Ta zëmë se një shok shkoi në Durrës me shërbim, e caktoi Partia të ndihmojë e të kontrollojë, prandaj, për t'u vënë në dijeni të gjendjes së organizatës, lexoi materialet kryesore dhe të veçanta për këtë rreth. Por nuk është e tëra kjo, pse kemi të bëjmë me një organizatë rrethi dhe

me njerëz. Materialet që u studiuuan, mund të mos jenë të mjaftueshme, pra duhet të shkohet medocemos edhe në organizatat-bazë, ku të merret takim me komunistët, të njihen njerëzit dhe mentalitetet e tyre. Mirëpo një mbështetje për një qëllim të tillë në aparatet e komiteve të Partisë nuk e kemi, sepse kartotekat kanë dokumente individuale, që pasqyrojnë jetën e çdo komunisti me të mirat dhe me të metat e tij, pavarësisht se në mbajtjen dhe në zhvillimin e tyre ka dobësi. Mund të kërkohet, për shembull, biografia e një shoku, por kjo s'mjafton. Prandaj a nuk do të ishte me vend që të mendohej për krijimin e ndonjë dosjeje ose libri për historikun e çdo organizate-bazë? Po çfarë mund të kishte në këtë dosje ose libër?

Spektori i organizimit pranë komitetit të Partisë të bëjë një studim mbi jetën e organizatës-bazë. Në qoftë se nuk kemi të dhëna që nga krijimi i saj, këtë ta bëjmë duke filluar që tani, domethënë, të shënohet gjendja, shtrirja, forcimi i saj, anët e mira, heroizmat e komunistëve, tarafe, qëndrime të padrejta, tendenca të ndryshme që janë manifestuar, si vjedhje, mashtrime etj. dhe këto jo vetëm nga ana statistikore. Të dihet që në këtë organizatë ka pasur këto sëmundje, të shënohen cilat janë zhdukur, cilat vazhdojnë.

Për shembull, kooperativa bujqësore e Shtërmenit ka të ardhura të mira, anëtarët rrojnë mirë, po si është zemra e kooperativës, organizata-bazë, këtë si do ta dimë? Ose, organizata-bazë e Hotit s'ishte në pozita të shëndosha për krijimin e kooperativës bujqësore, kurse tani është bërë një organizatë shumë e mirë, po si do ta mësojmë një gjë të tillë? Mund të lindin edhe më vo-

në një organizatë tendenca të ndryshme, prandaj kur t'i kesh të dhënat, atëherë je i përgatitur dhe di se si t'i shtrosh çështjet, sipas kushteve të çdo organizate.

Në këtë mënyrë do të jepet pasqyra e jetës së organizatës. Atje të shënohen, gjithashtu, edhe karakteristikat e disa komunistëve më të vjetër dhe kuadrove kryesorë. Të gjitha këto, kur të shkojë një i ngarkuar në mbledhjen e organizatës, do t'i shërbejnë shumë, se do të njohë të kaluarën e organizatës, si edhe gjendjen e tanishme etj. Edhe vetë sekretari i komitetit të Partisë të rrethit duhet të njihet me materiale të tilla për organizatën ku shkon. Kur të kthehet nga zona, përveç atyre që do t'i thotë byrosë për ato që pa dhe për punën që bëri, duhet të ketë edhe vetë një bllok, në të cilin të shënojë karakteristikat e punës, të shfaqjeve e të gjendjes së organizatës ku ishte, si dhe disa tendenca që janë dukur te ky ose ai komunist. Për këto gjëra duhet t'i referohet edhe seksionit të organizimit. Kështu, çdo njeri i interesuar ka mundësi të informohet duke lexuar një pasqyrë reale të së kaluarës e të gjendjes aktuale të organizatës. Shefi i organizimit ka pikëpamjen e vet mbi ato që i kanë dhënë të deleguarit dhe i vendos në dosjen e organizatës, i shkruan në librin e saj ose i shënon në kartën e çdo komunisti. Pikëpamjen e vet e thotë edhe instruktori që ka atë organizatë-bazë në zonën e vet. Të tilla materiale do t'u shërbejnë sekretarëve të komiteteve të Partisë si orientim për punën e tyre.

Po ç'mund të nxjerrim nga kjo punë? Shumë gjëra. Për shembull, si shkojnë pranimet në një organizatë, nëse pranohen gra dhe sa pranohen. Ose mund të shi-

kohet çështja e mäsave, e shlyerjes së tyre, si qëndrojnë ata që janë përjashtuar nga Partia. Nga këto të dhëna udhëheqja mund të nxjerrë konkluzione dhe detyra. Mbajtja e një libri ose dosjeje për organizatat-bazë nuk duhet të shtojë punën burokratike. Ky libër duhet të jetë si një ndihmës i pasqyrës së përgjithshme të gjendjes së organizatës së Partisë dhe jo vetëm si historik, të jetë një libër i veçantë për të treguar, për shembull, përbërjen e organizatës-bazë, luftën, kapacitetet, perspektivat e saj, në mënyrë që kur shkon në organizatë për të dhënë një direktivë, e di ku vete, e di kë ke përpara, e di si ta shtrosh çështjen. Prandaj të gjitha këto kanë rëndësi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
taritit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

T'I BËJMË STUDENTËT TË NDERGJEGJSHËM PËRSE MËSOJNË DHE SI TË MËSOJNË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1964

Puna me studentët ka një rëndësi të madhe. Partia dhe organizata e rinisë në universitet duhet të punojnë seriozisht për edukimin e tyre. Në vija të përgjithshme çështjen e edukimit të studentëve ne e shtruum edhe në Plenumin e Komitetit Qendror të Partisë, që u zhvillua në korrik të këtij viti. Por organizatat-bazë të Partisë, veçanërisht ato të rinisë, duhet të punojnë edhe më mirë për të edukuar një rini revolucionare dhe të zjarrtë, me dashuri të madhe për mësimin dhe për punën. Kjo çështje duhet t'ju preokupojë seriozisht ju, shokë të Komitetit Qendror të BRPSH, se keni shumë të meta në këtë drejtim.

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të Komitetit të Partisë të Universitetit të Tiranës mbi punën mësimore-educative me studentët.

Para se të flas për universitetin, mund të them se edhe në shkollat e tjera, veçanërisht në klasat e larta të shkollave të mesme, organizatat e rinisë në punën e tyre lënë shumë për të dëshiruar. Kjo çështje duhet parë seriozisht. Jam në dijeni se në këto shkolla mbledhjet e organizatës së rinisë nuk zhvillohen vazhdimisht, të rinjtë nuk para venë në to. Te nxënësit e klasave të larta të shkollave të mesme duken prirje për njëfarë pavarësie. Unë e kuptoj se të rinjtë e kësaj moshë duhet të jenë të pavarur, po kjo s'duhet të arrijë deri aty sa këta të mos bëjnë pothuajse fare pjesë në organizatën e tyre të rinisë. Teserën e rinisë e kanë, e duan dhe e mbajnë me kujdes, po fakti është se mjaft prej tyre nuk shkojnë as në mbledhje. Mirëpo, duke mos shkuar në mbledhje, mbeten jashtë influencës së edukimit nga ana e Partisë dhe kështu lindin disa shfaqje të huaja në radhët e tyre, bile edhe te fëmijët e familjeve me përbërje të mirë. Prandaj puna e organizatave të Partisë dhe të rinisë duhet të forcohet që në klasën e parë të shkollës së mesme, kur te të rinjtë fillon të ketë njëfarë pjekurie, ndryshe do të kemi vësh-tirësi më vonë për ta edukuar të riun ashtu siç kërkon Partia, pavarësisht se është nga një familje e mirë.

Në përgjithësi, i riu 16-17-vjeçar nuk interesohet të lexojë gazetën «Zëri i rinisë». A e shikoni ju këtë çështje? Pse nuk shtrohet ky problem në mbledhjen e organizatës-bazë të rinisë të klasës, e cila të caktojë detyra që gazetën ta lexojnë të gjithë anëtarët e organizatës, ta diskutojnë dhe të vendoset që të rinjtë, kur është nevoja, të bëjnë edhe mbledhje rreth problemeve që trajton gazeta? Kërkesa të tilla do ta bëjnë anëtarin e

organizatës së rinisë që jo vetëm të marrë gazetën, por edhe ta studiojë e të përfitojë prej saj. Me sa di unë, të rinjtë janë dhënë pas leximit të gazetës «Sporti popullor», të cilën e lexojnë me një zell të madh dhe dinë të thonë deri dhe sa gola ka shënuar ky apo ai lojtar. Unë nuk them që të rinjtë të mos e lexojnë gazetën «Sporti popullor», por në radhë të parë ata duhet të lexojnë gazetën «Zëri i rinisë».

Ne kemi një rini të pastër, po të mos harrojmë se çështja e edukimit të rinisë studenteske dhe e intelektualëve ka një rëndësi të madhe. I kemi theksuar edhe hcrë të tjera disa shfaqje intelektualiste, po nuk gabojmë kur i përsëritim, me qëllim që t'i mbajmë mirë parasysh. Tendencat e intelektualëve janë analizuar nga marksistët e mëdhenj, prandaj as intelektualët tanë nuk mund të përjashtohen nga këto tendenca. Cilat janë disa prej tyre?

Mosinteresimi i pedagogëve për punën me rininë jashtë orës së mësimi, është një tendencë pothuaj e përgjithshme e intelektualëve. Ka në universitet që thonë: «Unë jam pedagog, punën time e njoh, prandaj de-tyra që kam është të vete në shkollë dhe si të bëj mësimin, të iki». Me një fjalë, bëhen përpjekje të pakta dhe ka mendjemadhësi, duke u nisur nga mendimi se «unë jam pedagog». Kjo tendencë të çon në tërheqjen para vështirësive, në zbutjen e luftës kundër armiqve të klasës, kundër imperializmit, revizionizmit etj., të çon në një individualizëm dhe shkëputje graduale nga jeta. Kjo shkëputje graduale bën që pedagogu të jetë indiferent ndaj çështjeve me interes shoqëror, bën të krijohet tek ai psikoza se i jep rinisë vetëm dituri, është

më superior nga të gjithë, prandaj të trajtohet më mirë nga të tjerët dhe të gjithë të kenë respekt të veçantë për të, të gjithë të zbatojnë mendimet dhe porositë e tij!

Kundër këtyre tendencave intelektualiste ne duhet të luftojmë dhe të mbajmë gjallë frymën revolucionare patriotike që karakterizon rininë tonë. Të mos harrojmë se armiku punon shumë në këtë drejtim. Ai synon të nxitë edhe shfaqje intelektualiste e t'i zhveshë njerëzit nga fryma revolucionare. Vetë çështja e shkencës, e diturisë që u jep pedagogu studentëve, me format e zhvillimit të kësaj pune, krijon tek ai idenë e krahasimeve. Pedagogu e di kush i ka shpikur këto ose ato gjëra në fushën që është specializuar vetë e si po zhvillohen më tej ato në vendet e tjera, pasi atij i bien në dorë materiale të ndryshme që flasin mbi këto përparime në fushën e shkencës dhe të teknikës në botë. Në këtë mënyrë ai mund të formojë edhe ndonjë pikëpamje të gabuar, duke thënë se ne në Shqipëri jemi prapa. Kjo, aq më tepër në imagjinatën e ndonjë të riu, mund të krijojë iluzione politike se në vende të tjera jetohet mirë. Prandaj, në qoftë se Partia nuk punon në rrugë të drejtë, ndonjëri do të rrëshqasë, se ai nuk e gjykon këtë nga ana klasore, nuk mendon se kush i përfiton të mirat në vendet kapitaliste, sepse pak futet në luftën e klasave, për shkak se puna jonë nuk e mban në një tension të vazhdueshëm e të shëndoshë revolucionar.

Edukimi i rinisë në universitet varet, në radhë të parë, nga puna e Partisë dhe e rinisë, e cila duhet të ngrihet me të gjitha forcat që nxënësit të mësojnë seriozisht, të mos thonë si disa që «neve na mjafton ve-

tëm një tresh», sepse tendenca e intelektualizmit është vetëm të fitojë një dituri, që ta ketë sa për të dalë mbi të tjerët, sa për t'u quajtur si person me arsim të lartë, pavarësisht se universitetin mund ta mbërojë me të gjitha notat tresha. Koncepti i të kënaqurit me pak është shumë negativ. Në universitet, midis studentëve, duhet të ketë më shumë sedër dhe konkurrim për të fituar dituri dhe për ta vënë atë në shërbim të popullit. Nuk është e drejtë të mendohet vetëm sa për të marrë diplomën, pa s'prish punë se del i çalë në teori dhe me përgatitje të dobët për jetën.

Shfaqje tjetër negative është edhe dëshira e disave që duan të punojnë atje ku dëshirojnë ata dhe s'marrin parasysh nevojat e mëdha të atdheut dhe të shoqërisë. Që këtë fillon edhe edukimi jo i shëndoshë i të rinjve nga ana e organizatave të Partisë e të rinisë. Prandaj rinia universitare duhet t'i futet mësimi me zell të madh dhe të dalë me nota jo sa për të kaluar, por të punojë për ta zotëruar lëndën. Në qoftë se studenti lufton për të zotëruar lëndën, atëherë ka marrë edhe notën e mirë. Nga kjo bazë duhet të fillojë përvetësimi i lëndës, asimilimi i saj, prandaj nota e mirë t'i shërbejë studentit që dituria e marrë të vihet në shërbim të shoqërisë dhe jo për të kënaqur egoizmin personal, tendencë kjo e rrezikshme tek intelektualët.

Çështja është që Partia dhe organizata e rinisë ta forcojnë më tej punën me nxënësit dhe me studentët, që këta të jenë të ndërgjegjshëm përse mësojnë, si të mësojnë dhe për cilin mësojnë. Kjo duhet t'i udhëheqë ata në radhë të parë. Për këtë qëllim është e domosdoshme që të punojnë më mirë organizata-bazë e Partisë si

edhe organizata e rinisë. Me edukimin e studentëve duhet të merren në radhë të parë pedagogët, sidomos ata pedagogë që janë komunistë. Pedagogëve Partia u ka besuar edukimin e brezit të ri. Këtë punë me rininë pedagogët mund ta bëjnë mirë, kur studentët të venë të përgatitur qysh më parë nga organizata e rinisë, duke filluar nga klasa e parë e shkollës së mesme, në mënyrë që të rinjtë të jenë të brumosur mirë politikisht dhe ideologjikisht. Në këtë drejtim sot ka akoma të meta, pasi edukimi i gjithanshëm bëhet i zbehtë dhe i cunguar edhe në universitet.

Djemtë dhe vajzat që venë në universitet, mendoj se janë plotësisht të pjekur ta mësojnë teorinë marksiste-leniniste. Mundet që marksizëm-leninizmi në universitet të mos zhvillohet si në Shkollën e Partisë, por duhet të zhvillohet më gjerë se ç'zhvillohet sot për sot. Kështu, për shembull, mund të bëhen leksione me probleme të kohës dhe të përshtatshme për rininë. Këto leksione mund të jenë për probleme shoqërore, politike, ideologjike, të ilustruara nga jeta në vendin tonë dhe jo thjesht teorike. Edhe punë teorike të zhvillohet me rininë, por kjo të bëhet e lidhur ngushtë me praktikën, me jetën. Disa shfaqje të huaja të rinjtë ne duhet t'i mbytim që kur janë fillestare, por këtë ta bëjmë në rrugë të drejtë, jo me rrugë administrative, por në radhë të parë me anë të edukimit politik e ideologjik, duke zhvilluar leksione interesante.

Te të rinjtë ka disa probleme të veçanta, siç janë ai i dashurisë, i martesës, i muzikës etj., etj. Partia duhet të dijë çfarë gjëra jo të shëndosha zënë vend në diskutimet dhe në bisedimet e rinisë universitare për

probleme të tilla dhe në përputhje me këtë të ndërtohet edhe puna politiko-edukative e saj. Mbledhjet me tema të tilla të jenë të ilustruara me shembuj nga jeta, që të ngjallin interes të rinjtë. Kur t'u flasim atyre, për shembull, mbi dashurinë, t'u drejtohem drejtpërdrejt, jo si jezuitët, vetëm duke moralizuar. Prandaj mbledhjet për diskutimin e problemeve shoqërore, siç janë dashuria dhe martesja, të përgatiten si duhet, konkretisht, në bazë të ideologjisë dhe të moralit proletar. Ne jemi për dashurinë e sinqertë, që është baza e martesës për krijimin e familjes së re. Por çështje të dashurisë, të martesës, të së bukurës etj. nuk mund të trajtohen lehtë, sidomos me rininë, tek e cila mund të influencojnë lehtë rrymat dekadente. Ne kemi ideologjinë tonë, sipas së cilës të japim shpjegime, por mbajmë parasysh edhe jetën tonë, kushtet e vendit tonë, traditat e popullit tonë.

Për çdo gjë ne nisemi nga ideologjia proletare dhe hedhim hapa përpara në përshtatje me kushtet tona. Ne duhet të ruajmë karakteristikat e bukura të popullit tonë edhe në fushën e krijimit të familjes. T'i shpjegohet djalit se kur lidh marrëdhënie me një vajzë dhe dashurohet me të, ai duhet të merret vesh edhe me familjen, sipas kushteve tona, por jo i nxitur nga pasionet e çastit, të martohet me vajzën dhe pastaj ta braktisë atë e menjëherë të dashurojë një tjetër. Prindërit nuk mund të lejojnë që vajza e tyre të kërkojë të lidhë jetën me një djalë që ka lënë tri-katër vajza të tjera. Jemi dakord që të rinjtë e të rejat të njihen mirë me njëri-tjetrin, por të mos harrojmë se jetojmë në Shqipëri, jemi shqiptarë, nuk jemi si në vendet borgjeze apo në

vendet e ish-demokracisë popullore ku shfaqjet e degjenerimit moral janë të zakonshme. Ne në Shqipëri do të zbatojmë drejt normat e moralit komunist edhe në fushën e dashurisë, të martesës e të krijimit të familjes së re socialiste.

Pra, ka gjëra të tilla që janë të domosdoshme t'ia shpjegojmë mirë dhe t'ia bëjmë të njohura rinisë, të frymëzuar nga vija e drejtë e Partisë, me qëllim që t'u dalim përpara rreziqeve që e kërcënojnë atë. Kjo kurdoherë është një përgatitje, se kalitja e vërtetë e studentit do të bëhet kur të mbarojë universitetin, kur të dalë në jetë, kur të shkojë në minierë, në zonën e malësisë etj. dhe atje të ndeshet me vështirësitë, të marrë takim me popullin dhe Partinë. Në jetë, pra, ai do të kalitet më shumë dhe do të kuptojë çdo gjë mirë e më mirë. Kjo është rruga jonë.

Rinia jonë është e gëzuar, punëtore, e ndershme, me fantazi të zhvilluar. Këto cilësi t'i ruajmë e t'i zhvillojmë, se janë thesare, po kurdoherë t'i kanalizojmë në rrugën e proletariatit, të Partisë. Po si do t'i ruajmë e do t'i zhvillojmë këto cilësi, mos vallë me rrugë administrative? Jo, edukimi i rinisë me politikën dhe me ideologjinë e Partisë, duhet të bëhet me metodën e bindjes, kjo është kryesorja.

Rinia jonë është e pastër si kristali, po të mos harrojmë se edhe kristali thyhet, prandaj edhe pastërtinë e rinisë ta ruajmë, po edhe të punojmë që rinia të mos thyhet. Kjo kërkon që Partia t'i qëndrojë afër rinisë, ta bindë për çdo gjë me vijën e saj të drejtë, pse i riu është revolucionar. Në qoftë se ti i thua të riut diçka që nuk është e përshtatshme për moshën e tij, ai

kthen rrugën, zemërohet. Por anëtari i Partisë është më i pjekur dhe me eksperiencë, prandaj duhet të kuptojë edhe veçoritë dhe kërkesat e atij që është i ri. Në fazën e rritjes së të riut, ka momente psikologjike që duhen mbajtur parasysh. Kur do të bisedosh diçka me të, duhet të gjesh rastin dhe me mënyrën më të përshtatshme, ta bindësh dhe ta tërheqësh drejt, që ai të zhvillohet e të lulëzojë si një filiz i drejtë, i shëndetshëm. Kjo është një punë delikate dhe me rëndësi, po e domosdoshme të bëhet nga Partia.

Për universitarët tanë këto çështje duhet të bëhen objekt i një studimi të përditshëm, duke përdorur format dhe metodat më të përshtatshme të punës. Kemi të bëjmë me universitarë, që janë të rritur, me kulturë dhe dituri. Për edukimin e tyre dhe të intelektualëve duhet të aktivizohen njerëz të zotë, të vendosur, të përgatitur mirë dhe me intelekt, të cilët, kur të flasin para studentëve, t'u ngjallin interes që këta të vijnë e t'i dëgjojnë me qejf dhe me qëllim që të përfitojnë. Në qoftë se studentët nuk vijnë në mbledhje, kjo do të thotë se ata që flasin para tyre, nuk përgatiten mirë, mbledhjet nuk bëhen për probleme që u interesojnë të rinjve, ose trajtohen çështje që nuk i përshtaten kohës.

Ne nuk duhet të alarmohemi për ndonjë shfaqje të huaj që ka në universitet, por nuk duhet as ta nënvleftësojmë çështjen, por të veprojmë në rrugë të drejtë. Është fakt se në universitetin tonë kemi brumë shumë të mirë. Por kur bëhen vërejtje e jepen këshilla si këto që përmenda, nuk do të thotë se atje puna është përtokë. Në universitet ne kemi njerëzit e Partisë, rininë e kemi shumë të mirë, po duhet ta forcojmë pu-

nën edhe më shumë e të punojmë më tepër edhe me pedagogët.

Ju, shokë të universitetit, duhet të kuptoni drejt edhe çështjen e titujve shkencorë. Pedagogët janë të shumtë, një pjesë e tyre do të punojnë për të marrë edhe titujt, por çështja është që të gjithë të kualifikohen. Detyra e pedagogëve është të mësojnë vazhdimisht, të mos kënaqen me ato që kanë mësuar, të zhvillojnë e të thellojnë njohuritë e tyre, jo vetëm çdo vit, por çdo orë. Duke punuar kështu, atëherë pedagogu do ta bëjë edhe më tërheqëse orën e mësimit. Detyrat që kryen pedagogu i universitetit jashtë këtij institucioni, ndihmojnë, por detyra kryesore e pedagogut është në radhë të parë në universitet, prandaj këtu ai duhet të përqendrojë të gjitha forcat, që të kualifikohet vazhdimisht dhe të punojë me pasion për edukimin revolucionar të rinisë.

Ju uroj suksese në punë!

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NUK DUHET TË LAKMOJMË PËR NUMRIN E DISKUTIMEVE, PO PËR CILËSINË E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1964

Në relacionin që na është paraqitur, organizata-bazë e Partisë e Degës së Punëve të Brendshme në rrethin e Korçës përmendet për keq, pse «ka marrë në shqyrtim problemin e pronës socialiste»! Më duket se shqyrtimi i këtij problemi nga ana e kësaj organizate është i drejtë, sepse me këtë rast u jepet punonjësve të degës eksperiencë se si punon armiku, ç'metoda përdor ai për të dëmtuar ekonominë tonë, zbulohen dobësitë që ekzistojnë dhe ndihmohet që këto dobësi të zhduken, ndryshe prapa tyre fshihet armiku, i cili gjen rast të vjedhë, të djegë dhe të dëmtojë pasurinë socialiste. Prandaj, veprimi i kësaj organizate-bazë që diskutoi

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa çështje të punës së komiteteve të Partisë të ndërmarrjeve, kooperativave bujqësore dhe të institucioneve.

mbi pronën shoqërore, të mos quhet gabim, përkundrazi, një punë e mirë. Kjo do t'i shërbejë forcimit të punës sonë në drejtim të mbrojtjes së pronës shoqërore, sidomos atje ku ka shturje e pakujdesi. Nga ana tjetër, Dega e Punëve të Brendshme, merr masa për të forcuar punën e vet, për të zbuluar veprimtarinë e elementit armik, që orvatet të na dëmtojë edhe në sektorin ekonomik.

Po kështu, në relacion, thuhet në një vend se «në kooperativën bujqësore të Libonikut bëhen mbledhje të shpeshta me të gjithë komunistët edhe pse këtu ka komitet partie». Mendoj se mbledhje të komunistëve mund të bëhen, varet nga problemet që preokupojnë Partinë. Natyrisht, kjo s'do të thotë që për çdo gjë të zhvillohet mbledhja e të gjithë komunistëve, por ndonjëherë do të ketë edhe mbledhje të tilla, kur shihet e nevojshme.

Këtu u ngrit çështja se në organizatat-bazë të Partisë diskutojnë vetëm disa. Sigurisht, është mirë të diskutojnë të gjithë, po kryesorja është të diskutohet mirë, kjo ka rëndësi. Organizatat-bazë t'i rrahin çështjet si duhet, se të gjithë në organizatë mund edhe të mos flasin. Mund të flasin pak komunistë e megjithatë të merren vendime të drejta e të organizohet kontrolli i zbatimit të tyre.

Çështjen e diskutimeve të mos e shohim nga pikëpamja numerike dhe të kënaqemi duke thënë se «kjo mbledhje që e mirë se diskutuan, për shembull, njëzet veta». Ndodh që diskutojnë shumë si numër, por një pjesë e diskutimeve janë kashtë. Neve na intereson që diskutimet të jenë të mira, me brumë që në organizatat-

-bazë të ketë njerëz të tillë, të cilët, kur konstatojnë se një shok nuk është në rrugë partie, të ngrihen, ta kundërshtojnë dhe të shfaqin mendimin e tyre për të zgjidhur sa më drejt problemin. Kur në mbledhje të organizatës-bazë bëhen qoftë edhe pak diskutime që të mobilizojnë, që kritikojnë në rrugë partie, kjo mund të jetë e mjaftueshme, se nuk është e domosdoshme të diskutojnë të gjithë, por kur nuk flet asnjë, mbledhja bëhet e mërzitshme. Ne nuk duhet të lakmojmë për numrin e diskutimeve, po për cilësinë e tyre.

A do të themi që ky shok nuk ka diskutuar asnjëherë në organizatë? Natyrisht, do të themi, do të nxisim që shokët të jenë aktivë. Por kjo duhet parë sipas rasteve, sepse ka komunistë që qëndrojnë në radhët e para, janë shembull në jetë dhe në punë, janë në rregull, janë komunistë të mirë, por s'para flasin. Të mos harrojmë se «nga guri me vrimë kemi kaluar të gjithë». Në fillim, kur vinte puna për të hapur gojën në mbledhjet e Partisë, të gjithëve na shkonin djersë. Këtë ta kujtojmë. Sigurisht tani komunistët e rinj janë më të zhvilluar e më të përparuar nga sa ishim ne atëherë, prandaj kanë edhe më shumë mundësi për të folur, por çështja është te cilësia e diskutimeve, kjo duhet ta preokupojë më tepër organizatën.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tarlatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

SIGURIMI I UJIT ËSHTË NJË PROBLEM I MADH JETIK PËR POPULLIN

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1964

Çështja e ujërave është problem i madh jetik për një popull, sepse ka të bëjë me sigurimin e ujit të pijshëm, me zbulimin e ujërave minerale dhe termale, me sigurimin e ujërave për nevojat e industrisë, për ujitje etj. Prandaj ky problem në Shqipëri ndoshta duhet të studiohet me imtësi, të ketë plane zbatimi të përcaktuara me afate të gjata dhe të shkurtra për plotësimin e nevojave me ujë të qyteteve dhe të fshatrave. Të dyja këto duhet të ecin paralelisht.

Për fshatin çështja e ujit është shumë e vështirë. Tani për tani të studiohet cilat fshatra kanë ujë të pij-

1 Një nga çështjet që u diskutua në këtë mbledhje ishte edhe ajo mbi veprimtarinë e organizatës-bazë të Partisë të Ndërmarrjes Hidrogjeologjike në Tiranë në drejtim të punës së saj me njerëzit.

shëm të rrjedhshëm, a e kanë të mjaftueshëm për numrin e tanishëm të banorëve, në cilat fshatra është i panjaftueshëm etj. Ne duhet, medoemos, t'u sigurojmë ujë fshatrave që s'kanë, po nga ç'vend dhe për sa kohë, kjo duhet studiuar e përcaktuar. Duhet të dihet me kohë se sa ujë i nevojitet këtij ose atij fshati, duke pasur parasysh perspektivën e rritjes natyrore të popullsisë dhe zhvillimin ekonomik. Të luftojmë që ta gjejmë ujët sa më afër dhe të mendojmë e të marrim masa për ta sjellë. Pra ky është një problem i madh. Krahas kësaj të vijmë edhe te çështja e ujërave për nevojat e industrisë dhe për qytetet, problem ky akoma më i rëndësishëm.

Për të gjitha këto probleme, Ndërmarrja Hidrogeologjike duhet të bëjë një punë më të organizuar. Detyrat e saj janë nga më të ndryshmet. I duhet herë pas here t'u vijë në ndihmë edhe dikastereve apo ndërmarrjeve të tjera, për probleme që u dalin. Këto probleme duhen studiuar për t'ia paraqitur Byrosë Politike dhe të procedojmë frontalisht për to. Nuk mund të krijojmë çdo gjë të plotë dhe menjëherë, po çdo vit t'i shtojmë forcat dhe të caktojmë ku duhet dhënë përparësi dhe ku nuk duhet dhënë. Ky është një problem i madh. Kështu si është organizuar puna tani në këtë ndërmarrje, nuk mund të ecet si duhet.

Për hidrometeorologjinë ne kemi një institut të tërë. Natyrisht edhe ky është i nevojshëm. Por shumë më tepër e nevojshme është çështja e ujërave, sepse ndërsa me hidrometeorologjinë studiojmë vetëm çështjen e reshjeve, punë edhe kjo e nevojshme dhe një shkencë e tërë, që na intereson, në radhë të parë, për bujqë-

sinë, edhe sigurimi i ujit për të pirë, për të ujitur si dhe për nevojat e fabrikave që ndërtohen etj. është domosdoshmëri. Prandaj të studiohen dhe të vendosim se si t'i zgjidhim më mirë këto çështje.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

ADMINISTRIMI I MIRË I DRITHIT KA RËNDESI TË MADHE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

15 shtator 1964

Mendoj se nuk ka nevojë t'u dërgohen rretheve material i veçantë për çështjen e drithit, por atyre t'u ritheksojmë detyrën që të zbatojnë me rreptësi vendimin e Byrosë Politike dhe urdhëresën e Qeverisë për këtë problem në të gjithë kompleksin dhe të mos harrojmë çështjen e kursimit të bukës në të gjitha format që u thanë edhe në këtë mbledhje.

Normat orientuese të konsumit të drithit janë caktuar. Këto norma janë të mjaftueshme dhe janë caktuar të tilla me qëllim që për drithin të tregohet një kujdes i madh, si për ekonomizimin e tij, ashtu dhe për

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi zbatimin e vendimit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror për shtimin dhe për administrimin e drithërave të bukës.

uljen e importit e kursimin e devizës. Kështu, popullit i japim bukë në sasi të mjaftueshme dhe njëkohësisht asgjë nuk shpërdorohet. Është më mirë që drithi të jetë në depot e shtetit, sepse kështu kemi mundësi të përballojmë më mirë situatat e ndryshme dhe nuk do të lejojmë të shpërdorohet buka.

Parulla armiqësore në këtë drejtim ka pasur dhe do të ketë, por Partia duhet t'i sqarojë fshatarët dhe të gjithë popullin se bukën e kemi të mjaftueshme. Është konstatuar se mjaft fshatarë vijnë për të marrë bukë në qytet. Kjo gjë mund të evitohet në qoftë se marrim masa për të hapur furra në fshat. Kur të ngrihen furra kudo, edhe në fshat, populli do të shohë se buka gjendet në dyqan në çdo kohë si në qytet dhe kështu te secili do të krijohet bindja se nuk do të mbetet pa bukë. Në këtë mënyrë do t'u jepet përgjigjja e merituar edhe parullave të armikut dhe rregullat nuk do të prishen.

Në qoftë se Mokrës ose Gorë-Oparit, për shembull, u mungon drithi i nevojshëm, duhet të përpiqen të realizojnë planin e mishit, të qumshtit, të mollëve etj. Nëse këto nuk i realizojnë dhe kanë pretendime që shteti t'i furnizojë me bukë, kjo nuk është e drejtë dhe tregon se organet e Partisë dhe të pushtetit atje nuk punojnë si duhet. Prandaj duhet të vihet rregull e organizim, që fshatarët e këtyre zonave të punojnë e të prodhojnë që t'i japin shtetit prodhime të tjera që dhe ai t'u japë drithë.

Kjo çështje, pra, duhet të kuptohet drejt dhe ndihma të jetë reciproke, prandaj këto gjëra u duhen shpërguar mirë fshatarëve. Në këtë drejtim, sidomos ju pu-

nonjësit e grumbullimit, duhet të jeni shumë rigorozë. Detyra juaj është të realizoni planin shtetëror të grumbullimeve, bile ta tejkaloni atë. Nga ky parim duhet të udhëhiqeni ju në punën tuaj, asnjë konsideratë tjetër nuk duhet t'ju bëjë t'i shmangeni detyrës. Prandaj zbatoni ligjet dhe urdhëresat dhe luftoni për të realizuar detyrat në frymën e kursimeve. Kjo është detyra juaj kryesore.

Rëndësi të madhe ka edhe administrimi i mirë i drithit nëpër depot. Të luftohen firot, dëmet nga lagështira, nga thatësira, nga minjtë etj., se mund ta grumbullosh bereqetin, po më vonë të të humbasë një pjesë.

Për sa i përket çështjes së vendimeve që merren për t'i dhënë nga shteti kaq apo aq kuintalë këtij apo atij rrethi, ju duhet të jeni të kujdesshëm dhe të luftoni me argumente kur shihni se një rreth u ka kërkuar Komisionit të Planit apo Qeverisë më tepër drithë. Kur rrethi i Rrëshenit, ta zëmë, ka kërkuar drithë tepër, duhet të ndërhyni që të mos i jepet aq sa ka kërkuar dhe këtë t'ua argumentoni Qeverisë apo Komisionit të Planit që do të vendosin se sa drithë do të japin.

Këto masa i marrim se jemi të detyruar nga gjendja aktuale e drithërave të bukës. Ne e dimë që sa më shumë bukë e nënprodhime të drithit t'i japësh popullit, aq më mirë është, por sot kushtet nuk na lejojnë të japim më tepër. Po të veprohet ndryshe, atëherë mund të vijnë momente që të dëmtohem shumë politikisht. Në qoftë se sot japim shumë e nesër të detyro-

hemi ta pakësojmë furnizimin, është më keq. Prandaj t'i shohim mirë këto çështje, me frymë partie, t'i gjykojmë politikisht. Çështja e bukës ka rëndësi shumë të madhe.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

REVIZIONIZMI MERR FORMA TË NDRYSHME — TË LUFTOJMË ME VENDOSMËRI KUNDËR TYRE

Shënime

15 shtator 1964

Nevoja e organizimit të luftës kundër revizionizmit modern në shkallë ndërkombëtare paraqitet urgjente më shumë se kurdoherë tjetër. Revizionistët modernë e kanë shumë frikë këtë dhe përdorin çdo mjet për ta penguar. Ata na akuzojnë ne si «përçarës», akuzojnë ata që luftojnë brenda në partitë e tyre si «shisionistë» «deviatorë», «dogmatikë», «bëjnë punën e armikut» etj., etj. Ata i përjashtojnë këta komunistë nga partitë duke i akuzuar si «renegatë», «tradhtarë», «përçarës», për të vetmen arsye se luftojnë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit.

Derisa revizionistët modernë ngritën krye kundër marksizëm-leninizmit, partive marksiste-leniniste dhe komunistëve revolucionarë, derisa ata shqelmuar normat leniniste të diskutimit dhe derisa «teoritë» e tyre antimarksiste kërkojnë dhe luftojnë me të gjitha mjetet dhe hapur që t'i rivendosin në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, duhet që nga marksistë-leninistët t'u shpallet atyre luftë e hapët, vendimtare, deri në shkatë-

rrimin e plotë e përfundimtar. Çdo hezitim nga marksistë-leninistët është i dëmshëm, çdo zvarritje e luftës me pretekste gjoja taktike është e dëmshme dhe çon ujë në mullirin e revizionistëve.

Revizionistët modernë, për të penguar luftën tonë të drejtë, përdorin shumë metoda. Në fillim, kur ata s'kishin dalë hapur me veprimtarinë e tyre, kundërshtimet ndaj marksizëm-leninizmit i quajtën «mosmarrëveshje me Partinë Komuniste të Kinës». Më vonë luftën e drejtuan nën parullat: «Konflikti sovjeto-shqiptar», «kundër dogmatikëve shqiptarë» etj. Pas një kohe të gjatë lufte me ne ata nxorën parullën «Konflikti sovjeto-kinez» dhe ne na cilësuan «gramafoni i Kinës», «sateliti i Kinës» dhe nga «agjentë të imperializmit» na bënë «agjentë të Kinës»!

Pra, konfliktin e madh ideologjik në mes marksizëm-leninizmit dhe revizionistëve modernë që po zhvillohet në shkallë ndërkombëtare në gjirin e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, revizionistët modernë përpigën ta kanalizojnë në «luftën kundër dogmatikëve në gjirin e lëvizjes komuniste», (lexo kundër marksistë-leninistëve).

Në këtë orientim që i dhanë revizionistët konfliktit u ndihmuan në radhë të parë nga një «numër dërrmues» i partive komuniste dhe punëtoresh të botës që udhëhiqeshin nga krerët revizionistë, të cilët u ndodhën solidarë me grupin tradhtar të Hrushovit, por edhe nga taktika e ndonjë partie që influencohej nga ideja e mosdaljes hapur në luftë, që ndiqte politikën «hapin e parë» ta hedhin ata, se kishte frikë se mos «na akuzojnë përçarës», e kishte njëfarë besimi se

mund të bisedohej me revizionistët, se mund të diskutohet me ta e të zgjidheshin disa gjëra etj., etj. Këta i shfrytëzonin momentet, por natyrisht kjo mori fund dhe dinamizmi i luftës sonë të drejtë dhe i rrugës tradhtarë të Hrushovit, qëllimi i tij që të mbyste luftën tonë sa më shpejt, të na nënshtronte, të na detyronte të kapitullonim, të gjitha këto i precipituan gjërat.

Por, prapëseprapë ato taktika «pritjeje» lanë gjurmët e tyre në partitë e tjera marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita të drejta, edhe akoma tash e kësaj dite mjaft nga këto parti s'po dalin hapur në luftë, ngurojnë dhe vazhdojnë edhe tani të dalin hapur, kur çdo gjë është e qartë mbi tradhtinë e hrushovianëve, kur vetë ata janë plotësisht të qartë për këtë tradhti dhe rrezikshmëri të tyre.

Revizionizmi modern, që ka për qëllim kryesor dhe të vetmin të sulmojë, të shkatërrojë, të degjenerojë marksizëm-leninizmin, synon në përçarjen e marksistë-leninistëve, të partive që qëndrojnë në pozitë marksiste-leniniste, që të mund kështu t'ia arrijë qëllimit të tij kryesor.

Grupi renegat i Hrushovit përpiqet të dominojë dhe ta drejtojë ai këtë luftë antimarksiste, pra, ai, në luftën kundër nesh përpiqet të ruajë edhe unitetin e revizionistëve, edhe dominimin mbi ta. Po kjo është e pamundur dhe sa kohë shkon, do të bëhet akoma më e pamundur, derisa të bëhet fatale për të. Revizionizmi në vetvete ka farën e përçarjes për revizionistët vetë, pse, pavarësisht nga qëllimi i tyre i përbashkët, ata janë antimarksistë, pa parime, ata janë borgjezë, nacionalistë, ata janë agjentë të kapitalizmit botëror, të ideolo-

gjisë borgjeze, kapitaliste. Prandaj uniteti i tyre është një iluzion. Ata do të degjenerojnë në nacionalistë borgjezë të thjeshtë dhe do të inkuadrohen në luftën kundër nesh, po me etiketa të ndryshme, me qëllime e taktika të ndryshme, me detyra e ambicie që do të sjellin fërkime çdo ditë e më të mëdha në mes tyre. Ata do të shiten tek ai kapitalist që i paguan më shumë dhe lufta e tyre do të përputhet e do të ketë të njëjtin përfundim me krizat dhe kontradiktat që brejnë kapitalizmin dhe socialdemokracinë. Ky proces ka filluar në gjirin e revizionizmit modern dhe është në zhvillim.

Blloku i ashtuquajtur «monolit» kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, Partisë Komuniste të Kinës dhe marksizëm-leninizmit brenda këtyre 4 vjetëve, është çarë nga lufta jonë e drejtë dhe e vendosur, dhe nga lufta e partive të tjera marksiste-leniniste dhe e marksistë-leninistëve në botë.

Imperializmi amerikan, me ndihmën e grupit të Hrushovit ka arritur ta dobësojë disi Bashkimin Sovjetik, ka lehtësuar punën e tij minuese, ka fituar disa baza e pika mbështetjeje për punën e vet intensive të mëvonshme. Kreditë dhe favorët që ai u bën Titos, Gomulkës, Kadarit, Zhivkos, kanë për qëllim jo vetëm që këta t'i bëjë për vete dhe të degjenerojnë vendet e tyre në vende kapitaliste, por që këta, duke u ndihmuar nga amerikanët të dobësojnë ekonomikisht edhe Bashkimin Sovjetik, të bëhen «të pavarur», të krijojnë kriza në Bashkimin Sovjetik, të bëhen partnerë të fuqishëm në KNER, t'i imponojnë edhe vullnetin politik grupit të Hrushovit, ta detyrojnë atë që, me kapitalet e huaja që hyjnë në Bashkimin Sovjetik, të gjunjëzohet përpara

imperializmit. Pra Amerika krijon dhe fuqizon agjunkturën në KNER, që këtë organizatë ta hedhë nën ndikimin e vet, që atje të arrijë të bëjë ligjin, të futet, pra, nga të dyja portat në Bashkimin Sovjetik për ta marrë kalanë nga brenda.

Futja e Titos në KNER, gjoja si vëzhgues, është njëkohësisht një siguri për partnerët e tjerë, se Hrushovi nuk do të mundë t'u imponohet dot. Kështu që miqtë e Titos në KNER duhet të qëndrojnë në këtë organizatë për të përfituar nga ekonomia sovjetike, për t'u forcuar vetë dhe për të dobësuar Bashkimin Sovjetik.

Grupi i Hrushovit ka hyrë në këtë ingranazh, ai s'mund të tërhiqet se i ikën koka, ai është i detyruar të bëjë lëshime. Zaret janë hedhur në këtë rrugë, portat i hapi tradhtia. Të gjithë imperialistët përpiqen të vendosin kapitale në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera të ish-demokracisë popullore në Evropë, përpiqen të krijojnë zonat e influencës politike, ekonomike, kulturore, përpiqen të krijojnë mbështetje në grupimet politike në këto vende. Ky proces ekonomik-politik është në zhvillim të plotë.

Tani, si e ndjek procesi ideologjik procesin e parë? A ecën me një hap, a koordinohet, a gjen pengesa, a ndjek të njëjtat qëllime? Ta analizojmë.

S'ka dyshim se që të gjithë revizionistët modernë do të ruajnë në përgjithësi parullat e përgjithshme të luftës kundër marksizëm-leninizmit, të formuluar në Kongresin e 20-të dhe të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, por çdo grupim sipas kushteve e nevojave të tij do të tjerë nuanca të ndryshme, interpre-

time të shumëllojta, që do t'i përshtaten shkallës së degjenerimit të shpirtrave që ka marrë në patronazh, do t'u përshtaten nevojave të shkallës së degjenerimit të vendit të tij, nevojave që rrjedhin nga aleancat me borgjezinë kapitaliste të huaj dhe frymës kozmopolite në përgjithësi. Pra, revizionizmi modern në format e tij do të ndryshojë dhe do të degjenerojë, duke ndjekur gjurmët e asaj ideologjie që e polli, por në brendinë dhe në veprimet e saj (të gjitha llojet dhe format që mund të marrin rrymat e ndryshme revizioniste), ajo mbetet dhe zhvillohet si një rrymë e egër antimarksiste. Lufta jonë kundër imperializmit dhe pjellës së tij, revizionizmit modern, do ta demaskojë këtë pa mëshirë; revizionizmi modern do të përpiqet të gjejë forma dhe stratagjema të reja për t'u shpëtuar demaskimit dhe shpartallimit nga ana e marksizëm-leninizmit, prandaj ne do të shohim dekompozimin e tij, shturjen, humbjen e forcës së gënjeshtres, humbjen e unitetit fals.

Grupi revizionist sovjetik do të jetë për një kohë akoma lidërshipi i revizionizmit modern, për arsye të potencialit shtetëror që e mbështet këtë ideologji dhe për arsye se e maskon këtë tradhti nën autoritetin e madh të Partisë Komuniste të Leninit. Imperializmit amerikan i intereson kjo situatë, sepse revizionizmi modern bën dëmin e vet në botën komuniste dhe kjo gjë mund të arrihet më shpejt kur bajraku mbahet nga grupi i Hrushovit. Por edhe sikur të dojë (dhe do) që të jetë ndryshe, nuk ka ç'bën. Duhet të punojë dhe punon në dizagregimin e autoritetit të Bashkimit Sovjetik nga çdo pikëpamje. Kjo strategji e imperializmit botëror ndaj autoritetit ideologjik të hrushovianëve për

minimin dhe për dobësimin e tij po zbatohet, me anën e Titos dhe të grupimeve të tjera revizioniste që futen javash-javash në shërbim të dy padronëve (Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik), si nga jashtë edhe nga vetë politika direkte e imperializmit ndaj Bashkimit Sovjetik.

Prandaj variacionet revizioniste, aleancat dhe zënkat në mes tyre do të diktohen nga kontradiktat e brendshme dhe nga imperativi i jashtëm i diktuar nga kapitalizmi botëror. Por kurdoherë si rryma dhe agjuntura të imperializmit, revizionistët modernë janë dhe do të mbeten, derisa të shkulen nga rrënjët, armiq të tërbuar të marksizëm-leninizmit, armiq të të gjitha atyre partive marksiste-leniniste që qëndrojnë në pozita të drejta, armiq të komunistëve revolucionarë, të patriotëve, të paqes, të lirisë së popujve, të socializmit dhe të komunizmit.

Grupi hrushovian do të luftojë për të mbajtur nën drejtimin e tij revizionistët e tjerë, t'i frymëzojë dhe t'i drejtojë këta, por ai nuk do të mundë, pse forcat e tjera aleate të tij po e grijnë këtë autoritet. Lufta e revizionistëve modernë kundër marksizëm-leninizmit nuk zhvillohet vetëm dhe thjesht në terrenin teorik, po zhvillohet edhe konkretisht në luftën për shkatërrimin e sistemit socialist në ekonomi, në kulturë etj. Prandaj revizionistët modernë synojnë, në aleancë me imperialistët, të shkatërrojnë vendet socialiste, që qëndrojnë në pozita të patundura dhe njëkohësisht luftojnë që teoritë e tyre të sjellin në vendet ku ata janë në fuqi reformat e dëshiruara prej tyre, domethënë vendosjen e kapitalizmit. Mirëpo pikërisht zbatimi i kësaj vije në vendet e ndryshme ku sundojnë revizionistët, nuk do të bëhet

uniform, pse do të haset në rezistencë të brendshme dhe të jashtme. Do të shtohen, pra, kontradiktat në zbatimin e kësaj vije tradhtare brendapërbrenda dhe në mes të njëri-tjetrit; kontradiktat e tyre me padronët, imperialistët e ndryshëm, do të shtohen dhe lufta jonë do t'i thellojë edhe më shumë këto kontradikta.

Aktualisht revizionistët modernë pa përjashtim, duke zhvilluar luftën ideologjike kundër partive tona, po bëjnë transformimet në partitë dhe në vendet e tyre drejt likuidimit të fitoreve socialiste. Këto procese po zhvillohen jo kudo njëlloj, jo kudo me një ritëm dhe jo kudo të drejtuara nga grupi sovjetik. Në këto procese kanë ndërhyrë tash shumë faktorë që gërryejnë unitetin e mendimit revizionist dhe të veprimit uniform. Grupi i Hrushovit përpiqet t'i ruajë këtë unitet dhe monopol drejtimi dhe veprimi, por forcat centrifugale po veprojnë, po vepron policentrizmi italian.

Policentrizmi italian, duke pasur kurdoherë në plan të parë luftën kundër nesh, dhe duke u hequr se gjoja ka gjetur metodën më të mirë të kësaj lufte, synon të shkatërrojë fuqinë dominuese, drejtuese, koncentruese të revizionizmit sovjetik, kërkon të shpejtohet procesi i degjenerimit politik, ideologjik, ushtarak, strukturor, të vendeve socialiste, kërkon (po këtë s'e pohon haptazi) që në vendet socialiste «të ketë më shumë liri» në parti (dhe këndeje të krijohen sistemet e shumë partive). Policentrizmi italian, pra, kërkon nga revizionistët e tjerë, dhe në radhë të parë nga sovjetikët, të japin shembullin (duke e humbur vendin e lidërshit) për ndërtimin e «socializmit» specifik në të gjithë botën, që do të thotë t'u vihet përballë marksizëm-leninizmit dhe

socializmit e komunizmit, një shartim i kapitalizmit botëror me socialdemokracinë. Që të bëhet kjo, dhe këtu revizionistët italianë janë nga më konsekuentët, duhet hequr dorë nga «autoriteti i një partie», nga lidershipi, duhet çuar deri në fund destalinizimi, duhet likuiduar «sistemi» që krijoi «kultin e Stalinit», duhen ndërruar kushtetutat etj., etj., pse vetëm kështu revizionistët modernë në vendet kapitaliste mund të marrin pjesë lirisht në parlamentet borgjeze dhe me anë reformash strukturore, me rrugën parlamentare ata mund «të ndërtojnë socializmin» tok me partitë e tjera «demokratike», demokristiane, socialiste etj. Ky është orientimi direkt i Palmiro Toliatit.

Imperializmi botëror, nëpërmjet policentristëve italianë, u thotë grupeve revizioniste që janë në fuqi se «në rast se duan t'u bëjnë ballë dogmatikëve, duhet t'i heqin frikën imperializmit nga socializmi stalinian dhe që atij t'i hiqet frika duhet të bëjnë transformime rrënjësore në vendet e tyre». Rrugë tjetër s'ka, thonë policentristët italianë. Revizionistët italianë u thonë shokëve të tyre në vendet socialiste se ata dhe të gjithë shokët e tyre revizionistë të vendeve kapitaliste janë në mes dy zjarreve.

«Nga njëra anë aleatët tanë kapitalistë (të maskuar në parti të ndryshme me etiketa demokratike) jo vetëm s'kanë besim te ne, në fjalët tona, në planet e në programet që shtrojmë ne, por me këto ritme që po ecni sidomos, ju, sovjetikë, po na prishni shumë punë. Aleatët e mundshëm s'po na qasin as te dera, pa le të futemi brenda.

Nga ana tjetër, vazhdojnë ata, ne po demaskohemi

çdo ditë nga marksistë-leninistët, po çahen partitë tonë, po krijohen parti të reja marksiste-leniniste, po krijohet rreziku i formimit të një internacionaleje të re marksiste-leniniste.

Ju, u thonë indirekt revizionistët italianë shokëve të tyre, që janë në fuqi në vendet ish-socialiste, keni fuqinë në dorë dhe kundërshtarët tuaj (marksistë-leninistët) i kapni dhe i fusni nëpër burgje e i pushkatoni, kurse ne s'e bëjmë dot një gjë të tillë». Prandaj Toliati, para se të vdiste, dha alarmin e kundërshtimit dhe të frikës, alarmin e pajtimit përfundimtar me kapitalistët, alarmin për marrjen e masave urgjente dhe rrënjësore për degjenerimin e tërë sistemit të socializmit dhe, pra, të zbatimit integral, pa humbur kohë, të vijës revizioniste që kanë proklamuar. Tendenca e revizionistëve italianë do t'u vijë për hosh revizionistëve të vendeve kapitaliste, pse ata s'humbasin gjë, por fitojnë ndonjë lëmoshë më të mirë nga kapitalizmi, të cilit ata i shërbejnë.

Por revizionistët sovjetikë dhe të tjerët në vendet e ish-demokracisë popullore, s'mund të jenë plotësisht dakord me italianët dhe aspak dakord me disa aspekte të vijës italiane, aspekte që kërkojnë «të zbutin pushtetin e tyre dhe të ndajnë këtë pushtet me të tjerët». Shpejtimi që kërkon Toliati në të gjithë gamën, i demaskon totalisht revizionistët e vendeve ish-socialiste, prandaj ata kanë planet e tyre, taktikat e tyre, ritmet e tyre. Çështja për ta, pra, sa vete po komplikohet, rëndohet, vështirësohet. Përçarje, mosmarrëveshje të reja u dalin, konflikte antagonistike po u lindin, në ta ka hyrë e po thellohet grindja.

Sovjetikët dhe revizionistët e tjerë të Evropës «socialiste» dhe Titoja brenda, natyrisht janë dakord me italianët për shumë gjëra dhe ecin në këtë drejtim, por midis tyre ka edhe kontradikta siç janë metodat e dezagregimit që propozon Toliati. Ky e ka parashikuar edhe këtë refuzim, prandaj kërkon të ketë disa qendra drejtimi dhe veçanërisht në vendet kapitaliste, sovjetikët të heqin dorë nga përpunimi direkt i drejtimit ideologjik, kulturor dhe deri në njëfarë shkalle të ndajnë me këta qendrat e tjera dhe ndikimin politik në to.

Me fjalë të tjera, «meqenëse ju nuk bëni si themi ne dhe nuk jepni shembullin që kërkohet, na lini të lirë dhe rehat të veprojmë ne në vendet kapitaliste dhe në vendet e reja që po çlirohen», thonë revizionistët italianë. «Ju bëni politikën e aleancave të mëdha, vazhdojnë ata, ju merruni me tregti, ju financoni ndërmarrje, po ideologjinë dhe sidomos mënyrën e ndërtimit të socializmit dhe marrjen e pushtetit me rrugën parlamentare në këto vende, na i lini neve, se rruga jonë s'është dogmatike, po liberale, elastike, e pastruar nga çdo mbeturinë staliniane, toleruese dhe socialiste në çdo pikëpamje, deri edhe te feja, lufta kundër së cilës nuk mund të bëhet siç theksojnë Marksi e Lenini e siç është vepruar te ju, në Bashkimin Sovjetik e në demokracitë popullore».

Pozitat e Polonisë janë të njohura në grupimin revizionist. Ato janë antisovjetike. Lidhjet e saj me Hrushovin janë bazuar në shantazhin reciprok. Ato në brendi janë dy shtete kapitaliste dhe marrëdhëniet e tyre të shumanshme janë ndërtuar në këto baza. Gomul-

ka vepron independent, ka lidhje të shëndosha me amerikanët, mban lidhje me sovjetikët për përfitime ekonomike dhe politike nacionaliste. Ai synon të rrëzojë prestigjin dhe forcën e Bashkimit Sovjetik, dominimin e grupit të Hrushovit, ai është dakord dhe me Titon në këtë drejtim.

Revizionistët polakë duhet të jenë, në thelb, më afër pozitive italiane për shumë arsye. Ata kanë qenë dhe janë antisovjetikë nga më të këqijtë, ata kanë pasur kurdoherë tendenca të theksuara shkëputjeje dhe «independence». Partia e tyre jo vetëm që është një bashkim i partisë komuniste me atë të socialdemokratëve, jo vetëm që krahu socialdemokrat në vend që të influencohej nga komunistët ka marrë rrugën e djathtë, por Partia Punëtore aktuale e Polonisë është «bashkimi» i një numri të madh grupesh që e bën atë një grupim «partish të ndryshme» që rrojnë nën një çati, që kanë cilado vijën e saj, kuadrot e saj, influencën e saj, zonat e veprimit të saj. Përveç kësaj, në Poloni kisha është bërë një forcë e madhe vepruese ideologjike dhe politike, pavarësisht se ajo nuk ka një parti zyrtare «demokristiane». Kështu, deri në njëfarë shkalle në Poloni janë bërë transformime «liberale» në parti, në rrugën që shprehet Toliati. Natyrisht, këtu influenca amerikane, angleze, franceze është e madhe e po forcohet. Ka mundësi që të bëhen edhe ndryshime në formë, por ndryshimi në fakt po zhvillohet drejt liberalizmit kapitalist. Natyrisht, polaku është dhe do që të bëhet një partner i keq dhe i rrezikshëm socialshovinist i grupit revizionist sovjetik. Çështja e mbrojtjes së kufirit Oder-Najse që përbën sot një lidhje sovjeteto-

-polake, me kalimin e kohës dhe me transformimin e aleancave, s'do të jetë më një «kapistall sovjetik për polakët». Lidhjet ekonomike me kohë do të dobësojnë ndikimin sovjetik revizionist mbi polakët.

E tillë është situata edhe në Hungari, me disa nuanca më pak të theksuara se të revizionistëve polakë, por Titoja punon në drejtimin e tyre dhe do t'i sjellë «në rrugën e dëshiruar».

Hungarezët kanë gjetur një rrugëdalje të atillë që i përngjet asaj të polakëve, por pa shumë grupime në gjirin e partisë. Partia e Punonjësve të Hungarisë është bërë dhe vazhdon të bëhet me tërë kuptimin e fjalës socialdemokrate. Ajo hapi portat e partisë dhe të shtetit nga të tëra anët dhe reaksioni e borgjezia në vend që të organizonin një kundërrevolucion tjetër me armë, bëri e po bën kundërrevolucion në paqe, në qetësi, pa zhurmë e ligjërata, vetëm mbahet një etiketë ose një tabelë gjoja komuniste. Çdo gjë tjetër zhvillohet në rrugën antikomuniste. Imperialistët dhe borgjezia janë të kënaqur nga Kadari. Ky ruan format me komunizmin, ruan «miqësinë (gjoja socialiste) me Bashkimin Sovjetik» dhe me të tjerët, po zemra i qëndron gjetiu, vepron në rrugën e vet, merr ndihma nga të dyja anët dhe s'bën fort zhurmë, derisa të përcaktohen më mirë pozitat e «Evropës Qendrore», pastaj ngre zërin «mëshari hortist dhe nagist». Me kishën hungareze marrëdhëniet po bëhen normale, ajo dalngadalë do të marrë forca, do të manifestohet si në Poloni dhe do të ndihmojë më mirë e më hapur në konsolidimin e pozitave «të demokristianizmit» që po bëhet aleat i kdaristëve dhe bile në kushte shumë më të favorshme se-

sa ato që «lyp Toliati nga papa i Romës» që s'ka për t'u pranuar as psalt në kishë.

Revizionistët bullgarë dhe çekë hëpërhë paraqiten «bastione» të Hrushovit.

Tendencat separatiste në Çekosllovakia u manifestuan në mënyrë serioze dhe kërcënuese për klikën në fuqi. Grupi sovjetik përfitoi nga kjo për të hedhur më mirë në dorë grupin e Novotnit, për ta bërë atë të bindur krejtësisht dhe ia arriti qëllimit përkohësisht. Novotni paraqitet i bindur e në një radhë me Hrushovin, tendencat sllovaqe separatiste hëpërhë heshtin, të shohim deri kur, por kjo aleancë dhe qetësi është e përkohshme, është koniunkturale, është diktuar edhe nga nevojat e ekonomisë, edhe nga frika e revanshizmit gjerman.

Revizionistët gjermanë duhet të jenë në kontradiktë të mëdha me të gjithë, por e kanë çapin të shkurtër dhe frymën të zënë.

Grupi revizionist i Ulbrihtit është në pozita të vështira, në pozita vartësie nga sovjetikët dhe nga të tjerët, ai nuk mund të manifestojë një vullnet të tijin, ai është i dënuar të hiqet zvarrë prej tyre. Ai bazat e veta s'i ka si të tjerët, partia s'është e fortë, revanshizmi, nacionalizmi, shovinizmi gjerman janë në kulm. Atje s'duan reforma, atje duan «të tërën dhe jo një pjesë». Por megjithatë Gjermania është pjesa më delikate e më nevralgjike për të gjithë revizionistët modernë. Ajo u ndreq ose u prish planet, u ruan maskën e demagogjisë, apo ua çjerr. Prandaj revizionistët gjermanë dhe vetë Republika Demokratike Gjermane janë «gurë shahu», janë «monedhë tregu» për revizionistët modernë

në pazarllëqet me imperialistët amerikanë, anglezë, francezë dhe me Gjermaninë e Bonit.

Të gjitha problemet kapitale politike, ideologjike, ekonomike, të mbrojtjes, të bashkekzistencës, të aleancave të ndryshme të revizionistëve modernë evropianë dhe të titistëve ziejnë në një kazan të tillë. Grupimet revizioniste që janë në krye të partive komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste grazhdin e kanë te sovjetikët (pra lidhen materialisht me ta), po zemrën dhe tendencat duhet t'i kenë me toliatistët. Toliati do që të ketë tri qendra të tjera, tri lidershipe: qendra italiane, qendra franceze, qendra spanjolle dhe tok me to të ndajë zonat e influencës, zonat e veprimit.

Partia Komuniste e Francës është e lidhur më fort me sovjetikët, për arsye të vetë përbërjes dhe të edukimit të ndryshëm të partisë, për interesa të mëdha «rublare» dhe pse ka frikë nga hegjemonia e Partisë Komuniste të Italisë. Prandaj ky grupim revizionist, me gjithë liberalizmin e tij dhe hapjen drejt aleancave me socialistët e fundi i fundit edhe me Dë Golin, kërkon të ruajë aleancën sovjetike.

Grupi revizionist spanjoll në emigracion po e humbet kredinë, ka degjeneruar. Pasionarja është në fund të jetës, ajo mbështeti Hrushovin në vijën dhe në planet e tij. Gjithë njerëzit rrëth saj mbahen me rubla, pra i shërbejnë klikës hrushoviane, por duhet të ketë shumë prej tyre që, duke u rezervuar, të mos u pritët «koromania sovjetike», sytë i kanë nga platforma e Toliatit, e vetmja që mund t'u sigurojë hyrjen në Spanjë dhe legalizimin e partisë, kombinimin e aleancave tradhtare me frankistët dhe reaksionin spanjoll.

Përveç kësaj rruge, sot për sot, ata s'shohin rrugë tjetër. Por derisa të jetë gjallë Ibarruri, ata nuk e kanë lehtë të lëvizin se mbeten rrugëve e pa bukë. Prandaj hëpërhë preferojnë jetën luksoze, llogjet e deklaratat skandaloze kundër nesh dhe revolucionarëve spanjollë, brenda dhe jashtë Spanjës.

Për hrushovianët dhe për toliatistët, grupet e tjera revizioniste në partitë komuniste e punëtore të vendeve kapitaliste s'kanë as peshë as vlerë. Ata shërbejnë për numër. Për toliatistët ata përbëjnë një rrezik, prandaj kërkojnë t'i marrin në patronazh të tyre, qoftë edhe si numër, për t'i pasur si kundërpeshë e për presion ndaj grupit sovjetik. Natyrisht, sovjetikët këtë gjë s'e pranojnë dhe s'do ta pranojnë kurrë. Prandaj kontradikta do të thellohet.

Partitë komuniste e punëtore që jetojnë në ilegalitet dhe që luftojnë, s'janë e s'mund të jenë me revizionistët. Krerët e tyre që rrojnë në emigracion, janë me ata që u japin të holla, ata kanë degjeneruar krejtësisht. Tendenca e hrushovianëve është që këta t'i nxjerrë në legalitet, t'i inkuadrojë në aleancë me krerët e borgjezisë që sundojnë në vendet e tyre, të bëhen shërbëtorët e tyre dhe demagogë revizionistë për të diskredituar marksizëm-leninizmin dhe socializmin e vërtetë.

Kjo është, sipas mendimit tim, panorama globale në vija të përgjithshme. Në këto situata ne do të luftojmë.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

TE MËSOHET MË MIRË GJUHA E HUAJ NË SHKOLLA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

16 shtator 1964

Në kushtet që jemi ne, në shkollat tona duhet të jetë i detyruar mësimi i një gjuhe të huaj dhe ajo të mësohet mirë nga nxënësit. Nuk jam i mendimit që në shkolla të kemi dy ose tri gjuhë të huaja të detyruara, sepse kësaj i thonë «shumë e për lumë». Mund të jetë një gjuhë e detyruar dhe tjetra të jetë fakultative, pasi kështu mendoj se është më mirë. Edhe gjuha e dytë na duhet, por duhet t'i kushtohet rëndësi në radhë të parë mësimi të një gjuhe të huaj nga çdo nxënës dhe këtë ai ta zotërojë mirë.

Ka rëndësi të caktuara se cilën gjuhë do të zgjedhim të detyrueshme për të mësuar, si edhe kohën kur

1 Në këtë mbledhje, përveç të tjerave, u diskutua edhe çështja e përmirësimit të mësimi të gjuhëve të huaja në shkolla.

duhet mësuar. Këtë duhet ta gjykojmë jo në mënyrë sentimentale, por duke e parë çështjen të lidhur me disa faktorë:

Së pari, rëndësi ka që gjuha e huaj t'u shërbejë nxënësve në jetë dhe t'u japë mundësi të zhvillojnë më tej njohuritë e marra në shkollë. Për këtë duhet të sigurohen librat e nevojshëm.

Së dyti, në shkollat tona të mësohet ajo gjuhë për të cilën kemi kuadro më të shumtë dhe më të aftë. Ky, pra, është një kompleks i tërë, që duhet parë. Kështu mendoj të studiohet kjo çështje.

Janë këta faktorë që ne duhet t'i kemi parasysh, t'i studiojmë, pastaj të vendosim se cila gjuhë do të mësohet në shkollë në mënyrë të detyrueshme dhe cila gjuhë si fakultative. Po të vihen tri gjuhë të huaja e të mësohen qysh në klasën e pestë, tani për tani kësaj s'ia dalim dot, sepse nuk do të kemi kuadrin përkatës, gjithashtu do të kemi edhe mungesa teknike e materiale.

Hapja e fakultetit të gjuhëve të huaja është e nevojshme. Të shikojmë mundësitë që kemi për pedagogë dhe ç'mund të bëjmë në këtë drejtim. Ky fakultet të përgatitë kuadro për mësues të gjuhëve të huaja: për anglisht, frëngjisht dhe rusisht. Gjuha e dytë, hëpërhë, do të mësohet vetëm në disa shkolla, atje ku kemi kuadrin përkatës. Kështu të zgjidhet ky problem.

Nxënësit tanë nuk i mësojnë si duhet gjuhët e huaja. Kjo vjen për shumë arsye, një nga të cilat është se vetë pedagogët nuk bëjnë shumë kujdes. Duhet të

shihet gjithashtu edhe çështja e provimeve, të forcohen kërkesat ndaj nxënësve, në mënyrë që ata t'i mësojnë sa më mirë gjuhët e huaja.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verballi i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TË AKTIVIZOHEN DISA GRUPE NJERËZISH PËR TË NDJEKUR PROBLEMET NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

16 shtator 1964

Në kooperativat bujqësore janë arritur suksese, janë vënë edhe rregulla, por në lidhje me çështjen e intensifikimit të bujqësisë dhe zbatimin e agroteknikës, probleme të rëndësishme këto, që kanë të bëjnë me ngritjen e mëtejshme të bujqësisë, kryesitë e kooperativave bujqësore mendoj se veprojnë në mënyrë primitive. Për këto probleme nuk ka ndarje punc në udhëheqjen e kooperativës, në mënyrë që të ndiqen me përgjegjësi të caktuar, për shembull, mbarëvajtja e ujitjes, e sistemit të tokave, e shërbimeve të tjera etj. Për të gjitha këto përgjigjet në përgjithësi vetëm kryetari i kooperativës.

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi punën e Partisë për zbatimin e vendimit të Plenumit të tetorit 1962 për intensifikimin e bujqësisë dhe detyrat për të ardhmen.

Nuk janë të rralla rastet që ndodh kështu: mbahen konferenca, shkojnë njerëzit në bazë për të dhënë direktivat e Komitetit Qendror, por në realitet, siç u tha këtu, shpeshherë ka formalizëm. Mendoj se detyrat që shtrohen herë pas here për bujqësinë, nuk do të kryhen si duhet, në qoftë se rreth kryesisë së kooperativës nuk do të organizojmë grupe të veçanta njerëzish, me një përgjegjës në krye nga shokët më të mirë të kooperativës, për t'u kujdesur që problemet të zgjidhen, fjala vjen, një grup të ndjekë sistemimin e tokave kurrizpeshku, një grup çështjen e mirëmbajtjes së kanaleve, tjetri të kujdeset për problemin e farnave, mbjelljen dhe kontrollin e parcelave etj., etj.

Në kushtet e tanishme, kur vjen puna që shtrohet një çështje, kjo mbetet si një detyrë e përgjithshme. Mund të themi se për këtë ose për atë problem kemi skuadra e brigada, caktojmë këto ose ato detyra. Kjo është e vërtetë, por udhëheqja e skuadrës dhe e brigadës ka nevojë për ndihmë e kontroll, në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror, të Qeverisë dhe të organeve të Partisë e të pushtetit në rreth. Mirëpo kryesia e kooperativës bujqësore ka probleme të veçanta për të cilat duhet vepruar konkretisht. Realizimi i këtyre detyrave nën përgjegjësinë e një grupi të caktuar kooperativistësh, me një nga shokët më të mirë në krye, që të jetë përgjegjës përpara kryesisë së kooperativës, mendoj se ka rëndësi, prandaj kjo anë e organizimit të punës duhet marrë në dorë. Rëndësi ka që përgjegjësit e grupeve të caktohen sipas prirjeve dhe aftësive. Për shembull, ai që është më i zoti për ujitje të ngarkohet në krye të grupit për ujitje; ai që interesohet

më shumë për çështjen e farnave, të vihet në krye të grupit për këtë problem, në mënyrë që udhëzimet e përgjithshme që jepen nga lart, t'i marrë, t'i studiojë, t'i zbërthejë, t'i zbatojë bashkë me grupin dhe të përgjigjet përpara kryesisë së kooperativës, e kështu me radhë. Kjo është një luftë e madhe që duhet fituar, sepse kështu si drejtohet sot në kooperativat bujqësore, pa një ndarje pune të organizuar mirë, pa krijuar grupe njerëzish me përgjegjësi për çdo problem, puna nuk mund të ecë si duhet.

Në kooperativat bujqësore kemi njerëz me rrogë, që janë përgjegjës për problemet financiare. Por për organizimin e punës me grupe nuk është nevoja të kemi njerëz me rrogë, po të kemi ndarje pune. Këtu do të duket vlera e këshilltarëve ose e teknikëve të bujqësisë që kemi në rrethe. Kur të vejë një nga këta, fjala vjen, nga Fieri në Mallakastër dhe të kontrollojë problemin e qilizmës në kooperativat bujqësore, do të dijë kujt t'i drejtohet për t'i kërkuar llogari, do të dijë t'u japë gjithashtu edhe nga eksperiencia e tyre. Kurse tani specialistët e rrethit i kërkojnë të gjitha nga kryetari i kooperativës, i cili e ka vështirë t'i bëjë dhe t'i dijë të gjitha gjërat. Po të ndahet puna më mirë, sigurisht përgjegjës kryesor prapë do të jetë kryetari, po përgjegjës do të jetë edhe ai që është i ngarkuar në krye të grupit për një problem të caktuar dhe gjatë punës për zgjidhjen e problemit vë në dijeni vazhdimisht edhe kryesinë e kooperativës, që di pastaj konkretisht se cila është gjendja dhe çfarë bëhet për këtë ose për atë problem. Prandaj them që udhëheqja e kryesisë së kooperativës sot është primitive, sidomos për pro-

bleme të mëdha të agroteknikës, ajo nuk shfrytëzon si duhet teknikën që kemi dhe atë që do të kemi në të ardhmen. Gjendja na detyron të punojmë në mënyrë më të menduar dhe të organizuar si duhet.

Kooperativat tona bujqësore, me bashkimin e tyre, janë bërë qendra të mëdha ekonomike, por disiplina në to nuk është e fortë si në fabrikë. Prandaj, po të mos krijojmë një formë të përshtatshme organizimi, nuk do të na shkojnë mirë punët edhe paskëta. Nga pikëpamja teknike ne jemi zhvilluar, përparime kemi pasur dhe kemi, po pa organizim nuk mund të ecim. Po ta bëjmë këtë ndarje pune, mendoj se do të ecim më mirë dhe këtë kemi mundësi ta bëjmë. Ndarja e punës rrit përgjegjësinë dhe u vë gishtin problemeve të mëdha. Prandaj mendoj ta shohim këtë çështje, se tani për çdo gjë në rreth thërriten kryetarët e kooperativave, por ata, sado të zotë që të jenë, nuk mund të jenë kompetentë për të gjitha çështjet dhe, kur ngarkohen me të gjitha, sa venë në fshat i harrojnë, prandaj dhe problemet ndiqen në përgjithësi.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verballi i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

NE SHQIPTARËT THEMI: ATIJ QË LUFTON MARKSIZËM-LENINIZMIN, BJERI KOKËS!

Nga biseda me ambasadorin e ri të RP të Kinës

18 shtator 1964

Pas përshëndetjeve të zakonshme, pasi i uroi mirëseardhjen mysafirit dhe e pyeti si e ndiente veten në Shqipëri etj., shoku Enver Hoxha zhvilloi me të një bisedë të ngrohtë miqësore:

Gëzohemi shumë që ju ka pëlqyer vendi ynë! Ai ka pësuar mjaft ndryshime në krahasim me të kaluarën, ka bërë përparime të mëdha, të cilat, tani që erdhët vetë, do t'i shikoni, siç thonë latinët *de vizu*, me sy. Kjo vlen më shumë sesa të dëgjosh ose të lexosh, sepse me sy shikon vetë çdo gjë, shikon krijimin dhe vetë krijuesit në punë e sipër, me të mirat dhe me të metat e tyre, shikon luftën që bëhet për ndërtimin socialist dhe luftën kundër të metave e dobësive. Do të shikoni gjithashtu te ne punën e madhe të Partisë në luftë me vështirësitë, do të ndieni miqësinë e sinqertë,

të thellë, marksiste, që ushqen populli ynë për popullin kinez.

Ne e kemi thënë edhe më parë që me ambasadorin dhe me njerëzit e ambasadës kineze në Shqipëri duhet t'i forcojmë më shumë lidhjet e kontaktet, t'i bëjmë ato më të shpeshta që të plotësojmë kështu atë boshllëk që na krijon largësia, të cilën duhet ta llogaritim. Në mes partive, shteteve dhe popujve tanë ka plot çështje për të diskutuar, prandaj shkëmbimi i mendimeve në mënyrë shoqërore është i nevojshëm. Nuk është e domosdoshme që kur njëri shfaq një mendim, tjetri të japë medoemos një përgjigje, aty për aty. Njeriu mund të japë edhe mendimin e tij personal, por ndoshta atë çështje ai duhet ta diskutojë edhe me shokët, sepse ka probleme që kërkojnë rrahje të gjerë mendimesh. Rëndësi ka që shkëmbimi i mendimeve të bëhet i shpeshtë, në mënyrë shoqërore. Ashtu sikurse bisedoni ju me shokët në ambasadë për problemet që ju dalin, kështu duhet edhe së bashku të bëjmë diskutime me njëri-tjetrin. Kur e biseduam këtë çështje me shokët Çu En Lai dhe Çen Ji, ata qenë dakord. Por mund të ndodhë që, kur diskutojmë, ndonjë çështje mund të jetë e drejtë, ndonjë tjetër mund të mos jetë e drejtë. Kjo sqarohet. Rëndësi ka që ne të njohim mendimet e njëri-tjetrit dhe pastaj të diskutojmë gjersa të gjejmë zgjidhjen e drejtë të problemit. Prandaj edhe ne, nga ana jonë, edhe ju, nga ana juaj, ta zbatojmë dhe ta zgjerojmë bashkëpunimin.

Ja, për shembull, unë kam një mendim, që më ra ndër mend pak më parë se të takoheshim së bashku. Është një mendim personal, që më lindi pasi dëgjova

në radio lajmin që Hrushovi i ka përgënjeshtuar deklaratat e parlamentarëve japonezë, duke thënë se nuk është e vërtetë që ai ka deklaruar se Bashkimi Sovjetik ka shpikur një armë të tmerrshme për të likuiduar gjithë njerëzimin dhe se ka kërcënuar një shtet të huaj. Tani, ky lajm duhet vërtetuar, si ka thënë Hrushovi e qysh e ka thënë.

Mendimi që më lindi është ky: po të ishim ne në vend të shokëve kinezë do ta kapnim menjëherë këtë përgënjeshtim të Hrushovit dhe, pa humbur kohë, do të përgënjeshtrojmë pjesërisht ato që kanë thënë socialistët japonezë për çështjet kufitare, do të mbanim mbi vete ato që kemi thënë për ishujt Kurile, do të thoshim se këtë çështje Hrushovi e ka ngritur në lidhje me japonezët, se Amerika ka folur për Okinavën. Ne do të thoshim se atë e kemi thënë, gjë tjetër nuk kemi thënë, ose do të gjenim një formë që të thoshim se ne nuk i kemi shtruar çështjet e kufijve ashtu sikurse thonë socialistët japonezë në deklaratat e tyre pas vizitës që bënë në Kinë. Kështu, duke sqaruar këto gjëra, ne hedhim poshtë propagandën që bën Hrushovi dhe ata që e pasojnë, të cilët sulmojnë Kinën me deklaratat e socialistëve japonezë, me qëllim që të fusin armiqtë në mes popullit kinez dhe popujve sovjetikë. Tani, siç mendoj unë, pas të dhënave që kemi, Hrushovi kërkon që konfliktin ndërkombëtar në mes marksistë-leninistëve dhe revizionistëve ta reduktojë në një konflikt për çështje kufitare, ai mundohet ta lokalizojë këtë konflikt të madh ndërkombëtar në një konflikt thjesht kufitar kino-sovjetik.

Ndoshta, ky mendim që shfaqet për këtë problem

është i parrahur mirë, por, duke u bazuar në faktin se jemi midis shokësh, ne i themi hapur ato që mendojmë. Hrushovi me këtë përgënjeshttrim bën dy gjëra: nga njëra anë mohon atë që ka thënë dhe, nga ana tjetër, i thotë opinionit botëror që japonezët po shpifin, po shtojnë gjëra të paqena. Mendimi im është që, meqenëse ai i mohoi ato që u ka thënë japonezëve, atëherë përse ne të mos sqarojmë si qëndron e vërteta, pavarësisht se socialistëve japonezë mund t'u vijë hidhur? Në qoftë se ata janë njerëz të mirë, do ta kuptojnë dhe në qoftë se janë të ligj, atëherë t'i mbajnë për vete ato që kanë thënë.

Lufta e madhe që po bëjnë partitë marksiste-leniniste, u ka shkaktuar humbje kolosale revizionistëve, jo vetëm në politikën ndërkombëtare, por edhe brenda në gjirin e revizionistëve. Kjo është në favor të marksizëm-leninizmit, bën pjesë në hallkën e fitoreve të marksizëm-leninizmit në këto situata, që, duke i gjykuar realisht, janë me të vërtetë të vështira.

Në këtë drejtim po duken prej kohësh shenja tronditëse në kampin e revizionistëve, mosmarrëveshjet e mëdha që ekzistojnë midis tyre do të shtohen. «Testamenti»¹ i Toliatit, nga një studim i parë që i kemi bërë, tregon qartë përçarjen dhe tendencat e ndryshme që ekzistojnë në mes revizionistëve dhe që, sipas mendimit tonë, janë të pazgjdhshme. Në krye të çdo tendence të

1 Është fjala për promemorjen e Toliatit me titull «Mbi çështjet e lëvizjes punëtoare ndërkombëtare e të unitetit të saj» që u pagëzua me emrin «testamenti». Ajo përshkohet fund e krye nga shtrembërimi i marksizmit dhe pasqyron vijën e «socializmit Italian» dhe teorinë e «policentrizmit Italian».

tyre ekziston, në radhë të parë, lufta kundër marksizëm-leninizmit, kundër partive marksiste-leniniste. «Testamentin» e Toliatit ne e gjykojmë si një testament antisovjetik nga kreu e gjer në fund, por njëkohësisht edhe antihrushovian, megjithëse filli kryesor i tij është antimarksist. Duket tendenca që italianët nuk janë vetëm. Me italianët janë edhe polakët, me ta duhet të jenë për disa çështje edhe hungarezët. Kundër italianëve janë Hrushovi me udhëheqësit bullgarë. Valter Ulbrihti për disa çështje ka hezitime, kurse Novotni është shpallur pro Hrushovit. Pra, rreth italianëve ne shohim një grupim revizionistësh.

Toliati është policentrist, ai nuk do ta mbajë më në kurriz Hrushovin, kurse Hrushovi është koncentrist, ai tregon grushtin dhe kërkon që të gjithë t'i binden atij. Midis revizionistëve, pra, ka një konflikt të madh, i cili, po të dimë ne ta shfrytëzojmë, do të jetë në favorin tonë, sepse edhe «teoritë» e Toliatit kanë farën e madhe të degjenerimit dhe të përçarjes së revizionistëve, edhe «teoritë» e Hrushovit kanë farën e përçarjes, si të grupimit të tij revizionist, ashtu edhe brenda radhëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Pa hyrë thellë në këtë çështje, Toliatin, që është një kominternist i vjetër dhe që e njeh mirë veprimtarinë e Internacionales të udhëhequr nga Lenini dhe të prirë nga flamuri i marksizëm-leninizmit, që shpartalloi Internacionalen e Dytë, e frikëson, sikurse e thotë vetë ai, krijimi i një Internacionaleje tjetër të re me seksione. Këtë ai e ka frikë. Kjo do të thotë se Toliati ka frikë unitetin tonë të çeliktë marksist-leninist dhe mendon se, duke u dhënë liri partive, duke mos qenë

ato të drejtuara nga Hrushovi, i cili po bën shumë gabime, do të na izolojë dhe do të na likudojë ne. Por gabohet, sepse metoda e Toliatit çon në dobësimin e vetë frontit koherent të revizionistëve dhe ndihmon ngritjen e shpejtë të forcave revolucionare që ekzistojnë në çdo parti dhe udhëhiqen nga flamuri i marksizëm-leninizmit.

Partitë tona duhet ta kalitin vazhdimisht unitetin midis tyre, pasi ky i tmerron revizionistët, është vdekje për ta. Fjalën e kam te fakti se tani pikëpamja e disa partive për të mos dalë hapur kundër Hrushovit etj., etj., nuk duhet të ekzistojë më. Ne mendojmë se lufta e sotme midis dy rrymave të mëdha në lëvizjen komuniste nuk është një luftë speciale drejtuar kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, por është luftë që bëjnë revizionistët hrushovianë dhe titistë kundër marksizëm-leninizmit. Prandaj të tërë marksistë-leninistët duhet të dalin hapur në luftë për mbrojtjen e tij dhe të mos ecet me disa konsiderata që mund të kishin vlerë vetëm në fillim. Po të mos veprojmë të gjithë së bashku, atëherë e frenojmë lëvizjen tonë.

A është vallë marksiste që të lejojmë Hrushovin dhe bandën e tij të lokalizojnë luftën vetëm kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të tjerët të heshtin? Jo! mendon Partia jonë. Nuk u lejohet shokëve të disa partive që, për arsye të ndryshme, thonë akoma: «Dale, të presim lë na sulmojnë ne, pastaj të kundërveprojmë». Mëndimi ynë është se tani nuk ka si pritet më. Të gjithë ne duhet ta sulmojmë Hrushovin, se kështu mbrojmë

marksizëm-leninizmin. Po të dalin të gjithë hapur, atëherë revizionistët do ta kenë edhe më keq. Një parti marksiste-leniniste duhet t'i ketë parasysh faktorët e brendshëm, por mbrojtja e marksizëm-leninizmit është një domosdoshmëri. Ne, shqiptarët, themi: atij që lufton marksizëm-leninizmin, bjeri kokës!

Qarkullojnë sot edhe disa pikëpamje që janë, si të thuash, primitive. Ka njerëz që thonë: «Të mos dalim hapur se do të na quajnë «gramafon» i Kinës». Është marksiste kjo? Jo, nuk është marksiste. Partitë e vërteta komuniste janë të pavarura nga njëra-tjetra. Ato varen vetëm nga marksizëm-leninizmi. Kur Lenini ngriti lart flamurin e marksizmit kundër kapitalizmit dhe Internacionales së Dytë, armiqtë i quajtën satelitë të Bashkimit Sovjetik të gjithë ata që mbrojtën vijën e Leninit. Më vonë, gjithashtu, ata që mbrojtën vijën e drejtë të Stalinit kundër Buharinit, Troçkit, Zinovievit etj., i quajtën prapë satelitë të Bashkimit Sovjetik, sepse ishin solidarë në luftën kundër armiqve dhe qëndronin besnikë të marksizëm-leninizmit. Prandaj, në çoftë se te disa ekziston ideja dhe frika se mos i quajnë «gramafon i Kinës», këto duhen hedhur poshtë. Revizionistët le të thonë ç'të duan, marksistë-leninistët të vazhdojnë punën e tyre revolucionare.

Rëndësi sot për ne ka uniteti ynë i përbashkët marksist-leninist. Armiqtë duhet të shikojnë se në radhët tona nuk ka nuanca në vijë, se të gjithë jemi të bashkuar, gjë që është e domosdoshme për ne, sepse vemi në luftë dhe jo në dasëm, dhe sepse për të korrur sukses në luftë, duhet të jesh i organizuar. Kështu duhet të jemi ne.

Si të mos hidhërohemi ne, shqiptarët, nga udhëheqësi i një partie dhe shteti mik, që i tha katër herë ambasadorit tonë në Republikën Popullore të Kinës se «nuk është nevoja që Shqipëria të dërgojë ambasador në vendin e tij», pasi gjoja ne, shqiptarët, do të bëjmë shpenzime?! Ne e kuptojmë se ai nuk e bëri këtë për shkak të shpenzimeve tona, por për shkak se po të jetë ambasadori ynë në vendin e tij, si një vend që udhëhiqet nga një parti motër marksiste-leniniste, ai do të thotë atje mendimin e Partisë së Punës të Shqipërisë. Sigurisht në qoftë se ai vend vëlla nuk e do ambasadorin tonë, ne nuk do ta dërgojmë, por duam të vëmë në dukje se lufta kundër imperializmit dhe revizionizmit nuk bëhet kështu. Në qoftë se dikush na qan hallin se nuk kemi me se ta mbajmë ambasadën tonë në vendin e tij, ne i përgjigjemi me një fjalë të urtë të popullit tonë: «Mos i qaj hallin kalorësit se i varen këmbët». E përse të mos dërgojmë ne ambasador në një vend mik? Kjo nuk është e drejtë, sepse pastaj mund të themi edhe ne: «Ju shokë që s'pranoni ambasadorin tonë, mos na dërgoni ambasadorin tuaj në Shqipëri».

Luftën kundër revizionizmit ne duhet ta bëjmë jo vetëm në fushën politike dhe ideologjike, por edhe në atë ekonomike e kulturore. Partitë tona duhet të ndjekin me kujdes të madh se socialdemokracia dhe revizionizmi në këtë drejtim po zhvillojnë një aktivitet të jashtëzakonshëm gjer në fushën e kinematografisë e të teatrit për të degjeneruar njerëzit dhe partitë. Edhe këtë luftë ne duhet ta përballojmë.

Këto janë çështje që kanë rëndësinë e tyre, bile kanë shumë rëndësi. Prandaj është e drejtë që edhe ne

të organizojmë mbledhje, të mos kemi frikë nga armiq-të se, duke u mbledhur, do të na akuzojnë si përçarës. Ata si përçarës na kanë akuzuar neve që kur ka lindur dielli. Por ne, duke qenë të gjithë në një front të drejtë marksist-leninist, shumë gjëra duhet t'i koordinojmë në mënyrë revolucionare, si një shtab i madh luftarak.

Është e drejtë të kujtojmë se shokët tanë revolucionarë në të gjithë botën, që luftojnë në kushte shumë të vështira, kërkojnë ndihmë dhe kjo ndihmë u duhet dhënë në radhë të parë nga partitë marksiste-leniniste që janë në pushtet. Në qoftë se të gjithë e përqendrojmë luftën në këtë drejtim, atëherë do t'i shkatërrojmë planet e revizionistëve. Në «testamentin» e Toliatit, në një vend kërkohet që revizionistët të largohen «nga diskutimet parimore ideologjike» dhe ta mësojnë partinë të merret «me çështjet e brendshme», gjë që do të thotë të merren me asgjë. Kjo tregon se Toliati ka frikë nga krijimi i Partisë së re Komuniste marksiste-leniniste të Italisë. Do të jetë pikërisht kjo parti e re që do të bëjë punën, duke u bazuar në parimet e për-bashkëta dhe në stilin revolucionar të luftës, ajo do të jetë e aftë për të luftuar me sukses në praktikë për të drejtat e proletariatit italian, për të zhvilluar luftën kundër revizionizmit modern. Luftën kundër pikëpamjeve antimarksiste të Toliatit partitë marksiste-leniniste duhet ta bëjnë realitet, sepse është një luftë e drejtë.

Komunistët e çdo vendi, përveç luftës së drejtë brenda në atdheun e tyre, kanë edhe një detyrë tjetër: të dalin edhe jashtë kufijve të vendeve të tyre. Në kohën e Leninit të madh, në kohën e Kominternit, mijëra shokë komunistë dilnin në mënyrë të fshehtë ilegalisht

jashtë Bashkimit Sovjetik dhe shpërndareshin nga të katër anët, si në Francë, Itali, Austri, Shqipëri etj., për të përhapur idetë e Leninit. Tani situatat janë më të favorshme për ne, sepse partitë tona janë në fuqi, sepse kemi marrëdhënie diplomatike e ekonomike me vendet e ndryshme dhe njerëzit tanë do të çojnë atje fjalën e Partisë. Armiqtë do të na akuzojnë, se këtë punë kanë, por ne nuk kemi frikë nga akuzat e tyre. Se mos nuk e kanë akuzuar ata Leninin, Stalinin, Dimitrovin! Por edhe ne le të na akuzojnë, ne do të bëjmë punën tonë revolucionare.

Dihet se marksizëm-leninizmi nuk është dogmë, ai zbatohet në mënyrë krijuese në përshtatje me kushtet e çdo vendi. Por kjo nuk i jep të drejtën askujt që të mendojë se çdo vend ka «marksizmin» e vet. Teoria shkencore marksiste-leniniste është universale dhe as kinezohet, as indonezianohet, as italianizohet, siç kërkon të bëjë Toliati, me parullën «rruga italiane për në socializëm».

Ja, këto mendime kisha unë këtë radhë për shkëmbimën e pikëpamjeve me ju, shoku ambasador. Revisionistët janë në situata të vështira, sa më shumë që forcohem ne, aq më thellë do të rrokullisen ata në humnerë.

Shokë jemi, por një mendim mund ta kemi të drejtë, një tjetër mund ta kemi edhe të gabuar. Sidoqoftë atë që kemi në mendje është mirë ta themi, qoftë edhe sikur ta kemi gabim, se gabimet për njerëzit janë. Ndodh që njerëzit gabojnë, por ata që janë në rrugë të drejtë më shumë bëjnë të mira, por edhe gabimet që mund të kemi i ndreqim dhe përpiqemi të bëjmë kurdoherë mirë.

Do të kemi rast të takohemi përsëri, të bisedojmë, të diskutojmë dhe jo vetëm për këto çështje, por edhe për çështje ekonomike, për çështje të bujqësisë, të industrisë, të kulturës, sepse edhe për këto është mirë të përfitojmë nga eksperiencia e njëri-tjetrit.

Ambasadori kinez e falënderoi shokun Enver për këtë bisedë të ngrohtë dhe miqësore dhe, pasi foli për përshtypjet e tij mbi vendin tonë, theksoi se do të punojë për forcimin e zhvillimin e miqësisë midis partive, qeverive dhe popujve të Kinës e të Shqipërisë.

Në fund shoku Enver Hoxha e falënderoi dhe i uroi punë të mbarë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**TË JEMI VAZHDIMISHT NË SULM
KUNDËR REVIZIONIZMIT
Shënime**

21 shtator 1964

Lufta e marksistë-leninistëve kundër revizionistëve modernë është një luftë që duhet të zhvillohet në shkallë ndërkombëtare. Ajo nuk mund të konsiderohet si luftë në mes dy ose më shumë partive, si luftë e disa pjesëve të botës kundër disa pjesëve të tjera të botës komuniste, nuk mund, pra, të konsiderohet si luftë ideologjike rajonale as konflikt i veçuar midis dy ose më shumë shtetesh socialiste.

Pra polemika në mes nesh e revizionistëve duhet të marrë një karakter të organizuar parimor, marksist-leninist, ndërkombëtar. Përmbajtja e drejtë e luftës sonë parimore duhet të përfaqësojë jo vetëm sqarimin, mobilizimin, organizimin luftarak të marksistë-leninistëve në të gjithë botën, por duhet të sqarojë edhe të gjitha masat përparimtare të botës për kuptimin e drejtë të të gjitha problemeve kryesore, kombëtare e ndërkombëtare, t'i kuptojnë këto në prizmin e drejtë revolucionar të materializmit dialektik dhe historik dhe të armatosen kështu këto masa për të zhvilluar një punë

të gjerë revolucionare kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tyre, kundër revizionistëve modernë dhe shërbëtorëve të tyre.

Ne lipset të ndërmarim, pra, një luftë kolosale, të kapërcejmë pengesa shumë të mëdha, të ndërtojmë taktika të shumta, duke u mbështetur në parimet dhe duke synuar në zgjidhjen e problemeve strategjike të mëdha të lëvizjes sonë revolucionare. Pra, duhet të mendojmë e të veprojmë të organizuar si në luftë, dhe si në një luftë të rreptë ku kemi përpara armiq të tërbuar: imperializmin botëror me mjete të mëdha ekonomike, me mjete luftarake kolosale, me mjete propagandistike dhe politike të pakufizuara etj.; kemi përpara socialdemokracinë botërore, të organizuar politikisht në forma e në parti të ndryshme, me një fuqi materiale propagandistike të konsiderueshme dhe me një eksperiencë dinake dhe të madhe për korrupsionin e njerëzve dhe për mashtrimin e tyre; kemi përveç këtyre, revizionizmin modern, aleat besnik i të parëve, që është në pushtet, ka milituar për një kohë të gjatë në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ka qenë i topitur, i goditur, por jo pa aktivitet klandestin dhe njeh më mirë nga të dy të parët principet tona, metodat e punës dhe të luftës sonë, ka në dorën e tij të gjitha materialet e Kominternit e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe i manipulon për interesat e tij.

Nga ana tjetër, revizionistët modernë që janë në fuqi e në pushtet, kanë në dispozicion të tyre aparatet shtetërore, të cilat i deformojnë gradualisht dhe i kthejnë në aparate shfrytëzuese dhe shtypëse për masat, kanë forca e mjete ushtarake, financiare, propagandisti-

ke të mëdha. E tërë kjo makinë tash është kurdisur kundër nesh, vepron dhe lufton në të gjitha frontet kundër marksizëm-leninizmit, partive dhe shteteve tona.

Armiqtë tanë i kanë të gjitha këto, por e drejta është nga ana jonë dhe e keqja e gënjeshtër nga ana e tyre. Masat dërrmuese, proletariati revolucionar, fshatarësia revolucionare, janë nga ana jonë, pakica shfrytëzuese është me ata. Përveç të tjerave, ne kemi armën e madhe, kyçin e të gjitha problemeve: ideologjinë marksiste-leniniste që ata s'e kanë, që ata mund ta njojnë, por s'është ideologjia e tyre që mund ta shtrembërojnë, por që ky shtrembërim kthehet kundër tyre, që mund të gënjejnë për një kohë, por jo përgjithmonë. Pra, vetëm duke u mbështetur fort e pa lëkundje në mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të Stalinit, partitë marksiste-leniniste, grupet marksiste-leniniste dhe të gjithë marksistët në botë, me siguri, do ta fitojnë betejën.

Të gjithë duhet t'i koncentrojmë forcat, t'i organizojmë dhe t'i hedhim në luftë. Të jemi vazhdimisht në ofensivë. Kundër armikut të bëjmë një luftë frontale dhe një luftë partizane, një luftë legale dhe ilegale, një luftë politiko-ideologjike dhe një luftë ekonomike edhe me armë kur të paraqitet nevoja. Lufta jonë t'u përshtatet kurdoherë kohës, momentit, vendit, situatave politike, ekonomike, ushtarake, kurrë të mos jetë në bisht të situatës, të tërhiqet zvarrë, por t'u dalë përpara me kohë, t'i parashikojë situatat, të përcaktojë që përpara se në këto rrethana o situata, në këtë pjesë ose në atë pjesë të botës, taktikisht duhet sulmuar ose duhet tërhequr për të përgatitur sulmin, kurse në këto ose në

ato situata, në këtë apo në atë vend, për këtë ose për atë problem, duhet kurdoherë e kurdoherë të jemi në sulm të vazhdueshëm, të mos lëmë ta marrë iniciativën armiku.

Kudo dhe kurdoherë duhet të jemi të përgatitur ushtarakisht dhe kjo të shkojë kudo dhe kurdoherë në ngritje e në perfeksion. Neve na duhet të forcojmë kudo punën dhe luftën revolucionare të Partisë, që komunistët të ngrihen politikisht e ideologjikisht, të forcojnë shpirtin organizativ, të bëhen dinamikë për çdo gjë.

Ne duhet të përgatitim një aparat të madh e të zgjuar propagandistik që të përballojmë, të demaskojmë helmin armik dhe të mobilizojmë e të udhëheqim masat në luftë e në veprim.

Ne e kemi përballuar deri diku zjarrin e revizionizmit modern. Brenda pak vjetësh ne kemi arritur rezultate të mira, kemi arritur që grupin e Hrushovit, të Titos dhe të revizionistëve të tjerë modernë t'i demaskojmë gjerësisht dhe planet t'ua prishim: ata ne i penguan dhe vazhdojmë t'i pengojmë seriozisht. Lufta jonë i bëri të ngadalësojnë vrapin, të zbulojnë këmbët dhe planet e tyre, që kontradiktat në mes tyre jo vetëm të shfaqen, por të thellohen. Lufta jonë bëri që tradhtia e tyre në çdo sektor të duket qartë, ajo bëri që aleancat e fshehta të revizionistëve me imperialistët të zbulohen dhe ata të detyrohen të veprojnë hapur. Këto janë fitore mbi të cilat ne do të mbështetemi në luftën tonë të mëtejshme. Por kjo luftë duhet të bëhet më e organizuar, goditjet tona duhet të jenë të ashpra, vendimtare, të hapëta, pse edhe ato të armiqve do të jenë të ashpra,

vendimtare dhe të hapëta. Asnjë iluzion tjetër s'duhet të kemi. Kush mendon se armiku do të tërhiqet nga pozitë e tij, se do të bëjë «përmirësime», «autokritikë», «kthesa» etj., ai s'është hiç në të, ai është oportunist, i frikshëm e kompromisaxhi.

Disa parime, veçanërisht të mëdha leniniste-staliniane, duhet t'i kemi kurdoherë parasysh e t'i zbatojmë drejt në luftën tonë aktuale të madhe.

Partitë marksiste-leniniste janë indipendente, të pavarura nga njëra-tjetra, s'ka parti mëmë dhe parti bijë etj.

Por, këto parti të pavarura nga njëra-tjetra, këto parti të barabarta, s'janë të zgjidhura nga njëra-tjetra, por të lidhura me njëra-tjetrën dhe fuqimisht bile, fort bile, nga idetë e pavdekshme, vepruese, aktive, revolucionare të marksizëm-leninizmit. Teoria marksiste-leniniste s'është një teori boshe, s'ka fjalë të zbrazëta dhe slogane që mund të shpallen, që mund të mos zbatohen ose të zbatohen shtrembër. Revizionistët këtë doktrinë e kanë kthyer në formula boshe që i llomotitin dhe që nuk i zbatojnë në rrugën marksiste-leniniste. Edhe Hrushovi bërtet se «s'ka parti mëmë dhe parti bijë», por të gjitha partitë e tjera përpiqet t'i ketë bija dhe bija skllave dhe t'i lidhë ato me partinë mëmë, jo në rrugën marksiste-leniniste, natyrisht, por në atë anti-marksiste, jo për qëllime të revolucionit, po të kundër-revolucionit.

Revizionistët modernë flasin për «disiplinë partie dhe për disiplinë marksiste-leniniste në mes të partive komuniste», por në realitet këto janë vetëm formula, se në praktikë ata luftojnë për një disiplinë skllavëruese

ndaj partisë «mëmë», ndaj qëllimeve dhe veprimeve antimarksiste të hrushovianëve, disiplinë për luftë kundër nesh. Me disiplinën brenda në partitë e tyre ata kuptojnë disiplinën antimarksiste, përjashtimet nga partia të komunistëve të vërtetë, kërbaçin, vrasjet.

Revizionistët modernë mbledhjet e tyre në mes partive, rregullat organizative që duhet të dominojnë në këto mbledhje e në këto relata, i trumbetojnë se gjoja «i bëjnë e i zhvillojnë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste», por në realitet ky është bluf, çdo gjë në thelb është antimarksiste dhe çdo rregull e princip marksist shkelet pa skrupull.

Revizionistët modernë, duke shtrembëruar Deklaratën e Moskës, duke e shkelur atë hapur edhe në format organizative, të gjitha mbledhjet e tyre që po bëjnë, dypalëshe, tripalëshe, shtatëpalëshe (dhe këto janë me qindra e në forma të ndryshme) i quajnë «të drejta, të domosdoshme, të arsyeshme». Çdo mbledhje që bëjmë ne (dhe ne s'kemi bërë asnjë mbledhje) është «ilegale, përçarëse, antimarksiste». Çdo mbledhje e të gjitha partive, që atyre u vjen në mendje dhe u leverdis t'i thërresin, i bëjnë për interesat e tyre antimarksiste, për ata një mbledhje e tillë është «legale, marksiste» etj. dhe ne, thonë disa prej tyre, jemi të detyruar të vemi, se përndryshe jemi «përçarës», «dogmatikë» etj. Dhe, në rast se ne mbledhjes së tyre i kundërvëmë mbledhjen tonë, ata këtë e quajnë «mbledhje përçarësishe, tradhtarësh, dogmatikësh» etj. E kështu ka shumë çështje.

S'ka parim marksist-leninist që revizionistët modernë të mos e hedhin poshtë, të mos e shtrembërojnë,

ose ta përdorin për ndonjë moment si të plotë e të pacunuar. Por edhe në këtë rast, të mos gabohemi, ata e bëjnë për demagogji dhe s'u prish shumë punë ta citojnë në situatën e caktuar që e përdorin. Ata e bëjnë këtë për të gënjyer.

Kurse ne marksistë-leninistët duhet t'i kuptojmë dhe t'i zbatojmë drejt, pa frikë, të gjitha parimet marksiste-leniniste. Derisa ne, në veprimet tona bazohemi vetëm në parimet marksiste-leniniste, ato do të jenë të drejta, frytdhënëse, shkatërruese për revizionistët dhe pra do të qëllohen, do të sulmohen nga të katër anët dhe me të gjitha bateritë e shpifjeve revizioniste.

A duhet ne, për këtë arsye, të ngadalësojmë punën tonë, luftën tonë, veprimet tona? Në asnjë mënyrë! E kundërta do të thotë se ne kemi frikë, se lufta jonë s'është e vendosur, se në radhët tona ka nga ata që e pengojnë këtë luftë të drejtë, ka disfatistë, liberalë, të lëkundshëm, frikacakë, revizionistë të maskuar e të tjerë të këtij kallëpi.

Prandaj në këtë luftë të rreptë, dy gjëra duhen pasur parasysh: uniteti i partive marksiste-leniniste me marksizëm-leninizmin dhe spastrimi i tyre nga kategoria e njerëzve që përmenda më lart. Aleanca me anti-marksistët në parti s'mund të ketë, fraksione në parti s'mund të lejohen, aleanca jashtë partive me revizionistët e tradhtarët s'mund të ketë sukses. Prandaj partitë tona dhe partitë e reja që po ndërtohen duhet të kenë, të ruajnë dhe të forcojnë vetëm dhe vetëm karakterin e partive të tipit Lenin-Stalin. Vetëm të tilla parti do ta udhëheqin këtë luftë të madhe të revolucionit, parti të tjera të një karakteri tjetër ose do të që-

ndrojnë në mes të rrugës, ose do të qëndrojnë në bisht, ose do të bëhen si «Balli Kombëtar» në vendin tonë.

Është e vërtetë të themi që lufta jonë e madhe kundër revizionistëve modernë, me gjithë sukseset që ka pasur, nuk ka qenë e organizuar si duhet, as në mes të partive tona marksiste-leniniste, as në shkallë ndërkom-bëtare.

Deri diku, ne me kinezët kemi pasur kontakte partie, por shumë të rralla: kemi koordinuar luftën politiko-ideologjike, por jo në mënyrë organike. S'ka pasur tjetër koordinim.

Me partitë e tjera marksiste-leniniste nuk kemi pasur asnjë punë të organizuar, asnjë mbledhje partie për taktika të përbashkëta. Kemi pasur kontakte shumë të rralla me disa shokë dhe këto me karakter «përshëndetje», «solidariteti» në vija të përgjithshme.

Me partitë dhe me grupet e reja marksiste-leniniste ne kemi pasur kontakte të mira pune politike, ideologjike, organizative dhe vazhdojmë ta forcojmë këtë punë. Në fakt, nuk kemi pasur dhe vazhdojmë të mos kemi marrëdhënie konkrete dhe efektive me disa parti, që e konsiderojnë veten antirevizioniste dhe kjo jo për fajin tonë. Arsyet e një gjëje të tillë duhet t'i kërkojmë e t'i gjejmë tek ata. Hezitimet vijnë nga ata, jo nga ne, dhe e kanë burimin në «moskomprometimin ndaj sovjetikëve», për të mos i akuzuar si «ekstremistë» dhe, pra, duhet të mendojmë se këto parti kanë rezerva ndaj sovjetikëve dhe ndaj qëndrimeve marksiste-leniniste të Partisë sonë.

Pa e mburrur dinamizmin e luftës së Partisë sonë kundër revizionistëve, lufta e ndonjë partie, sado e

madhe, taktikisht ka pasur shumë hezitime, ngadalësim të ekzagjeruara, qëndrime disi statike. Kurse partitë e tjera kanë treguar në këtë luftë lëkundje të theksuara në qëndrimet e jashtme, një javashllëk të dëmshëm, një maskim formal etj., kurse partitë dhe grupet e reja marksiste-leniniste, brenda mundësive të tyre të fillimit, kanë treguar një frymë luftarake.

Që të forcojmë luftën, duhet të forcojmë lidhjet ndërmjet nesh, të forcojmë organizimin ndërkombëtar të luftës, në radhë të parë duhet të organizojmë mbledhje partish të rregullta dhe të dalim me platformë të njëjtë politike, ideologjike, organizative marksiste-leniniste për luftën kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe socialdemokracisë... Përpara armikut duhet të jemi fort të organizuar, të jemi të gjithë në një front dhe të gatshëm e revolucionarë kudo.

Çdo gjë të paqartë në mes nesh ta sqarojmë, që, kështu, të mos i bjerë njëri gozhdës e tjetri patkoit, njëri të qëndrojë përpara, tjetri në bisht. Çdo arsye taktike e kundërt të bazohet në marksizëm-leninizmin dhe në rrethanat konkrete.

Një punë e tillë mendoj se nuk është një «disiplinë qorre», por e vetëdijshme, ky s'është një unitet fiktiv, po unitet real, luftarak, marksist-leninist, kjo s'është vartësi njëri nga tjetri, por një koordinim pune dhe lufte i nevojshëm, i domosdoshëm përpara armikut, kjo s'është një ndërhyrje në punët e brendshme të shteteve dhe të partive tona, por është një bashkëpunim i frytshëm për lulëzimin e vendeve tona, për fuqizimin e marksizëm-leninizmit, për forcimin e luftës revolucionare në botë, për triumfin e marksizëm-leninizmit në

shkallë botërore, kundër ideologjisë borgjeze, kundër socialdemokracisë dhe revizionizmit modern.

Konsideratat e armiqve, shpifjet e tyre dhe epitetet që ata do të na vënë për këto veprime të drejta tonat, neve jo vetëm nuk duhet të na trembin, të na tronditin, por përkundrazi të na forcojnë, pse «kur të shan armiku kjo do të thotë se je në rrugë të drejtë».

Armiku ka shumë frikë nga një luftë e organizuar, nga një luftë e shumanshme jona. Lufta është shumë e koklavitur dhe ka shumë aspekte. Ajo s'ka vetëm aspektin thjesht ideologjik, doktrinar, por zbatimi i saj në jetë, në të gjitha shfaqjet, në politikë, në ekonomi, në kulturë etj., etj., është një punë e gjerë dhe e vështirë.

Qëndrimi i drejtë parimor i vendeve tona socialiste në këto probleme kyç, jo vetëm duhet të forcojë e të kalitë gjendjen brenda te ne, por duhet të shërbejë edhe si një ndihmë e çmueshme për marksistë-leninistët e tjerë në vende të ndryshme, duhet të bëhet një burim eksperience për punën e tyre. Por, kuptohet se kjo s'është e tëra. Revizionistët modernë, që janë në fuqi, e bëjnë dhe do ta bëjnë me të madhe këtë punë. Ata kanë në dispozicion mjete kolosale. Përveç kësaj, ata në shumë vende kapitaliste kanë të organizuar propagandën e tyre nëpërmjet partive komuniste ku sundojnë revizionistët.

Toliati s'e ka keq për veten e tij, kur thotë në testamentin e vet se duhet t'i largojmë komunistët italianë nga diskutimi i parimeve bazë të marksizëm-leninizmit dhe t'i tërheqim anëtarët e partisë në çështjet e ditës, në veprimet e rastit etj., etj. Pra, planit të tyre ne duhet t'i

kundërvëmë planet tona dhe organizimit të tyre, organizimin tonë.

Është e qartë se partitë e reja komuniste dhe grupet e majta duhet të luftojnë në të gjitha frontet për parimet, për aksionet e përditshme, për aleancat e tyre kundër imperializmit, kundër socialdemokracisë, kundër partisë së tyre revizioniste, kundër grupit renegat të tyre, Hrushovit etj.

Siç shihet, lufta është kolosale, pra edhe ndihma jonë për ta duhet të jetë e madhe dhe që të jetë efikase, duhet të jetë e organizuar. **Prandaj organizimi i punës, i luftës, e siguron suksesin e vijës së drejtë politike, ideologjike, ushtarake, ekonomike etj.**

*Botohet për herë të parë, me
disa shkurtime, sipas origjinalit
që gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

AFRIMI I N. HRUSHOVIT ME BONIN INKURAJON SYNIMET AGRESIVE TË MILITARIZMIT GJERMAN

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

23 shtator 1964

Po mbushen 20 vjet nga shkatërrimi i Gjermanisë naziste dhe mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, por traktati i paqes me Gjermaninë nuk është nënshkruar akoma. Vendimet e Jaltës e të Potsdamit parashikonin rregullimin e Gjermanisë së pasluftës, duke pasur si bazë zhdukjen përfundimtare të militarizmit dhe të revanshizmit gjerman. Popujt e Evropës dhe të botës, që i kishin akoma të gjalla tmerret e luftës dhe shkatërrimet e panumërta të saj, donin që të likuidohej një herë e përgjithnjë kjo vatër e rrezikshme e luftës në qendër të Evropës, mbi të cilën bien përgjegjësitë kryesore për dy katastrofat e mëdha që pësoi kontinenti ynë brenda një gjysmë shekulli.

Por ngjarjet e këtyre dy dekadave në Evropë dhe në botë nuk u zhvilluan ashtu siç parashikohej dhe dëshirohej nga popujt. Fuqitë e mëdha perëndimore, Shtetet e Bashkuara, Anglia dhe Franca, ish-aleate të Bash-

kimit Sovjetik në koalicionin antifashist, mbi të cilat binte gjithashtu një përgjegjësi e posaçme për denazifikimin e Gjermanisë dhe krijimin e kushteve të favorshme për krijimin e një shteti të ri gjerman, ndoqën rrugën e ringjalljes së militarizmit e revanshizmit gjerman. Pasi shkelën në mënyrë arbitrare marrëveshjet e përbashkëta të kohës së luftës, në zonat gjermane të pushtuara nga ushtritë e tyre, ata krijuan një shtet të veçantë, ku u ruajtën jo vetëm monopolet hitleriane, përgjegjëse për shpërthimin e luftës, por edhe kuadrot kryesorë të Rajhut të Tretë. Kështu ndodhi që republika e Bonit u bë shumë shpejt një shtet militarist agresiv, i cili në qendër të politikës së vet vuri rishikimin e rezultateve të Luftës së Dytë Botërore dhe të kufijve që u vendosën si pasojë e fitores mbi nazizmin gjerman. Kështu ndodhi që, me ndihmën e imperializmit amerikan dhe të aleatëve të tij, në Gjermaninë Perëndimore u ngrit përsëri flamuri i militarizmit dhe parulla e vjetër e falimentuar «marshimi drejt lindjes», u bë përsëri motoja kryesore e qeveritarëve të Bonit.

Ishte pikërisht kjo politikë e imperialistëve, e Shteteve të Bashkuara, Anglisë dhe Francës, e cila frymëzohej nga urrejtja e tyre klasore për komunizmin dhe nga qëllimi për vendosjen e sundimit të tyre botëror, që krijoi përsëri në qendër të Evropës një vatër të madhe për acarimin e tensionit ndërkombëtar dhe një plasdarm të rrezikshëm për shpërthimin e provokacioneve dhe të agresioneve të reja. Me këtë politikë, që drejtohej në radhë të parë kundër interesave jetike të popullit gjerman dhe me nxitjen e tyre të drejtpërdrejtë, imperialistët krijuan rrezikun e shpërthimit të

aventurave të reja nga ana e militarizmit gjerman, e ngarkuan atmosferën e Evropës me një tension të ri, që përmban në vetvete farën e agresionit dhe të luftës.

Është thënë disa herë, ose më mirë të themi që s'ka ditë të mos flitet, se nuk mund të justifikohet në asnjë mënyrë fakti që gati 20 vjet pas mbarimit të luftës, të mos jetë përfunduar akoma traktati i paqes me Gjermaninë, që mbeturinat e Luftës së Dytë Botërore të mbahen akoma të gjalla dhe që populli gjerman të mos gëzojë akoma barazinë e plotë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sigurisht, përgjegjësinë për këtë gjendje e mbajnë fuqitë perëndimore dhe aleatët e tyre të Bonit, të cilët refuzojnë me këmbëngulje që të përfundohet traktati i paqes me Gjermaninë. Por kjo nuk do të thotë që vendet e tjera që kanë marrë pjesë në luftën kundër Gjermanisë hitleriane janë të detyruara ta nënshkruajnë traktatin e paqes kur të dojë dhe si të dojë Uashingtoni ose Boni. Tanimë koha ka vërtetuar se fuqitë perëndimore nuk janë të interesuara për të nënshkruar një traktat paqeje dhe për të njohur realitetin e sotëm në Gjermani, ekzistencën e dy shteteve gjermane. Kushti i tyre i parë dhe i fundit për nënshkrimin e këtij traktati është mosnjohja e këtij realiteti, ose më mirë të themi, ndryshimi i këtij realiteti, duke zhdukur Republikën Demokratike Gjermane me gllabërimin e saj nga Boni. Por një kërkesë e tillë është krejtësisht absurde dhe e papranueshme. Përfundimi i një traktati të tillë paqeje, siç e dëshirojnë Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre, nuk do të ishte më një traktat paqeje, në të vërtetë ai do të justifikonte e do të sanksiononte një agresion të hapët kundër

një shteti të pavarur e sovran, siç është Republika Demokratike Gjermane dhe do t'u hapte rrugën agresioneve të reja kundër shteteve të tjera të Evropës Lindore, të cilat më shumë se kushdo tjetër kanë vuajtur nga nazizmi hitlerian.

Këtej del se qëndrimi ndaj çështjes gjermane në përgjithësi dhe traktatit të paqes në veçanti është plotësisht i drejtë dhe e ruan gjithnjë të pandryshuar vlerën e tij. Nënshkrimi i traktatit të paqes me të dy shtetet gjermane, përderisa nuk është realizuar akoma bashkimi i tyre, është një detyrë jo vetëm aktuale, por edhe mjaft imperative. Traktati i paqes me Gjermaninë, që do t'u jepte fund mbeturinave të rrezikshme të Luftës së Dytë Botërore, do t'i kthente popullit gjerman sovranitetin dhe dinjitetin e tij të plotë, do të hapte rrugën e bashkimit, njëkohësisht do të zhdukte edhe vatrën kërcënuese të tensionit e të zjarrit që përbën Berlini Perëndimor. S'ka asnjë dyshim se përfundimi i traktatit të paqes dhe kthimi i Berlinit Perëndimor në një qytet të lirë e të çmilitarizuar do të ndihmonte shumë për të krijuar kushte më të mira e më të favorshme për bashkimin e dy Gjermanive, kushte të cilat sot, kur mungon akoma një traktat paqeje, nuk mund të thuhet se ekzistojnë.

Zhurma e madhe që kanë bërë e bëjnë fuqitë perëndimore kundër përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë dhe vringëllimi i armëve nga ana e tyre, janë një provë tjetër që tregon se ato janë për luftën dhe jo për paqen, se ato janë për ndarjen e Gjermanisë dhe jo për bashkimin e saj, se ato duan ta përdorin Gjermaninë Perëndimore si një bazë agresioni kundër vende-

ve socialiste. Zvarritja e përfundimit të traktatit të paqes përbën për fuqitë imperialiste një mjet dhe një mënyrë për të mbajtur zjarrin të ndezur, për të qenë të lira në veprimet dhe në planet e tyre të rrezikshme, për të bërë kërcënime e shantazhe, për të përgatitur agresione. S'kalon ditë që të mos dëgjojmë nga Uashingtoni e Boni të bërtitura e ulërime ujqish që kërkojnë të gllabërojnë Republikën Demokratike Gjermane, të rivendikojnë tokat perëndimore të Polonisë dhe të kundërshtojnë kufirin Oder-Najse, të pretendojnë territoret e Çekosllovakisë, të Bashkimit Sovjetik etj.

Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste nuk mund kurrësi të pajtoheshin me këtë zvarritje, që përmban në vetvete qëllimet agresive të revanshistëve të Bonit dhe të fuqive imperialiste perëndimore. Prandaj ato edhe kishin shpallur qëllimin e tyre që brenda një kohe të shkurtër e të caktuar traktati i paqes me Gjermaninë të nënshkruhej me të dy shtetet gjermane ekzistuese nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse në luftën kundër Gjermanisë hitleriane. Ato e kishin bërë të qartë se në rast se Republika Federale Gjermane dhe fuqitë e tjera perëndimore refuzonin të nënshkruanin traktatin, ato, ashtu siç kishte propozuar Bashkimi Sovjetik, do të nënshkruanin një traktat të veçuar me Republikën Demokratike Gjermane, duke zgjidhur njëkohësisht edhe problemin e Berlinit Perëndimor.

Ky ishte një qëndrim i qartë, pa ekuivoqe dhe plotësisht i zbatueshëm. Përfundimi i traktatit të paqes me Republikën Demokratike Gjermane, ashtu siç parashikohej në vitin 1961, do të ishte një provë shumë e qartë e vendosmërisë së vendeve socialiste për mbrojt-

tjen e paqes dhe të sigurimit ndërkombëtar, do të ishte një pengesë jo e vogël në rrugën për realizimin e planeve agresive të imperialistëve amerikanë dhe të revanshistëve të Bonit. Mbi të gjitha ai do t'i jepte Republikës Demokratike Gjermane të gjitha atributet e saj si shtet sovran, do të forconte së tepërmi sigurimin dhe pozitën e saj ndërkombëtare, do t'i jepte fund gjendjes së rrezikshme në Berlinin Perëndimor.

Mbahet mend se si N. Hrushovi, në një fjalim që mbajti në radiotelevizionin e Moskës më 7 gusht 1961, pat deklaruar se «shtytja e përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë edhe për disa vjet të tjerë do të thotë të çosh ujë në mullirin e forcave agresive, të zbrapsesh përpara presionit të tyre. Një gjendje e tillë do të inkurajonte edhe NATO-n edhe qeverinë e Bonit për formimin në Gjermaninë Perëndimore të divizioneve të reja, pajisjen e tyre me armë atomike dhe me armë termobërthamore, kthimin e Gjermanisë Perëndimore në forcën kryesore të shpërthimit të luftës së re botërore».

«Në qoftë se do të hiqnim dorë nga nënshkrimi i traktatit, theksonte ai, fuqitë perëndimore do ta vlerësonin këtë si një pikë të dobët strategjike dhe do të zgjeronin menjëherë rrjetin e kërkesave të tyre. Ato do të kërkonin likuidimin e rendit socialist në RD Gjermane, do të shtronin detyrën e shkëputjes nga Polonia dhe nga Çekoslovakia të tokave që u janë kthyer atyre në bazë të marrëveshjeve të Potsdamit. Por edhe në qoftë se të gjitha këto do t'ia arrinin fuqitë perëndimore, prapëseprapë ato do të paraqitnin pretendimin e

tyre kryesor — të likuidonin rendin socialist në të gjitha vendet e kampit socialist».

E gjithë bota e di se ne e patëm përkrahur pa rezerva këtë pozitë të drejtë të Bashkimit Sovjetik. Por ç'ka mbetur tani nga këto deklarata të N. Hrushovit? Asgjë. Ato janë arkivuar, është hequr dorë prej tyre dhe avazet e tjera kanë filluar të këndojnë tani udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik. Është e habitshme, por është e vërtetë. Ata nuk flasin më për pasojat negative e të rrezikshme që ka sjellë dhe sjell zvarritja e nënshkrimit të traktatit të paqes me Gjermaninë. Mos do të thotë se këto pasoja nuk ekzistojnë më, nuk zhvillohen, ose nuk thellohen akoma më tepër? Hesh-tja ndaj tyre nuk e bën gjendjen më të lehtë, ashtu siç nuk e ulin, por përkundrazi, e shtojnë oreksin e revan-shistëve të Bonit buzëqeshjet e ëmbla dhe kortet e kohëve të fundit midis Hrushovit dhe kancelarit Erhard. Çështja gjermane ekziston, ajo mbetet e pazgjidhur. Ekzistojnë, pra, dhe mbeten rreziqet që rrjedhin nga kjo gjendje. Në qendër të Evropës, në Republikën Federale Gjermane, po grumbullohen e po dendësohen gjithnjë e më shumë retë e zeza të kërcënimeve e të agresioneve. Rreziku që u kërcënohet vendeve të Evropës Lindore, dhe në radhë të parë Republikës Demokratike Gjermane, nuk është zhdukur. Politika kapitulluese e kompromiseve dhe e lëshimeve e udhëheqësve sovjetikë e ka theksuar edhe më tepër atë. Do të jetë e pafalshme të mos shikohej se sa më shumë afrohet grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij me imperializmin amerikan dhe Gjermaninë Perëndimore, aq më shumë ndihmohet politika e këtyre të fundit për izolimin e

Republikës Demokratike Gjermane, aq më shumë kërcënohen sovraniteti dhe integriteti tokësor i atyre vendeve ndaj të cilave revanshistët gjermanë kanë pretendime territoriale.

Në qoftë se sot, domethënë këta dy vjetët e fundit, fuqitë imperialiste dhe sundimtarët e Bonit paraqiten gjoja «më të matur», kjo nuk do të thotë se synimet e imperializmit kanë ndryshuar. Ka ndryshuar vetëm taktika, e cila tani për tani konsiston në një kombinim sipas rastit dhe rrethanave, «të politikës nga pozitat e forcës» me diversionin politik të vazhdueshëm dhe me një luftë ekonomike të formave të ndryshme. Politika kapitulluese dhe veprimtaria tradhtare e N. Hrushovit për t'u afruar dhe për të bashkëpunuar me imperializmin përbën, pa dyshim, një nga faktorët që përcaktojnë adoptimin e kësaj taktike. «Bashkimi i popullit tonë (lexo: gllabërimi i Republikës Demokratike), deklaroi Erhardi në një fjalim që mbajti në Bon më 17 qershor të këtij viti, dhe kapërcimi i tensionit në Evropë dhe në botë (lexo: politika e «bashkekzistencës paqësore» e N. Hrushovit) nuk janë në kundërshtim me këtë, përkundrazi, e lehtësojnë rrugën për t'iu afruar gjithnjë e më shumë këtij objekti».

Më përpara qeveritarët e Bonit ngulnin këmbë pranë Shteteve të Bashkuara që çdo afrim i tyre me grupin e Hrushovit në kuadrin e së ashtuquajturës bashkekzistencë paqësore duhej të shoqërohej me lëshime të bujshme të revizionistëve modernë në çështjen gjermane. Tani Boni nuk bën shumë zhurmë mbi këtë kusht; përkundrazi, përpiqet edhe ai, me sa mundet, të bëhet partizan i flaktë i të ashtuquajturit afrim mi-

dis «Lindjes dhe Perëndimit». Arsytet janë të qarta: nga një anë imperialistët, pra edhe ata të Bonit, kanë tani më mjaft sigurime se N. Hrushovi është gati të shkojë atje ku duan ata; nga ana tjetër, me sa duket, grupi i Hrushovit po ua plotëson këtë kërkesë. Heqja dorë nga përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë është një shërbim i madh që u bëhet revanshistëve gjermanë dhe një hap i rëndësishëm drejt lëshimeve të tjera esenciale.

Mund të duket e çuditshme, por është fakt që nënshkrimi i traktatit të miqësisë, ndihmës reciproke dhe bashkëpunimit midis Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Demokratike Gjermane që u nënshkrua në Moskë më 12 qershor 1964, u prit me njëfarë kënaqësie dhe simpatie të veçantë në Perëndim. «Qarqet qeveritare të Uashingtonit — shkruante një revistë borgjeze politike italiane — gati sikur shkojnë pas shtypit komunist, i cili ka folur për një «kontribut të madh për bashkekzistencën paqësore», e kanë quajtur traktatin e Moskës si «një nga rezultatet e uljes së tensionit»».

Nuk ka ndonjë vështirësi të madhe për të kuptuar pse fuqitë perëndimore, të cilat deri tani thërrisnin «rrëmbeni armët» dhe bëheshin gati për luftë sa herë bëhej ndonjë propozim konstruktiv nga vendet socialiste në lidhje me çështjen gjermane, ose kur merrej ndonjë masë konkrete për forcimin e pavarësisë e të sovranitetit kombëtar të RD Gjermane, buzëqeshën kaq ëmbël kur u nënshkrua traktati i ri sovjeto-gjerman. Nga njëra anë, me këtë akt të ri të hartuar në Moskë N. Hrushovi hoqi dorë nga nevoja e përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë dhe përgjithësisht

nga qëndrimi i përbashkët që vendet socialiste kishin kundrejt çështjes gjermane. Nga ana tjetër, me këtë akt N. Hrushovi shtron rrugën për komplotin e tij të madh në dëm të RD Gjermane, në dëm të kampit socialist dhe të paqes në Evropë e në botë.

Në traktatin e nënshkruar nuk shtrohet më problemi i kthimit të Berlinit Perëndimor në një qytet të lirë e të pavarur, por kjo çështje kufizohet dhe shikohet si «një entitet politik më vete». Ky hap prapa është një tjetër lëshim i rëndësishëm që u bëhet imperialistëve amerikanë dhe revanshistëve të Bonit. Por ka edhe më. Traktati parashikon që, në rast agresioni të armatosur kundër njërës nga palët (domethënë kundër RD Gjermane), ato duhet t'i drejtohen OKB-së, dhe, pas «ndërrhyrjes së saj për ruajtjen e paqes», ndërpriten të gjitha masat e marra për mbrojtje. Këtu shihet qartë vija kapitulluese e Hrushovit, i cili, në emër të «bashkekzistencës paqësore», kërkon të legalizojë parimin e ndërrhyrjes së OKB-së, domethënë të imperialistëve amerikanë, kundër lirisë e pavarësisë së popujve. Kush mund të bëjë në Gjermani një agresion të armatosur pa pjesëmarrjen e imperialistëve amerikanë dhe cilat do të ishin ato forca në OKB që do ta detyronin këtë organizatë të merrte masa kundër tyre?

Se ç'ka bërë e ç'po bën OKB-ja në rastet e agresioneve imperialiste kundër popujve të tjerë, tanimë kjo dihet mirë dhe s'ka nevojë për shpjegime. Në të gjitha këto çështje, përveç iluzioneve dhe mashtrimeve të N. Hrushovit, s'ka asgjë tjetër reale.

Se sa i «ka prekur» imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre të Evropës Perëndimore traktati sovjeta-

-gjerman dhe sa të interesuar janë ata për lëshimet e reja që premtion Hrushovi, këtë e dëshmon edhe vizita e afërme që Hrushovi do të bëjë në Bon. Të krijohet përshtypja se ky traktat u nënshkrua pikërisht për të lehtësuar këtë vizitë, për të hapur rrugën e afrimit të udhëheqësve sovjetikë me Bonin. Asnjë nuk mund ta kuptojë se si është e mundur të bëhet një vizitë e tillë në Bon menjëherë pas nënshkrimit të traktatit, të cilin udhëheqësit sovjetikë mundohen ta paraqesin si «një garanci për të shmangur një agresion nga forcat e militarizmit e të revanshizmit, që synojnë në revizionimin e rezultateve të Luftës së Dytë Botërore». Ç'lidhje mund të ketë midis takimit me «forcat e militarizmit dhe të revanshizmit» dhe masave që pretendohet se janë marrë për «garancinë» e rezultateve të Luftës së Dytë Botërore, këtë e di vetëm N. Hrushovi. Por këtë tradhti të hapët të Hrushovit e shohin tani të gjithë, e sheh edhe populli gjerman.

Pikërisht pse në vijën tradhtare e kapitulluese të Hrushovit nuk ka më asnjë garanci, është i mundur të bëhet një takim i tillë. Në qoftë se revanshistët dhe militaristët nuk do të shikonin ndonjë përfitim për arritjen e qëllimeve të tyre, nuk do të nxitoheshin ta ftonin N.Hrushovin në Bon, qoftë edhe si turist të thjeshtë. S'ka asnjë dyshim se prapa kësaj vizite fshihet një komplot i ri i Hrushovit. Tanimë është provuar se pazarllëqet e tij politike kanë dëmtuar kurdoherë interesat e Bashkimit Sovjetik dhe të të gjithë kampit socialist. Aq më të rrezikshme janë këto pazarllëqe për çështjen gjermane, e cila është shumë delikate dhe e komplikuar. Për hir të «bashkekzistencës paqësore» e të

afrimit me imperializmin, gjë nga e cila shpreson të nxjerrë përfitime politike dhe ekonomike, grupi renegat i Hrushovit nuk ngurron të bëjë pazarllëqe me imperialistët prapa krahëve e në kurriz të vendeve socialiste, nuk ngurron të bëjë objekt tregtie e të sakrifikojë një vend të tillë si RD Gjermane.

Tani propagandistët e N.Hrushovit, dhe në radhë të parë dhëndri i tij, Axhubei, i cili kohët e fundit vizitoi RF Gjermane dhe bëri bisedime të fshehta me Erhardin, po mundohen të bindin të tjerët se «djalli nuk është aq i tmerrshëm sa e bëjnë». Për shembull, në faqet e gazetës që drejton, «Izvestia», ai mundohet të tregojë se jo të gjithë udhëheqësit e Gjermanisë Perëndimore janë revanshistë e militaristë, bile ka mjaft personalitete të veçanta që janë «realistë», «objektivë», «të arsyeshëm» etj., etj. Që përpara kësaj vizite ai i pat kërkuar falje ambasadorit gjerman në Moskë pse gazeta e tij kishte botuar një lajm me burim nga Gjermania Demokratike mbi një fjalim të anëtarit të Byrosë Politike të PSBGJ, Norden, që përmendte të kaluarën naziste të presidentit të RFGJ, Lybke.

Po të kemi parasysh se me gojën e Axhubeit flet Hrushovi, kjo nuk është një propagandë e thjeshtë për të krijuar një atmosferë lehtësuese në prag të takimit Hrushov-Erhard. Kjo tregon qartë një tendencë dhe një orientim të ri drejt minimizimit të rrezikut që përbejnë militarizmi dhe revanshizmi i Gjermanisë Perëndimore, ajo ka për qëllim të përpunojë opinionin në drejtim të një afrimi të grupit të Hrushovit me Gjermaninë Perëndimore. Por një politikë e tillë nuk është aspak në favor as të Bashkimit Sovjetik, as të vendeve

të tjera socialiste dhe as të paqes e të sigurisë së popujve. Ajo të kujton veprimet e një njeriu të paarsyeshëm, i cili i hap derën hajdutit që dikur ka hyrë në shtëpinë e vetë atij dhe i ka shkaktuar dëmet më të mëdha.

Këto janë faktet. Dhe ato tregojnë se politika kapitulluese e N.Hrushovit nuk mund të mos i shtojë edhe më tepër rreziqet që ekzistojnë për lirinë e pavarësinë e Republikës Demokratike Gjermane, nuk mund të mos sjellë shqetësime të reja, në radhë të parë, për Poloninë e për Çekoslovakinë, ndaj të cilave Boni ka pretendime të mëdha territoriale. Por rreziku më i madh qëndron në faktin se kjo politikë ia shton vazhdimisht oreksin imperializmit, i cili nuk ka hequr kurrë dorë nga përmbysja e sistemit socialist dhe vendosja e sundimit të tij botëror. Qëndrimi i ri i N.Hrushovit në çështjen gjermane vërteton edhe një herë se ai po bëhet komplis për realizimin e strategjisë globale të imperializmit amerikan kundër paqes e sigurisë së popujve.

Ne kemi mosmarrëveshje të mëdha parimore ideologjike me Partinë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë dhe mendojmë se pikërisht pikëpamjet e gabuara të kësaj partie, që është futur në ingranazhin e tmerrshëm të politikës tradhtarë e të shantazhit të Hrushovit, i bëjnë këtë parti dhe popullin e Republikës Demokratike Gjermane të vuajnë dhe të ndodhen në një dilemë të madhe që konsiston: të flasin hapur apo të vërtiten nëpër kallëpet e labirintet e politikës akrobatike tradhtarë të hrushovianëve.

Vetëm një rrugë e vendosur marksiste-leniniste e

Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë e zgjidh këtë nyje gordiane dhe ne mendojmë se komunistëve gjermanë nuk u mungon kuraja. Ne, si kurdoherë, ngremë zërin në mbrojtje të Republikës Demokratike Gjermane, të marrin fund një herë e mirë shantazhet e hrushovianëve dhe metodat cinike e minat e nëndheshme kundër Republikës Demokratike Gjermane.

Duhet të luftohet e të demaskohet pa ngurrim nga gjermanët vetë, dhe nga të gjithë ne, një Munih i ri kundër Republikës Demokratike Gjermane. Ata që mendojnë se duke sakrifikuar Republikën Demokratike Gjermane do të sigurojnë qetësinë në kufijtë e tyre, ata janë naivë (gjëja më e paktë që mund të themi).

Te ne populli gjerman dhe komunistët gjermanë le të shohin miq e shokë nga më besnikët dhe të jenë të sigurt se ne i kemi mbrojtur dhe do t'i mbrojmë me të gjitha forcat parimet e marksizëm-leninizmit; dhe është kjo që na bën të mbrojmë me të gjitha forcat drejt e pa frikë, Republikën Demokratike Gjermane dhe popullin vëlla gjerman.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit» Nr. 228 (5010), 23 shtator 1964

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 3. Tiranë, 1965

TË SHTOJMË DHE TË EKONOMIZOJMË MË SHUMË PYJET DHE LËNDËT DJEGËSE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

2 tetor 1964

Studimet që bëhen duhet të na shërbejnë për të përcaktuar më mirë orientimet tona për probleme të caktuara. Ne jo vetëm që mund t'i rishikojmë orientimet që kemi dhënë për normat e lëndëve djegëse, por edhe orientimet për prodhimin e këtyre lëndëve.

Të gjithë e dimë se ç'rëndësi të madhe kanë pyjet, dhe ç'probleme serioze përbëjnë ato. Megjithëkëtë, vendimet që ka marrë Plenumi i Komitetit Qendror² për zhvillimin e tyre, nuk po zbatohen si duhet. Ne duhet

1 Në këtë mbledhje u diskutua mbi sigurimin e lëndës së drurit për vitin 1964-1965 dhe në pesëvjeçarin e katërt, si dhe bilanci i lëndës djegëse për pesëvjeçarin e katërt.

2 Ky problem u shqyrtua dhe u diskutua në Plenumin e 14-të të KQ të PPSH që u mbledh më 2-3 nëntor 1959.

jo vetëm të kërkojmë një raport mbi punën që bëhet për mbarështrimin dhe përtëritjen e pyjeve, po të rishikojmë edhe çështjen e forcimit të mëtejshëm të vendimit që kemi marrë për këtë pasuri të madhe të vendit tonë.

Vendimet e marra nuk i kemi zbatuar si duhet, sepse kemi hasur në vështirësi. Është fakt se ka pasur raste që lënda e drurit është kalbur në pyll dhe këtu ka influencuar, gjer në njëfarë shkalle, edhe mungesa e kontrollit, po ka pasur edhe vështirësi teknike. Është punë e lehtë që punëtorët e sharrave t'i presin trunget, po gjer tani nuk është zgjidhur si duhet problemi se si do të transportohen prej andej këto trunqe. Nevojat e ekonomisë sonë për lëndë druri janë më të mëdha sesa prodhimi i këtyre lëndëve, sepse sot për sot ne nuk shkojmë dot të presim në çdo pyll, për shkak të mungesës së rrugëve e të mjeteve, gjë që kërkon investime të mëdha, të cilat ne i bëjmë në bazë të mundësive tona.

Çështja është që në planet tona nevojat dhe përdorimin e lëndës së drurit t'i parashikojmë më mirë se deri tani, sepse eksperiencia nuk na mungon. Paralelisht me këtë të parashikojmë edhe nevojat për sasinë e fidanëve pyjorë që duhet të mbjellim, duke zëvendësuar kështu ata që presim. Kjo kërkon që ne të rishikojmë edhe planin e investimeve, sepse zhvillimi i ekonomisë sonë nuk mund të ndërpritet. Është fakt se çdo vit që kalon, investimet e mëdha që bëjmë për ndërtimet, kërkojnë gjithnjë më shumë lëndë druri. Prandaj, nëse ecim me këto ritme në prerjen e pyjeve, do të vijë një ditë që nuk do të na dalë llogaria as me

plonin që kemi bërë. Kjo kërkon të përpilojmë një plan tjetër dhe për këtë duhet të marrim masa serioze që kësaj çështjeje t'i vëmë një rëndësi të dorës së parë edhe për të ardhmen e afërt, edhe për perspektivën, për periudhën pas 30-40 vjetësh. Ashtu sikurse i kemi vënë dhe i vëmë rëndësi çështjes së ullinjve, për t'i shfrytëzuar brezat e ardhshëm, kështu duhet të mendojmë edhe për problemin e pyllëzimeve. Mua më duket se pyllëzimi është më i lehtë të bëhet në ato vende ku ne kemi bërë prerje. U bënë 9 vjet, për shembull, që kemi ndaluar prerjen e druve në Llogora, megjithatë nuk po shohim që pyjet atje të rriten, janë mbjellë fidanë pyjorë, po zhvillimi i tyre është shumë i ngadalshëm, sepse mungon shërbimi, si për shembull, të mos mbillet vetëm një vit dhe të ndërpritet, po mbjellja të vazhdohet rregullisht për çdo vit.

Problemi tjetër që ne shqyrtojmë është ai i lëndëve djegëse. Jam dakord me të gjithë shokët për këtë problem, po ne duhet ta shohim më seriozisht, duke bërë konkretisht llogaritë. Ne investojmë dhe mund të investojmë edhe më shumë në këtë drejtim, që të gjejmë fusha të reja naftëmbajtëse, për të cilat kemi shpresa të mëdha. Në këtë situatë duhet të vendosim një regjim shumë të fortë për përdorimin e naftës. Nuk e kam çështjen që të kemi norma për harxhimin e naftës vetëm për automobilat, por norma të kemi edhe për ndërtimin e industrisë sonë në të ardhmen, e cila është parashikuar të punojë me naftë. Që të arrijmë suksese në këtë drejtim, duhet të mbajmë parasysh edhe përdorimin e metodave të dyta, se më duket që nganjëherë bëjmë teori. Çështjen e kam për t'u kujdesur e për të

shtuar përpjekjet që të shfrytëzojmë të gjitha rezervat gjeologjike. Të largohemi nga teoritë boshe, të caktojmë fondet e devizës së nevojshme për shpimet në zonat ku ka naftë, ta nxjerrim atë gjer në fund, ose të krijojmë mundësi t'i kthejmë ato në rezerva të shfrytëzueshme. Më duket se në këtë drejtim duhet të interesohe mi në mënyrë serioze. Pikërisht këtu të orientohemi, gjersa të krijojmë rezerva të mjaftueshme.

Për problemin e ngrohjes, studimet janë të mira. Ato që u ngritën këtu, janë të dobishme dhe duhet t'i zbatojmë sipas vendit dhe kushteve. Nuk është e drejtë të themi se në këto situata nuk mund të bëjmë gjë dhe të hidhemi në përdorimin e mjeteve ultramoderne për ngrohje, se nuk i kemi akoma mundësitë, por duhet të caktojmë një orientim, sipas të cilit të përdorim për ngrohje edhe qymyrin në një shkallë më të gjerë se deri tani, po jo ta lëmë këtë çështje në dorë të artizanatit dhe vetëm të pyesim nganjëherë i bëri apo nuk i bëri sobat. Nuk është aspak serioze ta lëmë këtë problem të madh vetëm si një orientim. Përdorimi më i gjerë i qymyrgurit duhet të bëhet gradualisht, gjithashtu ne nuk mund të zëvendësojmë menjëherë me gaz as drutë, as qymyrin. Zëvendësimin të mos e bëjmë vetëm me fjalë, po ta studiojmë mirë problemin, të marrim masa për briketimin e qymyrit të Alarupit dhe për heqjen e ujit, për përgatitjen e sobave rezistente, higjienike etj.

Të gjitha këto probleme duhet t'i marrim seriozisht, se po t'i ngremë vetëm në mënyrë teorike, po të mos hartojmë një plan mbi baza të shëndosha, po të mos sigurojmë mundësi realizimi për mungesë devize,

investimesh etj., atëherë këto që themi, do të mbeten në letër. Prandaj për çdo gjë të caktohen afate, si për shembull, sobat të bëhen brenda kësaj kohe, të caktohet sasia sa do të bëhen këtë vit, sa vitin tjetër, pra të sigurohet realizimi i tyre. Më vonë, kur të kemi me bollëk gaz dhe energji elektrike, do të kalojmë në një etapë tjetër, sepse do të kemi më shumë forcë ekonomike dhe rezerva më të mëdha, pra atëherë mund të bëjmë edhe ndryshimet përkatëse në përdorimin e lëndëve djegëse, kurse tani të mos ngopemi me lugë të zbrazët. e të hidhemi në përdorimin pa kriter e pa kursim të energjisë elektrike etj. T'u caktojmë detyra konkrete dikastereve përkatëse që merren me këto çështje, po t'u sigurojmë atyre në perspektivë edhe fondet. Në qoftë se nuk sigurohet deviza dhe materiali i nevojshëm, problemi nuk mund të zgjidhet.

Duke qenë në situata të vështira për rezerva lëndësh djegëse, mendoj se këtë çështje duhet ta shohim më konkretisht, të marrim vendime ç'duhet bërë, të caktojmë njëkohësisht edhe fondet përkatëse. Në këtë drejtim të përputhen mirë planet. Po kështu, në qoftë se do të përdorim qymyr për djegie, duhet të caktojmë zonat dhe afatet brenda të cilave duhet të realizohet kjo detyrë, duhet t'u japim këtyre zonave edhe sobat e përshtatshme. Këtë çështje, pra, ta rishikojmë me kujdes.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

HISTORIA ESHTË SHKENCË QË KËRKON TË PASQYROHEN DREJT NGJARJET

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

2 tetor 1964

Të gjitha vërejtjet që u bënë në këtë mbledhje, t'i shohë konkretisht redaksia. Në qoftë se del ndonjë gjë e re, atëherë të konsultohemi. Rëndësi ka çështja që vija e përgjithshme e Partisë të pasqyrohet drejt.

Lidhur me periudhën e Skënderbeut mendoj të bazohemi në formulën e Stalinit, që përcakton se ç'është kombi. Po unë jam me mendimin e Mehmetit për të dalë qartë karakteri i luftërave të popullit tonë para Rilindjes. Po të marrim historinë e popujve të tjerë, del se, për shembull, edhe kombi francez ose ai spanjoll nuk janë formuar menjëherë me lindjen e borgjezisë. Disa tipare themelore të kombit, si bashkësia e territorit, e gjuhës, kanë ekzistuar edhe përpara formimit të tij.

¹ Në këtë mbledhje u diskutua mbi disa probleme të vëllimit të dytë të «Historisë së Shqipërisë».

Duhet të dalë mirë në dukje që populli shqiptar edhe përpara Skënderbeut, megjithëse nuk ishte akoma një komb, sipas përkufizimit marksist, u rezistonte valëve të shumta të pushtesve. Pra shqiptarët kanë luftuar edhe në kohë të lashta për ruajtjen e fiseve të tyre. Kur vijmë në kohën e Skënderbeut, edhe më vonë, është më e kristalizuar ndjenja e mbrojtjes së vendit, të atdheut, të lidhjeve midis fiseve e princave shqiptarë. Skënderbeu ka luajtur një rol të madh për krijimin e shtetit shqiptar, të unitetit të popullit shqiptar, po këtë unitet, në atë kohë, si e përcakton marksizmi, nuk e gjen dot akoma të plotë si unitet kombëtar. Çështja është të dalë se me Skënderbeun, që udhëhoqi popullin shqiptar në aleancë me princat e tjerë shqiptarë, u forcuan shumë disa tipare themelore që do të qëndronin më vonë në bazën e formimit të kombit shqiptar; populli shqiptar kishte ekzistuar shumë kohë më parë, po me Skënderbeun ai futet në një etapë të rëndësishme.

Më vonë pati rënie, pati dobësim në lidhjet midis shqiptarëve, po rezistenca e popullit tonë nuk mori fund, ajo vazhdoi në mënyra spontane dhe të organizuara, pasive dhe aktive, ku kundër taksave, ku duke mos shkuar nizamë, ku kundër kajmekamëve të sulltanit, ku me luftë të armatosur etj. Kjo ishte një rezistencë e shumanshme, natyrisht, jo e organizuar mirë. Shkalla e organizimit të luftës ishte e lidhur me gjendjen e perandorisë, zhvillimin e forcave shoqërore, të mentalitetit të krerëve feudalë, siç ishte, për shembull, edhe Ali pashë Tepelena, të cilit nuk mund t'i vëmë atë frymë që kishin Silvio Peliko dhe kontët bor-

gjezë, si Kavuri, që ishin përfaqësues tipikë të borgjezisë italiane dhe që bënë risorxhimenton. Ne Rilindjen e kemi shumë të përparuar dhe ndryshon, për shembull, nga ajo italiane e kohës së Kavurit.

Fjala «Rilindje» ka fituar një traditë në historinë e popullit tonë, siç ka fituar edhe renesansa në Evropë. Rilindja jonë i ka të përcaktuara qartë karakteristikat e veta. Po të hidhemi edhe më përpara, te Ali Pasha dhe Bushatllinjtë. Këta kishin për qëllim të krijonin një dominim të tyre, kurse lufta për çlirim të vërtetë kombëtar, për të hedhur poshtë zgjedhën turke, fillon më vonë, luftë që mori një zhvillim të dukshëm me kryengritjet popullore të udhëhequra nga Rrapo Hekali e Zenel Gjoleka.

Çështja e Ali pashë Tepelenës dhe të tjera duhen përcaktuar mirë dhe më duket se në tekst janë përcaktuar drejt. Aliu kishte të gjitha karakteristikat e një pashai, por, nga ana tjetër, si shqiptar që ishte, ka pasur ndjenja shqiptare, prandaj kur u fut në luftë kundër turqve, kishte për qëllim që vendi të çlirohej prej tyre. Ai kishte mendimin të krijonte një pashallëk shqiptar dhe vetë synonte të bëhej sundimtar autonom. Kështu mund të themi edhe për Bushatllinjtë, po të dyja palët nuk arritën të bashkoheshin dot. Po pse mos ishte vallë Porta e Lartë e Sulltanit më e fortë se në kohën e Mehmetit të dytë, apo të Muratit të dytë, që ata s'arritën dot të çliroheshin? Jo, sulltanët nuk ishin më të fortë, edhe për faktin se atëherë në Evropë dhe në Ballkan ekzistonin lëvizjet çlirimtare, siç ishte sidomos revolucioni grek, që në atë kohë kishte marrë vrull. Çlirimi

nuk u arrit dot. Një nga arsyet ishte se Ali Pasha me Bushatllinjtë nuk u bashkuan me njëri-tjetrin.

Këto ngjarje në tekst të shkruhen ashtu siç janë zhvilluar, me karakteristikat e tyre të vërteta, sepse historia është shkencë dhe kërkon që ngjarjet të pasqyrohen kurdoherë drejt.

Me gjithë mendimet që u dhanë, shokët le ta rishikojnë edhe një herë, të bëjnë korrigjimet, siç thamë, në bazë të vërejtjeve që u bënë në Byrosë Politike, shumica e të cilave janë të drejta. Pastaj teksti të botohet.

*Botohet për herë të parë, me
ndonjë shkurtim, sipas tekstit
të nxjerrë nga procesverbali i
mbledhjes së Byrosë Politike
të KQ të PPSH që gjendet
në AQP*

**LETËR E HAPUR
ANËTARËVE TË PARTISË KOMUNISTE
TË BASHKIMIT SOVJETIK**

5 tetor 1964

Të dashur shokë,

Një gjendje e rëndë është krijuar në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare. Bashkimi Sovjetik, kampi socialist, partitë komuniste, çështja për të cilën komunistët dhe proletarët e gjithë botës kanë luftuar me heroizëm, duke mos kursyer as jetën e tyre, çështja e socializmit dhe e komunizmit ndodhen përpara një rreziku të madh, po kalojnë një nga periudhat më të vështira të historisë së tyre. Revizionizmi i hapët, përçarja e plotë, tradhtia dhe degjenerimi i kërcënojnë ato sot më shumë se kurdoherë tjetër.

Shkaktari dhe fajtori kryesor i kësaj gjendjeje të rëndë është grupi i Hrushovit. Ky grup, pasi shtiu në dorë, me metoda puçiste e komplotiste, udhëheqjen e partisë së lavdishme të krijuar nga Lenini i madh dhe të shtetit të parë e më të fuqishëm socialist në botë, të Bashkimit Sovjetik, është futur tanimë në rrugën e tra-

dhtisë më të madhe ndaj marksizëm-leninizmit e çështjes së socializmit, është bërë bartësi dhe përhapësi kryesor i rrymës oportuniste e revizioniste që bren sot lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare dhe që ka minuar në themel unitetin e saj.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste disa herë me radhë i kanë bërë thirrje udhëheqjes së partisë suaj, me N. Hrushovin në krye, që të heqë dorë nga vija e revizionizmit dhe e përçarjes, të rishikojë me kurajë pozitën e saj dhe të kthehet përsëri në rrugën e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, të dënojë qëndrimet e veta shoviniste e veprimet armiqësore ndaj partive motra e vendeve socialiste vëllezër dhe të rivendosë marrëdhëniet e miqësisë e të solidaritetit proletar me to.

Bile edhe pas Kongresit të 22-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, kur N. Hrushovi u vërsul me sulmet publike më të ulëta dhe me shpifjet më të përbindshme kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj, Partia jonë i është drejtuar udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që të rishikojë pozitën e saj dhe të rikthehet në rrugë të drejtë. «Partia e Punës e Shqipërisë, siç u tha në fjalinë e mbajtur më 7 nëntor 1961, me ndërgjegje të qetë e të pastër, i bën thirrje Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i bën thirrje Komitetit Qendror të ri që zgjodhi Kongresi i 22-të që, me drejtësinë leniniste, me objektivitet e gjakftohtësi, jo në mënyrë të njëanshme, të gjykojnë mbi gjendjen e krijuar në marrëdhëniet midis dy partive e dy vendeve tona. Partia jonë ka qenë kurdo-

herë e gatshme, për hir të unitetit të lëvizjes komuniste e të kampit socialist, të interesave të vendeve tona, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ekzistuese. Por ajo gjithnjë ka qenë dhe është e mendimit që këto çështje të zgjidhen drejt dhe vetëm në rrugë marksiste-leniniste në kushtet e barazisë dhe jo të presioneve e të diktatit»¹.

Edhe në prill të vitit 1963 Partia jonë, në një artikull të botuar në organin e Komitetit Qendror «Zëri i popullit», theksonte: «Në qoftë se N. Hrushovi është për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe forcimin e unitetit, këtë duhet ta tregojë me vepra, të ndërmarrë hapa realë e jofiktivë, të heqë të gjitha pengesat që ai ka krijuar në marrëdhëniet midis dy partive e dy vendeve tona. Ashtu siç guxoi të sulmojë në mënyrë shpifëse, të ndërhyjë në punët e brendshme dhe të kryejë veprime armiqësore kundër Partisë e vendit tonë, ashtu ai duhet të marrë edhe guximin t'i dënojë botërisht këto qëndrime e veprime antimarksiste dhe të kthehet në respektimin rigoroz të normave internacionaliste të marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtore e midis vendeve socialiste»².

Mirëpo grupi i Hrushovit jo vetëm nuk ia vuri veshin zërit të arsyes dhe i përbuzi këshillat shoqërore të Partisë sonë e të partive të tjera motra, por vazhdoi me këmbëngulje akoma më të madhe kursin e tij të tradhtisë, shtoi sulmet dhe veprimet armiqësore kundër Par-

1 Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 22, f. 168-169.

2 Nga artikulli i gazetës «Zëri i popullit», 18 prill 1963 me titull: «N. Hrushovi përsëri në rolin e demagogut, shpifësit dhe përcarësit».

tisë sonë dhe partive të tjera motra, kundër marksizëm-leninizmit, kundër unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste. Ngjarjet dhe faktet kanë provuar në mënyrë të pakundërshtueshme se N. Hrushovi është një tradhtar e armik i ndërgjegjshëm dhe i vendosur të ecë deri në fund në rrugën e tij kundërrevolucionare.

Vendimi i fundit për të thirrur arbitrarisht dhe në mënyrë të paligjshme një mbledhje të veçantë të partive që ecin pas gjurmëve të tij, është një komplot i ri i madh që flet qartë se grupi i Hrushovit është përçarësi më i madh që ka njohur historia e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Në këtë komplot të ri antikomunist që do të sanksionojë përçarjen e plotë e të hapët të kampit socialist e të lëvizjes komuniste, N. Hrushovi përpiket të tërheqë sa më shumë parti. Lidhur me këtë ai u ka dërguar të gjitha partive, ndërmjet tyre edhe Partisë sonë, një letër, me anën e së cilës njofton se ai ka vendosur të thërresë më 15 dhjetor të këtij viti mbledhjen e komisionit të redaktimit dhe nga mesi i vitit të ardhshëm mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Në letër Partia jonë ftohet të dërgojë në Moskë delegacionin e saj për të marrë pjesë në punimet e komisionit të redaktimit dhe të njoftojë sa më parë përbërjen e delegacionit.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke marrë parasysh se grupi i Hrushovit ka tradhtuar përfundimisht çështjen e marksizëm-leninizmit e të socializmit dhe se të gjitha përpjekjet e shpresat për ta sjellë atë në rrugë të drejtë kanë dështuar plotësisht,

ka vendosur të mos i përgjigjet letrës së tij të 30 korrikut 1964. Me grupin renegat të Hrushovit Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka të bëjë më.

Me këtë rast dhe në këto kushte Partia e Punës e Shqipërisë vendosi t'ju drejtohet me këtë letër të hapur juve, anëtarëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, pionierëve të kauzës së madhe të komunizmit, për të cilët ne kemi pasur dhe kemi një respekt e dashuri të thellë. Në këtë letër ne duam t'ju themi juve, me zemër të hapët e me sinqeritet vëllazëror, atë të vërtetë që N. Hrushovi jua ka fshehur për vite me radhë. Ai ju ka mashtruar dhe po ju mashtron. Ai ju ka mohuar juve çdo të drejtë të njiheni me materialet e Partisë sonë, të Partisë Komuniste të Kinës dhe të partive të tjera marksiste-leniniste.

Partia e Punës e Shqipërisë ju drejtohet juve, sepse ajo mendon se në këtë situatë përgjegjësia dhe roli juaj janë historikë. Ju përket juve të thoni fjalën tuaj. Në Bashkimin Sovjetik askush tjetër përveç jush nuk mund të ndalojë kursin revizionist të N. Hrushovit. Ju jeni forca që mund ta shpëtoni Bashkimin Sovjetik, atdheun e Tetorit të Madh dhe partinë e lavdishme të bolshevikëve nga qorrrokaku ku e ka futur N. Hrushovi, të mbronin marksizëm-leninizmin, nderin dhe dignitetin e Bashkimit Sovjetik, të ngrinin lart flamurin revolucionar të partisë suaj, të cilin N. Hrushovi e ka njollosur me turp.

Të dashur shokë,

Grupi i Hrushovit po bën një zhurmë të madhe rreth së ashtuquajturës mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Ai po mundohet t'ju mbushë mendjen juve dhe gjithë komunistëve të botës se kjo qenka një mbledhje e domosdoshme, se ajo gjoja do t'i shërbeka zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe forcimit të unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste. Ky është një mashtrim i madh, një bluf, një manovër e rrezikshme.

Në të vërtetë kjo mbledhje, si nga rrethanat në të cilat po thirret, nga mënyra se si po përgatitet ashtu edhe nga platforma politike e saj, nuk i shërben aspak çështjes së unitetit marksist-leninist. Ajo ka për qëllim të minojë unitetin, të përçajë përfundimisht lëvizjen komuniste, të konsolidojë pozitat e lëkundura të revizionizmit dhe të forcojë luftën kundër marksizëm-leninizmit, duke i bërë kështu shërbimin më të madh borgjezisë imperialiste.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë deklaron se Partia e Punës e Shqipërisë shprehet me vendosmëri kundër mbledhjes përçarëse të revizionistëve modernë dhe e dënon kategorikisht këtë komplot të ri të klikës hrushoviane.

Për ç'arsye Partia e Punës e Shqipërisë refuzon të marrë pjesë në këtë mbledhje dhe përse e dënon atë?

Së pari, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë është i bindur se, në kushtet dhe në rrethanat e sotme, kur në lëvizjen komuniste ndërkombëtare

ekzistojnë divergjenca të thella për çështje themelore e strategjike midis marksistë-leninistëve dhe revizionistëve, rreth të cilave zhvillohet tani një polemikë e madhe, thirrja me rrëmbim e mbledhjes së partive komuniste e punëtore nuk është në dobi të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të forcimit të unitetit mbi baza të shëndosha marksiste-leniniste, nuk është aspak «rruga më efektive për forcimin e kompaktësisë së lëvizjes komuniste», por përkundrazi, është rruga drejt minimit të plotë të saj.

Me pikëpamjet dhe me veprimet e tyre revizionistët modernë i kanë thelluar e i kanë ashpërsuar gjithnjë e më shumë divergjenca ekzistuese, e kanë minuar përherë e më tepër unitetin, janë futur gjithnjë e më thellë në llumin e tradhtisë e të përçarjes. Me të gjitha këto ata e kanë bërë edhe më të vështirë thirrjen e mbledhjes ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore, e kanë shtyrë edhe më larg atë. Tani duhet një punë më e madhe dhe një kohë më e gjatë për të përgatitur kushtet e nevojshme për thirrjen e mbledhjes që do t'i shërbente me të vërtetë unitetit marksist-leninist të kampit socialist e të lëvizjes komuniste.

Së dyti, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë deklaroi se mbledhja që po thirret tani me iniciativën e grupit të Hrushovit, është një mbledhje krejt arbitrare dhe e paligjshme, meqenëse janë shkelur brutalisht normat e parimet e sanksionuara në Deklaratën e Moskës të vitit 1960, që rregullojnë marrëdhëniet midis partive. Askush nuk ka të drejtë të thërrisë mbledhjen e përgjithshme të partive komuniste e punëtore sipas qejfit të vet, pa u konsultuar me partitë

e tjera dhe pa marrë më parë pëlqimin e tyre. Ne deklarojmë publikisht se asnjë konsultim paraprak nuk është bërë për këtë çështje me Partinë e Punës të Shqipërisë.

N. Hrushovi, krejt arbitrarisht, ka vendosur që parimin e sanksionuar në mbledhjen e Moskës të vitit 1960, të arritjes së pikëpamjeve unike me anën e konsultimeve të barabarta e shoqërore, ta zëvendësojë me parimin e nënshtrimit të pakicës ndaj shumicës. Partia e Punës e Shqipërisë është shprehur dhe shprehet kundër një parimi të tillë sepse kjo është një shkelje flagrante e barazisë dhe e pavarësisë së partive motra, është një orvatje për t'u imponuar të tjerëve vullnetin e së ashtuquajturës shumicë. Por edhe në qoftë se flasin për shumicën, shumica e vërtetë, reale dhe jo e rreme e fiktive, nuk është aspak në anën e revizionistëve. Kundër thirrjes së mbledhjes komuniste ndërkombëtare, në kushtet dhe në rrethanat e sotme, janë shprehur në mënyrë krejt të përcaktuar një numër i konsiderueshëm partish motra që kanë në radhët e tyre rreth gjysmën e komunistëve të mbarë botës pa llogaritur këtu një armatë të tërë komunistësh revolucionarë që bëjnë pjesë në partitë e vendeve të tjera, ku udhëheqjet kanë shkarë në pozita revizioniste dhe që gjithashtu dënojnë veprimet përçarëse e tradhtarë të N. Hrushovit.

Së treti, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë deklaroi se grupi i Hrushovit, duke organizuar në mënyrë të ngutshme, arbitrare dhe të paligjshme të ashtuquajturën mbledhje ndërkombëtare, në fakt ai përpiqet të organizojë një mbledhje fraksio-

nistësh. Kjo duket qartë edhe nga letra e 30 korrikut e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ku thuhet: «Sipas mendimit tonë, komisioni duhet të fillojë punën edhe në qoftë se ndonjëra nga të 26 partitë komuniste nuk do t'i dërgojë përfaqësuesit e saj në afatin e caktuar». Dhe më poshtë letra vazhdon: «Refuzimi i kësaj ose i asaj partie nga puna kolektive nuk mund të shërbejë si arsye për shtytje të reja në çështjen e realizimit të masave që kanë si qëllim përpunimin e rrugëve e të metodave të forcimit të unitetit internacjonalist të marksistë-leninistëve të të gjithë botës».

Pra, është e qartë se N. Hrushovi ka vendosur ta thërresë mbledhjen edhe pa pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shumë partive, të cilat qysh më parë janë shprehur kundër mbledhjes ndërkombëtare në kushtet dhe në rrethanat e sotme. Kjo do të thotë se, mbledhja që po thirret tani, do të jetë një mbledhje vetëm e udhëheqësve të disa partive, dhe kryesisht e atyre që ndjekin pas N. Hrushovit, do të jetë një mbledhje revizionistësh. Edhe vetëm ky fakt hedh poshtë gjithë demagogjinë e N. Hrushovit për gjoja unitet e kompaktësi dhe zbulon sheshit synimet e tij antimarksiste e përçarëse.

Tani po bëhet e qartë për të gjithë se grupi i Hrushovit, duke thirrur me ngut të ashtuquajturën mbledhje ndërkombëtare të partive komuniste e punëtorë, synon të arrijë dy objektiva kryesorë: nga njëra anë të intensifikojë luftën kundër marksizëm-leninizmit, të dënojë disa vende socialiste e disa parti komuniste dhe t'i «përrjashtojë» ato nga kampi socialist e lë-

vizja komuniste; dhe nga ana tjetër, të forcojë radhët e frontit revizionist, t'i nënshtrojë gjithë revizionistët ndaj diktatit të tij, t'u imponojë atyre një «kartë të re» duke u lidhur duar e këmbë.

Arritja e këtyre objektivave është vendimtare për fatet e grupit revizionist të Hrushovit, i cili gjendet përpara vështirësish shumë serioze. Lufta parimore dhe e vendosur e partive marksiste-leniniste dhe e komunistëve revolucionarë në botë jo vetëm u çori maskën revizionistëve hrushovianë dhe po shkatërron planet e tyre armiqësore, por ka krijuar në gjirin e vetë revizionistëve modernë situata të rënda. Midis tyre kanë lindur kontradikta të theksuara, të cilat shprehen qartë sidomos në tendencat për të kundërshtuar hegjemoninë dhe paternalizmin e grupit të Hrushovit.

Në këto kushte për revizionistët hrushovianë nuk mbetet rrugë tjetër: ata duhet ta çojnë deri në fund përçarjen me marksistë-leninistët, ndërsa aleatëve të tyre revizionistë t'ua vënë të dy këmbët në një këpucë, t'u imponojnë kontrollin dhe sundimin e tyre, të frenojnë çdo orvatje për pavarësi, sado formale qoftë ajo.

Këto plane që N. Hrushovi synon të arrijë me mbledhjen që po përgatit, kanë ndeshur në pengesa të mëdha, jo vetëm nga partitë marksiste-leniniste, që i kanë të qarta qëllimet tradhtarë të N. Hrushovit në dëm të komunizmit dhe të kampit socialist, por edhe nga disa aleatë të tij revizionistë. Në radhë të parë, duhet thënë se disa nga kundërshtarët revizionistë të mbledhjes së propozuar nga Hrushovi, të cilët, me gjithë këtë do të marrin pjesë në mbledhjen përgatitore, janë po aq revizionistë, bile edhe më konsekuentë se

vetë N. Hrushovi. Kundërshtimi i tyre për mbajtjen e mbledhjes ndërkombëtare nuk frymëzohet nga preokupacioni për unitetin e lëvizjes komuniste dhe të kampit socialist, por nga qëllimi që përçarjen e plotë dhe luftën kundër marksizëm-leninizmit ta bëjnë me metoda të ndryshme nga ato të N. Hrushovit, më efikase, sipas tyre, me më pak pasoja të rrezikshme për ta, duke i zgjatur jetën vetes me anë të krijimit të iluzioneve false rreth pozitës së tyre etj. Veç kësaj, kundërshtimi i tyre frymëzohet ngaqë nuk duan t'i vënë vetes zinxhirë në duar, duan të fitojnë «pavarësinë» nga klika hrushoviane, të jenë të lirë të lidhen drejtpërdrejt me socialdemokracinë apo me borgjezinë imperialiste, si dhe kur të duan.

Manovrat që po bëjnë tani N. Hrushovi dhe pauesit e tij, taktikat që ata po përdorin nuk mund të fshehin qëllimet antimarksiste të revizionistëve modernë, armiqësinë e tyre ndaj marksizëm-leninizmit. Ata nuk do të mund të mashtrojnë askënd. E bëjnë apo nuk e bëjnë mbledhjen revizionistët, e bëjnë tani apo më vonë, asgjë nuk ndryshon. Marksistë-leninistët e vërtetë do ta forcojnë edhe më shumë luftën e tyre parimore për demaskimin e revizionizmit hrushovian dhe të të gjithë revizionistëve modernë, luftë e cila do të sjellë disfatën dhe shkatërrimin e plotë të këtyre armiqve të rrezikshëm të komunizmit.

Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë dhe është për mbledhjen ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore. Por ajo ka qenë dhe është për një mbledhje që do t'i shërbente unitetit të vërtetë të lëvizjes komuniste mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe të interna-

cionalizmit proletar, mbi bazën e parimeve revolucionare të deklaratave të Moskës të viteve 1957 e 1960. Ajo ka qenë dhe është me vendosmëri kundër çdo mbledhjeje që do të sanksiononte përçarjen e hapët, ose që do të krijonte një unitet të rremë mbi baza antimarksiste, revizioniste.

Partia e Punës e Shqipërisë ka deklaruar edhe më parë dhe e përsërit edhe tani se, për të përgatitur një mbledhje të unitetit marksist-leninist të lëvizjes komuniste, është e domosdoshme të merren parasysh gjendja e sotme në lëvizjen komuniste, ndryshimet që janë bërë dhe proceset që janë zhvilluar në të qysh nga mbledhja e vitit 1960 dhe, në përshtatje me këto rrethana e kushte, të përcaktohen masat dhe hapat që duhen ndërmarrë për të arritur në një mbledhje ndërkombëtare që do të shprehte me të vërtetë mendimin dhe vullnetin e gjithë komunistëve të botës dhe do t'i shërbente arritjes dhe forcimit të atij uniteti luftarak për të cilin lëvizja jonë ka sot nevojë më tepër se kurrë.

Baza e vetme e unitetit të vërtetë të kampit socialist e të lëvizjes komuniste është marksizëm-leninizmi dhe internacionalizmi proletar. Asnjë bashkim nuk mund të bëhet mbi bazën e revizionizmit, asnjë bashkim nuk mund të ketë midis marksistëve dhe revizionistëve që kanë tradhtuar çështjen e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Plani i N. Hrushovit për bashkimin e lëvizjes komuniste mbi bazën e revizionizmit është plani i përçarjes dhe është i destinuar të dështojë me turp. Gjithashtu, çdo orvatje, çdo shpresë, çdo iluzion për të gjetur një platformë të ndërmjetme, të kënaqshme për të gjithë, që të bashkojë si

marksistët ashtu edhe revizionistët, është e kotë dhe pengon çështjen e arritjes së unitetit të vërtetë parimor të lëvizjes komuniste, që është i vetmi unitet i mundshëm.

Qëllimet tradhtarë që përpiqet të arrijë grupi i Hrushovit me mbledhjen e tanishme, nuk janë aspak të rastit. Drejt këtyre objektivave kanë synuar kurdoherë përpjekjet e revizionistëve hrushovianë: Ata e filluan përçarjen me përhapjen e kursit të tyre revizionist. Ata e thelluan përçarjen me veprimet e tyre anti-marksiste e antisocialiste. Dhe ata po e çojnë tani përçarjen deri në fundin logjik. Por revizionistët nuk duhet të harrojnë se nga mbledhja e tyre separatiste dhe nga «masat kolektive» që do të marrin ata, qiejt nuk do të përmbysen. Mbledhja e tyre do të jetë e frytshme dhe shumë e favorshme për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Dita e mbledhjes së revizionistëve do të mbetet në histori si dita e tradhtisë së tyre të plotë e të hapur dhe në të njëjtën kohë si dita që do të shënojë katastrofën e tyre përfundimtare. Lëvizja komuniste revolucionare do të ecë përpara, pa revizionistët dhe në luftë kundër revizionistëve dhe në këtë rrugë luftarake do të arrijë me siguri unitetin e saj. Ky do të jetë uniteti i vërtetë marksist-leninist për të cilin luftojnë dhe do të luftojnë me guxim marksistë-leninistët në botë.

Të dashur shokë,

N. Hrushovi përpiqet t'ju mbushë mendjen juve, komunistëve të Bashkimit Sovjetik, popujve sovjetikë dhe gjithë njerëzve në botë se, me ardhjen e tij në fuqi,

nis një epokë e re, një kthesë e madhe historike. Dekada e sundimit të tij paraqitet si dekada e «lulëzimit të Bashkimit Sovjetik», e «marshimit triumfal drejt komunizmit», si dekada e «triumfit të paqes e të bashkëzistencës paqësore», si dekada e «forcimit të lëvizjes komuniste» dhe e «zhvillimit krijues të marksizmit». Revizionistët modernë e fillojnë «historinë e vërtetë» të Bashkimit Sovjetik që nga viti 1953.

Të gjitha këto janë gënjeshtër dhe vetëm gënjeshtër. Me ardhjen në fuqi të grupit të Hrushovit, fillon me të vërtetë një kthesë historike, por kjo është një kthesë e madhe regressive, kthesa që i hapi dyert oportunizmit dhe revizionizmit, tradhtisë e degjenerimit, minimin të unitetit dhe fillimit të përçarjes në lëvizjen komuniste, afrimit dhe bashkimit me imperializmin e armiqtë e tjerë të popujve dhe të socializmit, sabotimit të revolucionit dhe restaurimit të kapitalizmit.

Asnjë njeri dhe asnjë grup tjetër deri më sot nuk u ka shkaktuar Bashkimit Sovjetik, kampit socialist, lëvizjes komuniste, çështjes së socializmit e të komunizmit dëme dhe të këqija kaq të mëdha sa Hrushovi dhe grupi i tij. Historia e Bashkimit Sovjetik dhe e komunizmit ndërkombëtar nuk njeh renegat më të madh e armik më të tërbuar e më të rrezikshëm sesa grupi revizionist hrushovian.

Atë që nuk mundën të bënin në kohën e tyre imperialistët me intervencionin e armatosur, Trocki, Buharini dhe armiqtë e tjerë të pushtetit sovjetik, atë që nuk mundën të bënin dot fashistët gjermanë në kohën e Luftës së Dytë Botërore, po përpiqet ta bëjë tani grupi i Hrushovit.

Kush e ka poshtëruar, kush e ka diskredituar, kush e ka sulmuar më rëndë, kush ka shpifur më shumë se N. Hrushovi kundër pushtetit sovjetik, kundër rendit socialist sovjetik?

Është Hrushovi ai që i vuri kryq periudhës më të lavdishme të Bashkimit Sovjetik, kur populli sovjetik, nën udhëheqjen e partisë, me Stalinin në krye, kapërcëu vështirësi kolosale, i bëri ballë me guxim rrethimit të egër kapitalist, shpartalloi kundërrevolucionin, ndërtoi për të parën herë në botë shoqërinë socialiste, korri fitoren e madhe historike në luftën patriotike dhe e shndërroi Bashkimin Sovjetik në një shtet të fuqishëm të zhvilluar e të përparuar socialist, me një autoritet dhe rol të paparë në arenën ndërkombëtare. Ai e parqiti të gjithë këtë periudhë si periudhën gjatë së cilës në Bashkimin Sovjetik kanë mbretëruar terrori e persekutimet, burgjet e kampet e përqendrimit, shkeljet e ligjshmërisë e të demokracisë, arbitrariteti e despotizmi, varfëria dhe uria. Me të gjitha këto N. Hrushovi u bëri një shërbim shumë të madh imperialistëve, duke u dhënë armë për të sulmuar e për të diskredituar Bashkimin Sovjetik. Raporti famëkeq «sekret» që Hrushovi mbajti në Kongresin e 20-të, si dhe fjalimet e tjera të tij, u bënë ushqimi kryesor, burimi i pashtershëm për të gjithë propagandën më reaksionare antikomuniste e antisovjetike.

Kush mund t'i besojë Hrushovit për shpifjet e tij mbi krimet e Stalinit? A mund t'u zihet besë trillimeve të komisioneve hetimore të krijuara nga Hrushovi, shkrimeve të Axhubejve dhe ditarëve të Solxheni-

cinëve¹ me shokë? Mos vallë imperializmi dhe agjentët e tij, që e kishin halë në sy Bashkimin Sovjetik dhe që donin ta mbytnin atë që në djep, paskan ndenjor duar-kryq dhe s'paskan bërë asgjë kundër tij? Dikur vetë N. Hrushovi më 1938 pat thënë: «Jakirët, balickët, tjupçenkët, zatonskët dhe maskarenjtë e tjerë donin të sillnin në Ukrainë panët polonezë, donin të binin këtu fashistët gjermanë, çifligarët dhe kapitalistët... Ne kemi shfarosur shumë armiq, por akoma jo të gjithë. Prandaj duhet t'i mbajmë sytë hapur. Ne duhet të kemi gjithmonë në mendje fjalët e shokut Stalin se gjersa ekziston rrethimi kapitalist, në vendin tonë do të dërgohen spiunë dhe diversantë».

Po ky Hrushov, një vit më parë, më 1937, thoshte: «Partia jonë do të shtypë pa mëshirë bandën e tradhtarëve, do të fshijë nga faqja e dheut gjithë kërmën trockiste të djathtë. Garanci për këtë është udhëheqja e patundur e Komitetit tonë Qendror, udhëheqja e patundur e udhëheqësit tonë shokut Stalin... Ne do t'i shfarosim gjer në fund armiqtë, nga i pari gjer tek i fundit, dhe do ta shpërndajmë hirin e tyre në erë». Por në vend që të fshinte nga faqja e dheut kërmën trockiste, të shfaroste të gjithë armiqtë e të hidhte në erë hirin e tyre, renegati Hrushov dogji trupin e Stalinit, hodhi në erë hirin e tij, të këtij mbrojtësi dhe udhëheqësi të madh të fitoreve historike, të Bashkimit Sovjetik, rehabilitoi nga i pari deri tek i fundit gjithë kundërrevolucionarët, i shpalli ata viktime të Stalinit dhe vendosi t'u ngrejë atyre përmendore.

¹ Solxhenicin — shkrimtar kundërrevolucionar ultrarevolucionist.

Se ç'viktima janë këto që merr në mbrojtje N. Hrushovi, ne, shqiptarët, e dimë fort mirë nga eksperiencia jonë. Ndërsa udhëheqësit e Partisë e të shtetit shqiptar, që kanë udhëhequr popullin në luftën e madhe të çlirimit e të ndërtimit të socializmit, Hrushovi i ka quajtur agjentë të imperializmit të shitur për 30 aspra, vrasës e terroristë; armiqtë e Partisë e të popullit tonë i ka marrë hapur në mbrojtje duke i quajtur komunistë të vërtetë revolucionarë, internacionalistë, patriotë e viktima të pafajshme.

Vetëm një tradhtar, një armik i komunizmit mund të vërsulet kundër Stalinit, udhëheqësit të madh të Partisë Komuniste, të popullit sovjetik dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare me shpifjet dhe sulmet më të përbindshme. Hrushovi ua ka kaluar edhe imperialistëve, reaksionarëve dhe renegatëve më të tërbuar të komunizmit, Kautskit, Trockit, Titos e Gjilasit, në sulmet e tij antikomuniste kundër Stalinit. E çfarë s'ka thënë ai kundër Stalinit! Ai ka quajtur «vrasës», «kriminel ordiner», «despot të tipit të Ivanit të tmerrshëm», «diktatori më i madh në historinë e Rusisë» etj., etj. J. V. Stalini, atë që për 30 vjet me radhë udhëhoqi partinë e bolshevikëve dhe popullin sovjetik nga fitorja në fitore, atë që mbrojti me guxim vijën e Leninit të madh, atë që frymëzoi Stahanovët dhe heronjtë e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, atë që ngriti peshë dhe udhëhoqi me vendosmëri punëtorët e fshatarët, gjithë popullin sovjetik, në Luftën e Madhe Patriotike, atë me emrin e të cilit në gojë u hodhën në sulm mbi armiqtë dhe u vranë Matrosovët, Kosmodemjanskajat, heronjtë e Stalingradit e qindra mijë heronj e luftëtarë të tjerë.

A nuk keni menduar, shokë, vallë përse shprehet një urrejtje kaq e egër për Stalinin, përse ai sulmohet e diskreditohet me kaq tërbim, përse nxihet me kaq paturpësi e gjithë periudha e lavdishme e popullit sovjetik dhe e partisë së tij kur në krye ishte J. V. Stalini? Dhe a nuk shikoni ju një lidhje logjike midis sulmeve dhe shpifjeve kundër Stalinit dhe lëvdatave e mburrjeve për krerët e imperializmit, për Ajzenhauerin, Kenedin, Xhansonin etj., të cilët Hrushovi i ka quajtur njerëz «të arsyeshëm», që «gëzojnë besimin absolut të popullit të tyre», që «preokupohen seriozisht për ruajtjen e paqes», dhe vdekjen e ndonjërit prej këtyre udhëheqësve të imperializmit, sikurse ishte rasti i Kenedit, ai e ka konsideruar si «humbje të madhe për njerëzimin» dhe e ka shpallur ditë zije edhe për komunistët? Vetëm një sharlatan, një njeri pa karakter e pa cipë mund të veprojë ashtu si veproi Hrushovi ndaj Stalinit, të cilit ai, sa ishte gjallë, i thurte ditirambe, e quante «mik të afërt e shok luftime të Leninit të madh», «mik të popullit e at të dashur», «mareshalin e madh të fitores kundër fashizmit», «gjeniun e udhëheqësin më të madh të njerëzimit».

Si është e mundur që ju, komunistët sovjetikë, populli sovjetik, arritët fitore kolosale historike duke pasur në krye të partisë e të shtetit një njeri që bënte vetëm krime e gabime të gjithfarëllojshme? A ka absurditet më të madh e falsifikim më trashanik të historisë sesa kur mohohen meritat e mëdha të Stalinit si udhëheqës i partisë e komandant suprem i Ushtrisë Sovjetike dhe ngrihen në qiell roli e meritat e N. Hrushovit, i cili paraqitet si strateg i madh jo vetëm i Luftës Patriotike,

por edhe i luftës civile, si pionier i erës kozmike etj., etj. Është për të ardhur keq se edhe disa shokë lufte të Stalinit, të cilët bashkë me të dhe nën udhëheqjen e tij drejtuan operacionet e mëdha gjatë Luftës Patriotike, tani, sipas direktivave të Hrushovit, falsifikojnë historinë, mohojnë atë që kanë pohuar dje vetë me gojën e tyre.

Me shpifjet dhe me sulmet e ulëta kundër Stalinit, të denja vetëm për një njeri të rrugës, N. Hrushovi fyen rëndë popullin e madh sovjetik, partinë e tij, diktaturën e proletariatit dhe rendin socialist sovjetik, fyen Ushtrinë e lavdishme Sovjetike, lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe popujt e punonjësit e gjithë botës, fyen socializmin dhe marksizëm-leninizmin. Dikur vetë Hrushovi ka pas thënë «kush ngre dorën kundër shokut Stalin, ai e ka ngritur atë kundër ne të gjithëve, kundër klasës punëtore, kundër punonjësve! Kush ngre dorën kundër shokut Stalin, ai e ka ngritur atë kundër doktrinës së Marksit, Engelsit dhe Leninit» (nga fjalimi në mitingun e Moskës në janar të vitit 1937).

Pikërisht këtë bëri vetë Hrushovi. Duke ngritur dorën kundër Stalinit, ai ngriti dorën kundër të gjithëve, kundër komunizmit, kundër marksizëm-leninizmit.

Duke ngritur dorën kundër Stalinit, Hrushovi ngriti dorën kundër vetë sistemit socialist sovjetik. Ai ka frikë ta pohojë këtë publikisht, me gjithë thirrjet që i bëhen nga aleatët e tij më konsekuentë për t'i shkuar deri në fund likuidimit të pasojave të «kultit». Por fakti është se duke i quajtur tri dekadat e udhëheqjes së Stalinit një anomali, një largim nga rruga leniniste dhe duke punuar intensivisht për minimin e sistemit

socialist, Hrushovi po shqelmon vetë sistemin socialist sovjetik dhe po udhëheq evolucionin paqësor të degjenerimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik. Dhe, o ironi, këtë rrugë tradhtarë socialdemokrate ai e quan «kthim te Lenini», «ndjekje të rrugës së vërtetë leniniste»!

Ky është qëllimi dhe kuptimi i vërtetë i gjithë zhurmës së N. Hrushovit mbi të ashtuquajturën luftë kundër kultit të individit dhe pasojave të tij.

Grupi i Hrushovit ka ngritur dorën kundër gjësë më të shtrenjtë, armës më të fuqishme të popullit sovjetik për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit dhe për ndërtimin e komunizmit, kundër diktaturës së proletariatit dhe partisë komuniste. Ai po orvatet ta çarmatosë popullin, t'i heqë nga duart pushtetin, të degjenerojë partinë. Ai ka shqelmuar dhe e ka hedhur poshtë vijën konsekuente marksiste-leniniste të partisë bolshevike, traditat dhe frymën e saj revolucionare, i ka imponuar partisë një kurs oportunist e revizionist në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë, kurs që ka vënë në rrezik fitoret historike të socializmit në Bashkimin Sovjetik, për të cilat partia dhe populli sovjetik kanë luftuar me heroizëm të madh, kanë bërë sakrifica të shumta, kanë derdhur gjak.

Për të realizuar këtë kurs klika revizioniste e Hrushovit ka bërë spastrime të mëdha të vazhdueshme në radhët e kuadrove të partisë e të shtetit, si në qendër ashtu edhe në bazë, duke larguar të gjithë kuadrot të cilët ajo nuk kishte besim dhe duke vendosur në vend të tyre kuadro besnikë të kursit të saj. Brenda dhjetë vjetëve Hrushovi ka përjashtuar nga Komiteti

Qendror, i zgjedhur në Kongresin e 19-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në vitin 1952, mbi 70 për qind të anëtarëve të tij dhe në Kongresin e 22-të përjashtoi nga Komiteti Qendror, i zgjedhur në Kongresin e 20-të, rreth 50 për qind të anëtarëve të tij. Po kështu, në prag të Kongresit të 22-të ai, nën pretekstin e qarkullimit të kuadrit, zëvendësoi 45 për qind të anëtarëve të komiteteve qendrore të partive të Republikave të Federuara, të komiteteve të partisë të qarqeve dhe të krahinave, si dhe 40 për qind të anëtarëve të komiteteve të partisë të qyteteve dhe të rajoneve. Në vitin 1963 klika e Hrushovit zëvendësoi edhe një herë, nën pretekstin e riorganizimit të partisë mbi bazën e prodhimit, më tepër se gjysmën e anëtarëve të komiteteve qendrore të Republikave të Federuara dhe të komiteteve të partisë në qarqe.

Njerëzit që rrethojnë sot N. Hrushovin dhe që i shërbejnë atij, përbëjnë një shtresë të privilegjuar, të degjeneruar nga pikëpamja ideologjike, që ka tradhtuar çështjen revolucionare të klasës punëtore sovjetike, që lufton kundër marksizëm-leninizmit dhe socializmit. I vetmi preokupacion i tyre është forcimi i pozitës së vet ekonomike dhe i sundimit të vet politik. Grupi i Hrushovit, i mbështetur te kjo shtresë, po e kthen Partinë e lavdishme komuniste të Bashkimit Sovjetik në një parti revizioniste dhe shtetin socialist sovjetik në një diktaturë të klikës hrushoviane.

Tezat e tij mbi të ashtuquajturën «parti të të gjithë popullit» dhe «shtet të të gjithë popullit» janë një mashtrim i madh. Ato s'kanë asgjë të përbashkët me marksizëm-leninizmin dhe shërbejnë vetëm për përga-

titjen e terrenit për restaurimin e kapitalizmit. «Ecja përpara, domethënë drejt komunizmit, kalon përmes diktaturës së proletariatit dhe ndryshe as që mund të bëhet», ka thënë Lenini. Duke e shpallur të likuiduar diktaturën e proletariatit në Bashkimin Sovjetik, grupi i Hrushovit bën një hap prapa shumë të rrezikshëm drejt kapitalizmit. I ashtuquajtur i «shtet i gjithë popullit» i N. Hrushovit s'është gjë tjetër veçse një maskë për të fshehur diktaturën e klikës së tij, që drejtohet kundër klasës punëtore dhe fshatarësisë sovjetike, kundër popullit sovjetik. N. Hrushovi lufton vetëm kundër diktaturës së proletariatit dhe është për ruajtjen e pushtetit shtetëror, për ta përdorur atë si mjet për realizimin e qëllimeve të veta kundërrevolucionare dhe për të mbajtur të shtypur e të nënshtruar popullin dhe komunistët sovjetikë. Po kaq e rrezikshme është edhe teza mbi «partinë e të gjithë popullit», e cila fshin karakterin klasor proletar të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe hap rrugën për degjenerimin e partisë marksiste-leniniste në një parti revizioniste. Këtyre qëllimeve u shërbejnë të gjitha organizimet dhe riorganizimet në parti e në pushtet që ka ndërmarrë N. Hrushovi herë pas here.

Shokë, pushteti sovjetik, pushteti i parë socialist në botë që vendosi Revolucioni i Tetorit, Partia e madhe Komuniste e Bashkimit Sovjetik, ndodhen përpara rrezikut shumë serioz të degjenerimit të tyre në një pushtet borgjez dhe në një parti revizioniste borgjeze. Në këto momente pasiviteti është i pafalshëm dhe vdekjeprurës. Përpara masave të gjera të anëtarëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të popullit

sovjetik shtrohet imperative detyra e lartë dhe e shenjtë historike: të mbrohet diktatura e proletariatit, të mbrohet Partia Komuniste e themeluar nga Lenini.

N. Hrushovi, që kur ka ardhur në fuqi, ka marrë një varg masash e reformash në fushën e ekonomisë, e sidomos të bujqësisë, rreth të cilave ka bërë një zhurmë të madhe. Por cili është qëllimi dhe kuptimi i vërtetë i këtyre masave dhe reformave? Ato janë në kundërshtim me parimet e socializmit e të komunizmit, ato janë një orvatje për të futur në ekonominë socialiste sovjetike forma të tilla organizimi dhe metoda të tilla drejtimi të marra hua nga eksperiencia e Jugosllavisë titiste dhe e vendeve kapitaliste. Grupi i Hrushovit e ka zëvendësuar parimin socialist të shpërblimit sipas punës me stimul material të absolutizuar e të fetishizuar prej tij, ka minuar drejtimin e planifikuar e të centralizuar të ekonomisë, ai po inkurajon parimin kapitalist të luftës për fitime, nxit konkurrencën e lirë kapitaliste, shkatërron pronën e përbashkët të të gjithë popullit dhe e copëton atë, sikurse veprimet me stacionet e makinave dhe të traktorëve.

Komunizmi i N. Hrushovit është në thelb një variant i socializmit borgjez. Britmat e tij mbi kujdesin për të mirën e popullit, për një jetë më të mirë për çdo njeri, janë krejt hipokrite e demagogjike. Ajo për të cilën merakoset grupi i Hrushovit është kujdesi për një jetë më të mirë, më të rehatshme e më të begatshme, për një shtresë të privilegjuar e të degjeneruar, e cila siguron të ardhura të mëdha në formën e rrogave, shpërblimeve dhe të honorareve të larta dhe me anë të shpërdorimeve, ryshfeteve, vjedhjeve etj. Idealin e

lartë të komunizmit Hrushovi e ka reduktuar te «pjata e mirë me gulash». Si model të komunizmit të tij ai merr Shtetet e Bashkuara të Amerikës, eksperiencën e industrialistëve dhe rekomandimet e fermerëve të mëdhenj amerikanë, të Itonëve dhe Harstëve me shokë. Ai ka arritur deri atje sa t'u shtrijë dorën imperialistëve amerikanë që, me dollarët dhe kreditë e tyre, «të ndërtojnë» komunizmin në Bashkimin Sovjetik. Revizionistët hrushovianë u kanë hapur dyert depërtimit të ideologjisë borgjeze, mënyrës së jetesës borgjeze, degjenerimit borgjez në art, në letërsi e në kulturë, gjallërimit të gjithfarë tendencave antisovjetike, anti-socialiste, përhapjes së rrymave dekadente perëndimore. Ata propagandojnë me të madhe individualizmin dhe egoizmin borgjez, humanizmin dhe pacifizmin borgjez.

A nuk flasin qartë të gjitha këto se në ç'rrugë të rrezikshme po e fut Bashkimin Sovjetik N. Hrushovi? Të gjitha këto nuk janë aspak hapa përpara drejt komunizmit, por hapa prapa drejt kapitalizmit. Në këto rrethana përpara komunistëve revolucionarë sovjetikë, përpara popullit sovjetik, shtrohet çështja: a do të lejojnë ata që grupi i Hrushovit të realizojë me qetësi veprën e tij kriminale, kundërrevolucionare, apo do të ngrihen në mbrojtje të fitoreve të socializmit e të komunizmit në Bashkimin Sovjetik dhe të ndalin kursin antisovjetik e antisocialist të N. Hrushovit?

Të dashur shokë,

Sa kohë që partia juaj mbante lart të pastër flamin e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit

proletar dhe ndiqte një vijë konsekuente revolucionare në të gjitha çështjet e politikës së brendshme e të jashtme, Bashkimi Sovjetik për dekada të tëra ka qenë kësh-tjella e revolucionit dhe e socializmit, flamurtari i luftës kundër imperializmit, mbrojtësi e përkrahësi i madh i lirisë e i pavarësisë së popujve, luftëtar i madh për çështjen e çlirimit të klasës punëtore e të paqes në botë. Komunistët revolucionarë dhe popujt e të gjithë botës e shikonin me respekt të thellë dhe me dashuri të madhe Bashkimin Sovjetik, merrnin shembull dhe frymëzoheshin nga qëndrimi i tij parimor, revolucionar. Krijimi i kampit socialist, rritja e lëvizjes komuniste e punëtore, hovi i madh i luftës çlirimtare të popujve janë të lidhura ngushtë me rolin dhe kontributin internacionalist të vendit të parë të socializmit, Bashkimit Sovjetik. Në këtë kohë në kampin socialist, në lëvizjen komuniste dhe në të gjitha organizatat demokratike ndërkombëtare ekzistonte një unitet i plotë mendimi dhe veprimi. Të gjitha forcat revolucionare të botës, me Bashkimin Sovjetik në krye, vepronin të bashkuara si një trup i vetëm kundër forcave të imperializmit dhe të reaksionit.

Por N. Hrushovi, me kursin e tij politik, u vuri minat prestigjit, autoritetit dhe rolit të Bashkimit Sovjetik në botë. Ai, në emër të Bashkimit Sovjetik, përçan kampin socialist e lëvizjen komuniste ndërkombëtare, saboton dhe mbyt revolucionin e luftën çlirimtare të popujve, mashtron dhe frikëson popujt, zbukuron e mbron kapitalizmin dhe imperializmin.

Shikoni, shokë, ç'tragjedi të madhe po luan grupi i Hrushovit me vendin tuaj, që ka kaq tradita të shkël-

qyera revolucionare, kaq merita të mëdha historike! Ai e ka lidhur dhe po e bashkon gjithnjë e më shumë Bashkimin Sovjetik me armiqtë e tërbuar, me ata kundër të cilëve komunistët dhe populli sovjetik kanë bërë një luftë të vendosur dhe heroike.

Grupi i Hrushovit ka bërë aleatë dhe miq të Bashkimit Sovjetik ata që duan t'i bëjnë varrin këtij. Ai ka bërë aleat dhe mik të Bashkimit Sovjetik imperializmin amerikan që është koka e imperializmit botëror, qendra e reaksionit dhe burimi kryesor i luftës e i agresionit, shfrytëzuesi dhe xhandari ndërkombëtar, armiku numër një i popujve të të gjithë botës.

Ai ka bërë mik e vëlla klikën e Titos, që ka tradhtuar me kohë marksizëm-leninizmin, që zhvillon një veprimtari minuese kundër forcave të socializmit, të lirisë e të paqes në botë, që i shërben me zell imperializmit, që mbahet në këmbë me dollarët amerikanë dhe që është dënuar njëzëri nga lëvizja komuniste ndërkombëtare.

Miq dhe aleatë të tij janë bërë renegatët e klasës punëtore, shërbëtorët e borgjezisë dhe antikomunistët e tërbuar, krerët e djathtë reaksionarë socialdemokratë, si Gi Mole, Spaku, Uilsoni e të tjerë.

Miq e aleatë të tij janë bërë borgjezia reaksionare indiane, të cilën N. Hrushovi e armatos dhe e ndërson për të shtypur popullin indian dhe për të zhvilluar agresion kundër një vendi vëlla, siç është Republika Popullore e Kinës.

Miq dhe aleatë të tij janë bërë Vatikani i Romës, kjo qendër e vjetër reaksioni dhe obskurantizmi, janë bërë të gjitha forcat reaksionare dhe kundërrevolucio-

nare të botës, deri te revanshistët e Bonit, me të cilët Hrushovi po përpiqet të bjerë në ujdi.

Gjithë t'këtë e luftës së tij N. Hrushovi e ka drejtuar kundër aleatëve dhe miqve të vërtetë e besnikë të Bashkimit Sovjetik.

Ju jeni në dijeni të sulmeve të egra, të shpifjeve dhe të akuzave monstruoze, të veprimeve armiqësore që grupi i Hrushovit ka bërë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, Republikës Popullore të Shqipërisë, popullit shqiptar dhe udhëheqësve të tij. E për çfarë nuk i ka akuzuar ai Partinë dhe popullin tonë! Në luftën kundër Partisë e popullit tonë ai përdori kërcënimet dhe presionet, ndërhyri brutalisht në punët e brendshme, vendosi bllokadën ekonomike dhe preu marrëdhëniet diplomatike. Ai, nga tribuna e Kongresit të 22-të, u bëri thirrje të hapura komunistëve dhe popullit shqiptar për kundërrevolucion, për përmbysjen e udhëheqjes së partisë e të shtetit, thirrje që përsëriten vazhdimisht nëpërmjet organeve të propagandës sovjetike, dhe sidomos të radio Moskës në emisionet e saj për Shqipërinë. Po përse gjithë kjo urrejtje, gjithë kjo armiqësi ndaj një vendi socialist, ndaj një partie marksiste dhe një populli vëlla, urrejtje dhe armiqësi që nuk e kanë shprehur ndaj vendit tonë as armiqtë imperialistë më të tërbuar? Cili ishte «krimi» që kishin kryer kjo Parti e ky popull? «Krimi» i vetëm i tyre ishte se ata nuk pranuan t'i nënshtroheshin vijës tradhtarë të N. Hrushovit, dolën në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, demaskuan dhe kundërshtuan qëllimet përçarëse të revizionistëve.

Një luftë të ashpër zhvillon grupi i Hrushovit ku-

ndër vendeve të tjera socialiste që nuk i nënshtrohen diktatit të tij, si dhe kundër të gjitha partive komuniste që kundërshtojnë revizionizmin dhe mbrojnë marksizëm-leninizmin. Kundër tyre ai përdor të gjitha armët e metodat që përdorin armiqtë e klasës. Ai ndërhyr brutalisht në punët e tyre të brendshme, shkel sovranitetin dhe pavarësinë e tyre, bën presione e shantazhe për gjunjëzimin e tyre, mbjell përçarje dhe organizon komplete, siç bëri kohët e fundit edhe kundër Partisë Komuniste të Japonisë, përdor organizmat e përbashkët të Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke dhe të Traktatit të Varshavës për t'i vënë vendet socialiste nën sundimin e grupit të tij, për t'i shfrytëzuar ato për qëllimet e veta egoiste e shoviniste.

Me të gjithë kursin dhe veprimtarinë e tij N. Hrushovi u ka sjellë dhe po u sjell shërbime të mëdha imperializmit dhe reaksionit botëror dhe ka dëmtuar e po dëmton rëndë çështjen e socializmit, të lirisë së popujve e të paqes në botë.

Revizionizmi modern, që u përhap me vrull të madh pas Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, u hapi rrugën kundërrevolucionit të përgjakshëm në Hungari, ngjarjeve kundërrevolucionare në Poloni, vuri në rrezik vetë ekzistencën e disa partive komuniste e punëtore, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Danimarkë e gjetkë. Duke ndjekur kursin e Hrushovit, Partia Komuniste e Indisë, me Dangen në krye, është shndërruar në një vegël të borgjezisë së madhe reaksionare, në një parti nacional-shoviniste që ka tradhtuar idealet e klasës punëtore dhe të popullit indian. Në Algjeri revizionistët e larguan

partinë nga lufta e armatosur bashkë me popullin, e izoluan atë nga masat, e vunë në bisht të situatës dhe humbën kështu vendin e saj në jetën politike të Algjerisë. Një tragjedi të vërtetë pësoi Partia Komuniste e Irakut, e cila, pasi iu nënshtrua presionit nga ana e grupit të Hrushovit, ndoqi një vijë oportuniste, humbi vigjilencën dhe, për pasojë, u godit rëndë nga reaksioni dhe çështja e revolucionit në Irak pësoi një dështim të madh.

Revizionizmi po bren shumë parti komuniste e punëtoje, sidomos në Evropë, e cila është mbarsur me revizionizëm. Ato po shndërrohen nga parti të revolucionit social në parti të reformave sociale, po afrohen e po shkrihen me socialdemokratët, po largohen nga traditat dhe fryma revolucionare, po nanurisen me iluzionet e rrugës paqësore parlamentare, të cilën revizionistët e kanë ngritur në një parim strategjik botëror.

N. Hrushovi, për hir të çështjes së afrimit me çdo kusht dhe të bashkëpunimit të gjithanshëm me imperializmin amerikan, së cilës i shërben në të vërtetë e gjithë e ashtuquajtura politikë e tij e bashkekzistencës paqësore, ka kryer krime të rënda kundër lirisë e pavarësisë së popujve, kundër paqes, kundër vetë Bashkimit Sovjetik, kundër sigurimit të tij. Për hir të këtij afrimi e pajtimi Hrushovi, pas veprimeve aventureske, kapitulloi me turp gjatë krizës së Karaibeve përpara imperializmit amerikan, duke mos ngurruar të sakrifikojë as sovranitetin e Kubës. Çfarë turpi i ngarkoi ai Bashkimit Sovjetik, forcave të tij të armatosura, kur lejoi imperialistët amerikanë të kontrollojnë në det të hapët, në mënyrën më poshtëruese, anijet sovjetike, në një kohë

kur Kuba, një vend i vogël, 90 milje larg SHBA-së, mbrojti me nder dinjitetin e vet, nuk lejoi asnjë kontroll imperialist në tokën e vet, bile as kontrollin imperialist në anijet sovjetike brenda ujërave territoriale kubane.

N. Hrushovi sakrifikoi interesat kombëtare të popullit kongolez kur votoi për ndërhyrjen e trupave të OKB-së nën drejtimin e imperialistëve amerikanë. Ky kompromis solli pasoja tragjike për kauzën e lirisë e të pavarësisë së popullit kongolez, që tanimë dihen nga të gjithë.

Një tradhti dhe mashtrim i madh për popujt ishte Traktati i Moskës mbi ndalimin e pjesshëm të provave të armëve bërthamore, i cili në fakt drejtohet kundër interesave të vetë Bashkimit Sovjetik e të kampit socialist, i jep mundësi imperializmit amerikan të vazhdojë në mënyrë të njëanshme provat e nëndheshme e të rritë potencialin e tij atomik, të vazhdojë shantazhin bërthamor për të kërcënuar e për të trembur popujt.

Pazarllëqet e Hrushovit me imperializmin në kurriz të popujve janë të shumta. Me gjithë zhurmën e bërë për disa vjet me radhë për nënshkrimin e traktatit të paqes me Gjermaninë dhe zgjidhjen e problemit të Berlinit Perëndimor, tani ai e ka braktisur gati fare këtë çështje dhe, në prag të vizitës së tij në Gjermaninë Perëndimore, po përgatitet për të bërë kompromise të reja me revanshistët e Bonit, në dëm të interesave jetike të Republikës Demokratike Gjermane. Ndërsa të gjithë popujt e botës u ngritën në këmbë dhe dënuan me urrejtje e me vendosmëri aktet e reja agresive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës kundër Republikës Demokratike të Vietnamit, N. Hrushovi, për të mos e prishur me ame-

rikanët, me gjysmëzëri, mezi mundi të shprehë keqardhjen, me dy fjalë të zbehta, për ngjarjet e Tonkinit, në një kohë kur një vend vëlla socialist ndodhej dhe ndodhet akoma përpara një rreziku të madh.

N. Hrushovi jo vetëm që ka hequr dorë vetë nga lufta kundër imperializmit, por përpiqet me gjithfarë mënyrash të ndalojë edhe popujt e tjerë të bëjnë revolucionin dhe të luftojnë kundër imperializmit, përpiqet të frenojë dhe të mbytë lëvizjen çlirimtare botërore. Ai përhap gjithfarë iluzionesh pacifiste për imperializmin dhe krerët e tij, i këshillon popujt të rrinë urtë, të mos e zemërojnë imperializmin, t'i nënshtrohen imperializmit, sepse, sipas tij, «nga çdo shkëndijë mund të shpërthejë një zjarr botëror», i kërcënon dhe i frikëson ata me tmerret e luftës atomike, predikon paqen me çdo kusht e me çdo çmim. Ai ka arritur deri atje sa të propozojë krijimin e forcave policore ndërkombëtare në kuadrin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të bëhet kështu xhandar ndërkombëtar, bashkë me imperializmin amerikan, për të shtypur çdo lëvizje çlirimtare e revolucionare të popujve në botë.

Jo më kot imperialistët amerikanë, krerët e djathtë socialdemokratë dhe reaksionarët e të gjitha ngjyrave u thurin lëvdata pa kursim personalitetit të Hrushovit, politikës së tij, qëndrimeve të tij. Ata e quajnë atë një «politikan të madh realist, me të cilin mund të merresh vesh lehtë», «njeriun më të përshtatshëm në Moskë për Perëndimin», «kryeministrin sovjetik që vepron si politikan amerikan», «njeriun që po e fut botën komuniste në rrugën e një transformimi dhe evolucioni të madh» etj., etj. Ata kanë vënë te N. Hrushovi e grupi

i tij shpresa të mëdha, prandaj edhe i dalin përpara kursit të tij dhe i japin atij mbështetje e përkrahje, për ta tërhequr gjithnjë e më shumë në rrugën e tradhtisë, ku ai është futur prej kohësh. Ata flasin hapur se «nuk duhet ta lënë t'u shpëtojë nga duart ky okazion i madh», se «gjer në njëfarë shkalle SHBA duhet t'ia lehtësojnë detyrën Hrushovit» etj., etj.

Historia nuk njihet asnjë rast kaq tipik që kërret e imperializmit, armiqtë e klasës, të kenë lavdëruar me kaq bujë, me kaq entuziazëm një udhëheqës të një partie komuniste si N. Hrushovin, të kenë shprehur kaq hapur aprovimin, gëzimin dhe shpresat e tyre lidhur me kursin e tij politik. Vetë ky fakt flet qartë se në dobi të kujt vepron N. Hrushovi, se kujt i shërbejnë pikëpamjet dhe veprimet e tij.

Të dashur shokë,

Përballë rrezikut të madh të revizionizmit hrushovian që kërcënon kampin socialist, lëvizjen komuniste ndërkombëtare, vetë Bashkimin Sovjetik, janë ngritur sot në luftë të vendosur dhe parimore partitë komuniste që qëndrojnë në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, gjithë komunistët revolucionarë të botës.

Dhe nuk mund të ngjiste ndryshe. Komunistët që i kanë kushtuar jetën e tyre çështjes së revolucionit e të socializmit nuk mund të mos ngriheshin e të mos ngrihen kundër kësaj tradhtie të madhe që po i bëhet klasës punëtore nga ana e revizionistëve modernë. Ne jemi plotësisht të bindur se kjo luftë do të marrë çdo

ditë përpjesëtime të mëdha dhe është pikërisht kjo luftë që do t'i shkaktojë disfatën e fundit revizionizmit.

Në këtë betejë të madhe historike midis marksizmit dhe revizionizmit, nga e cila varet e sotmja dhe e ardhmja e socializmit, një përgjegjësi dhe rol i madh bie mbi ju, të dashur shokë, anëtarë të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Pikërisht në udhëheqjen e partisë suaj ka bërë vend e keqja më e madhe, aty është qendra e revizionizmit të sotëm. Rrezikshmëria e madhe që paraqet sot revizionizmi për mbarë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, qëndron në faktin se ai është shfaqur në partinë më të vjetër e më me autoritet në botë, në partinë bolshevike, në partinë e Lenin-Stalinit, se ai ka prekur vendin e parë e më të fuqishëm socialist, Bashkimin Sovjetik.

Grupi i Hrushovit, duke spekuluar me autoritetin e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të shtetit sovjetik dhe duke përdorur pushtetin shtetëror me të gjitha mjetet kolosale që ai ka në dispozicion, po përpigjet të mashtrojë komunistët sovjetikë, t'u imponojë atyre kursin e tij, të çoroditë udhëheqjet e shumë partive dhe t'i fusë ato në llumin e oportunitizmit.

Në situatën e rëndë të krijuar nga tradhtia e N. Hrushovit ka ardhur koha që ju, komunistët sovjetikë, të kryeni detyrën tuaj të lartë revolucionare ndaj partisë, popullit e vendit tuaj të lavdishëm, si dhe ndaj komunistëve, proletarëve dhe popujve të të gjithë botës, të mos lejoni klikën tradhtare hrushoviane të luajë me fatet e socializmit e të komunizmit. Komunistët revolucionarë sovjetikë nuk janë prehur kurrë në traditat dhe në meritat e së kaluarës. Sot më tepër se kurrë:

kërkohet që këto tradita të ripërtërihen me të njëjtën frymë revolucionare, me të njëjtën vendosmëri e principialitet, që të mbrohet emri i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që të ngrihet lart flamuri i saj revolucionar i hedhur përtokë nga Hrushovi. Këtë e kërkojnë interesat jetike të Bashkimit Sovjetik, të kampit socialist, të lëvizjes revolucionare e çlirimtare të botës.

Ju jetoni dhe punoni në vendin ku sot për sot sundon koka e revizionizmit modern. Prandaj lufta juaj për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit ka një rëndësi vendimtare. S'ka dyshim se kjo luftë nuk është e lehtë. Ajo kërkon përpjekje të mëdha, kërkon guxim e vendosmëri, bile edhe sakrifica. Por komunistët sovjetikë, gjatë historisë së tyre të lavdishme, kanë dhënë prova të shumta heroizmi e vetëmohimi në emër të çështjes së madhe të klasës punëtore. Ata asnjëherë nuk janë trembur, nuk janë mbrapsur përpara armikut, edhe në kohërat më të vështira, duke kryer gjithnjë me lavdi detyrën e tyre.

Partia e Punës e Shqipërisë ju drejtohet juve, anëtarëve të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me këtë letër të hapur, sepse ne ju duam, sepse ne ju konsiderojmë si dje edhe sot shokë luftime. Orvatjet e grupit të Hrushovit, për të prishur miqësinë sovjeto-shqiptare, për të mbjellë armiqtë e përçarje midis popujve tanë, do të dështojnë. Ndjenjat e miqësisë e të vëllazërimit të Partisë e të popullit tonë ndaj partisë e popullit tuaj nuk janë shuar e nuk do të shuhën kurrë. Komunistët dhe populli shqiptar kanë qenë dhe janë miq përjetë të Bashkimit Sovjetik. Pavarësisht se në krye të Bashkimit Sovjetik sot qëndron një grup renegatësh,

Partia e Punës e Shqipërisë, Republika Popullore e Shqipërisë dhe populli shqiptar do ta mbrojnë kurdoherë Bashkimin Sovjetik, shtetin e parë socialist të krijuar nga Lenini i madh kundër të gjithë armiqve të tij të jashtëm e të brendshëm. Ne nuk kemi harruar e nuk do të harrojmë kurrë se ç'është Bashkimi Sovjetik për ne, nuk do të harrojmë kurrë ndihmën e tij internacionaliste për çlirimin e vendit dhe ndërtimin e socializmit.

Qëndrimi i Partisë së Punës të Shqipërisë, i popullit shqiptar, ka qenë dhe mbetet i qartë e i prerë: luftë parimore pa kompromis deri në fund për shpartallimin e grupit revizionist të Hrushovit; miqësi, besnikëri dhe solidaritet të plotë internacionalist vëllazëror me popujt e Bashkimit Sovjetik.

Partia jonë i përmbahet me besnikëri deklaratës së bërë më 7 nëntor 1961 në mbledhjen solemne me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë: «Partia dhe populli ynë, pavarësisht nga sulmet, shpifjet dhe veprimet armiqësore që janë drejtuar kundër tyre, ruajnë të paprekura në zemrat e tyre ndjenjat e pastra të miqësisë me popujt vëllazër të Bashkimit Sovjetik. Partia jonë na ka mësuar ta duam Bashkimin Sovjetik, atdheun e madh të Leninit e të Stalinit, si në kohë të mira, ashtu edhe në kohë të vështira»¹.

Të udhëhequr nga këto parime, nga këto ndjenja dhe nga kjo frymë, Partia e Punës e Shqipërisë ju drejt-

¹ Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 22, f. 169.

tohet juve me bindjen se komunistët sovjetikë do të dinë, në këto momente historike, të plotësojnë me dinjitet misionin e tyre revolucionar internacionalist, do të qëndrojnë në çdo stuhi bij të denjë të partisë së tyre, të rrugës dhe të historisë së saj heroike.

Sa komplete dhe luftëra janë kurdisur nga armiqtë e klasës, të partisë e të popullit sovjetik, kundër Bashkimit Sovjetik që nga Revolucioni i Tetorit! Por gjithnjë armiqtë janë shpartalluar. Çështja e socializmit, pushteti sovjetik, është mbrojtur me nder. Ju, bijtë e partisë bolshevike, nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit, dërrmuat intervencionin e fuqive imperialiste që u derdh si bishë për të mbytur revolucionin dhe triumfuat në luftën e përgjakshme civile kundër armiqve të tërbuar të klasës. Përkrah jush në ato ditë ishin me aksione luftarake, me mendje e me zemër komunistët, proletarët dhe gjithë revolucionarët e popujt e shtypur të botës. Ju, bijtë e partisë bolshevike, nën udhëheqjen e vazhduesit të madh të veprës së Leninit, J. V. Stalinit, luftuat me heroizëm të rrallë gjatë Luftës Patriotike dhe mposhtët trimërisht, në fushën e betejës, fashizmin gjerman, duke u bërë çlirimtarë të popujve të Evropës. Përsëri në këtë luftë të madhe ju kishit aleatë partitë komuniste e punëtore të botës, proletarët dhe gjithë popujt, mbarë njerëzimin përparimtar.

Sot kundër partisë suaj, kundër Bashkimit Sovjetik përsëri po turret një rrezik i madh. Ata i kërcënon ngà brenda e nga jashtë komploti që po kurdisin së bashku imperialistët me revizionistët modernë. Ky komplot, që po bëhet në kondita paqësore, është në fakt shumë më i rrezikshëm për fatet e socializmit në Bash-

kimin Sovjetik, për gjithë lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, për fatet e revolucionit në përgjithësi. Në krye të këtij komploti janë krerët e imperializmit amerikan e të reaksionit botëror dhe klika e Hrushovit. Kauza e socializmit dhe e Revolucionit të Tetorit, së cilës ju i keni kushtuar jetën tuaj, ju bën thirrje përsëri që të mposhtni komplotin e madh kundërrevolucionar, që po ju kanoset, me të njëjtin heroizëm dhe frymë revolucionare që ka karakterizuar gjithë jetën tuaj prej militantësh leninistë. Ashtu si dje, edhe sot, në këtë luftë të drejtë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik, ju nuk jeni vetëm. Përkrah jush janë partitë komuniste e punëtore marksiste-leniniste, janë gjithë komunistët revolucionarë, gjithë proletarët e popujt e botës, që përbëjnë një forcë shumë më të madhe nga përkrahësit dhe aleatët që keni pasur në betejat kundër armiqve të klasës, armiqve të Bashkimit Sovjetik në të kaluarën.

Partia e Punës e Shqipërisë, që nuk e ka zakon të flasë prapa gardhit, por sheshit dhe sinqerisht, deklaroi me zemër të pastër e me vendosmëri se ajo është me ju. Ne e konsiderojmë si një detyrë të lartë internacionaliste luftën që duhet zhvilluar kundër komplotit revizionist-imperialist për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik, vendit të parë të socializmit. Dhe Bashkimi Sovjetik nuk mbrohet duke thënë «ne jemi me Bashkimin Sovjetik, qoftë edhe në rrugë të gabuar». Kështu mendojnë vetëm tradhtarët. Kështu nuk mbrohet Bashkimi Sovjetik. Kështu mbrohet vetëm tradhtia. Ne nuk duam një

Bashkim Sovjetik ku të sundojnë tradhtarët revizionistë, nuk duam që të shikojmë se si revizionistët po u vënë kazmën fitoreve të Revolucionit të Tetorit dhe po e shtyjnë vendin në aleanca me imperializmin për restaurimin e kapitalizmit në tokën e atdheut të vaditur me gjakun e bijve më të mirë të partisë, të klasës punëtore, të popullit sovjetik. Ne duam ta shikojmë Bashkimin Sovjetik ashtu si dje, sot, nesër e gjithmonë kështjellë të fuqishme të kauzës së socializmit e të komunizmit, të revolucionit e të lirisë së popujve, të paqes në botë.

Ne, komunistët shqiptarë, gjithë punonjësit e patriotët e Shqipërisë socialiste, pavarësisht se të paktë në numër dhe të gjendur vazhdimisht nën sulmet e egra të imperialistëve e të revizionistëve, po luftojmë e do të luftojmë me vendosmëri e pa përkulje deri në fund për të mbrojtur çështjen e madhe të përbashkët, marksizëm-leninizmin, për të mbrojtur Bashkimin Sovjetik. Në këtë luftë ne kemi marrë dhe marrim të gjitha përgjegjësitë që na takojnë dhe mendojmë se është koha që të gjithë komunistët dhe revolucionarët e vërtetë, të gjithë ata për të cilët është e shtrenjtë kauza e marksizëm-leninizmit, e socializmit dhe e revolucionit, duhet të marrin në këtë situatë me guxim përgjegjësi të plotë.

Ne shprehim edhe një herë bindjen tonë të plotë dhe besimin e patundur se shokët tanë, komunistët e partisë së lavdishme të Leninit e Stalinit, ashtu siç kanë qenë dje shembull i madh frymëzimi për të gjithë komunistët dhe popujt e botës, do të dinë që edhe sot

të kryejnë me ndërgjegje të lartë revolucionare detyrat me përgjegjësi që u ngarkon historia.

Për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e socializmit e të komunizmit, për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik, nën flamurin e madh të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, komunistët sovjetikë do të bashkojnë përpjekjet e tyre, luftën e tyre të fuqishme, me ato të të gjithë komunistëve dhe proletarëve të të gjitha vendeve, për demaskimin dhe për shpartallimin e plotë të revizionizmit modern dhe të imperializmit.

Komiteti Qendror i Partisë
të Punës të Shqipërisë
Sekretari i Parë

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 239 (5021), 6 tetor 1964

Botohet sipas librit: «E vërteta marksiste-leniniste do të triumfojë mbi revizionizmin», vëll. IV, f. 14. Tiranë, 1965

AQ SA DETYRA DHE TË DREJTA KA PËR BURRAT, AQ KA EDHE PËR GRATË

Bisedë me një delegacion të grave kineze

10 tetor 1964

Përfaqësueset e grave të RP të Kinës u pritën në mënyrë të përzemërt. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha:

Jam i gëzuar që takohem sot me ju, përfaqësueset e grave kineze. Nga takimet me njëri-tjetrin ne mësojmë, njihemi më shumë dhe forcojmë miqësinë për të cilën kanë nevojë popujt. Nuk ka rëndësi nëse një popull është i madh ose i vogël, rëndësi ka miqësia internacionaliste e parë në prizmin e marksizëm-leninizmit. Gratë tona e pritën me gëzim ardhjen tuaj, ashtu sikundër e pritën edhe gratë kineze delegacionin e grave shqiptare që ishte para disa muajsh në Kinë.

Ju thatë se, megjithëqë jeni akoma në fillim të vizitave, keni përshtypje shumë të mira nga vendi ynë, keni përfituar shumë; keni qenë në Durrës, në Vlorë, në Fier dhe në Shkodër; në Fier dhe në Durrës vizi-

tuat dy kooperativa bujqësore, kurse në Shkodër shkua-
at edhe në zonën kufitare. Besoj se që atje patë edhe
jugosllavët. Siç thoni ju kinezët, revizionistët jugoslla-
vë janë djaj, por ama janë djaj të mëdhenj, jo të ve-
gjël, sepse janë një grupim i rëndësishëm i revizioniz-
mit modern, grupim ky që ka prapa imperializmin ame-
rikan. Imperializmi amerikan flet për socializmin me
gërmazin e Titos. Grupimi titist është po aq i rrezik-
shëm sa edhe grupimi tjetër revizionist, me Hrushovin
në krye, në mos më i rrezikshëm.

Në Jugosllavi nuk ka kooperativa bujqësore, kur-
se në vendin tonë kooperativat bujqësore jo vetëm ek-
zistojnë, por forcohen e përparojnë vazhdimisht. Siç
e thatë edhe ju, këtë realitet e patë vetë, sepse vizituar
kooperativa bujqësore dhe disa familje kooperativis-
tësh.

*Pasi përfaqësueset e grave kineze folën për pritjen
e ngrohtë që u është bërë kudo që shkuan, për për-
fitimet e mëdha nga takimet me gratë dhe për suk-
seset që janë arritur në Shqipëri, e mori fjalën shoku
Enver Hoxha, i cili, midis të tjerave, tha:*

Në vendin tonë janë bërë përparime të mëdha në
industri, në bujqësi, në arsim e në kulturë, sepse Par-
tia jonë udhëhiqet nga parimet e marksizëm-leninizmit.
Kush e nënvleftëson marksizëm-leninizmin, jo vetëm
bën gabim, por një mëngjes do të gjendet me gisht në
gojë. Marksizëm-leninizmin e nënvleftësojnë revizionis-
tët modernë, por këta, nën çdo maskë që të fshihen, do
të pësojnë disfatë nga marksizëm-leninizmi. Ky është
ligj. Forca jonë qëndron te marksizëm-leninizmi, pa-
rimet e të cilit nuk mund të ndryshohen. Mund të bëj-

në sa të duan përpjekje e dallavere, të përdorin njëqind taktika, si imperialistët e ndryshëm, ashtu dhe Titoja e Hrushovi, por forcën e marksizëm-leninizmit nuk kanë për ta mposhtur. Marksizëm-leninizmi vepron nëpërmjet partive marksiste-leniniste, nëpërmjet grupeve marksiste-leniniste, që po zhvillohen në të gjitha kontinentet, vepron brenda në radhët e partive revizioniste dhe në të gjithë botën, në mënyrë të heshtur ose të hapur, vepron edhe nëpërmjet aksioneve të njerëzve përparimtarë. Prandaj, forca e marksizëm-leninizmit, e përfaqësuar në një mënyrë të tillë, nuk mund të rrëzohet nga kushdo qoftë.

Marksizëm-leninizmi jo vetëm shtyn përpara forcat e mëdha të popujve, por njëkohësisht shkatërron imperializmin dhe revizionizmin. Më parë borgjezia dhe imperializmi ishin të fortë, në kulmin e fuqisë së tyre, por tani ata po zbrapsen, sepse në gjirin e tyre ekziston një forcë e madhe, që rritet dhe po i bren nga brenda. Kjo është klasa punëtore dhe fshatarësia revolucionare. Kjo forcë bëhet e pamposhtur, fitimtare, se udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi.

Bashkimi Sovjetik, pas Revolucionit të Tetorit, u bë një forcë kolosale e marksizëm-leninizmit, por tani atij i ka hipur në zverk revizionizmi, i cili përpiqet të shkatërrojë atdheun e madh të Leninit dhe të Stalinit, ta bëjë atë një shtet borgjez. Kjo ndodhi sepse atje marksistë-leninistët i kishte zënë gjumi. Por kjo nuk do të thotë se ata do të flenë përjetë. Nuk mund të mos dalin forca të mëdha revolucionare në Bashkimin Sovjetik për të mposhtur revizionizmin. Këto forca do të zgjohen, do të dalin dhe do t'i godasin për vdekje armiqtë

revizionistë. Në këtë rrugë ata kanë mbështetje të partitë që qëndrojnë në pozita marksiste-leniniste.

Sukseset e arritura vërtet janë të shumta, por Partia jonë e kupton se përpara ka një rrugë të gjatë për të bërë, pasi akoma nuk e kemi fituar davanë, siç themi ne. Ndërtimi i socializmit dhe çuarja gjer në fund e revolucionit arrihen me punë dhe me luftë të pandërprerë. Ne e zhvillojmë dhe do ta zhvillojmë këtë luftë në dy fronte, si kundër imperializmit, ashtu dhe kundër revizionizmit modern. Por që kjo luftë të zhvillohet me sukses, në radhë të parë, ne duhet të jemi të fortë brenda. Prandaj Partia jonë lufton të forcojë radhët e veta, të forcojë ekonominë, ushtrinë, kulturën, të ngrejë nivelin arsimor, kulturor e profesional të punonjësve, të burrave e të grave, të ngrejë nivelin e tyre politik dhe ideologjik me qëllim që të mundim më shpejt dhe më me sukses të ndërtojmë socializmin e të mposhtim imperializmin dhe revizionizmin.

Komiteti Qendror i Partisë sonë i ka vënë rëndësi të madhe çështjes së gruas, sepse ajo në jetën e shoqërisë luan një rol vendimtar. Natyrisht, Partia jonë çështjen e gruas nuk mund ta shihte me syrin e ideologjisë borgjeze, sikurse e ka parë borgjezia prusiane, sipas së cilës «detyra e gruas është të lindë fëmijë, të vejë në kishë dhe të punojë në kuzhinë». Këto janë qëllimet e kapitalizmit ndaj gruas. Kurse marksizëm-leninizmi ka të tjera qëllime ndaj kësaj force të madhe të shoqërisë. Aq sa detyra dhe të drejta ka për burrat, aq ka edhe për gratë. Marksizmi e vë gruan në një barazi të plotë me burrin, bile në një barazi me fave më të shumta. Partia jonë e inkurajon shumë gru-

an, sepse kjo ka në supet e saj një të kaluar të rëndë, jo vetëm nga pikëpamja fizike, por edhe nga pikëpamja politike e kulturore. Përveç detyrave që i ka të njëjta si edhe burrat, gruaja ka edhe funksione të shenjta natyrore dhe të mundimshme për t'i kryer.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto, Partia jonë, qysh në krijimin e saj dhe vazhdimisht, i ka dhënë dhe i jep gruas një përkrahje të shumanshme, të vazhdueshme, konsekuente. Ajo ka një platformë të qartë politike dhe ideologjike për të drejtat e gruas në jetë, në punë, ashtu si edhe për burrat. Natyrisht, realizimi i këtyre të drejtave është një luftë e madhe që ka ndër-marrë Partia dhe ne kemi suksese të shumta në këtë drejtim. Partia jonë ka ecur dhe ecën kurdoherë në bazë të mësimëve të Leninit dhe të Stalinit, sipas të cilave pa gruan nuk ka socializëm. Kjo është absolutisht kështu. Bile, po të shihet thellë, në qoftë se nuk i vihet rëndësi çështjes së gruas, mund të ngjasin katastrofa, të cilat, siç thotë Lenini, duhet të evitohen. Gruaja është një nga faktorët vendimtarë për ndërtimin e socializmit. Prandaj ne ndjekim me kujdes të jashtëzakonshëm çështjen e gruas dhe kemi krijuar prej kohësh organizatën e BGSH, që është një nga levat e rëndësishme në duart e Partisë.

Puna e çliroi njeriun, puna çliron edhe gruan. Gjatë tërë historisë së njerëzimit gratë asnjëherë nuk kanë qëndruar pa punë. Nuk flas për gratë e bejlerëve dhe të kapitalistëve, të mbretërve apo të imperatorëve, por për gratë e popullit. Këto, gjatë shekujve, kanë punuar dhe janë robëtuar kurdoherë. Partia jonë i ka dhënë gruas mundësinë të punojë dhe të krijojë të mira për

shoqërinë, për veten e familjen. Kjo është bërë e mundur sepse Partia i ka hequr punës së vjetër, shfrytëzuese e skllavëruese për gratë, jo vetëm frymën, por edhe metodën e përdorur nga borgjezia, nga kisha, nga xhamia dhe e ka shndërruar atë në punë për vete dhe për shoqërinë, nëpërmjet së cilës edhe gratë prodhojnë, krijojnë dhe pasurojnë e zbukurojnë botën e tyre shpirtërore. Që të arrihej kjo, Partia jonë, si një parti marksiste, ka pasur kurdoherë në plan të parë detyrën: t'i japë gruas kulturë, kulturë të përgjithshme dhe kulturë praktike në punë, t'i ngrejë asaj personalitetin, të zhdukë te njerëzit, veçanërisht te burrat, idenë e superioritetit apo të sunduesit mbi gruan, të krijojë idenë e barazisë, të shokut të luftës dhe të jetës.

Me këto nuk dua të them se e kemi arritur plotësisht qëllimin tonë, sepse kemi akoma shumë për të bërë. Siç na mëson marksizëm-leninizmi, në ndërgjegjen e njerëzve trashëgohen mbeturina të vjetra, që na zënë këmbët si ferrat, të cilat duhet t'i shkullim nga rrënjët. Ne bëjmë të gjitha përpjekjet që gruaja të ngrihet politikisht dhe ideologjikisht, t'i kuptojë mirë problemet, se kështu do të luftojë për çështjen e Partisë dhe do të edukojë drejt brezin e ardhshëm për ndërtimin e socializmit e të komunizmit. Dhe gruaja luan një rol të madh në këtë drejtim. Po të mos e kuptojë gruaja këtë, brezi i ri nuk do të rritet si duhet. Sa më vonë ta kuptojë gruaja detyrën e madhe të edukimit të vetes dhe të brezit të ri, aq më vonë ndërtohen socializmi dhe komunizmi.

Partia jonë ka theksuar kurdoherë që çështja e gruas të mos shihet në mënyrë formale, si një slogan

ose parullë. Në qoftë se ky problem merret formalisht dhe mbetet si një parullë, nuk do të kemi rezultate, por në qoftë se luftohet që kjo vijë e drejtë marksiste-leniniste të zbatohet në jetë, atëherë rezultatet do të jenë të mëdha.

Gruaja jonë e shikon me gëzim luftën që bën Partia për emancipimin e saj të plotë, prandaj ajo e do me gjithë shpirt Partinë. Është një sukses i madh që gratë e vendit tonë e kuptojnë politikën e urtë të Partisë edhe në fushën e emancipimit të gruas. Ky është një nga ata faktorë që ka forcuar lidhjet e gruas shqiptare me Partinë. Prandaj ne kemi siguruar shumë suksese në ndërtimin socialist të vendit tonë në të gjitha fushat, kemi siguruar edhe edukimin e një brezi të ri të shëndoshë marksist-leninist.

Ne që jemi të thyer në moshë kemi kaluar shumë halle në jetë. Shoqet e reja tani gëzojnë jetën e lumtur dhe sa kalon e më të lumtur do ta kenë. Ne jemi krenarë që kemi kontribuar për lulëzimin e jetës së brezit të ri, i cili me siguri ka për ta bërë punën edhe më mirë se ne e do të luftojë edhe më shumë për socializmin dhe për komunizmin. Kështu do të ndodhë, sepse Partia jonë çdo vit forcohet dhe krijon të tilla mundësi që brezi i ri të bëjë mrekullira për popullin dhe vendin e vet. Ndonjëherë të rejat kanë për të na kritikuar ne, të vjetrit, jo për të keq, por do të thonë se «aq dinin, aq bënë». Por ne besojmë se lufta, që kemi bërë dhe po bëjmë për brezat e ardhshëm, nuk do të harrohet. Ne nuk dëshirojmë që shoqet e reja të bëjnë marshimin e gjatë të prindërve të tyre, por jemi të sigurt se, po të jetë nevoja, ato do ta bëjnë atë sipas tradi-

tave të lavdishme të prindërve të tyre. Me këto tradita brezi ynë i ri njihet çdo ditë, sepse Partia jonë ka punuar dhe punon që të rejave dhe të rinjve të vendit tonë t'u bëhen të njohura e kaluara, vuajtjet e hallet e popullit, t'u shpjegohet se socializmi është një gjë e bukur, por nuk ka rënë nga qiejt, se ai është ndërtuar mbi tokë nga njerëzit, është mbrujtur me gjakun dhe me djersën e njerëzve më të mirë, me përpjekjet e me sakrificat e mëdha të masave punonjëse.

Me gjithë sukseset e shumta që kemi arritur në të gjitha fushat e ndërtimit socialist, ne kemi akoma vështirësi të mëdha, kundër të cilave ne luftojmë çdo ditë dhe i kapërcejmë. Nuk ka gjë që s'kapërcehet nga një popull trim e punëtor që ka në udhëheqje një parti marksiste-leniniste. Ne kemi akoma mungesa edhe në drejtim të edukimit të punonjësve dhe të grave, prandaj na duhet të punojmë edhe më tepër. Por edhe nga ana ekonomike na duhet të bëjmë akoma më shumë përpjekje për të ngritur nivelin e jetesës së popullit. Detyra të mëdha na dalin edhe në fushën e mbrojtjes, prandaj përgatitemi rregullisht që të jemi kurdoherë të gatshëm, se ne, shqiptarët, kemi një fjalë të urtë që thotë: «Ujë të fle, hasmi s'fle».

Tani armiqve u kanë hyrë ethet për çështjen e bombës atomike. Por imperialistët dhe revizionistët nuk kanë ç'të bëjnë, monopolin e armës atomike ata nuk mund ta mbajnë dot për një kohë të gjatë. Ne e dimë se këtë monopol ata e mbajnë për të vrrarë popujt, për të na vrrarë ne, në radhë të parë. Pavarësisht se tani armën atomike e kanë në dorë armiqtë e ko-

munizmit, do të vijë me siguri dita kur këtë armë nuk do ta kenë vetëm ata.

Pastaj shoku Enver Hoxha pyeti shoqet e delegacionit të grave kineze për komunet popullore, për kulturat që mbillen në to dhe rendimentet që merren.

Pasi iu përgjigj pyetjeve, kryetarja e delegacionit të grave kineze foli për përshtypjet që patën gjatë vizitave nëpër vendin tonë dhe, pasi i uroi shokut Enver Hoxha shëndet të plotë, e falënderoi për pritjen shumë të ngrohtë dhe bisedën e përzemërt.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 27-të V—VIII

1964

- TË MBROJMË TË SOTMEN QË TË SIGUROJMË TË NESËRMEN — Shënime rreth veprimtarisë antimark-siste të grupit të Hrushovit (Qershor 1964) 1—5
- NE GJITHMONË E KËMI PARË ARTIN SI ARMË TË EFEKTSHME PËR EDUKIMIN E MASAVE — Nga biseda me delegacionin e dramaturgëve kinezë (5 qershor 1964) 6—13
- REVIZIONISTËT HRUSHOVIANË JANË PËR IZOLI-MIN E POPUJVE TË AZISË E TË AFRIKËS — Nga artikulli i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (11 qershor 1964) 14—22
- MËSIMET E PARTISË MBËSHTETEN NË TEORINË DHE NË PRAKTIKËN REVOLUCIONARE — Disku-tim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 qershor 1964) 23—27
- KUR SEMINARET PËRGATITEN MIRË, NDIHMOJ-NË NË ZGJIDHJEN E PROBLËMEVE — Disku-tim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 qershor 1964) 28—30

- NË KUSHTET E SOTME KA MUNDËSI TË ZHVILLOHET NJË PUNË MË E MIRË SHKENCORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 qershor 1964) 31—35
- EDUKIMI DUHET BËRË NË MËNYRË TË GJITHANSHME E TË VAZHUESHME DHE JO ME FUSHATA — Nga biseda me anëtarët e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës (18 qershor 1964) 36—45
- ZGJERIMI I NJOHURIVE BUJQËSORE NDIHMON SHUMË PËR RRITJEN E PRODHIMIT — Nga fjala para punonjësve të ndërmarrjes bujqësore «Perlat Rexhepi» në Shkodër (19 qershor 1964) 46—49
- KUADROT E MESËM JANË MBËSHTETJA E KUADRIT TË LARTË — Fjala para nxënësve e mësuesve të teknikumit veterinar dhe me kuadrot e Stacionit Qendror të Zooteknisë në Shkodër (19 qershor 1964) 50—56
- TË JEMI TË PËRGATITUR PËR TË PËRBALLUAR ÇDO AGRESION TË MUNDSHËM ARMIK — Nga fjala me drejtuesit e një nënreparti ushtarak në një fshat të Shkodrës (20 qershor 1964) 57—61
- SOCIALIZMI BAZOHET NË PUNËN E PËRBASHKËT — Fjala para kooperativistëve të Bërdicës të rrethit të Shkodrës (20 qershor 1964) 62—70
- KOMUNISTI ËSHTË I PARI NË SULM DHE I FUNDIT NË TËRHEQJE — Fjala në takimim me komunistët e organizatave-bazë të Partisë të Fabrikës së Cigareve, të SMT-së dhe të Fabrikës së Tisazhit në Shkodër me rastin e shpërndarjes së tesarave të reja të Partisë (20 qershor 1964) 71—84

- UDHËHEQJA E PARTISË NË RRETH T'I PËRGJIGJET NIVELIT TË KUADROVE — NDIHMA E SAJ TË JETË SA MË EFEKTIVE — Diskutim në byronë e Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës (21 qershor 1964) 85—97
- SKUADRAT E RENDIMENTIT TË LARTË T'I SHËRBEJNË NGRITJES SË MËTEJSHME TË BUJQËSISË NË PËRGJITHËSI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (29 qershor 1964) 98—103
- SHKURTIME NË SHPENZIME TË BËJMË, POR PA ULUR NIVELIN E JETESËS SË POPULLIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (1 korrik 1964) 104—107
- KUR POPULLI ZBATON NJË VIJË TË DREJTË, S'KA FORCË QË E LËKUND DHE E MPOSHT — Nga biseda me miq belgjianë të Shoqatës së Miqësisë Belgjikë-Shqipëri (6 korrik 1964) 108—117
- EDUKIMI I PUNONJËSVE ME MORALIN KOMUNIST ËSHTË PROBLEM KYÇ — Fjala e mbylljes në Plenumin e 13-të të KQ të PPSH (9 korrik 1964) 118—174
- PARTIA JONË ECËN SYPATREMBUR NËPËR VALËT E STUHITË E KOHËS DHE FITON — Fjala në Plenumin e 13-të të KQ të PPSH me rastin e shpërndarjes së tesarave të reja anëtarëve të Plenumit (9 korrik 1964) 175—178
- MARKSIZËM-LLENINIZMI I BËN NJERËZIT TË KENË KOKË TË KTHJELLËT DHE ZEMËR TË FORTË — Nga biseda me një komuniste australiane (10 korrik 1964) 179—191
- HRUSHOVIT NE NUK I FËRKOJMË KRAHËT, POR

- I THEMI POPULLIT SOVJETIK: JA KU E KE ARMIKUN! — Nga biseda me ambasadorin e ri të RD të Vietnamit (11 korrik 1964) 192—199
- TË SQAROJMË TË LËKUNDURIT, TË LUFTOJMË KUNDËR ATYRE QË JANË TË VENDOSUR NË RRUGËN E TRADHTISË — Bisedë me një shok marksist-leninist nga Austria (24 korrik 1964) 200—223
- NJERIU ËSHTË NJË «MAKINË» E KOMPLIKUAR DHE DELIKATE QË, PO TË MBAHET MIRË, JETON E PUNON GJATË — Nga biseda me një delegacion të shëndetësisë të RP të Kinës (4 gusht 1964) 224—226
- TË GJITHË MARKSISTË-LENINISTËT DUHET TË ZHVESHIN SHPATËN KUNDËR REVIZIONIZMIT MODERN — Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste (marksiste-leniniste) të Australisë (13 gusht 1964) 229—245
- TA BËJMË POGRADECIN NJË MARGARITAR TË VENDIT TONË — Fjala para popullit të Mokrës në mitingun e organizuar me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të rrethit të Pogradecit (30 gusht 1964) 246—256
- JETËN E PARTISË TA SHOHIM NË DINAMIZMIN E SAJ — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1964) 257—264
- T'I BËJMË STUDENTËT TË NDËRGJEGJSHËM PËRSE MËSOJNË DHE SI TË MËSOJNË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1964) 265—274
- NUK DUHET TË LAKMOJMË PËR NUMRIN E DISKUTIMEVE, PO PËR CILËSINË E TYRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1964) 275—277

SIGURIMI I UJIT ËSHTË NJË PROBLEM I MADH JETIK PËR POPULLIN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1964)	278—280
ADMINISTRIMI I MIRË I DRITHIT KA RËNDËSI TË MADHE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 shtator 1964)	281—284
REVIZIONIZMI MERR FORMA TË NDRYSHME — TË LUFTOJMË ME VENDOSMËRI KUNDËR TYRE (shënime) (15 shtator 1964)	285—300
TË MËSOHET MË MIRË GJUHA E HUAJ NË SHKO- LLA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (16 shtator 1964)	301—303
TË AKTIVIZOHEN DISA GRUPE NJERËZISH PËR TË NDJEKUR PROBLEMET NË KOOPERATIVAT BUJQËSORE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Po- litike të KQ të PPSH (16 shtator 1964)	304—307
NE SHQIPTARËT THEMI: ATIJ QË LUFTON MARK- SIZËM-LENINIZMIN, BJERI KOKËS! — Nga biseda me ambasadorin e ri të RP të Kinës (18 shtator 1964)	308—318
TË JEMI VAZHDIMISHT NË SULM KUNDËR RE- VIZIONIZMIT (shënime) (21 shtator 1964)	319—329
AFRIMI I N. HRUSHOVIT ME BONIN INKURAJON SYNIMET AGRESIVE TË MILITARIZMIT GJER- MAN — Artikulli i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (23 shtator 1964)	330—343
TË SHTOJMË DHE TË EKONOMIZOJMË MË SHU- MË PYJET DHE LËNDËT DJEGËSE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (2 tetor 1964)	344—348

HISTORIA ËSHTË SHKENCË QË KËRKON TË PAS- QYROHEN DREJT NGJARJET — Diskutim në mble- dhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (2 tetor 1964)	349—352
LETËR E HAPUR ANËTARËVE TË PARTISË KO- MUNISTE TË BASHKIMIT SOVJETIK (5 tetor 1964)	353—391
AQ SA DETYRA DHE TË DREJTA KA PËR BU- RRAT, AQ KA EDHE PËR GRATË — Bisedë me një delegacion të grave kineze (10 tetor 1964)	392—400

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1978